



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 7, 8 DHE 11 KORRIK 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 07., 08. I 11. JULA 2016. GODINE**

**KORRIK - JUL
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
8. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
9. Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit,
10. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015,
11. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015,
12. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015,
13. Shqyrtimi i Propozimit për shpalljen e 5 Shtatorit - “Dita e Bamirësisë - Nëna Terezë”.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-109 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-071 o Budžetu Republike Kosova za 2016.godinu,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-100 o državnoj pomoći,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-079 o strateškim investicijama u Republici Kosovo,
7. Imenovanje člana Upravnog odbora Sudskom instituta Kosova,
8. Izbor jednog (1) člana Sudskog saveta Kosova,
9. Izbor zamenika direktora Regulatornog organa za vodne usluge,
10. Razmatranje Izveštaja Radio televizije Kosova za 2015. godinu,
11. Razmatranje Izveštaja Ureda regulatora za energiju za 2015. godinu,
12. Razmatranje Izveštaja Centralne izborne Komisije za 2015. godinu,
13. Razmatranje Predloga o proglašenju 5. Septembra - "Dan dobročinstva - Majka Tereza".

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kolegët deputetë, të cilët do të bëjnë betimin, do t'i presim derisa të vijnë, i kemi zotin Shukri Buja dhe Driton Çausi, deputetë të rinj.

Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Deputeti Nuredin Ibishi nuk qenka, ne e presim. Zoti Ymeri e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Faton Topalli.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Sistemi shëndetësor edhe në këto ditë është në qendër të një debati publik dhe politik që rezulton se nuk është në gjendjen që do të dëshironim të gjithë ne, por përkundrazi, pothuajse çdo ditë na paraqiten kronika të ndryshme në mediat elektronike dhe të shkruara për gjendjen jo të mirë dhe dukurive negative në institucionet shëndetësore.

Për mua ka qenë shqetësuese kur kam shoqëruar një kronikë të paraqitur në një nga televizionet tona, ku pacienti Xhafer Osmani ishte i shtrirë në Klinikën Infektive dhe për gjashtë ditë, pasi ishte kafshuar nga një gjarpër helmues, ishte prekëse kur nëna e tij, e shtyrë në moshë, e shikonte djalin e tij duke vuajtur dhe tërë trupin e mavijosur. Dhe, nga ana tjetër, vështirësitë dhe përpjekjet e ekipit mjekësor për të trajtuar dhe shëruar, por nuk i kishin mundësitë për shkak të mungesës së serumit specifik kundër kafshimit të gjarpërinjve.

Shtrohet pyetja si është e mundur që në Klinikën Infektive të mos gjendet ky lloj bari. A duhet neve së pari të na ndodhë diç që askush nuk e dëshiron, e pastaj të marrim masa e të veprojmë sikur në rastet tragjike në Prizren e Kolovicë.

Mos harroni se të gjithë jemi përgjegjës për mosveprim, sepse jemi bërë si spektator dhe vetëm shikojmë.

“Bota është një vend i rrezikshëm për të jetuar, jo për shkak të njerëzve që bëjnë gjëra të këqija, po për shkak të njerëzve që i shohin ata dhe nuk bëjnë asgjë”, thotë Albert Ajnshtajn.

Për rastin në fjalë duhet falënderuar gazetarët dhe televizionin, sepse tani Klinika Infektive është furnizuar me serumin specifik që përdoret kundër kafshimit të gjarprit, por jo në sasi të mjaftueshme, e besa edhe për raste të tjera ne duhet falënderuar gazetarët që po na i hapin sytë.

Qeveria e Kosovës dhe, në veçanti Ministria e Shëndetësisë, duhet të gjejë fonde për përshpejtimin e reformave në thelb të sistemit të shëndetësisë në përgjithësi, veçanërisht në funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore, e në të njëjtën kohë duhet të rritet transparenca dhe menaxhimi i përgjegjshëm i parasë publike.

Është koha e veprimit dhe e përgjegjësisë që ky sektor të nxirret një herë e përgjithmonë nga rruga e dukurive negative e skandaleve, korrupsionit dhe keqmenaxhimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara kolege e kolegë,

Më 31 mars të këtij viti ministri i Financave, zoti Abdullah Hoti, i ka dorëzuar Qeverisë dhe Kuvendit raportin e njësisë qendrore harmonizuese për sistemin e kontrollit të financave të brendshme.

Fjala është për një vlerësim të performansës të të gjitha organizatave buxhetore, duke filluar prej ministrive, komunave e deri tek institucionet e pavarura.

Ky raport ka kaluar në Komisionin përkatës dhe jam shumë i befasuar që sot nuk është sjellë në Kuvend dhe nuk është pjesë e diskutimit.

Nuk mund të mos e pranoj që jam i shqetësuar, madje i tmerruar, nga mungesa e kontrollit të brendshëm në të gjitha institucionet që shpenzojnë paratë publike.

Për tre minuta është vështirë për t'i thënë të gjitha dobësitë, të gjitha parregullsitë rreth kontrollit të brendshëm të financave publike, por dua të aktivizoj pullën e paralajmërimit të rrezikut, alarm, alarm, alarm në institucionet tona publike, nuk ka kontroll të financave të brendshme.

Me këtë alarm dua të sensibilizoj deputetët, qytetarët e Kosovës, pjesëtarët e shoqërisë civile dhe të ftoj ministrin Hoti, në veçanti, për të vepruar. 12% e institucioneve të Kosovës nuk i raportojnë fare ministrit Hoti për mënyrën se si i menaxhojnë financat publike.

34 deri 77% të organizatave buxhetore në Kosovë, pra duke filluar nga ministrinë, komunat e institucionet e pavarura, vlerësojnë se puna sa i përket kontrollit të brendshëm të financave nuk shkon mirë, që kemi jashtëzakonisht neglizhencë, që kemi probleme të mëdha, të cilat duhet të zgjidhen, duhet të adresohen.

Në të gjitha fushat për të cilat është bërë vlerësimi del se ka probleme të mëdha, pra nuk ka procedura të brendshme të punës, nuk ka përshkrim të detyrave të punës, nuk ka planifikim, nuk ka ndarje të përgjithësive, nuk ka trajtim të konfliktit të interesit, madje nuk ka procedura për raportimin e shkeljeve. Pra, shkelje ka, por nuk ka procedura për t'i raportuar ato.

Aty ku nuk ndahen përgjegjësitë, aty ku nuk janë të përshkruara vendet e punës, aty ka vetëm kaos, keqmenaxhim dhe, pse jo, edhe keqpërdorim.

Zoti Hoti, karshi disa institucioneve të tjera i kemi edhe pesë komuna me shumicë të popullsisë serbe, si Leposaviqi, Zubin-Potoku, Zveçani, Klllokoti dhe Mitrovica e Veriut, të cilat marrin para nga buxheti i Kosovës, por nuk iu përgjigjen as juve, as Qeverisë së Kosovës, as Auditorit të Përgjithshëm.

Te këto komuna, me apo pa “Zajednicën”, përfundon sovraniteti i Kosovës.

Kjo gjendje nuk është e re, ka qenë kështu edhe në vitin 2014, po prej ardhjes së koalicionit PDK-LDK në pushtet, gjendja jo vetëm që nuk është përmirësuar, por është përkeqësuar, d.m.th. diku për rreth 8% më e keqe se sa ka qenë më parë.

Pra, nuk kemi përmirësim, kemi përkeqësim. Zoti Hoti, ju jeni përgjegjësi kryesor për mbledhjen, planifikimin, shpërndarjen e financave publike, por edhe për kontrollin e shpenzimeve.

Zyrtarët tuaj thonë se mbretëron një kaos në organizim dhe planifikim. Ose merrni masa, organizoni dhe kryeni punët që ju takojnë, ose shkoni në shtëpi.

Në një ndërmarrje private sikur ju të kishit vepruar me financat private, siç veproni me financat publike, jo që do të mbeteshit pa punë, por do të shkonit qysh herët në shtëpi dhe do të largoheshit nga puna edhe për keqpërdorim të pozitës të cilën e mbani.

KRYETARI: Faleminderit!

Në bazë të radhitjes tani është nga LDK-ja Nuredini, nuk ka ardhur. Zoti Ibishi, a dëshironi ta merrni fjalën, sepse të kam thirrur edhe më herët, apo po pushon. Si të duash. Shpejtimi ose Vjosa, cili doni. Vjosa, fjala për ju.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Në fakt, çështja që do ta ngre sot ndoshta më shumë do të përshtatej si pyetje parlamentare, mirëpo për shkak se vetëm dje është bërë publike dhe nuk kishte kohë proceduralisht që të parashtrohet si pyetje, do ta ngre si çështje jashtë rendit të ditës, me shpresën që ministrat që janë prezentë, në veçanti ministri i Punëve të Brendshme, që ka qenë më parë edhe i Punëve të Jashtme, mund të japë kontributin e tij në sqarimin e kësaj çështjeje.

Dje jemi informuar sërish nga mediat që UNMIK-u ka lëshuar 36 urdhërarreste ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës. Zëdhënësi i UNMIK-ut në Kosovë, pra Zyra për informim në këtë mision, e ka konfirmuar këtë lajmë për mediat e Kosovës, duke thënë që të gjitha këto 36 urdhërarreste ndërkombëtare në emër të Kosovës janë të vlefshme nga Njësia ndërlidhëse e Interpolit që vepron në kuadër të UNMIK-ut.

Natyrisht që UNMIK-u nuk ka treguar për çfarë veprash penale bëhet fjalë, edhe pse kjo është pak e rëndësishme, sepse çështja që dua të ngre është fakti që UNMIK-u, së paku sipas tyre, po i ngre këto urdhërarreste ndërkombëtare me kërkesë të institucioneve vendëse për persona që janë

të vendosur jashtë Kosovës apo kanë ikur nga ligji për shkak të veprave penale që i kanë bërë në territorin e Kosovës. Këtu natyrisht që bëhet fjalë për qytetarët e Kosovës të të gjitha nacionaliteteve.

Është evidente që Kosova sot nuk është anëtare e Interpolit dhe shpresoj që ndoshta edhe mund të na sqarohen nga ministri se në çfarë faze jemi, a është aplikuar, a pritet të aplikohet dhe cilat janë gjasat për anëtarësim së shpejti dhe natyrisht nuk kemi as marrëdhënie kontraktuale me Europolin.

Megjithatë, përderisa ky Kuvend i Kosovës që nga viti 2008 miraton një mision të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, i cili quhet EULEX, dhe i cili, ndër të tjera, ka edhe të drejtë t'i lëshojë këtu urdhërarreste ndërkombëtare, sepse i është dhënë sipas Kushtetutës së Kosovës sovranitet në këtë fushë, pra i është deleguar sovranitet dhe i janë deleguar kompetenca, është e paqartë për mua për çfarë arsye, përderisa kemi prezencën e EULEX-it në Kosovë, që akoma UNMIK-u, pra një mision që edhe sipas mendimit të GJND-së kanë ndryshuar rrethanat dhe nuk mund ta kryejë punën e vet siç e ka pasur me Rezolutën 1244 pas vitit 2008, akoma ka kompetenca në fushën e lëshimit të urdhërarresteve ndërkombëtare dhe atë e bën, siç po thonë ata, në emër të Kosovës.

Unë mendoj që një ushtrim i një kompetence të tillë nga ana e UNMIK-ut e dëmton Republikën e Kosovës, përkundër bashkëpunimit simbolik që natyrisht duhet ta kemi me atë zyrë që akoma është në Kosovë sipas Rezolutës 1244, sepse siç dihet, edhe nga transkriptet e fjalimeve të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, edhe anëtarëve të tjerë, të cilët akoma nuk e kanë njohur Kosovën, një ushtrim i kompetencave nga ana e UNMIK-ut krijon huti te shtetet mosnjohëse, sidomos ato që janë gjeografikisht larg Kosovës dhe nuk kanë kontakte me ne, sepse Rusia dhe shtete të tjera që e përkrahin akoma Serbinë, vazhdimisht dëshirojnë ta krijojnë përshtypjen se UNMIK-u është ai që e administron Kosovën dhe se Republika e Kosovës nuk është shtet i pavarur se sovran.

Meqenëse një ushtrim i tillë i kompetencave apo përzierje e UNMIK-ut në çfarëdo kompetence, që është kompetencë sovrane e Republikës së Kosovës, qoftë në fushën e politikës së jashtme, qoftë në fushën e sigurisë, e dëmton pra Kosovën në rrafshin ndërkombëtar, do të ishte e rëndësishme që institucionet e Kosovës, edhe pse këtu po flasim natyrisht për prokurorinë dhe gjyqësinë, kërkesa të tilla t'i bëjnë vetëm në drejtim të EULEX-it deri në momentin kur Republika e Kosovës të bëhet anëtare e Interpolit dhe e Evropolit.

Në raportin që është përgatitur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe që është miratuar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, thuhet që UNMIK-u po ashtu po ndihmon në fasilitimin e dialogut.

Ish-ministri i Jashtëm e di shumë mirë sa përpjekja është bërë nga ana e Republikës së Kosovës që nga viti 2008 që çështja e dialogut Kosovë-Serbi të mos ketë lidhje me UNMIK-un, pra të kalojë nga niveli i Kombeve të Bashkuar në nivelin e Bashkimit Evropian dhe i tillë ka qenë, do të thotë që nga fillimi i tij në vitin 2011, mirëpo një raport i tillë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm tregon që UNMIK-u po tenton të rikthejë kompetenca edhe në fushën e fasilitimit të dialogut.

Pra, përderisa institucionet e Kosovës duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshme në këtë fushë, unë sërish mendoj që bashkëpunimi duhet të mbetet, sidomos në nivel simbolik, sepse ne nuk jemi vendi i vetëm që e kemi një zyrë të Kombeve të Bashkuara ka edhe shtete të tjera sovrane...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem, mos ua u ndal fjalën deputetëve!

VJOSA OSMANI: Do të thotë, vetëm më mbeti fjalja e fundit në gjysmë. Pra, gjithmonë duke pasur kujdes që ky bashkëpunim të mos ndërhyjë në kompetenca ekzekutive që u takojnë, qoftë institucioneve të Kosovës, qoftë kompetenca që institucionet e Kosovës dhe ky parlament i kanë kaluar tek EULEX-i, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi kemi shumë të lajmëruar për fjalë, unë do të mundohem të bëj radhitjen edhe në bazë të partive politike. Deputeti Nuredin Ibishi e ka fjalën, për arsye se e kam thirrur në fillim, pastaj shkojmë në bazë të atij cikli. Faleminderit!

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Në kuadër të planit të punës të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së për mbikëqyrjen e Ligjit të Policisë së Kosovës E ka realizuar vizitën zyrtare në veri të vendit, përkatësisht në Drejtorinë Rajonale në Stacionin Policor Veriu i Mitrovicës.

Gjatë kësaj vizite të Komisionit në veri, Komisioni nuk pati nevojë për një eskortë të veçantë sigurie, përveç një patrulle policore, e cila pati më tepër për detyrë të udhëtojë deri te Drejtoria Rajonale Stacioni Policor. Nuk u parashtrua kërkesa për përcjellje të veçantë të KFOR-it, as të Policisë të EULEX-it apo të OSBE-së. Pra, ishte një vizitë rutinore pune e anëtarëve të Komisionit Funkcional për Siguri të Kuvendit të Kosovës. Komisioni në këtë takim është pritur nga persona të autorizuar zyrtarë të Policisë së Kosovës, zoti Besim Hoti, zëvendës drejtor i Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës, dhe Zhelko Bojiq, shef i Planifikimit të Operacioneve për këtë rajon.

Fillimisht nga kryesuesi u theksua për qëllimin e vizitës së kryesuesit të komisionit dhe më pastaj edhe e anëtarët e komisionit parashtruan pyetje lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për Policinë e Kosovës, bashkëpunimi i Policisë me qytetarët dhe komunitetet, marrëdhëniet ndëretnike, gjendja e përgjithshme e sigurisë në rendin dhe qetësinë publike, lëvizja e lirë, trendët e kriminalitetit, regjistrimi i automjeteve, siguria dhe rregullimi i trafikut rrugor dhe çështje të tjera të sigurisë.

Veçuam gjendjen e bashkëpunimit të Policisë së Kosovës me gjykatat dhe prokuroritë, bashkëpunimin e organizatave ndërkombëtare të sigurisë me mision në Kosovë, çështjet dhe problematikat e veturave pa targa që qarkullojnë në këtë pjesë të vendit. Nga zëvendës drejtori Hoti dhe shefi i Operativës, zoti Bojiq, u përshkrua gjendja e sigurisë e qetë dhe stabile dhe

gjendja e mirë e rendit të qetësisë publike, statistikat me trend të kriminalitetit dhe shkeljeve tjera në rajon që janë nën mesataren në Republikën e Kosovës krahasuar me rajonet tjera, si dhe si sfidë është paraqitur çështja e funksionalizimit të plotë në stacionet policore, në disa vendbanime të komunitetit joshumicë në këtë pjesë dhe funksionalizimin eficient të mbarëvajtjes të këshillave për siguri e bashkëpunim në komuna dhe komunitete për siguri në lokalitete.

U cek mbarëvajtja e integritetit të pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme së Serbisë në Policinë e Kosovës si çështje me rëndësi të veçantë, ndërsa sa i përket problematikës dhe angazhimit të rregullt të Policisë, gjendjen e përshkruan sikur edhe në rajonet tjera dhe në stacionet policore të Kosovës.

Se si është gjendja në veriun e Kosovës ndërmjet perceptimit dhe realitetit të qytetarëve që jetojnë atje dhe atyre në pjesë të tjera të Kosovës kur ka të bëjë me realizimin e marrëveshjes së parë të parimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, të nënshkruar në Bruksel në prill të vitit 2013, shoqëruar në marrëveshje tjera nga gushti i vitit 2015, në veçanti kur ka të bëjë për Policinë e Kosovës me transformimin e mbrojtjes civile, funksionimin e sistemit të drejtësisë penale me prokuroritë dhe gjykata që ende nuk janë funksionalizuar dhe ato për momentin janë ende në një lokalitet tjetër, pra në Vushtrri, mbeten ende të paralizuar për këtë pjesë.

Mendoj se situata nuk mund të qëndrojë në status quo duke pritur që dikush të na i zgjidhë problemet tona, por duhet që ne t'i qasemi vetë me bashkëpunim të autoriteteve të pushteti vendor në nivel rajoni dhe komunash në veri, domosdoshmërisht të formimit dhe funksionalizimit të prokurorive e gjykatave, funksionalizimit të këshillave e komiteteve për siguri me ekipet vepruese, ngritjen e bashkëpunimit me qytetarët duke u ofruar siguri dhe lëvizje të gjitha komuniteteve shumicë dhe pakicë, ngritjen e nivelit të sigurisë, por edhe luftimit të kriminalitetit, në veçanti të kontrabandës, rregullimin e regjistrimit të automjeteve, sigurinë e trafikut e tjerë, si dhe vizitat në të gjitha nivelet e pushteteve atje, pra duke filluar nga Kuvendi, Qeveria, këshillat gjyqësore dhe Prokuroria dhe të mos kënaqemi me stereotipat nga e kaluara me caktimin e koordinatori për Veri apo me datashim të një zyre në këtë pjesë të vendit.

Në përfundim të këtij takimi nga zyrtarë policorë u kërkua një përkrahje më e madhe e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë penale për komunat veriore në aspektin e kushteve të punës, dëftimin e objekteve dhe institucioneve tjera të drejtësisë penale, por edhe qendra për mbajtje policore, që në vend që të jetë Mitrovica, është vetëm një në Leposaviq, dhe krijon problematikë në zbatimin e ligjit.

Në mbyllje të këtij takimi, anëtarët e komisionit u zotuan për përkrahje të vazhdueshme të punës policore duke i adresuar çështjet dhe shqetësimet e tyre tek autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Çështja që sot dua ta ngre është çështja e punëtorëve të “Sharr Sallonit” në Han të Elezit. “Sharr Sallonit” dikur gjigant i prodhimit të azbestit në Kosovë ka qenë një ndërmarrje shoqërore, e cila përveç profiteve financiare për punëtorët, ka qenë një promotor i zhvillimit të Hanit të Elezit dhe më gjerë. E njohur për prodhimin azbestit, kjo ndërmarrje i ka eksportuar prodhimet e veta të azbestit në gjithë kontinentin e globit.

Qindra punëtorë të kësaj ndërmarrjeje i janë nënshtruar rrezikut permanent gjatë prodhimit të azbestit, duke e thithur pluhurin e azbestit të njohur shkencërisht si shkaktar i kancerit në organet e frymëmarrjes. Kushtet e punës pa asnjë mjet mbrojtës kanë bërë që shumica e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje të jenë të diagnostifikuar me “azbestos kancer”.

Në këtë ndërmarrje mund të numërohen me gishta punëtorët, të cilët e presin moshën e pensionit në 65 vjet. Këta punëtorë kanë kosto të lartë të shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes së kancerit të marrë në vendin e punës. Duke qenë kështu, këta punëtorë kanë bërë kërkesa individuale gjatë procesit të likuidimit të kësaj ndërmarrjeje që gjatë likuidimit një pjesë e mjeteve financiare t’i dedikohet individualisht secilit punëtor për trajtimin e sëmundjes profesionale, të marrë në vendin e punës.

Asnjë kërkesë e punëtorëve e proceduar me kohë gjatë procesit të likuidimit nuk është aprovuar dhe si pasojë punëtorët kanë mbetur në mëshirën e xhepit të tyre të varfër. Deri më tash, si pasojë e sëmundjes profesionale kanë vdekur mbi 100, e shumë janë në prag të vdekjes si pasojë e azbestosës - kancerit, të fituar në vendin e punës në “Sharr Sallonit”. AKP-ja duhet që këta punëtorë me sëmundje profesionale, të fituar në vendin e punës, t’i trajtojë në mënyrë humane, që së paku t’ua sigurojë një trajtim apo fatkeqësisht një vdekje të dinjitetshme.

Punëtorët e “Sharr Sallonit” pajtohen se pagesat e plota nuk mund të bëhen për shkak se procedura e likuidimit ka përfunduar, mirëpo Agjencia Kosovare e Privatizimit, në përputhje me nenin 41, paragrafi 3 dhe 4, të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në ka të drejtë që të bëjë shpërndarjen apo pagesën e pjesëshme të pagesave për këta punëtorë. Me këtë akt, AKP-ja do ta plotësonte një standard human dhe ligjor për këta punëtorë të “Sharr Sallonit”, të mbetur në mëshirën e fatit. Ata janë prindërit tanë, këta mund të jenë edhe vëllezërit tanë dhe ne ua kemi borxh që t’ua realizojmë një të drejtë ligjore të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën, bëhet gati deputeti Rexhep Selimi.

SHPEJTIM BULLIQI: I respektuar, zoti kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Kosovës,

Deputetë të respektuar,

Ka kaluar një vit që kur për herë të parë ky Kuvend ka nisur diskutimet dhe dyshimet e bazuara që janë duke u bërë lëshime në demarkimin nga Komisioni Shtetëror për Demarkacionin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Për më tepër se një vit përpjekjeve dhe punë të pandalshme së bashku me disa kolegë të fushave tjera, si: juristë, gjeodetë, historianë, ekonomistë dhe njohës të

fushës së të drejtës ndërkombëtare, kemi punuar në mënyrë intensive për gjetjen, grumbullimin dhe prezantimin e fakteve të shumta në lidhje me vërtetësinë e kufirit Kosovë - Mali i Zi.

Gjer më tani, me apo pavetëdije, askush nga institucionet shtetërore dhe Komisionit për Demarkacion nuk i ka marrë në shqyrtim faktet tona. Kjo lë të kuptojë se pa marrë parasysh gjetjet e bëra, institucionet shtetërore e kanë marrë si punë të kryer demarkacioni e kufirit. Konsiderojmë se ky veprim, duke neglizhuar faktet e reja dhe të verifikuara, e ka sjellë situatën politike në një gjendje pa rrugëdalje duke u krijuar mundësi qarqeve të ndryshme për ndërhyrje dhe presion sistematik bashkë me kushtëzimet në rrugën drejt integriteteve evropiane.

Me bindje të plotë morale dhe profesionale konsiderojmë që po të ishin marrë parasysh faktet e reja dhe po të ishte shpenzuar energji në kooperimin e gjithë spektrit profesional, së bashku me atë të komisionit shtetëror, do të ishte gjetur zgjidhja e pranueshme. Duke i marrë parasysh të gjitha këto gjëra dhe bazuar në mjegullinën e krijuar viteve të fundit për procesin e demarkacionit kufirit Kosovë - Mali i Zi, si dhe pamundësinë e daljes nga kjo situatë, e shfrytëzoj rastin që ta lus kryetarin e Kuvendit, zotin Kadri Veseli, që ta shfrytëzojë autoritetin e tij dhe në ambientet e Kuvendit të Kosovës ta organizojë një takim ndërmjet Komisionit Shtetëror për Demarkacion dhe grupit të njerëzve të kësaj problematike në përbërje nga prof. dr. Zejnullah Gruda, prof. dr. Enver Hasani, prof. dr. Florim Isufi, profesor doktor Përparim Ahmeti dhe unë Shpejtim Bulliqi.

Këtë kërkesë e bëj duke marrë parasysh faktin që deri më sot Komisioni Shtetëror për Demarkacion në asnjë moment nuk ka pranuar që të dalë publikisht dhe ta trajtojë bashkërisht me ekspertët e kësaj fushe këtë problematikë dhe në njëfarë forme duke u fshehur gjithnjë dhe sot e kësaj dite nga Qeveria, ose pas Qeverisë, për arsye se Qeveria e Kosovës e ka marrë rolin e zëdhënësit të këtij Komisioni për Demarkacion deri në ditët e sotme.

Konsiderojmë se në këtë takim do të analizohen të gjitha faktet e deritanishme dhe do të gjendet solucioni i zgjedhjes së këtij problemi. Për vendin dhe formën e takimit le të vendosë kryetari i Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Sa për informacion, kam biseduar me kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe shumë shpejt në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të procedohet marrëveshja e demarkacionit dhe Qeveria e Republikës së Kosovës në fakt ka pritur që ta kemi një koordinim të përbashkët. Unë besoj shumë që edhe ata janë të gatshëm të futemi në një debat, një tryezë në fakt, jo debat parlamentar, një tryezë, para se të vijë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në qoftë se ju jeni të pajtimit.

Ajo çka do të ishte më kryesore për arsye të sensitivitetit të situatës, askush nuk dëshiron ta marrë iniciativën, dhe unë si kryetar i Kuvendit do ta ndërmerri vetëm në qoftë se ka kërkesë zyrtare me shkrim, për arsye se është çështje edhe e privilegjit, edhe e humbjes politike që të kemi diçka që të mos merret primati nga kryetari i Kuvendit vetvetiu. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse s'kam bërë hapa deri më tani. Deri më sot ne nuk kemi material zyrtar. Për gjithë atë situatë, kjo më tepër është për opinionin publik, e cila u zhvillua, ne nuk kemi material ende, se nuk janë krijuar kushtet që Qeveria e Republikës së Kosovës ta sjellë materialin.

Po mirë! Në momentin që vjen, besoj javën e ardhshme ditën e parë unë do ta shpërndajë te të gjithë 120 deputetët, siç e kam unë, dhe në të njëjtën kohë e marrim atë material dhe në qoftë se ka kërkesë zyrtare, le të jetë e protokolluar zyrtarisht. Ne e mbajmë tryezën në sallën alternative, thërrasim edhe nga shoqëria civile, që të kemi të paktën mundësi të flasim një herë njerëzisht rreth kësaj çështjeje, e cila është shumë me rëndësi.

Pa emocione dhe akuza për njëri-tjetrin. Tek e fundit, vendimmarrja do të jetë transparente dhe publike këtu në këtë sallë. Edhe një herë e ka fjalën zoti Bulliqi. Urdhëro, Profesor!

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti kryetar,

Me sa kuptuat, kërkesa ime është publike për ju drejtpërdrejt, që ta ndërmerrni iniciativën dhe ta bëni një organizim të tillë. Kjo do të ishte në dobi të të gjithë kolegëve deputetë të Kuvendit, për arsye se është krijuar një paqartësi e madhe dhe ata njerëz i ka zgjedhur kjo Qeveri e Kosovës. Ata njerëz nuk kanë nevojë të fshihen pas Qeverisë së Kosovës. Ata njerëz duhet të dalin para publikut, duhet të dalin para qytetarëve të Kosovës dhe t'u japin sqarime dhe varësisht nga kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës, por pse jo edhe të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, unë edhe një herë po ju përsëris: Kërkesa ime është kërkesë publike që ta përdorni autoritetin tuaj si kryetar i Kuvendit, meqë deri tash nuk kemi gjetur mirëkuptim në asnjë instancë shtetërore të Republikës së Kosovës. Përdoreni autoritetin tuaj për arsye se faktikisht ne jemi institucioni vendimmarrës. Prandaj, këta njerëz kanë përgjegjësi që të japin deklarata rreth punës që kanë bërë ose thënë më mirë rreht mospunës që e kanë bërë në këtë komision.

Prandaj, unë kërkoj nga ju edhe njëherë publikisht që t'ua bëni ftesën publike të gjithë njerëzve të involvuar, deputetëve të Kuvendit të Kosovës që shprehin interesimin për të marrë dhe për ta kuptuar procesin e punës të këtij komisioni dhe sigurisht ekspertët me të gjeturat e tyre të vijnë dhe t'i paraqesin publikisht, edhe para mjeteve të informimit, sepse ky komision nuk është sekret, nuk është i fshehur qysh është fshehur deri në ditët e sotme. Duhet të dalë para opinionit publik, duhet të dalë para qytetarëve të Kosovës, duhet të dalë edhe para qytetarëve të Rugovës atje dhe t'i sqarojë të gjitha të pabërat ose të bëmat që i ka bërë në këtë punë të tij për tre vjet me radhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne po e vazhdojmë seancën, për hir të asaj që të mos e keqpërdorim këtë pjesë në të cilën jemi. Unë, për korrektësi, në momentin që e marrim materialin do t'ua shpërndajmë 120 deputetëve, përfshirë edhe veten time, dhe në të njëjtën kohë do të procedoj. Do të mundohem t'i bëj thirrje tryezës, edhe në qoftë se ka ndonjë palë, janë edhe kolegët e opozitës këtu, keqkuptim, tryeza do të jetë pjesë e punës sonë në Kuvend.

Për korrektësi, sot, pa u futur në seancë, u kam bërë një shkresë të gjithë kryetarëve të komunave, që në të njëjtën kohë të na e sjellin materialin nga gjendja kadastrale. Po ashtu, edhe ai material do t'u... Vetëm pak, vetëm pak...! Unë kurrë nuk jam duke paragjykuar, ju merreni gardianë, kushdo që është. Profesori tha shumë mirë, a ka mundësi që ne të bisedojmë njerëzisht? Çfarë ju krijon juve privilegj më shumë sesa ne të tjerëve për të menduar për demarkacionin? A jeni ju gardianët? Na lejoni ta... e hajt shko merru me Hashim Thaçin president, pra!

Kërkoj falje, në qoftë se vazhdoni kështu, vetëm po e futni në qorrsoak për qëllime politike, se bash hiç nuk po ju intereson demarkacioni. Po, veç “Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Isa Mustafa...” dhe ju e keni “zbuluar” Kosovën, ju e keni “çliruar” Kosovën, ju do të jeni me Kosovën! Urdhëroni fjalën cili të doni prej juve, përdoren, por mundësisht, njerëzisht. Na leni mundësi të flasim edhe ne. Cili dëshiron të flasë? Urdhëro! Visar Ymeri e ka fjalën, kryetari i Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Siç e përmendi edhe deputeti Bulliqi shumë qartë edhe siç është përmendur disa herë nga ekspertë të fushës, nuk ka paqartësi për marrëveshjen për demarkacionin. Është shumë e qartë, që marrëveshja për demarkacionin dëmton Kosovën.

Kushdo që ka dashur ta kuptojë këtë, deri më tash ka pasur njëqindmijë raste për ta kuptuar këtë, qoftë në aspektin juridik, qoftë në aspektin e metodologjisë së përdorur, që ka qenë e gabuar, qoftë në aspektin gjeografik, të pasurive natyrore, që mbesin në atë pjesë, e kështu me radhë... Me dokumente, me harta dhe me të gjitha dokumentet tjera të rëndësishme, të nevojshme, për këtë çështje tashmë ekspertët kanë folur. Pra, këtu e kemi një numër të njerëzve, që nuk po duan ta kuptojnë të vërtetën, prandaj edhe debati për këtë që po e proklamoni ky demokraci i madh, që është vendosur në krye të Kuvendit, është debat i kotë, sepse flet me njerëzit të cilët tashmë e dinë që kanë bërë keq, por nuk duan ta pranojnë që kanë bërë keq. Pse? Sepse, kanë interes të drejtpërdrejtë për të mos e pranuar që kanë bërë keq.

Pra, këta e dëmtojnë Kosovën jo prej mosdijes, këta e dëmtojnë Kosovën për shkak të interesit personal për këtë çështje, sepse është shumë e qartë, kushdo që i ka lexuar dokumentet e ndryshme, raportet e ndryshme që janë bërë, vlerësimet nga ekspertë të ndryshëm, e kupton shumë lehtë se si dhe në çfarë mënyre është dëmtuar Republika e Kosovës me këtë marrëveshje për demarkacion.

Po këtu, natyrisht që kjo marrëveshje kurdoherë do të silllet në Kuvend dhe natyrisht, se është në dorë të deputetëve, që këtë marrëveshje të mos e pranojnë, pra të mos bëhen vegël e lojës së personave individualë, të cilët duan ta mbrojnë interesin e tyre në politike përmes dëmtimit të interesit të Republikës së Kosovës.

Cili është ai interes? Ju e dini, Kadri Veseli ka bërë çmos për ta quaj Hashim Thaçin në presidencë, sepse ia lëshonte vendin për tu bërë kryetari Partisë Demokratike, përndryshe s’kish shans për t’u bërë kryetar i Partisë Demokratike. Hashim Thaçi, i cili e ka nënshkruar këtë marrëveshje për demarkacion, tash po të rishikohet marrëveshja për demarkacion, natyrisht që vërtetohet se Hashim Thaçi me vetëdije të plotë ia ka falur 8 200 hektarë, së paku, Malit të Zi. Dhe, kështu pastaj qenia e tij në politikë, po qe besa edhe rreziku nga ndjekja penale, e bëjnë atë që bëjë çmos për ta ratifikuar këtë marrëveshje sa më shpejt, se sa më shpejt që të ratifikohet, kjo nuk mund të rishikohet dhe rrjedhimisht dëmi nuk konstatohet institucionalisht. Dhe, ky është interesi i Hashim Thaçit.

Unë nuk e kuptoj, pse Isa Mustafa vepron në këtë mënyrë dhe me këtë zell kaq të madh për ta mbrojtur interesin e Hashim Thaçit. Këtë ende s’kam mundur ta kuptoj, cili është interesi i Isa

Mustafës personalisht, i cili është vendosur në pozitën e kryeministrit të Kosovës e që e mbron kaq shumë Hashim Thaçin, rrjedhimisht edhe Kadri Veselin.

Prandaj, mendoj unë që ky është një rrjet, i cili është natyrisht një analizë sipërfaqësore, po pajtohem me ju, i cili e bën këtë marrëveshjen e demarkacionit kaq të vështirë për ta kuptuar këta persona të cilët tashmë e kanë kuptuar qartë, mendoj unë, se çfarë i kanë bërë këtij ven di. Pra, nuk ka këtu paqartësi, por në anën tjetër, nuk ka edhe mundësi që kjo marrëveshje të ratifikohet në mënyrë demokratike këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse unë e di se këtu ka shumë deputetë që ia duan të mirën Kosovës dhe të cilët nuk pranojnë të bëhen vegla të këtyre njerëzve, që e kanë uzurpuar pushtetin. Por, ama, kemi parë që ka edhe shumë deputetë, të cilëve në fund interesi personal po ua mund arsyen për interesin e përgjithshëm.

Pra, këtu marrëveshja për demarkacion mund të ratifikohet, vetëm po që se hapet prapë qesja, nëse jepen terminale, jepen poste për diplomatë, për ambasadorë dhe për përfitime të tjera financiare, për të cilat ende nuk janë vërtetuar. Por, kjo është mundësia për ta ratifikuar marrëveshjen për demarkacion.

Unë po ju them këtu edhe qytetarëve të Republikës, se në asnjë mënyrë dhe me asnjë kusht kjo marrëveshje për demarkacion, as nuk bën të ratifikohet e as nuk bën të silltet këtu në Kuvend, në formën në të cilën është. Zgjidhja është shumë e thjeshtë dhe shumë e lehtë. Marrëveshja duhet rishikuar dhe procesi duhet të fillojë nga zeroja. Vetëm kështu mund të sigurohemi, që në bazë të informatave dhe në bazë të vlerësimeve të ekspertëve kjo marrëveshje të mos e dëmtojë asnjërin prej palëve. Pra, nuk ka asnjë forcë politike në Republikën e Kosovës, që e kundërshton idenë e demarkimit të kufirit me Malin e Zi. Mirëpo, ky demarkim i kufirit nuk duhet ta cenojë interesin e asnjëres prej palëve, as të Kosovës, as të Malit të Zi.

Dhe, ta vendosim kufirin aty ku ka qenë përherë dhe në këtë mënyrë, natyrisht që të gjitha palët do të ndahen të kënaqura, kështu kjo marrëveshje për demarkacion është imponim i qartë për të na marrë territor dhe si imponim me të duhet të përballemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndoshta Visar për zbulues... krejt po i di. Edhe ti Albinit ia ke zënë vendin, por mos ta keqkuptoj... rotacion... demokracia... s'po dua ta keqpërdor foltoren, por nuk është mirë të paragjykoj, se s'e di qëndrimin tim ende për këtë çështje. Kërkoj falje, në qoftë se e kam keqpërdor... Urdhëro, fol përmes mikrofonit, se me gishta... jo, jo, jo, unë nuk e hapa këtë çështje, nuk e hapa këtë çështje, nuk e hapa këtë temë, jemi në tridhjetë minutat e pikave jashtë rendit të ditës dhe ishte një propozim konkret... po, tash ta jap menjëherë fjalën, sa herë të duash... ishte një propozim konkret, të cilin unë publikisht mu desh, pasi që mu përmend emri dhe më erdhi keq të dal atje, për hir të mendjemadhësisë, po unë dal atje me qejf më të madh, se sa të flas nga këtu, po urdhëro... po, kjo ishte çështje të cilën e hapi profesori Shpejtim Bulliqi, kjo ishte krejt çështja e cila është ende në këtë Kuvend. As ne si deputetë, s'kemi mundur të bisedojmë për këtë çështje. Krejt kjo ishte. Ti e the mendimin tënd, e zbulove pse e kemi bërë, po urdhëro fjalën prapë, mos ta keqpërdor foltoren, se unë s'kam çfarë flas rreth kësaj çështjeje. Do të flas, kur të kemi mundësi. Urdhëro!

VISAR YMERI: Në fakt, ti ke çfarë flet shumë, po t'i s'do të flasësh, këtu është problemi. Dhe e dyta, çfarë thash prej këtu e që nuk u dëgjua në mikrofon, është një fjali shumë e thjeshtë: Mos e

keqpërdor ulësen e kryetarit të Kuvendit, për t'i sulmuar deputetët. Nëse, do të ballafaqohesh, dil te foltorja dhe ballafaqohu me deputetë, përndryshe kryeje punën e kryesuesit të seancës.

KRYETARI: Faleminderit! Shiko, me respektin e madh, po dal. Profesor, eja këtu!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Ju përshëndes të gjithëve. Edhe sot, pasi është Dita e Bajramit, me fat Bajrami të gjithëve! Në qoftë se ka mundësi, nuk e hapa çështjen, e para.

Pjesa në të cilën, pasi që e tha edhe Profesori, dëshiroam të drejtohet është ajo, tash po u drejtohem më si deputet i republikës së Kosovës. Qe nëntë muaj nuk ka formë, në të cilën nuk u jemi nënshtruar dhe ti duhet me e ditë së bashku me të gjithë kolegët, që ne njerëzisht, si shqiptarë, si qytetarë të këtij vendi, kurrë më shumë se sa ne nuk jeni. Na lëni mundësinë, në qoftë se ka mundësi, të flasim për çështjet për të cilat jemi zgjedhur. Ju, keni parasysh si kolegë, nuk po leni as me bisedua, ju nuk e dini as cilin mendim e kemi, ju nuk e dini as çfarë vendimi do të marrim. Po na leni mundësi pak edhe njerëzit le të na dëgjojnë edhe pastaj vendimmarrja do të jetë transparente.

Ti s'mund ta imponosh asnjërin nga këta kolegë të nderuar deputetë, se si do ta marrë vendimin. Po është mirë në një moment të caktuar të na lejoni të flasim. Edhe një, ti së bashku me të gjithë kolegët, duhet ta dini që s'mund të na ndalni. As me zor s'mund të na ndalni. Mos na vëni në pozicion të rëndë. Na lëni të flasim njerëzisht, na lëni, se jemi zgjedhur sikurse ju. Kjo! Ndoshta, gabimi im ajo çfarë e fola, ishte ky. S'jeni ju... mund të jeni pak më shumë, por përafërsisht njëjtë. E kemi çliruar të gjithë Kosovën dhe besoj se të gjithë mendojmë mirë për Kosovën. Kjo ishte.

A ka mundësi që një herë në Kuvend të na lejoni të flasim lirshëm për çështjen e demarkacionit dhe asociacionit e të na dëgjojnë njerëzit se çfarë po mendojmë dhe në fund kemi për të vendosur. Ama, kjo me paragjykime, ti e zbulon edhe qëllimin jetësor, "pse më ka qitë baba e nëna, ti ke me ia nis me e zbulue"... Mos, se s'është korrekte. Kjo është! Kërkoj falje në qoftë se e keqpërdora, po na lërë mundësinë të flasim. Goxha do vjet i ke, ti dhe unë e kemi treguar veten se ku kemi qenë deri dje. S'ka nevojë me i zbulua sot, po kurrë s'është e djeshmja çka është e sotmja dhe e nesërmja. Çfarë do të bëjmë? Krejt kjo ishte. Kërkoj falje!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Kanë kaluar më tepër se 30 minuta, që janë për këtë. Kështu që, unë e di që është thirrur edhe emri i Rexhep Selimit. Them të jetë i fundit, sepse koha ka kaluar Rexhep. Kështu që, e ka fjalën deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë, Ashtu siç tema për të cilën u fol deri më tash, çështja e demarkacionit, probleme po aq të mëdha dhe më shumë të ndjeshme, ka Kosova prapë. Po vazhdon të jetë njëri ndër problemet në vazhdimësi, siç është problemi i krijuar nga keqqeverisja në Kosovë, siç është ai i veriut. Pra,

Kosova po kalon në situatë të rëndë e këtë e thellon edhe më shumë qasja që pushteti ka ndaj kësaj situatë.

Koalicioni PDK-LDK-Lista Serbe në bashkëveprim të koordinuar me njëri tjetrin po thellojnë ndarjen e Kosovës në veri e jug, duke ia shtruar shtratin “Zajednicës” së Serbisë në Kosovë.

Ashtu siç këta partnerë të koalicionit e kanë ndarë tortën e pushtetit këtu në Prishtinë, po ashtu e edhe më keq, e kanë ndarë Kosovën në dy pjesë, ku në njërin anë sundon mafia e pushtetit e në anën tjetër Serbia me banda kriminele. Atje nuk i vjen era shtet i Kosovës, atje nuk ekziston Republika e Kosovës, atje nuk ka FSK, madje as Policia e Kosovës nuk është Polici e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka hequr dorë nga ajo pjesë.

E në ndërkohë, atje po ndodhë sërish rikolonizimi i papenguar përmes ndërtimit të lagjeve me kolonë të rinj, po ndodhë serbizimi i historisë përmes përmendoreve të krahëve e carëve serbë atje. E ministrat e Qeverisë Mustafa marrin pjesë në zbulimin e shtatoreve të carit në Mitrovicë, presin shiritin e lagjes në “Luginën e Diellit” e shefi i tyre kryeministër, i dënon ashpër me një status në Facebook. Sikur kjo nuk mjafton, partnerë të koalicionit të PDK-së dhe LDK-së, ministrat e Qeverisë së Kosovës nga Lista serbe flasin në podiumet e këtyre inaugurimeve të projekteve të Serbisë në Kosovës, sikur dikur në Gazimestan.

E për ta dëshmuar edhe një herë, se këta vazhdojnë rrugën e Milosheviqit, themeluesi i kësaj liste Jablanoviq, shkoi deri në Kosharen historike për t’u thurur lavdi ushtarëve pushtues që vrisnin shqiptarë në luftën e Kosovës, duke vënë lule ku vranë barbarët. E Qeveria prapë hesht!

Zonja e zotërinj, kolegë të mazhorancës,

Ja, pra, kush janë partnerët tuaj të koalicionit. Ata nuk kanë ndryshuar nga vitet e 90-ta, ashtu siç Serbia mbetet Serbi për Kosovën dhe shqiptarët, e njëjta sikur në kohën e Milosheviqit.

Edhe atëherë Serbia ndërtonte përmendore të carëve dhe mbretërve kudo në Kosovë, siç po bën sot në Mitrovicë, Graçanicë, e gjetiu. Edhe atëherë Serbia ndërtonte lagje kolonësh, siç ka ndërtuar dikur në Lumëbardh, Junik e Baballoq, ashtu siç po bën sot me “Luginën e diellit”.

Edhe atëherë Serbia i kishte do Rrahman Morina e do Riza Sapunxhiu, e do Husamedin Azema, siç ka sot në krye të pushtetit në Kosovë, me të cilët po bashkëbisedon e bashkëvepron herë në Bruksel, e herë në Prishtinë.

Por, duke parë sot ku janë këto përmendore që dikush i ngrinte Milosheviqi, në Prizren, në Prishtinë, Gjilan e gjetiu? Ku janë ato lagje që ndërtoheshin dikur për ta populluar Kosovën me kolonë serbë? Dihet! Por, para së gjithash, ku janë ata që dikur thoshin se Kosova nuk po humb asgjë me suspendimin e autonomisë. Disa janë harruar, e disa kujtohen për të këqijat që i kanë bërë vendit, ashtu siç edhe këta që sot bashkëveprojnë e bashkëveprojnë me Serbinë për “Zajednicën” dhe për kthimin e saj në Kosovë, një ditë ose do t’u harrohet emri, ose do të kujtohen për të këqijat që po ia bëjnë vendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë të nderuar, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

1. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Në këtë seancë janë parashtruar 22 pyetje parlamentare.

Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

Kryeministri nuk është këtu. Nuk është as deputeti Topalli.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

Kryeministri s'është i pranishëm.

A doni ta bëni pyetjen, deputete? Urdhëroni! Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam një kërkesë nga ju personalisht, po edhe nga Kuvendi.

Pra, duke marrë parasysh se Isa Mustafa po ikën sa herë që deputetët i bëjnë pyetje, dhe duke marrë parasysh se me Rregulloren e Kuvendit, pas dy pyetjeve, pyetjet tona, në fakt, nuk po përsëriten, ndërkaq problemet po vazhdojnë të jetojnë bashkë me Isa Mustafën dhe këtu e kam fjalën për “Luginën e diellit”, Car Llazarin, moshapjen e urës, edhe pse marrëveshja e Editës e parashihte që e njëjta të hapet në qershor. Në momentin që ai të vijë në këtë sallë të Kuvendit dhe besoj që kjo do të ndodhë gjatë ditës, sepse kështu zakonisht po vepron, po vjen pas periudhës kur përfundon koha për pyetjet parlamentare, tej u kthehemi përsëri pyetjeve parlamentare, sepse kjo është e papranueshme. Ka muaj të tërë që i njëjti, sa herë ka tema të rëndësishme nuk vjen, nuk përgjigjet, injoron deputetët dhe vjen pas përfundimit të kësaj periudhe dhe e injoron krejtësisht Kuvendin.

Kemi ngritur shumë pyetje, sidomos në këtë fazë dhe kërkojmë që të vijë këtu, për ndryshe, nuk vazhdojmë me seancë ose në momentin kur vjen, i kthehemi pikës së pyetjeve parlamentare.

Kjo duhet të marrë fund, sepse me Kushtetutë e ka obligim t'u përgjigjet deputetëve dhe Kuvendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

Kurteshi, doni të parashtroni pyetjen?

ISMAJL KURTESHI: Po! Do ta lexoj pyetjen, sepse lajm do të jetë kur kryeministri do të jetë këtu. Mungesa e kryeministrit është diçka e zakonshme, nuk është lajm, dhe para se ta lexoj, do t'u drejtohem qytetarëve të Kosovës se kryeministri i Kosovës e refuzon kontrollin e Kuvendit mbi Qeverinë, u ikën përgjegjësisë dhe për këtë është përgjegjës para këtij Kuvendi dhe qytetarëve të Kosovës.

Zoti kryeministër,

433 ish-pjesëtarë të strukturave ilegale të Serbisë janë futur në sistemin e pagave nga janari i këtij viti, edhe pse nuk janë të punësuar.

Në anën tjetër, mësimdhënësve të pensionuar nuk po u jepen – nuk u paguhen 3 rrogat jubilarë që u takojnë me ligj, me arsyetim se nuk ka para.

Këtyre të fundit nuk po u pranohet as përvoja e punës e viteve të 90-ta, po ashtu, sipas jush, për mungesë të buxhetit, edhe pse dihet mirë kontributi i tyre gjatë atyre viteve.

Janë edhe disa kategori të tjera që kanë kontribuar shumë për këtë vend dhe që e meritojnë dhe u takon me ligj përkrahja materiale, por nuk po e gëzojnë për shkak të mungesës së mjeteve financiare, ose, sipas jush, të FMN-së.

Zoti kryeministër,

Në cilin ligj e keni bazuar vendimin tuaj për t'u dhënë paga atyre që nuk janë të punësuar?

Si e arsyetoni mospërbushjen e obligimeve ligjore ndaj kategorive që u përmendën më lart. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në bazë të Rregullores së Kuvendit, kryeministri e ka deleguar përgjigjen dhe do ta paraqesë ministrja Edita Tahiri! Urdhëroni!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Kurteshi, ju i keni dy pyetje dhe të dyja janë të lidhura me çështjen e Mbrojtjes Civile, e cila është shuar më 11 janar të këtij viti, pra si strukturë paralele ilegale.

Unë po jap një herë përgjigjen e pyetjes që e bëre tash, e pastaj edhe për atë tjetrën.

Pyetja juaj lidhet me atë se si u trajtuan kontributet e periudhës së luftës për liri, dhe, siç e dini, Qeveria e Republikës së Kosovës që nga paslufta është duke i adresuar këto çështje në emër të; e para, mirënjohjes edhe institucionale, por edhe të anës financiare, dhe disa kategori tashmë janë trajtuar e zgjidhur, siç është çështja e veteranëve të luftës çlirimtare, luftës së armatosur, besoj në të ardhmen do të jetë edhe zgjidhja e çështjes së veteranëve të luftës paqësore.

E dyta, çështja e kontributeve, sidomos njohja e përvojës së punës së mësimdhënësve, të cilët kanë vepruar në periudhën e okupimit, pra, si një shtyllë e rezistencës, edhe ajo është zgjidhur.

Ndërsa, ka një varg çështjesh të tjera, që ju i përmendni këtu me të drejtë. Mirëpo, çdo shtet i ri dhe çdo luftë për liri dhe pavarësi në periudhën e pasçlirimit në një periudhë të shkurtër nuk mund t'i zgjidhë të gjitha këto çështje.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i trajtojë sistematikisht dhe, siç e thatë edhe ju në pyetjen tuaj, janë edhe kufizimet buxhetore, por me rëndësi është që jo vetëm kjo Qeveri, por të

gjitha qeveritë e kanë pasur në agjendë çështjen edhe të mirënjohjes, por edhe të shpërblimeve adekuate për çështjen e kontributeve për sa i takon periudhës çlirimtare 1989-1999. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Zoti Kurteshi, keni pyetje shtesë? Deputeti Kurteshi e ka fjalën!

ISMAJL KURTESHI: Në fakt, kjo përgjigje nuk ishte përgjigje e pyetjes sime. Kjo ishte më tepër njëfarë përgjigje filozofike, një demagogji.

Pyetja ime konkrete, në të cilën dëshiroj të përgjigjet, është: Në cilin ligj e keni bazuar vendimin për t'u dhënë paga atyre që nuk punojnë, e në të vërtetë punojnë kundër Republikës së Kosovës?

Le ta përmendë ligjin, nenin, pikën. Në çka janë bazuar, sepse janë duke i dhënë paratë e taksapaguesve sikur t'i kenë të babës së vet! Të babës i ruajnë, por të taksapaguesve po i japin. Po u japin kriminelëve pa u punësuar, e njerëzve, siç janë mësimdhënësit që u takojnë 3 rroga, e që s'ua kanë dhënë kurrë, e as s'janë duke ua dhënë, nuk kanë para.

Prapë edhe një herë po them, në cilin ligj jeni bazuar që po u jepni rroga atyre që s'janë duke punuar?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, urdhëroni!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Kurteshi! Çështja e shtrirjes së sovranitetit në pjesën veriore të vendit tonë është një çështje që na shoqëron gjatë gjithë periudhës së pasluftës...

(Ndërhyrje - reagim)

Dhe, zoti Kurteshi, edhe ju keni qenë pjesë e politikës, edhe qeveritare, dhe shumë qeveri kanë provuar të bëjnë shtrirjen...

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Zoti Kurteshi, lejojeni të flasë! Nuk je ti i cili e cakton!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Po vazhdoj, por po më dhimbset! Ismajli, bre, ka qenë një demokrat përpara, e tash po më dhimbset. E kam njohur mirë, po edhe ju.

(Ndërhyrje)

Po, veç në shtëpi kështu, shko e hajde. Këtu jemi në Parlament, vendi më demokratik.

Pra, më lejo ta përfundoj. Natyrisht unë mund të flas edhe ti duke folur, por vërtet më komod është kur po flasim duke u respektuar.

Pra, në emër të forcimit të shtetit, shtrirjes së sovranitetit në veri të vendit, që s'e kemi pasur shumë vjet, ne kemi zhbërë dhe po zhbëjmë strukturat ilegale paralele të Serbisë në Kosovë dhe për këta njerëz, të cilët kanë punuar në këto struktura, së pari kemi aplikuar ligjin e amnistisë, siç e dini, dhe tani po i shtrijmë institucionet dhe këta njerëz po i punësojmë me ligj dhe në emër të Kushtetutës për qytetarët tanë në gjithë Kosovën, prandaj edhe po i integrojmë dhe riintegrojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju lus, edhe këtyre që do të flasin e do t'u përgjigjen, edhe deputetëve, ta keni parasysh se do ta zbatojmë Rregulloren strikt. Pyetja bëhet për 2 minuta, përgjigjja jepet për 3 minuta. Pyetja plotësuese 1 minutë dhe përgjigjja 2 minuta. Mos u hidhëroni pastaj, se na duhet kohë!

Vazhdojmë tutje! Salih Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Urdhëro, zoti Salihu!

SALIH SALIHU: Kryeministri nuk është këtu dhe në dy seanca nuk vjen, kështu që po e lexoj pyetjen.

Zoti kryeministër,

Vitin e kaluar një kompani private, duke e shkelur legjislacionin për doganat u ka ikur detyrimeve doganore. Konkretisht kemi të bëjmë me futjen e grurit, i cili në dokumente është shënuar si grurë për ushqimin e kafshëve, ndërsa Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka monitoruar këtë çështje, ndërsa rekomandimet janë miratuar edhe në Kuvend, që kryeministri Isa Mustafa të raportojë brenda 6 muajve për masat e ndërmarra dhe tashmë është bërë një vit nga 4 qershori i vitit të kaluar që është miratuar në Kuvend, dhe kryeministri nuk ka raportuar se çfarë masash ka ndërmarrë.

Pra, pyetja është konkrete për kryeministrin: Zoti kryeministër, a mund të na tregoni se cilat veprime janë ndërmarrë deri tani, meqë Komisioni Doganor i Kosovës ka vërtetuar se kjo kompani ka futur grurë për ushqim të njerëzve, e jo për ushqim të kafshëve dhe e ka dënuar këtë kompani diku me 550.000 euro, mirëpo në këtë proces janë kyçur edhe institucionet e tjera, sidomos Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinës, e cila është nën përgjegjësinë apo nën kontrollin e Kryeministrit.

Unë mendoj se Agjencia e Ushqimit është nga agjencitë më të rëndësishme për vendin, madje më e rëndësishme edhe se Agjencia e Inteligjencës dhe Kryeministria nuk po merret fare me këtë agjenci, e cila i kontrollon të gjitha ushqimet që hyjnë nga importet e vendeve të tjera dhe kryesisht nga Serbia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Përgjigjja është e deleguar te ministri Zharku. Urdhëroni, deputet Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë me ratifikimin e 3 marrëveshjeve për financimin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë, rruga M2, pra Marrëveshja financiare e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim e Financim dhe vazhdim të ndërtimit të rrugës M2, e votuar në Kuvendin e Kosovës më datë 31. 7. 2013;

Marrëveshja për hua, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit Saudit për Zhvillim dhe për financimin e vazhdimet të rrugës M2, e votuar në Kuvendin e Kosovës më 5.12. 2013; Marrëveshja për hua, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe fondit OPEK për Zhvillim Ndërkombëtar për financimin dhe vazhdimin e ndërtimit të rrugës M2, e votuar më 27. 2. 2014.

Greis periodha për të 3 marrëveshjet për financimin e rrugës M2 është 5 vjet dhe po kalojnë 3 vjet nga miratimi i marrëveshjes së parë, ndërsa punët në rrugën Prishtinë-Mitrovicë nuk kanë filluar.

Pyetja ka qenë për kryeministrin, e bazuar si udhëheqës dhe bartës i përgjegjësive. Pra, përse ende nuk kanë filluar punimet në rrugën M2, kur fondet për investime janë siguruar dhe marrëveshja e fundit është miratuar më 27. 2. 2014? Prandaj, në cilën fazë jemi për fillimin e investimeve në rrugën Prishtinë-Mitrovicë, sepse së shpejti do të fillojmë t'i paguajmë kështet e marrëveshjes së miratuar, ndërsa punimet ende nuk kanë filluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka ministri Zharku.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Kolegë,

I nderuar deputet Haxhiu,

Ndërtimi i rrugës nacionale Prishtinë-Mitrovicë është një ndër projektet vitale për vendin tonë.

Siç e dini, për implementimin e këtij projektit gjatë vitit 2013 janë nënshkruar tri marrëveshje nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Marrëveshja mbi huan e njohur si ISISTA-a është nënshkruar më 22 maj 2013 me Bankën Islamike për Zhvillim në shumë prej 15 milionë e 410 mijë euro.

Marrëveshja me fondin e OPEK-ut për Zhvillim, në shumë prej 20 milionë dollarësh është nënshkruar më 5 shtator 2013, dhe

Marrëveshja me Fondin Saudit në shumë prej 60 milionë RIAL-Saudit u nënshkrua më 3 dhjetor 2013.

Të gjitha këto marrëveshje janë aprovuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe janë ratifikuar nga presidentja e Republikës së Kosovës gjatë viteve 2013 dhe 2014.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve Ministria e Infrastrukturës ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e zbatimit të projektit.

Gjatë mandatit tim me përfaqësuesit e Bankës Islamike si udhëheqëse e konzorciumit, takimi i parë është mbajtur më 25 mars 2015, në të cilin jemi pajtuar për orarin e aktiviteteve të nevojshme për implementimin e projektit.

Në përputhje me këtë, më 30 mars 2015, është bërë publikimi i njoftimit të përgjithshëm të prokurimit në “Digi market tenders world wide”.

Takimi i radhës është shtyrë me muaj nga ana e përfaqësuesve të Bankës Islamike, pa ndonjë arsytim, dhe përfundimisht është mbajtur më 2 dhjetor 2015, në të cilën kemi përditësuar orarin për implementimin e projektit.

Menjëherë pas këtij takimi Ministria e Infrastrukturës ka bërë shpallje publike për selektimin e ekspertëve për themelimin e njësisë dhe në fund të dhjetorit kemi bërë propozimet tona.

Duke vërejtur neglizhencën e tyre, kemi insistuar disa herë përmes shkresave zyrtare që sa më shpejt të themelojmë Njësinë për implementimin e projektit, duke kyçur në këtë proces edhe ambasadorin tonë në Arabinë Saudite, zotin Rexhep Boja.

Disa arsye për zvarritje kanë qenë edhe ndryshimet në ekipin përfaqësues të Bankës Islamike.

Por ju garantoj se Ministria e Infrastrukturës, si bartëse e projektit, në emër të Qeverisë i ka kryer absolutisht të gjitha obligimet e saj në përputhje me marrëveshjet, po që e ka pasur të pamundur të ndikojë te bartësi i konsorciumit, në këtë rast te Banka Islamike.

Përfundimisht javën e kaluar, gjegjësisht më 27 dhe 30 qershor, kemi marrë konfirmimin për themelimin e Njësisë për implementimin e projektit dhe tani më këtë javë kanë rifilluar kontaktet e rregullta me përfaqësuesit e Bankës Islamike dhe presim përsheptim të procesit të implementimit të projektit pas rishikimit të përbashkët të të gjitha afateve për aktivitetet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! A ka pyetje shtesë? Deputeti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit edhe ministër Zharku!

Po besoj që tani, pasi është deleguar te ju, edhe do të fillojë të implementohet projekti, i cili është në interesin e qytetarëve, të komunave, të cilat i përfshin kjo rrugë, edhe qytetarët e Kosovës.

Po besoj që pasi projekti tanimë është i detajuar, a kanë filluar, zoti ministër, edhe çështjet e shpronësimeve, për arsye se shumicën e kohës kur po fillon implementimi i projekteve të tilla, po evidentohen pastaj probleme pronësore dhe shpronësimi.

Pasi jeni tani edhe bartës i këtij projekti, a mund të na tregoni në cilën fazë është procesi i shpronësimit dhe pas zhvillimit të implementimit a do të kemi vonesa të këtilla të kësaj natyre, apo do të vazhdojnë të implementohen afatet kohore dhe të paktën të fillojë ndërtimi përpara se të fillojnë pagesat e kredisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti deputet,

Ju e dini, pjesa në rrugën e parë është kryer, pra projekti është kryer, në momentin që do të fillojmë projektin, do të vazhdojmë edhe prej Vushtrrisë deri në Mitrovicë, kurse natyrisht ka filluar edhe procesi i shpronësimit.

Në momentin që angazhohen, unë besoj që gjatë kësaj jave, eventualisht javën e ardhshme do të fillojë punën Njësia për implementim të projektit dhe do të vazhdojë me aktivitetet e parapara.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Raif Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Meqenëse kryeministri nuk është këtu, e desha t'ia bëj një pyetje lidhur me "Trepçën", për të cilën mendoj se ndër çështjet të rëndësishme të këtij vendi. Pyetjen po e lë për herën tjetër, me besimin që ai do të jetë këtu, sepse duhet ta di se deri ku ka arritur procedura me përgatitjen e Projektligjit për "Trepçën" dhe kur do të procedohet ai në Kuvend.

Përkundër faktit se kryeministri nuk është këtu, pyetjen po e lë për herën tjetër, por besoj që kryeministri do të jetë këtu dhe do të japë përgjigje, sepse është çështje mjaft e rëndësishme për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Faton Topalli nuk është këtu, ministri është.

Deputetje Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Ofrimi i mirëqenies së duhur sociale është një pjesë normale e cilitdo shtet të civilizuar evropian dhe se qytetarët e Kosovës kanë të drejtë ta kenë.

Duke qenë të njoftuar se marrëdhëniet në mes të komunës dhe Qendrës për Punë Sociale prej kohës së delegimit të përgjegjësive në nivel lokal nuk janë në nivelin e duhur dhe se Drejtoritë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e kanë në rend të dytë çështjen e mirëqenies sociale.

Duke reduktuar këtë vetëm në dhënien e ndihmave sociale, përderisa puna e një QPS-je është shumë e gjerë, që përfshin edhe fëmijët e braktisur, delikuentët e mitur, gratë e keqtrajtuara, kategoritë asociale, si narkomanët, të trafikuarit, e tjerë. Andaj mund të konstatojmë se decentralizimi i këtij shërbimi nuk e ka ndihmuar punën e tij.

Për më tepër, kanë rënë nivelet e shërbimeve edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve në komuna për të njohur problematikat e shërbimeve sociale.

Kjo ka bërë që edhe kapacitetet e vetë QPS-së të mos mund të fuqizohen me kuadro të nevojshme.

Duke ditur se QPS-të mbulojnë shumë nga fushat kryesore të praktikës në punën sociale, ku shumica prej tyre merren me çështjen e mbrojtjes së fëmijëve, ekziston një total prej 15 standardeve që janë zhvilluar që nga viti 2010, ku më të fundit janë ato për strehimin familjar dhe strehimin të farefisi.

Si pjesë e procesit të zhvillimit dhe pilotimit të standardeve për strehimin familjar dhe për strehimin të farefisi janë përfshirë dy komuna: Gjakova dhe Ferizaj.

Andaj pyetja ime parlamentare, i nderuar ministër, është: Çfarë lloj formule do të aplikoni për alokimin e mjeteve financiare dhe a do të jetë një shumë e saktë për secilën komunë, apo do të ketë dallime? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri Hoti e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Më lejoni t'ju informoj që mjetet për asistencë sociale dhe për raste të tilla ndahen nga Qeveria për Ministrinë e Punës, menaxhohen nga komunat përmes Qendrave për Punë Sociale sa i përket kualifikimit të familjeve të rasteve që hyjnë në asistencë sociale ose për raste të tilla.

Pra, nuk ka formulë që i ndanë këto nëpër komuna, sepse shkon për familje që i plotësojnë kriteret bazë të ligjeve përkatëse.

Është përgjegjësi e Ministrisë së Punës që t'i menaxhojë këto skema në mënyrë më të mirë të mundshme që të shkojnë te familjet dhe te rastet që kanë më së shumti nevojë.

Pra, nuk është formulë që ndan mjetet për komuna, por është formulë që i kualifikon familjet dhe rastet për të përfituar asistencë sociale ose në raste të cilat ju i përmendët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka pyetje shtesë. Deputeti Sali Salihu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi, ministri nuk është këtu. Faleminderit! Tjetër herë e bën pyetjen.

Deputeti Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Kujtim Shala, ministri nuk është. Deputeti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Po, ministri nuk është këtu, kur s'po i bëjmë pyetjet, pastaj ato po anulohen... Unë po e bëj pyetjen edhe një herë, ndoshta përgjigjet me shkrim.

Para disa javës në Prizren ndodhi një tragjedi, ku humbën jetën një vajzë 3-vjeçare dhe u lënduan dy persona të tjerë. Kjo fatkeqësi është pasojë e mosveprimit të pushtetit lokal dhe atij qendror, të cilët janë të obliguar të mbrojnë monumentet e trashëgimisë kulturore sipas Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore dhe sipas Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën historike të Prizrenit.

Të përkujtoj që në vitet e kaluara shumë organizata joqeveritare dhe opozita në Prizren kanë kërkuar që institucionet kompetente, në këtë rast Komuna e Prizrenit dhe Ministria e Kulturës, Sportit dhe Rinisë, të veprojnë dhe të mbrojnë Qendrën historike të Prizrenit sipas përgjegjësi që i përcaktojnë ligjet.

Po ashtu, Këshilli i Trashëgimisë Kulturore për Qendrën historike të Prizrenit që më 9 prill 2016, duke paraparë rrezikun që u kanoset qytetarëve ka kërkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të ndajë fonde emergjente për ndërhyrje dhe riparime në objektet e rrezikuara nga shembja.

Pyetja parlamentare: Pse Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit asnjëherë nuk ka marrë parasysh këto kërkesa dhe nuk ka vepruar për të mbrojtur trashëgiminë kulturore në Qendrën historike të Prizrenit? Pse nuk janë ndarë fondet e kërkuara për sanimin e gjendjes, a duhen më shumë viktima që Qeveria të kryejë obligimet e saj ndaj qytetarëve ashtu si i përcaktojnë ligjet e caktuara më lart? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Nuk është deputetja, ministri është këtu.

Deputeti Danush Ademi, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja për ministrin është: Qyteti i Ferizajt, i banuar më 140 mijë banorë, duke i bashkangjitur edhe qytetarët e komunës së Shtimes, ka mbetur anash nga lidhja e autostradës Prishtinë-Shkup. Për çfarë arsyes nuk ka mundësi që qytetarët e Ferizajt të kenë lidhje më të afërt apo të një unaze me qytetarët? Ndërsa qytetarët e Ferizajt duhet të kalojnë 13 kilometra rrugë deri në fshatin Babush të Muhaxhirëve si dhe 11 kilometra në fshatin Sojevë për t'u kyçur në autostradë.

Qyteti i Ferizajt njihet si qytet edhe i biznesit. Pyetja ime është: a do të bëhet një dalje më afër për qytetarët e Ferizajt, i nderuar ministër?

KRYESUESI: Ministri Zharku e ka fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Deputetë të nderuar,

Kolegë,

I nderuar deputet Ademi,

Ministria e Infrastrukturës është duke realizuar projektin e ndërtimit të autostradës R6 në bazë të kontratës së lidhur në korrik 2014 me konsorciumin “Bechtel&Enka” dhe punimet janë duke u ekzekutuar në bazë të projektit zbatues të përgatitur nga ky konsorcium.

Projekti është punuar sipas standardeve M, gjegjësisht autostradave transevropiane, me sistem të mbyllur për shpejtësi mesatare apo projektuese 120 deri 140 kilometra në orë dhe me shpejtësi maksimale të kufizuar prej 130 kilometra në orë.

Gjatë fazave të projektimit të trasesë së autostradës janë punuar raporte të ndikimit social dhe mjedisor si dhe është bërë studimi i fizibilitetit për trasenë e autostradës.

Në bazë të standardeve evropiane për autostrada, kyçjet duhet të jenë të projektuara në distanca jo më të vogla se 20 deri në 30 kilometra.

Megjithatë, në vendin tonë, duke marrë parasysh gjatësinë e tërë autostradës prej 60 kilometrave, projektuesi është përpjekur të gjejë zgjidhjen më të mirë për kyçje të popullatës, duke shkurtuar këtë distancë në 8,5 kilometra në mes të udhëkryqit që lidh autostradat “Ibrahim Rugova” dhe “Arbër Xhaferi” me atë të Lipjanit, si dhe gjatësinë prej 10.5 kilometra mes kyçjes në Bibaj të Ferizajt deri në Doganaj të Kaçanikut.

Natyrisht është e pamundur që traseja e autostradës të përfshijë në kyçjet e parapara të gjitha komunat dhe vendbanimet apo fshatrat që gravitojnë në korridorin e autostradës.

Siç po e shihni, distanca në mes të kyçjeve është aq e shkurtë sa që çdo zvogëlim i mëtejshëm do të rrezikonte seriozisht mbajtjen e standardeve minimale të pranueshme për autostrada si dhe përfshirjen e kësaj autostrate në rrjetin bazë evropian.

Më lejoni të theksoj se të gjitha kyçjet e autostradës janë të lidhura me rrjetin e rrugëve nacionale dhe rajonale, si dhe kanë qenë të parapara edhe me projektin fillestar nga kompania “Egis International”, e cila e ka përfunduar projektin në vitin 2010.

Sa i përket lidhjes së komunës së Ferizajt, banorët kanë dy qasje në autostradë dhe atë përmes kyçjeve në Bibaj dhe në Babush.

Siç e dini, largësia e kyçjes Bibaj nga kryqëzimi i rrugëve nacionale EN2 dhe EN 25.3, gjegjësisht prej urës që lidh rrugët për Shkup dhe Gjilan, është vetëm 2100 metra. Kurse largësia prej Prelezit deri në Babush, nëse nuk gaboju, është 6 kilometra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Nuk ka pyetje plotësuese. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Zoti ministër, duke pasur parasysh që në Republikën e Kosovës, në shkollat ose në sistemin arsimor të Kosovës fatmirësisht frekuentojnë edhe personat me aftësi të kufizuara, konkretisht personat të cilët janë me karroca.

Ne e dimë që këta shpeshherë ballafaqohen me qasje në objektet shkollore, pra kanë pengesa në qasjen në objektet shkollore. Pyetja ime është: A keni statistika sa prej shkollave i plotësojnë kriteret e qasjes dhe a ka Ministria e Arsimit ndonjë projekt që t’i përfshijë të gjitha shkollat, ose thjesht të garantojë qasje të sigurt për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke pasur parasysh që këtë kriter e kanë plotësuar vetëm shkollat të cilat janë ndërtuar pas luftës ose thjesht kohët e fundit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Arsim Bajrami e ka fjalën. Teknika, jepjani fjalën!

(Pesë minuta, teknika t’i ndreqë këto defekte, pesë minuta...)

Ju lutem, deputetët le t'i zënë vendet e veta.

Ministri Arsim Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuara deputete Musliu,

Fillimisht do të dëshiroj ta falënderoj deputeten për kujdesin e vazhdueshëm për nxënësit që kërkojnë një kujdes të veçantë shoqëror, bëhet fjalë për nxënësit dhe fëmijët me nevoja të veçanta për t'iu sigurua një qasje sa më të lehtë në shkolla.

Më lejoni të ju informoj se nga 1147 shkolla, sa ka në Republikën e Kosovës, kemi arritur që në 505 shkollat të sigurojmë qasje përmes renovimeve për fëmijët me nevoja të veçanta.

Ndërkaq në 149 shkollat të ndërtuara në periudhën e pasluftës, secila shkollë, me projektin e ndërtimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka për detyrë të ndërtojë edhe standardin e ofrimit të lehtësive për hyrje për nxënësit me nevoja të veçanta.

Ministria e Arsimit është duke kërkuar nga të gjitha nivelet e arsimit, pra nuk bëhet fjalë vetëm për shkollat parauniversitare, por edhe për arsimin e lartë që të sigurojnë standardet që janë ndërtuar në Kosovë sa i përket lehtësimit të qasjes në institucione për fëmijët me nevoja të veçanta dhe ne, në të gjitha projektet ndërtimore për të ardhmet kërkojmë nga komunat dhe nga vetë projektet që ne udhëheqim që të kenë hyrje të veçantë lehtësuese për këtë kategori të fëmijëve. Kështu që ky mbetet një kujdes i përhershëm jo vetëm në aspektin e infrastrukturës, por edhe në aspektin e ofrimit të kushteve për trajtim plotësisht të barabartë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputetja as nuk është, as s'ka pyetje shtesë. Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër Bajrami,

Siç e dini, paralelet e ndara të Shkollës së Mesme të Lartë në Zhegër funksionojnë që nga viti 1972.

Në këto paralele mësimet i vijnë 230 nxënës nga Zhegra dhe nga fshatrat përreth. Në këto paralele mësimi zhvillohet me vështirësi, sidomos pas zhvendosjes së nxënësve në shkollën fillore "Agim Ramadani" në shkollë të re.

Pasi që nga ajo kohë, në shtator të vitit 2011, në këtë shkollë nuk është investuar fare, kur dihen dëmtimet që i ka bërë tërmeti në vitin 2004. Vazhdimisht janë dhënë premtime nga Ministria e Arsimit si dhe nga Drejtoria e Arsimit në Gjilan që kjo shkollë të ndërtohet, mirëpo sot e asaj dite kjo shkollë është në një gjendje shumë të rëndë, bile është vlerësuar që atëherë se është objekt me rrezikshmëri të lartë.

Këto ditë, konkretisht para tri javësh në këtë shkollë u bë një inspektim nga inspektorë të Ministrisë së Arsimit dhe inspektorë nga Drejtoria e Arsimit në Gjiilan. U konstatua se gjendja teknike e kësaj shkolle nuk i përmbush as minimumin e kushteve për të zhvilluar proces mësimor dhe si e tillë duhet të mbyllet.

Qytetarët e fshatit Zhegër dhe fshatrat me rrethinë janë të indinjuar me këtë vendim të Inspektoratit dhe kërkojnë që kjo shkollë të mos mbyllet, po të ndërtohet shkollë e re, ashtu siç u është premtuar, sepse në këtë shkollë mësojnë jo vetëm nxënës nga Zhegra, por edhe nxënës nga dhjetëra fshatra në rrethinë të Zhegrës.

Pyetja, z. ministër është: Çka do të ndërmerrni që këto paralele të ndara në gjimnazin në Zhegër të mos mbyllen? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Ministri Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete Baftiu, Duke çmuar angazhimin tuaj për infrastrukturën shkollore në komunën e Gjilanit, më lejoni që lidhur me pyetjen tuaj të jap këtë përgjigje.

Në bazë të të dhënave të Departamentit të Infrastrukturës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në fshatin Zhegër ekziston paralelja e ndarë e gjimnazit “Zenel Hajdini” në Gjiilan dhe ka gjithsej 63 nxënës, si dhe paralelet e ndara në shkollën ekonomike “Marlin Barleti” në Gjiilan që ka 92 nxënës.

Sipas Ligjit për arsimin para universitar, pesë paralele janë të pamjaftueshme për të filluar ndërtimin e një shkolle të mesme profesionale.

Pra, mbi bazën e Ligjit për arsim para universitar dhe standardeve për ndërtimin e shkollave kërkohet që për një shkollë të mesme, qoftë gjimnaz apo shkollë profesionale, të ketë më shumë se pesë paralele për të arsyetuar edhe investimet shtetërore.

Më lejoni t’ ju them që çështja e infrastrukturës dhe ndërtimit të shkollave është një kompetencë tërësisht e bartur në komuna dhe ne ju lusim që të drejtoheni në Komunën e Gjilanit, në Drejtorin për Arsim, dhe të kërkonit prej tyre. Ministria e Arsimit është e gatshme që të gjejë një zgjidhje që kjo shkollë mos të mbyllet, të gjejë një zgjidhje që të shtohet numri i nxënësve dhe jemi të gatshëm të hyjmë edhe në bashkëfinancim me Komunën e Gjilanit për të ndërtuar në fshatin Zhegër një shkollë çfarë ju keni potencuar.

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Zonja Baftija, keni pyetje shtesë? Zonja Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Po, faleminderit!
Faleminderit, ministër!

Ju thatë se nuk mund të ndërtohet një shkollë me aq numër të vogël të paraleleve. Mirëpo, pse janë mashtruar këta qytetarë tash e sa vjet duke iu premtuar vazhdimisht qoftë nga niveli qendror, qoftë nga niveli lokal, që aty do të ketë një shkollë të re të mesme.

Nëse është puna kështu siç thoni, atëherë duhet t'iu bëhet një zgjidhje këtyre nxënësve apo këtyre paraleleve qoftë edhe në shkollën fillore “Agim Ramadani”, për arsye se ne, si qytetarë të fshatit Zhegër me rrethinë, e dini se kemi punuar edhe në kohë më të vështira, atëherë kur shkollat shtëpitë janë bërë shkolla. Kështu që këta qytetarë janë të vendosur që nëse mbyllen këto paralele, atëherë do të vazhdojnë edhe mësimin nëpër shtëpi. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër...!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuar deputete Baftija, Ju siguroj që do të bëjmë gjithçka që këta nxënës të mos kenë asnjë problem sa i përket qasjes në shkolla, do të gjejmë zgjidhje alternative, por nëse duhet të marrim një vendim për ta ndërtuar një shkollë të re, duhet ta rrisim numrin e nxënësve. Besoj që pajtoheni edhe ju me mua, se nuk mund të ndërtojmë një shkollë të mesme për 120 nxënës. Duhet një numër më i madh i nxënësve, sepse duhet të racionalizojmë, por ne do të punojmë me Komunën e Gjilanit që të shohim cila është mundësia, ndoshta duhet të angazhohemi për ta rritur numrin e nxënësve dhe atëherë jemi të gatshëm të fillojmë edhe ndërtimin e shkollës së re.

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

BESA BAFTIJA: I nderuar ministër, Edhe këtë vit testi i maturës u përcoll pothuajse me probleme të njëjta, sikurse edhe në vitet e kaluara. Siç janë publikimi i tekstit në rrjete sociale si dhe tentativa e kopjimit të nxënësve brenda klasave.

Mirëpo ajo që është shqetësuese që ka ndodhur gjatë testimit, që është parë në video në rrjetet sociale dhe në media, është largimi i një nxënësve nga Gjilani nga testi pasi kishte tentuar të kopjonte. Skena të cilat i pamë vërtet janë tmerruese, sepse po luhet me ndjenja dhe të ardhmen e nxënësve tanë.

KRYESUESI: Urdhëro, ministër Bajrami!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete, Kësaj radhe ju falënderoj për pyetjen jubilarë, sepse kjo është pyetja e 40 në këtë legjislaturë, përkatësisht e 39 në të cilën përgjigjem.

KRYESUESI: Regjia fjalën, barte fjalën, a e ndreqët...? Një orë kërkojnë këta për ta ndrequr, një orë...

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, e vazhdojmë seancën. Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. As deputetja, as ministri nuk janë këtu.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Ministri është këtu, deputetja nuk është.

Deputetja Albulena Haxhiu po ashtu pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Ministri është këtu, deputetja nuk është.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Urdhëro, i nderuar deputet! Fjala për ju.

Deputetë, po të doni e lëmë për të tjera herë. Urdhëro, po! Regjia, të lutem, deputeti Ismajl Kurteshi e ka fjalën, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, në raportin që e keni sjellë për kontrollin e brendshëm të financave publike thuhet që ka probleme në regjistrim të transaksioneve të prokurimit, të menaxhimit të pasurisë të të hyrave vetjake e të ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit, e deri te qasja e paautorizuar në të dhëna nga organizatat buxhetore.

Këto të dhëna na dëshmojnë për korrupsion, si dhe na japin indikacione për krim të organizuar. Mosregjistrimi i transaksioneve, problemet në menaxhimin e pasurisë dhe të të hyrave vetjake nuk janë thjesht mungesë përvoje apo gabim në punë. Ato janë aktivitete me natyrë kriminale, pavarësisht nëse në dukje krijohet përshtypja se aty qëndron një zyrtar i thjeshtë. Shuma totale e këtyre keqpërdorimeve është, në fakt, shuma e krizës sonë të përgjithshme institucionale, ekonomike, ligjore e shoqërore.

Pyetja është kjo, ministër: na listoni deri në detajet më të imta se cilat janë problemet me menaxhimin e pasurisë, transaksioneve, prokurimit, si dhe listën e organizatave buxhetore që i kanë këto probleme dhe emrat e zyrtarëve ligjërisht përgjegjës për këto abuzime? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, i nderuar ministër, fjala është për ju!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar deputet,

Unë fillimisht ju informoj që është hera e dytë në vitin 2015 që organizatat buxhetore kanë bërë vetëvlerësimin e tyre, punës së tyre sa i përket menaxhimit të rrezikut të regjistrimit të pasurisë, cilësisë së informatave, e tjera, e tjera.

Ne jemi duke e zhvilluar këtë proces që dy vjet radhazi, pra më 2014 dhe 2015, procesi është kryer në mbështetje të Sigmas të OESD-së dhe në përgjithësi ka përparim në këtë drejtim. Pra,

është vetëvlerësim që e bëjnë organizatat buxhetore për të identifikuar dobësitë e brendshme dhe për të identifikuar pastaj bashkë me Ministrinë e Financave dhe organizatat e tjera masat për adresimin e atyre dobësive të identifikuara.

Numri i organizatave buxhetore që e kanë plotësuar formularin e vetëvlerësimit është rritur në vitin e kaluar, më 2015 krahasuar me 2014. Sa i përket pyetjes suaj, këtu fjala është për fushat ku auditorët e brendshëm dhe auditorët e jashtëm kanë konstatuar të gjetura, si për shembull, regjistrimi joadekuat i transaksioneve, që nuk është lëshim material, por është regjistrim i gabuar i transaksioneve financiare që kanë kryer institucionet, organizatat buxhetore. Për shembull, pagesat me kontratë mbi vepër a janë paguar prej mallrave apo janë paguar prej pagave, prej fondit të pagave dhe mëditjeve.

Problemi i mosrealizimit të të hyrave të planifikuara, kryesisht nga komunat, por edhe nga organizatat e nivelit qendror, që prapë është lëshim procedural, por nuk është lëshim material i çështjeve. Janë identifikuar probleme me prokurimet publike, sidomos me kuotim të çmimeve deri në 10 mijë euro. Mandej, me ndarjen e kontratave në loto, te regjistrimi i pasurisë kemi të bëjmë më shumë me gabime teknike të lëshimit të regjistrimit të pasurisë ose të përcaktimit të vlerës së pasurisë që është regjistruar, por pasuria është aty, është çështje tjetër a është vendosur në sistem vlera e saktë e pasurisë në sektorin publik.

Ne kemi ndërmarrë masa edhe gjatë vitit 2015, në pjesën e dytë kryesisht, edhe gjatë këtij viti dhe tani jemi duke e bërë një plan detaj të punës për adresimin e këtyre të gjeturave. Për shembull, njëra prej masave që kemi ndërmarrë është integrimi i sistemit të Thesarit me E-pasurinë, regjistrimin e pasurisë edhe me KRPP-në për t'u siguruar që transaksionet që kryhen nga organizatat buxhetore kryhen prej kodeve që janë të parapara në buxhet.

Jemi involvuar shumë në trajnimin e stafit të auditorëve të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore dhe jo vetëm stafit të auditimit të brendshëm, por edhe zyrtarëve kryesorë administrativë dhe zyrtarëve kryesorë financiarë sa i përket procedurave për regjistrimin e pasurisë. Tek prokurimi, i kemi edhe me ligj që ka hyrë në fuqi nga janari i këtij viti, i kemi hequr kuotimet në 10 mijë euro, nuk ka kuotime...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Regjia, ju lutem, vlen edhe për ministrat, mos e ndalni fjalën!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Pra tek prokurimi me ligj i kemi hequr tani këto kuotimet e çmimeve nën 10 mijë euro, të gjitha duhet të shkojnë me procedura të rregullta të tenderimit dhe kemi avancuar në këtë drejtim, duke e aplikuar prokurimin elektronik dhe prokurimin e centralizuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, e cila tash kryen prokurime për të gjitha organizatat buxhetore sa i përket mallrave dhe shërbimeve që i përdorin të gjitha organizatat buxhetore.

Është përgatitur programi kombëtar për rritjen e numrit të auditorëve të brendshëm nëpër organizata buxhetore dhe shpejt do të fillojë me trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të rinj nëpër të gjitha organizatat buxhetore.

Jemi në finalizim të një marrëveshjeje me Luksemburgun, me Qeverinë e Luksemburgut, e cila do të na japë asistencë të fokusuar në kontrollin e brendshëm të financave publike, për të fuqizuar auditimin e brendshëm, menaxhimin më të mirë të riskut nëpër organizata buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Zoti deputet, a ke pyetje? Po, urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Zoti ministër!

Gjatë përgjigjes suaj disa herë e përmendët fjalën “lëshim”, do të thotë ka pasur lëshime. Besoj që pajtoheni që këto lëshime kanë edhe pasoja dhe ata që bëjnë lëshime, kanë emra dhe mbiemra, janë njerëz të cilët paguhen që të mos bëjnë lëshime.

Çka keni marrë konkretisht ndaj autorëve të lëshimeve dhe një çështje po më intereson. Përveç tjerash, janë bërë lëshime edhe në mosruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit. A do të thotë kjo përpjekje për t’i humbur gjurmët që edhe më vonë asnjëherë të mos zbulohen autorët e “lëshimeve”, siç thatë ju butë, se mund të jenë më të rënda se lëshime dhe se a duhet të përgjigjen veçanërisht për këtë ata që nuk po i arkivojnë materialet, e që është karakteristikë e çdo shtetit të organizuar, përndryshe jemi ‘sallamadi’. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri prapë e ka fjalën, deputet, ti prapë nëse do.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Më lejoni edhe një herë të adresoj, në cilësinë e ministrit të Financave mundohem të krijoj një sistem, i cili është funksional, edhe ky sistem, atë që e thashë, më lejoni të përsëris edhe një herë, pra krijimi i lidhjes fizike përmes softuerit në mes të sistemit të Thesarit ku kryhen pagesat, përmes KRPP-së ku shpallen tenderët dhe nënshkruhen, fuqizohen kontratat dhe pagesat që bëhen nëpër organizata buxhetore.

Pra, të sigurohem që mjetet që po i paguajmë, po i paguajmë për projektet të cilat i ka aprovuar ky Kuvend, që janë pjesë të Ligjit të buxhetit dhe, e dyta, të racionalizojmë shpenzimin e parasë publike përmes e - prokurimit dhe prokurimit të centralizuar. Vitin e kaluar kemi filluar me disa kontrata, sivjet kemi nënshkruar edhe kontrata të reja, kemi çuar përpara prokurimin elektronik në AQP, besoj në shtator edhe nëpër organizata të tjera të nivelit qendror dhe nga janari i vitit 2017 do të zgjerohet edhe nëpër komuna, për të krijuar një sistem që është vetërregullues.

Tani, nëse ka lëshime në sistem, janë organet kompetente që identifikojnë fajtorët potencialë edhe merren me ta. Por, për mua si ministër i Financave është që të sigurohem që paraja publike po menaxhohet me efikasitet dhe po shkon në vendin e duhur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, e do fjalën? Deputeti e ka edhe një herë fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Vetëm desha të them që asnjëherë nuk po marrim përgjigje konkrete në pyetjet konkrete. Ministrat është mirë të përgjigjen konkretisht në atë që po i pyesim. Po flasin shumë, por përgjigjja nuk është adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, ti u përgjigje dy herë, veç konkretisht. Ok! Deputetja Puhie Demaku, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, ministri nuk është këtu, urdhëro, zonja deputete.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Norvegji na kanë informuar se Drejtoria e policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Norvegjisë ka marrë një vendim mbi pasaportat norvegjeze, në bazë të të cilit shtetasit norvegjezë të lindur në shtetet e tjera, ku informatat janë vështirë të verifikueshme, nga tash e tutje në rubrikën “vendi i lindjes” shënohet “i panjohur”.

Ky vendim përfshin 31 shtete, kryesisht në Azi dhe Afrikë, por, për fat të keq, kësaj radhe e prek edhe Kosovën. Do të thotë, shqiptarëve të Kosovës që mbajnë nënshtetësinë norvegjeze sipas këtij vendimi në pasaportë vendlindja nuk do të shënohet, për shembull, në Prishtinë, Gjilan apo Pejë, por do t’u shënohet me “e panjohur”. Ky vendim do t’ua pamundësojë bashkatdhetarëve tanë në Norvegji që mbajnë shtetësinë norvegjeze udhëtimin dhe marrjen e vizave apo hyrjen në shtete me kontrolle restriktive, siç është SHBA-ja dhe për pasojë do t’i dëmtojnë padrejtësisht ata.

Pyetja ime për ministrin e Punëve të Jashtme dhe kjo çështje ka goxha kohë që ka ndodhur, do të thotë është gati një muaj prej kur e kam dorëzuar si pyetje, është se Ministria e Punëve të Jashtme a ka ndërmarrë ndonjë masë për të parandaluar apo për të përmirësuar këtë vendim, i cili është marrë atje? Unë pres nga ministri që të paktën në seancën e radhës të na japë një shpjegim, për shkak që bashkatdhetarët tanë në Norvegji po dëmtohen padrejtësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Ministri nuk është këtu, besoj se procedon, është në interes të qytetarëve tanë. Atëherë, unë do të rikthehem edhe një herë, pasi deputetët nuk janë në seancë për t’i lexuar pyetjet.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Dy i ka, i bën të dyja përnjëherë. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Pyetja e parë ka të bëjë me organizatat buxhetore. Gjysma e organizatave buxhetore sipas raportit të Njësisë qendrore harmonizuese kanë raportuar se ka mungesë të procedurave të brendshme, trajtim të pamjaftueshëm të konfliktit të interesit, se nuk raportohen kënaqshëm shkeljet, se ka mungesë të përshkrimit të detyrave, madje edhe mungesë të planeve të veprimit dhe monitorimit të tyre.

Këto fakte të thëna në variantin e përgjithësuar në raport dëshmojnë për një dështim rrënjësor të administrimit të shtetit dhe institucioneve të tij. Pyetja parlamentare është se në sa raste ka pasur konflikt të interesit dhe në cilat organizata buxhetore dhe në cilat organizata buxhetore nuk janë raportuar shkeljet dhe për çfarë shkelje ka qenë fjala?

Të lutem, zoti ministër, që të mos të bëheni si Edita Tahiri, që kur e pyet diçka, të kthen përgjigje krejt diçka tjetër, konkretisht pyetja do të thotë është kjo. Ju kisha lutur për përgjigje sa më konkrete.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuara deputete,

Ministria e Financave, në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë të OESD-së, unë u përgjigja shkurtimisht në pyetjen paraprake të deputetit, që bashkë me OESD-në, nëpërmjet projektit Sigma, për herë të dytë kemi implementuar projektin e vetëvlerësimit të organizatave buxhetore, pra është pyetësor që Ministria e Financave e shpërndan në të gjitha organizatat buxhetore dhe ato raportojnë menaxhimin e riskut, implementimin e procedurave, kodin e etikës dhe çështje të tjera që lidhen me to.

Ne jemi duke avancuar këtë sistem, kemi një projekt tjetër prapë që vazhdon me OESD-në për ta përmirësuar. Në vitin 2014 ka qenë hera e parë që është implementuar vetëvlerësimi nga organizatat buxhetore, është parë që ka pasur paqartësi në pyetjet që janë bërë atëherë dhe si rezultat në vitin 2015 janë rishikuar plot pyetje në kuadër të pyetësorit të vetëvlerësimit, në veçanti sa i përket perceptimit të riskut për organizatën buxhetore, vetëvlerësimin e brendshëm të saj, strukturat që janë në vend dhe përputhshmëria e procedurave me ligjet në fuqi.

Ne do të vazhdojmë më tutje ta avancojmë këtë proces, numri i organizatave buxhetore që janë duke u përgjigjur në pyetësorin e vetëvlerësimit është duke u rritur. Kanë dalë rekomandime shumë të mira për dobësitë që janë nëpër organizatat e ndryshme buxhetore, sa i përket kryesisht auditimit të brendshëm, nevojën për të pasur auditim të brendshëm në secilën prej organizatave buxhetore, për të trajnuar auditorë të brendshëm në përputhje me njohuritë e fundit dhe ndryshimet ligjore.

Ne kemi kaluar në Qeveri koncept-dokumentin për ndryshimin e Ligjit për auditim të brendshëm, tani e kemi finalizuar edhe ligjin dhe shpejt do të vijë ligji në Kuvend që do t'i adresojë shumicën e rekomandimeve që në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë adresuar, përfshirë edhe këto çështjet tuaja. Për çështje specifike se cilat organizata e kanë respektuar kodin e etikës, në cilat ka shkelje, ju mund të kërkonit informata në cilindo prej tyre, më në detaje. Kjo është përgjigjja ime në këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala prapë për ju, e nderuar deputete!

ALBULENA HAXHIU: Zoti ministër!

Prapë nuk iu përgjigje pyetjes që ta kam parashtruar, sepse saktësisht kërkoja në sa raste, domethënë ka pasur konflikt interesi dhe në cilat organizata buxhetore, saktësisht, sepse si ministër do të duhej ta dini, apo jo?

Dhe, çka keni bërë në lidhje me këto shkelje në raport me prokuroritë. A i keni dërguar domethënë këto shkelje në institucionet e prokurorisë, sepse ato do të duhej të merren me këto çështje, edhe thënë drejtën, nëse e lexojmë raportin e vitit 2014, por edhe raportin e vitit 2015, del që shumë më i mirë ka qenë raporti i vitit 2014 se ky i vitit 2015. Pra, shumë më shumë probleme, shkelje dhe të tjera ka në raportin e vitit 2015 se në atë të 2014-tës.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër, fjala për ju.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Më lejoni, të qartësoj, kur flasim për konflikt interesi, në rastin konkret, te menaxhimi i financave publike dhe njësitë e auditimit të brendshëm kryesisht janë rastet kur në Komitetet e auditimit që duhet të themelohen nëpër organizata buxhetore, të sigurohemi që nuk është menaxhmenti i lartë, sepse është menaxhmenti i lartë atij i të cilit auditimi i brendshëm i raporton sa i përket përmbushjes së rekomandimeve.

Pra, është konflikt interesi për t'u siguruar që anëtarët e Komitetit të auditimit nuk janë nga menaxhmenti i lartë. Unë nuk besoj që është vepër penale kjo, është lëshim procedural, të cilat ne duhet të sigurohemi që në menaxhmentin e lartë nuk ka persona që involvohen në Komitetin e auditimit, ku zhvillohen rekomandimet sa i përket auditimit të brendshëm ose adresimit të rekomandimeve nga auditori i jashtëm.

Tani sa i përket vlerësimit, unë e thashë në fjalën time në fillim. Më 2014 ka filluar për herë të parë vetëvlerësimi i organizatave buxhetore, janë ndryshuar pyetjet, natyra e pyetjeve në vitin 2015, sepse duket ka pasur paqartësi në atë se çka është kërkuar nga organizatat buxhetore të raportojnë. Jemi duke avancuar sistemin, vlerësimi është 2,23 - 2,3 afër, është pak më i vogël se sa i vitit 2014, por të keni parasysh që janë ndryshuar disa prej pyetjeve, plus shto kësaj që maksimumi i vlerësimit që mund të japin organizatat buxhetore është 3, që as vendet më të zhvilluara nuk e kanë maksimumin e vetëvlerësimit të brendshëm që arrijnë përmes këtyre pyetësorëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, deputete!

ALBULENA HAXHIU: Pyetja e dytë, por para se të kaloj te pyetja e dytë po shihet që në përgjigje u mundua t'ia hedhë fajin PDK-së. Unë s'po them që PDK-ja ka përgjegjësi. Natyrisht e ka fajin shumë më të madh, por tash kur jeni bërë të dyja bashkë, LDK e PDK, jeni shumë më të qetë.

Raporti e thotë kështu, i kisha sugjeruar deputetët e PDK-së e LDK-së le ta lexojnë raportin dhe e shohin çka po thotë ai raport.

Pyetja e dytë është se pikërisht ky raport, pra raporti i Njësisë Qendrore Harmonizuese thotë se 18, apo 31% e organizatave buxhetore nuk janë të mbuluara me auditim të brendshëm. Mes tyre edhe komunat e Zveçanit, Zubin Potokut, Kllokotit, Parteshit. Kjo tregon se përkundër faktit që ato marrin mjete nga buxheti i Kosovës, nuk e shohin të arsyeshme t'u përgjigjen kërkesave të Ministrisë së Financave dhe obligimeve ligjore për të bërë auditim të brendshëm.

Pyetja është se kur e keni në plan që këto komuna, që janë komuna të Republikës së Kosovës, t'i trajtoni si të tilla, ashtu edhe sikurse komunat e tjera?

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Në bazë të Ligjit për auditimin e brendshëm, të gjitha organizatat buxhetore që kanë një buxhet vjetor së paku 1 milion euro dhe që kanë së paku 50 të punësuar, janë të obliguara të themelojnë auditimin e brendshëm.

Shumica e organizatave buxhetore kanë auditim të brendshëm, disa që nuk kanë auditim të brendshëm, kryesisht e kanë për çështje të kufizimeve buxhetore, të cilat jemi duke i adresuar në vijimësi. Besoj që në buxhetin e ardhshëm do të sigurojmë kushtet e nevojshme dhe buxhet të nevojshëm që edhe ato organizata buxhetore që nuk kanë auditim të brendshëm, të kenë mundësi që të punësojnë së paku një auditor të brendshëm.

Por, për kontroll të brendshëm të financave publike kjo nuk është problem, sepse ne në Ministrinë e Financave e kemi Njësinë qendrore harmonizuese, e cila mund të kryejë auditimin për ato organizata që nuk kanë auditim të brendshëm. Ka plot raste kur ne auditime të tilla kemi kryer për plot organizata. Ne e kemi inkurajuar edhe Kuvendin e Kosovës, sepse ka plot agjenci në kuadër të Kuvendit të Kosovës që nuk e plotësojnë kriterin për të pasur auditor të brendshëm për të krijuar njësi të përbashkëta të auditimit të brendshëm. Por, ajo që është me rëndësi dhe për hir të opinionit, 98% e Buxhetit të Kosovës është në organizata që i kanë njësitë e aludimit të brendshëm. Janë disa komuna shumë të vogla, që besoj se këtë vit, eventualisht vitin e ardhshëm, do t'i komplotojnë këto njësi, pasi t'i krijojmë kushtet e nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Atëherë, pyetja e deputetes Donika Kadaj-Bujupi për ministrin Abdullah Hoti.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Vlerësimi për mjedisin e kontrollit, sipas raportit të prezantuar për kontrollin e brendshëm në bazë të raportit të Ministrisë së Financave për Mbikëqyrjen e Brendshme të Financave Publike del se ka një rënie të cilësisë në punë, rënie të përgjegjësisë së mbikëqyrjes për 6,6%. Është e njohur se gjatë qeverisjes së PDK-së kontrolli i financave publike ka qenë një pikë e dobët. Tani gjatë qeverisjes së përbashkët paska ndodhur edhe një keqësim i situatës, gjë që e vërtetojnë edhe burimet e brendshme të ministrisë.

Raporti juaj përpiqet ta arsyetojë këtë përkeqësim të situatës, duke akuzuar partnerin tuaj aktual të koalicionit, PDK-në, se gjatë vitit 2014 ka bërë mashtrime në vlerësimin e punës së organizatave buxhetore dhe se këtë vit vlerësimi është më real. Prandaj, pyetja është: A mund të shpjegoni këtu para deputetëve konkretisht arsyet, pse gjatë qeverisjes së PDK-së vlerësimet e brendshme kanë qenë mashtrim?

Nëse shifrat tregojnë përkeqësim të situatës mbi çfarë kriteresh e bazoni konkluzionin, se ka përmirësim gjatë qeverisjes së përbashkët, pra gjatë vitit 2015?

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Më lejoni që edhe një herë ta sqaroj: Më 2014 është bërë vetëvlerësimi i parë nga organizata buxhetore, më 2015 ka ndryshuar pak formati i pyetjeve bashkë me OECD-në. Tash janë të njëjtët persona që kanë bërë vetëvlerësimin në vitin 2014 dhe të njëjtët persona që kanë bërë prapë vetëvlerësimin më 2015. A mendoni se ata e mashtrojnë veten duke e vlerësuar veten më keq në vitin 2015, sesa në vitin 2014.

Pra, është çështje e formatit të pyetjeve. Unë besoj se deri tash dhashë, në disa paraqitje, mjaft evidencë se si është përmirësuar menaxhimi i financave publike nëpër vite: tek prokurimi

elektronik; tek lidhja e thesarit me KRPP-në; tek mbikëqyrja më e mirë e ekzekutimit të kontratave; tek prokurimet e centralizuara dhe plot çështje të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, e dëshiron fjalën prapë?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, pikërisht pse është vetëvlerësim, për këtë vetëvlerësim ju keni konstatuar se ka qenë mashtrim herën e parë dhe tash është më mirë. A pse keni përvojë më shumë në vetëvlerësim apo sepse atëherë ka qenë “pus” e tash “dri”, se kështu po i bie, nuk po shihet ndonjë përmirësim. Keq ka qenë, tash edhe më keq qenka bërë.

KRYETARI: Ministri edhe një herë e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Maksimumi i vlerësimit është 3. Nëse ne i mbërrimë 2,23, 2,3, që është në përputhje me standardet në shumicën e vendeve të zhvilluara, sa i përket menaxhimit të financave publike. Unë ju siguroj që sistemi i financave publike në Kosovë është kompatibil me shumicën e vendeve të BE-së, sa i përket vendosjes së strukturave të kontrollit të brendshëm. Normalisht, lëshime ka mjaft, por ne jemi duke i adresuar ato lëshime.

Kemi bërë një listë të gjatë të rekomandimeve të Komisionit për mbikëqyrje të brendshme të financave publike dhe tash po punojmë në një plan pune, për t'i adresuar ato lëshime. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, kërkoj falje, deputetja edhe një herë po e kërkon fjalën edhe po e përfundojmë. Hajde deputete, të lutem, veç ta përfundojmë.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Jo, veç për transkript, edhe një herë po dua ta theksoj se keni deklaruar që gjatë qeverisjes së PDK-së vlerësimet e brendshme kanë qenë joreale, që po i bie se kanë qenë mashtrim. Do të thotë, partneri juaj i koalicionit vitin e kaluar ka mashtruar në raporte. Këtë nuk na e thatë. Folët për përqindje, nuk folët për fusha, mirëpo veç ta dimë kah po shkojnë. Domethënë, edhe një herë dua ta theksoj dhe të na jepni ju shpjegimin, se a konstatojnë se ka qenë mashtrim vitin e kaluar. Kështu e keni shkruar në raport dhe, në fakt, dy vitet e kaluara, 2014-ën. Kështu shkruan në raport, tash nëse është gabim në raport, atëherë deklarojeni si të tillë, ose nëse keni gabuar, ta dimë kah po shkojmë, kah jemi.

KRYETARI: Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: E nderuara deputete, Ta lexojmë raportin drejt. Atë që thotë raporti, është që ka ndërruar formati i pyetjeve të vetëvlerësimit.

KRYETARI: Deputete, të kisha lutur, jashtë Rregullores, unë jam këtu për t'ua dhënë fjalën, e jo me ministrin...

MINISTRI ABDULLAH HOTI: ...Raporti është publik dhe secili mund ta shohë. Ka ndërruar formati i pyetjeve, që të jetë një vlerësim më adekuat të gjendjes nëpër organizata buxhetore.

KRYETARI: Deputete, po ndërrojmë parti e s'po bëhet kiameti, po lëre... s'e bëra me sherr, veç ja që reaguat.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, në faqen zyrtare kronike të Kuvendit. Deputete, urdhëro fjalën, kërkoj falje në qoftë se të kam lënduar, se unë e pata fajin. Veç pak, urdhëro, fjala është për ju.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Parti edhe mund të ndërroj, po me rëndësi është mos të ndërroj fytyrë. E dikush, po e ndërron fytyrën përditë.

KRYETARI: Deputete, ke të drejtë që reagoje, sepse ishte faji im si kryesues. Tash a futemi... ne jemi edhe njerëz, të kemi mirëkuptim.

Futemi tek pikat e rendit të ditës.

Së pari, e kemi një situatë të re, dy deputetë të rinj do ta japin betimin. Unë do të shkoj proceduralisht, për hir të protokollit jam i detyruar t'i lexoj, që të mos kemi vërejtje.

Deputetë të nderuar,

Para se të fillojmë me rendin e ditës ju njoftoj me kërkesë të kryetarit të Kuvendit me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilët në seancën e kaluar nuk kanë qenë të pranishëm për të bërë betimin.

Deputeti Shukri Buja, kandidat i subjektit politik PDK-PD-LB- PSHDK-PKK e zëvendëson ish-deputetin zotin Enver Hoxhaj, ndërsa deputeti Driton Çausi, kandidat i subjektit politik "Vetëvendosje", e zëvendëson ish-deputetin, zotin Besnik Bislimi.

Deputetët e rinj i ftoj, se betimi i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregullore të Kuvendit. Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili deputet para vetes dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht. Për të përmbushur këtë detyrim lus deputetët që të ngritën në këmbë, që ta dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe në fund së bashku shqiptojmë fjalën "betohem".

Teksti i deklaratës është: "Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin dhe do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës për garantimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut në përputhe me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!"

Faleminderit! Deputetëve të rinj u dëshiroj mirëseardhje dhe i ftoj, që ta nënshkruajnë tekstin e betimit, pastaj edhe e sjellin tek administrata. Është proceduralisht rregull. Faleminderit! Urime dhe suksese, kolegë!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 44, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit kemi propozim nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës së seancës së sotme plenare dhe për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03. L-049 për financat dhe pushtetin lokal.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, deputetin Naser Osmani, që ta paraqesë propozimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2016 ka shqyrtuar në parim projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim në parim, si dhe ka propozuar që shqyrtimi i parë dhe i dytë të bëhen me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1, neni 57, paragrafi 3, 5, 8 dhe 9 dhe neni 64, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet në seancën e sotme, domethënë më 7 korrik 2016.

2. Amendamentet eventuale për rishikimin e buxhetit mund t'i adresohen Komisionit për Buxhet dhe Financa deri më 11 korrik 2016.

3. Komisionet e përhershme deri më 12 korrik 2016 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.

4. Komisioni për Buxhet dhe Financa deri më 13 korrik duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancën plenare.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet në seancën plenare jo më vonë se më 14 korrik 2016.

Zoti kryetar,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka paraparë që edhe Ligji për financat e pushtetit lokal të procedohet në të njëjtën procedurë sikurse buxheti, duke marrë parasysh që është kërkuar që kjo çështje të rregullohet me urgjencë dhe atë:

- duke përdorur të gjithë paragrafët e Rregullores, si ato që i përmenda për Ligjin e Buxhetit dhe atë si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat të pushtetit lokal të bëhet në seancën plenare sot më 7 korrik;

2. Komisionet e përhershme deri më 11 korrik 2016 duhet të shqyrtojnë Projektligjin për raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa;

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa jo më vonë se 13 korrik 2016 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtimin e dytë në seancë plenare dhe

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financa të pushtetit lokal të bëhet në seancë plenare jo më vonë se 14 korrik.

Zoti kryetar,

Me fjalë të tjera, Komisioni për Buxhet dhe Financa rekomandon që të dy këto ligje të procedohen sipas rregullores, që u kërkua nga komisioni në procedurë të përshpejtuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryetar! Edhe pse Projektligjin për Buxhet e kemi pasur, po shkojmë me propozimin. Do të votojmë në fund për propozimin të cilin e dha kryetari i komisionit.

Urdhëroni grupet parlamentare, a ka dikush të flasë? Zonja Haxhiu nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Sa i përket propozimit të Komisionit për Buxhet, natyrisht se Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta përkrahë si të tillë për faktin se sa herë po vjen shqyrtimi i Buxhetit, qoftë buxheti i ri, qoftë rishqyrtime buxhetore, po detyrohem që me procedura të përshpejtuara ta shqyrtojmë këtë projektligj.

Pra, është e papranueshme që një ligj kaq të rëndësishëm për vendin të shqyrtohet brenda tri-katër ditëve. Ne e kemi marrë para dy ditësh buxhetin, kështu që nuk ka nevojë pse të ngutemi. Është dashur Ministria e Financave dhe Qeveria që ta sjellë më përpara në Kuvend, në mënyrë që deputetët të kenë më shumë mundësi për ta shqyrtuar dhe jo kësisoj, me shmangie të procedurave pastaj të na pamundësohen edhe debate të mirëfillta, mirëpo edhe mundësia për të proceduar amendamente në këtë rishqyrtim të Buxhetit.

Pra, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta përkrahë shmangien nga Rregullorja.

KRYETARI: Faleminderit! Asnjë grup tjetër parlamentar nuk ka kërkuar fjalën. Në bazë të Rregullores nenit 84 na duhen 2/3-at e deputetëve të pranishëm për propozimin e kryetarit të Komisionit Funkcional. S’ka.

Atëherë, shkojmë në votim. 78 deputetë janë brenda në sallë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, 76 deputetë kanë votuar, 63 për, 11 kundër, 2 abstenime. Një me dorë kundër ishte, a? Atëherë, bëhen 12 kundër edhe një për, bëhen 64. Mirë që nuk është çështje shumë e ndjeshme, se do të më dilte fjalë për këtë çështjen me dorë a t’i fus apo jo në votim. Le ta ketë parasysh protokollin. Miratohet propozimi i Komisionit Funkcional për plotësimin e rendit të ditës dhe për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për propozimin të cilin e dha kryetari i Komisionit Funkcional, se e kam vetëm njërën, po të dyja, se janë edhe propozimet për leximin e dytë.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Nëse dikush ka vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 16 dhe 17 qershor 2016 dhe më 17 qershor 2016 në orën 17:00, le të urdhërojë. Në qoftë se nuk ka siç po e shoh, atëherë Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të seancave plenare të mbajtura më 16 dhe 17 qershor 2016 dhe më 17 qershor 2016, në orën 17:00.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Më lejoni të prezantoj para jush rishikimin e buxhetit për 2016. Qeveria ka filluar këtë proces para disa javësh dhe në konsultim me organizatat buxhetore tani e kemi finalizuar dhe dorëzuar në Kuvend për shqyrtim.

Unë fillimisht dëshiroj të falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa, që e ka shqyrtuar këtë projektligj. Në harmoni me Ligjin për financat publike ne kemi dërguar instruksione tek të gjitha organizatat buxhetore dhe u kemi dhënë udhëzimet atyre, se çfarë duhet të bëjnë gjatë procesit. Kanë treguar konstruktivitet të gjitha organizatat buxhetore dhe ne me këtë rishikim të buxhetit e ruajmë stabilitetin e financave publike dhe financimin e qëndrueshëm të projekteve.

Më lejoni të theksoj se ky buxhet është plotësisht i dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar në kuadër të programit që Qeveria ka me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Unë ju informoj se në pjesën e parë të këtij viti kemi pasur një dinamikë më të mirë të zhvillimit ekonomik, se sa që kemi planifikuar fillimisht. Kjo, normalisht, është ndikuar nga reformat ekonomike të ndërmarra në pjesën e dytë të vitit të kaluar dhe një ambienti të jashtëm dhe të favorshëm ekonomik dhe si rezultat i këtyre zhvillimeve, por edhe i formalizimit të aktiviteteve ekonomike në rritje, gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti kemi pasur rritje të të hyrave prej 13,2% në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Dhe, për mendimin tonë, këto janë rezultate inkurajuese dhe që do të vazhdojnë edhe për pjesën e mbetur të këtij viti. Në fakt, ky vlerësim është mjaft konservativ. Prandaj, rishikimi i Buxhetit që sot po e prezantoj para jush në masë të madhe reflekton këto zhvillime dhe politika të Qeverisë për kursimin e parasë publike.

Në këtë rishikim ne kemi rritur parashikimin e të hyrave të përgjithshme për 33 milionë euro, për shkak të performansës më të mirë të të hyrave buxhetore.

Në linjë me zotimin tonë për të kursyer aty ku mundemi, ne kemi propozuar kursime në mallra dhe shërbime prej 5 milionë euro vetëm në organizatat buxhetore qendrore, pra në ministri, jo në komuna dhe jo në organizata të pavarura.

Kemi bërë rialokim të mjeteve nëpër projekte kapitale në shumë prej 27 milionë euro për shkak të dinamikës së ndryshme, më të ngadalshme të shpenzimeve kapitale në disa projekte.

Më lejoni të theksoj gjithashtu se asnjë projekt kapital që është aprovuar në buxhetin fillestar nuk është hequr nga lista, është rishikuar vetëm shumën e buxhetit nëpër këto projekte kapitale, në përputhje me dinamikën e shpenzimeve.

Me mjetet nga të hyrat shtesë, nga kursimet dhe nga rialokimet, ne kemi adresuar nevojat shtesë për investime kapitale dhe për disa shpenzime korrente.

Të hyrat e përgjithshme buxhetore me këtë rishikim do të jenë 1 miliard e 635 milionë euro, që paraqet një rritje prej 11% krahasuar me realizimin, që kemi pasur gjatë vitit 2015 dhe është një ngritje prej rreth 2%, krahasuar me buxhetin fillestar të këtij viti. Kjo si rezultat i rritjes së të hyrave në Administratën Tatimore prej 12,7% krahasuar me vitin 2015 dhe në Dogana me 9,3% krahasuar me vitin 2015.

Shpenzimet totale do të jenë 1 miliard e 732 milionë euro, që është një rritje prej 11% krahasuar me vitin 2015 dhe një rritje prej rreth 3% krahasuar me buxhetin fillestar të këtij viti.

Shpenzimet rrjedhëse do të jenë 1 miliard e 221 milionë euro, shumë e cila është në harmoni të plotë me marrëveshjen që kemi me fondin monetar ndërkombëtar për të qëndruar brenda kufizimeve, sa i përket shpenzimeve korrente.

Tek shpenzimet kapitale, planifikohen me këtë rishikim 499 milionë euro, që është një rritje prej 24% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, ose 8% krahasuar me buxhetin fillestar të këtij viti.

Në këtë rishikim është përmirësuar struktura e Buxhetit, pasi që pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, rritet me këtë rishikim nga 25% sa ka qenë, në 28%. Dhe, kjo është rritje sinjifikante, që është mundësuar edhe përmes adaptimit dhe aprovimit në Kuvend të asaj që e quajmë klauzolë të investimeve për financim të projekteve kapitale.

Ndryshimet kryesore të shpenzimeve janë si në vijim:

- kemi rritur shumën totale për pensionet e veteranë e për 7 milionë euro, pra nga 25 në 32 milionë;

- kemi rritur alokimin për projektin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit për 40 milionë euro shtesë për të përmbushur kushtet e kontratës.

- duke qenë se Kuvendi nuk ka bërë progres në gjetjen e financimit jashtë buxhetor për mediumin publik dhe për pjesën e dytë të vitit kemi ndarë një shumë prej 4,8 milionë euro, sa ka qenë në gjashtë muajt e parë;

- kemi ndarë 2,7 milionë euro për të kryer disa obligime nëpër komuna nga viti i kaluar;
- kemi ndarë 6,7 milionë euro projekte të reja kapitale, të shpërndara nëpër të gjitha komunat (në arsim, në infrastrukturë, në ambient, në sport, rini, banim social, restaurim të objekteve të kulturës dhe projekte të tjera);
- për shtat komuna të vogla kemi ndarë mjete për shpenzime korente për shkak se këto nuk arrijnë të përmbushin obligimet bazike që kanë për qytetarë dhe për biznese. Këto komuna janë: Obiliqi, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi, Juniku, Hani i Elezit dhe Mamusha.
- kemi ndarë mjete për Avokatin e Popullit dhe kemi mundësuar punësimin e 15 personave shtesë, në mënyrë që Avokati i Popullit të kryejë përgjegjësitë ligjore që ka.
- në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik kemi ndarë mjete shtesë për punësimin e 6 personave, për të mundësuar implementimin e plotë të platformës së prokurimit elektronik.

Prokurorit të shtetit i kemi ndarë mjete shtesë për kryerjen e obligimeve ligjore në përputhje me kërkesën që ka bërë prokurori i shteti.

Të nderuar deputetë,

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm, se financimi i prioriteteve vjen nga tatimet dhe ne do të kujdesemi maksimalisht, që paraja publike të shpenzohet sipas ligjit dhe me procedura plotësisht transparente.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas këtij prezantimi të projektligjit, tani hap diskutimin në parim për Projektligjin për Buxhet.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, e ka fjalën, pastaj do të vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 është reflektim i performancës pozitive të agjencive të të hyrave, Doganës dhe Administratës Tatimore, ku realizimi i të hyrave tatimore është për 2,1% më i lartë se buxheti fillestar dhe si rezultat i të hyrave me rishikim janë rritur për 33 milionë euro.

Të hyrat e përgjithshme buxhetore me rishikim do të jenë 1 653 milionë euro, ndërsa shpenzimet do të jenë 1 732 milionë euro, që do të ketë një deficit buxhetor prej 1,6% të bruto-produktit vendor.

Sa i përket strukturës shpenzimet rrjedhëse janë 1 221 milionë euro, ndërsa shpenzimet kapitale, që kanë shënuar rritje për 40 milionë euro, që përfshijnë financimin e autostradës Prishtinë -

Shkup, krahasuar me buxhetin fillestar paraqesin një shumë totale prej 499 milionë euro. Një kontribut në rritjen e shpenzimeve kapitale ka dhënë edhe fillimi i implementimit të klauzolës së investimeve.

Janë ndarë mjete në formë të subvencioneve për veteranët të luftës, për 7 milionë më shumë se sa që kanë qenë. Domethënë, tash do të ketë një fond rreth 32 milionë euro për këtë qëllim.

Financimi i RTK-së do të vazhdojë me shumën e njëjtë të mjeteve sikur në gjashtë mujorin e parë, dhe do të ketë një ndarje edhe për 4,8 milionë për gjashtëmujorin e dytë.

Do të ketë për 12 komunat që kanë më pak se 22 000 banorë, një ndarje për 4 milionë euro për shpenzime të mallrave dhe shërbime. Po ashtu ka pasur edhe një ndarje në shumën prej 6,7 milionë euro për projekte të reja.

Po ashtu, është vlerësuar nga Komisioni pozitivisht edhe rritja e rezervës buxhetore për 20%.

Këto ndryshime buxhetore janë rezultat i kursimeve, diku rreth 5 milionë euro. 27 milionë euro janë rialokime nga programi në program dhe 33 milionë euro janë si rezultat i rritjes së të hyrave mbi parashikimet me buxhetin fillestar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe i rekomandon për miratim në leximin e parë, ndërsa amendamenti do të bëhet sipas procedurës të cilën e kemi aprovuar pak më herët dhe në mes dy leximeve Komisioni do të punojë intensivisht që këto propozime eventuale dhe ndryshimet e nevojshme të rregullojnë në mënyrën e duhur dhe ta kompletojnë Ligjin e Buxhetit për vitin 2016.

Njëherësh, në emër të LDK-së ky rishikim apo ky ligj me ndryshime do të votohet dhe do të përkrahet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash është radha e grupeve parlamentare. Fjalën e ka zonja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, dhe le të përgatiten edhe tjerët për ta marrë fjalën nga radha e grupeve parlamentare.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Rishikimi i Buxhetit është një proces i rregullt nga ana e Qeverisë nëpërmjet të cilit bëhen përshtatjet dhe rregullimet e brendshme të kategorive buxhetore të organizatave buxhetore.

Nëse domi ta analizojmë me kujdes plotësimin dhe ndryshimin e secilës linjë buxhetore, që në fakt ka ndodhur në Buxhetin e vitit 2016, na duhet kohë për ta dhënë kontributin tonë si deputetë në rishikimin e Buxhetit.

Të nderuar deputetë,

Ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës dhe vërehet se janë bërë ndryshime në të hyrat buxhetore dhe janë bërë ndryshime edhe në shpenzimet buxhetore.

Nëse analizojmë me kujdes tabelat buxhetore, shohim se ka ndryshime të shumta në këto tabela krahasuar me Buxhetin e miratuar në fillim të vitit dhe vërehen edhe mosbarazime të shifrave në buxhet dhe gabime teknike për çka sugjerojmë Ministrinë që të bëjë përmirësimet, sidomos në tabelën 1. Të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme.

Është shumë me rëndësi që Qeveria të ketë bërë një analizë të mirë të Buxhetit në gjashtëmujorin e parë, ashtu që rishikimi i Buxhetit të jetë një plan realist i të ardhurave buxhetore dhe të ketë bërë një planifikim të mirë të shpenzimeve buxhetore ashtu që Buxheti të sigurojë financim të qëndrueshëm, të japë efektet e veta në të mirë të jetës së qytetarëve dhe të mos rrezikojmë stabilitetin e qëndrueshëm fiskal.

Me rishikimin e Buxhetit janë rritur të hyrat e rregullta për 33 milionë, ka rritje të hyrave në të ardhurat e korporatave për 3 milionë, në të ardhurat personale për 3 milionë, tatimi në vlerën e shtuar për 6 milionë, ka rritje të hyrave në Dogana, akciza e tjera, por ka edhe reduktime të shpenzimeve për mallra e shërbime, si dhe për shpenzime kapitale.

Reduktimet e shpenzimeve në emër të kursimeve, në kategorinë - mallra dhe shërbime, e po ashtu, edhe në kategorinë e investimeve kapitale mund të vë para vështirësive organizatat buxhetore në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Edhe pse ministri i financave deklaroi këtu, ashtu sikur që ka deklaruar edhe zëvendësministri në mbledhjen e Komisionit për Buxhet se nuk do të dëmtohen organizatat buxhetore me kursimet që janë bërë, ne kemi marrë shumë vërejtje nga organizatat buxhetore të cilat shprehin reagimet e tyre për shkurtime buxhetore të cilave u janë bërë dhe për mosmundësinë për t'i realizuar objektivat, të cilat i kanë paraparë për t'i realizuar.

Është shqetësuese sidomos shkurtimi në kategorinë e shpenzimeve kapitale, me arsyetimin e kursimeve në këtë kategori. Në këto investime përfitojnë qytetarët dhe nuk është shumë e arsyeshme të bëhen shkurtime të mjeteve në këtë kategori.

Edhe gjatë miratimit të Buxhetit për vitin 2016 jemi përballur me problemin e financimit të Radiotelevizionit të Kosovës, problem ky që bartet tani edhe në rishikimin e Buxhetit.

Është shqetësuese mungesa e vullnetit politik dhe neglizhenca e RTK-së dhe institucioneve kompetente për ta zgjidhur problemin e financimit të përhershëm të Radiotelevizionit të Kosovës.

Me ligj në prill të vitit të kaluar ka përfunduar financimi i Radiotelevizionit të Kosovës nga Buxheti i Kosovës dhe asnjë hap në drejtim të zgjidhjes së mënyrës së financimit me ligj të këtij mediumi publik nuk është bërë.

Tani, me rishikim të Buxhetit, është dashur të sigurohen 4,8 milionë euro për të vazhduar punën Radiotelevizioni i Kosovës.

Me rishikim shohim se janë ndarë edhe 7 milionë për veteranët e luftës. Ne mendojmë se është bërë mirë që këto mjete janë ndarë për të financuar veteranët e luftës, por Qeveria duhet të bëjë

rishikimin e procesit të fituarit të drejtës së veteranit të luftës ashtu që të respektohet Ligji për veteranët e luftës dhe ata që kanë abuzuar me këtë ligj të përgjigjen para drejtësisë.

Qeveria ka menduar të bëjë ndarje të reja për komunat për çka na është dashur që në mënyrë të përshpejtuar të miratojmë Ligjin për financat lokale, sepse shkelet formula e granteve.

Mirëpo, Qeveria është dashur të angazhohet edhe për institucionet tjera, të cilat kanë vështirësi për të funksionuar. Pesë universitetet publike, të cilat kanë vështirësi në pagesën e mësimdhënësve dhe funksionimin e tyre, është dashur që të merren parasysh.

Ne si Grup Parlamentar, e përkrahim Projektligjin për ndryshim-plotësim të Buxhetit dhe do të angazhohemi për të dhënë kontributin gjatë punës sonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa për të bërë përmirësimet që konsiderojmë se janë me interes të realizimit të objektivave të Qeverisë dhe në interes të perspektivës së përgjithshme të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Pantina! Urdhëroni!

SHQIPE PANTINA: Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për 2016 është shpërndarë në kuti të deputetëve dje në mesditë. Komisionit për Buxhet e Financa i është dhënë një orë kohë për të shqyrtuar një buxhet - një projektligj i cili i ka 400 faqe. Në fakt, kjo flet më së miri se sa serioze është kjo qeveri dhe sa seriozisht ky koalicion qeverisës e konsideron mënyrën e shpenzimeve të parasë publike ku ligjin më të rëndësishëm e kalon për më pak se 24 orë dhe atë me procedurë shkel e shko. Një praktikë e tillë le të kuptohet se Qeveria po tenton të fshehë diçka. Ndryshe, si arsyetohet kjo nguti?

Kjo flet edhe për një planifikim të dobët të Buxhetit. Përderisa për vitin e kaluar, ministri ishte arsyetuar se kishte marrë pozitën vonë dhe atij i është dashur që ta procedojë një buxhet i cili ishte hartuar nga një qeveri e mëhershme, kësaj radhe ai ka pasur kohë të mjaftueshme që të shqyrtojë dhe përcjell Buxhetin ashtu si duhet dhe ta planifikojë atë, prandaj nuk e kuptojmë se pse ai nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zëvendësi i ministrit arsyetoi se vonesat kanë ndodhur për shkak të negociatave me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe po ashtu tha se në një pikë nuk është arritur marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kjo kishte të bënte me pensionet për veteranë, përderisa ministri këtu thotë se është arritur dakordim i plotë me FMN. Tani, në fakt, nuk po e kuptojmë cila është e vërteta e plotë në këtë rast. Mirëpo, në qoftë se Buxheti është proceduar pa marrëveshje të plotë me FMN dhe kjo në pikën e veteranëve të luftës, kjo po tregon se kur juve ju konvenon për interesat tuaja, që janë kryesisht interesa klienteliste dhe fare të drejta për publikun e gjerë, ju nuk i merrni fare për bazë vërejtjet e miqve ndërkombëtarë përveç nëse FMN-në nuk e keni radhitur në listën e miqve që ju i konsideroni.

Me këtë rast, në fakt me pjesën për Buxhetin për veteranët e luftës, veteranëve u është shkelur e drejta, sepse atyre veteranëve që kanë luftuar vërtet në mbrojtjen e vendit, duke rrezikuar kështu që edhe ata të mos i gëzojnë beneficionet që dalin nga ligji për shkak të fryrjes së lisave të cilat janë bërë kryesisht në shkëmbim të votave për të cilat ju u keni ofruar këto beneficione.

Nuk është kjo e vetmja padrejtësi. Në fakt, qeveritë e mëhershme të drejtuara nga Thaçi, ajo Thaçi 1 dhe Thaçi 2, ishin cilësuar si qeveri asfalti. Me Qeverinë Mustafa kishte një optimizëm, të atillë që shpresonim se kjo qeveri që udhëhiqet nga një ekonomist Buxhetin mund ta orientojë kah zhvillimi ekonomik. Por, edhe kjo qeveri pjesën më të madhe të investimeve kapitale i ka përqendruar në asfalt.

Shuma totale sipas ministrit për investime publike është 499 milionë euro dhe nga këto 499 milionë 204,5 milionë euro shkojnë në Ministrinë e Infrastrukturës, gjegjësisht për ndërtim të rrugëve.

Në fakt, përveç Ministrisë së Infrastrukturës, edhe Ministria e Pushtetit Lokal e cila në fakt nuk ndodhë asnjëherë në praktikë, 3,5 milionë të Buxhetit do t'i harxhojë për të ndërtuar rrugë dhe trotuare plus, shtu këtu, buxhetet e komunave veç e veç, të cilat po ashtu në një pjesë të madhe shkojnë në asfalt, kështu pothuaj se i bie që gjysma e Buxhetit shkon thjesht në asfalt për deri sa, ta zëmë investimet kapitale në shëndetësi janë vetëm 18 milionë. Pra, për Qeverinë është më e rëndësishme të ndërtojë rrugë se sa të kujdeset për mirëqenien e qytetarëve dhe të investojë në shëndetësi e cila është një nga sektorët më problematikë pothuaj i gjithë sektorit qeveritar.

Pra, e njëjta logjikë e investimeve në asfalt shkon edhe në komuna. Ta marrim si shembull vetëm komunën e Drenasit e cila i bie me rend të alfabetit të jetë e para. Janë plot 25 projekte vetëm për vitin 2016, që kanë të bëjnë me asfalt dhe vetëm një projekt, ta zëmë, për ndërtimin e çerdheve. Edhe kjo po ashtu flet për prioritetet e kësaj Qeverie, e cila më të rëndësishëm e ka asfaltin, ndërtimin e rrugëve, edhe për faktin se është forma më e mirë dhe më e lehtë për të abuzuar dhe keqpërdorur me tenderë dhe nuk i kushton fare rëndësi edukimit të brezave, e veçanërisht kujdesit ndaj fëmijëve, duke pasur parasysh mungesën e madhe të çerdheve publike me të cilat ballafaqohet e gjithë Kosova.

Pra, shumica e mjeteve të alokuara për komunën dhe në shumicën e komunave janë mbi 60% të Buxhetit të cilat shkojnë në paga e mëditje dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre pagave janë kryesisht për administratë e cila në fakt nuk po kthehet në shërbime më të mira.

Pra, brenda afatit kohor e cila na është dhënë në dispozicion për ta shqyrtuar këtë Buxhet, konkluzioni është se edhe ky Buxhet si edhe i qeverive të mëhershme, është Buxhet i asfaltit dhe absolutisht nuk garanton zhvillim ekonomik dhe mirëqenie për qytetarët, prandaj si të tillë Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta mbështesë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim dhe ndryshim të ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Së pari dua të cek dhe falënderoj ministrin për një angazhim të madh për të rritur të hyrat në Buxhetin e Republikës së Kosovës sidomos për sektorin i cili ka qenë shumë i anashkaluar në sektorin e ekonomisë së Kosovës. Fjalën e kam për sektorin e argjendarëve. Besoj se këtë sektor e kemi rregulluar me disa udhëzime administrative dhe me ligjin për TVSH, ashtu që edhe në

vitin e ardhshëm 2017 do t'i kemi të hyrat më të shumta sepse për import argjendarët do të kenë lehtësime.

Në aspektin e komuniteteve, disa herë kemi folur për këtë çështje, por nuk kemi mund ta gjejmë një zgjidhje për rregullimin e dy njësive buxhetore. Njësinë e parë e kemi për zyrën e komuniteteve dhe të dytën e kemi për ministrin e komuniteteve dhe kthim.

Ju e dini se më 2015 kemi ndarë sipas kodeve këtë buxhet por nuk mundëm të realizojmë asnjë cent. Edhe këtë vit kemi menduar që të gjejmë një zgjidhje më afatgjatë dhe kemi cekur në nenin 10 dhe nenin 11 ku thuhet se ky Buxhet duhet të riprogramohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës, por deri tani edhe zyra e kryeministrit - zyra e komuniteteve, edhe në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim janë nisur të shpenzojnë pare pa riprogramim dhe kjo është një shkelje e ligjit, shkelje e Ligjit të Republikës së Kosovës, sidomos nenin 10 dhe 11.

Unë prej kryeministrit dhe ministreve të gjejmë një formulë ku komunitetet tjera jo serbe do të gëzojnë të marrin projekte prej këtyre dy njësive ekonomike ose njësitë buxhetore. Në të kundërtën, unë besoj se jo që do të abstenojmë, por të votojmë kundër këtij Buxheti të Republikës së Kosovës.

Edhe në këtë rishikim kemi hasur disa zvogëlime në projektet e komuniteteve dhe unë besoj se kjo do të përmirësohet në rishikim në Komision, sidomos për ndërtimin e shtëpinë e kulturës në Mitrovicë ku i kemi pasur në fillim të Buxhetit afro 40 000 euro, por kemi pa se ky është zvogëluar për 23 000 euro, prandaj besoj se gjatë shqyrtimit në komision, kjo do të përmirësohet, në të kundërtën "6+" nuk do të votojë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare, tjerë që donë të marrin fjalën nuk ka. E ka fjalën zonja Xhevahire Izmaqu, nga Partia Demokratike e Kosovës dhe le të përgatitet profesori Muhamet Mustafa nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pastaj zonja Besa Baftija, nga Lëvizja "Vetëvendosje".

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kam vetëm një propozim, të cilin do ta bart pastaj në Komisionin Funkcional si amendament. Është çështja te propozimi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Pra, kërkesa e tyre është adresuar saktë për shifrën prej 30 000 eurove në kategorinë e mallrave e shërbimeve.

Prandaj, pasi jam anëtar e Komisionit Funkcional, po e bart si lobim dhe besoj se do të ketë mirëkuptim edhe nga ministri, pasi është institucion i pavarur dhe i shërben vendit edhe në kohën kur ne kemi nevojë për reforma në administratën publike. Pra, këtë do ta bart edhe si amendament dhe besoj që nuk është shifër shumë e madhe dhe është shumë mirë e justifikuar prej Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Faleminderit ministër!

KRYETARI: Faleminderit! Profesor, fjalën e merrni ju!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër dhe i nderuar Kabinet qeveritar,

Mendoj se dokumenti që e kemi para veti dhe që ka të bëjë me rishikimin e Buxhetit për vitin 2016 me të vërtetë shpreh një trend pozitiv të konsolidimit të financave publike, të të ardhurave dhe disa nga komponente që mund të konsiderohen si rrethana pozitive në stabilitetin makro ekonomik, i cili mendoj që në vitet e ardhshme Qeverisë dhe neve do të na mundësojë që më me qetësi dhe më me një shikim afatgjatë dhe menduar më mirë t'i ndjekim prioritetet nacionale të zhvillimit ekonomik.

Mendoj që është rrethanë pozitive që ne sot po ia japim vizën në leximin e parë një rishikimi të Buxhetit që do të thotë rritje të ardhurave buxhetore për 33 milionë në krahasim me planifikimin në fillim të vitit, ose 165 milionë në krahasim me Buxhetin e vitit të kaluar, që do të thotë mbi 11% rriten të ardhurat buxhetore në krahasim me vitin e kaluar.

Gjithashtu, pozitive është se ne po rrisim edhe investimet kapitale, të cilat do të prodhojnë një rritje më të madhe ekonomike, 36 milionë në krahasim me Buxhetin në fillim dhe 100 milionë në krahasim me vitin e kaluar, që do të thotë 99 - 100 milionë investimet kapitale rriten në krahasim me vitin 2015, që do të thotë diku 20%, e që është një kthesë e mirë.

Po ashtu, për stabilitet flet edhe rritja e bilancit bankar nga rreth 290 milionë në 335 milionë. Këto janë rrethana pozitive të cilat duhet të thellohen me politika dhe prioritetet zhvillimore të cilat do të stimulojnë rritjen ekonomike dhe gjenerimin e vendeve të punës.

Mendoj se ka ardhur koha që ne të bëjmë një analizë më të thuktë të problemit të imobilizimit të kapitalit financiar në Kosovë. Fakti se këtu kemi një bilanc bankar 335 milionë ose 5,6% të GDP dhe kjo bashkë me Fondin e Privatizimit dhe bashkë me Fondin e Pensioneve, do të thotë se jashtë vendit neve na mobilizohen diku rreth 2 miliardë dollarë, që do të thotë diku rreth 30% të GDP dhe në këto kushte edhe sipas teorisë dhe sipas praktikës ekonomike është vështirë të gjenerojmë rritjen ekonomike që ne e synojmë, në qoftë se 1/3 e GDP rri e imobilizuar diku, nuk qarkullon, neve na krijon rrethanë vështirësuese që të mbërrijmë normat e rritjes ekonomike të cilat i kemi kërkuar dhe të cilat besoj se janë të arritshme dhe diku prej vitit të ardhshëm ndoshta kalojnë në 5, pastaj në 6 e 7% ashtu që të tejkalohen ato probleme që kanë të bëjnë me gjenerimin e vendeve të punës.

Në këtë drejtim, mendoj se ndoshta duhet të bëhet ndonjë analizë dhe bashkë me partnerët ndërkombëtarë të shohim këtë problem të imobilizimit të një vlere të shtuar në Kosovë që krijohet në mënyrë që ta fusim në funksion të zhvillimit ekonomik.

E dyta. Mendoj që është një e mirë që po e kontrollojmë hyrjen në borxh, në borxhin e brendshëm dhe borxhin e jashtëm po kontrollohet dhe nuk kemi rrezik të ngarkesës. Megjithatë, një strategji dhe një investim në rritje ekonomike e këtij borxhi dhe në punësim do të ishte i dëshirueshëm në mënyrë që të mos vijmë në situatë me probleme të pagesës së borxhit.

Një çështje që duhet ndoshta t'i kushtojmë kujdes, është aftësimi i segmenteve të caktuara të shtetit ligjor, komponimit të shtetit ligjor. Konkretisht, ne kemi biseduar për kontekstet biznesore dhe për mungesën e stafit dhe kushteve në gjykatën e Kosovës apo gjykatat e Kosovës që të

trajtohen kontekstet biznesore dhe ekziston një rekomandim i Kuvendi. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjë që është pozitive, ka reaguar pozitivisht për këtë prandaj ne duhet të shohim të rrisim një destinim të Buxhetit për këtë komponentë të atij departamenti të gjykatës dhe një ristrukturim brenda ministrisë ose Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe eventualisht me mbështetje shtesë në mënyrë që kontekstet biznesore të trajtohen brenda disa viteve ashtu sikur që kemi kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës brenda disa muajve.

Problemi, shumë i rëndësishëm, dhe i vështirë me të cilin do të ballafaqohemi, është barra e transfereve sociale dhe e pakos sociale, duke përfshirë këtu edhe pensionet dhe sidomos pensionet e veteranëve.

Kjo është një çështje mjaft aktuale, që ne duhet me transparencë dhe prioritet të shohim se sa ka mundësi Kosova ta trajtojë këtë. Ekziston një limit i investimeve në çështje sociale, nëse nuk duam që të rrezikojmë stabilitetin makro ekonomik dhe rritjen ekonomike. Dhe, brenda atij limiti, ne do të shohim çka duhet bërë. Ose duhet të zvogëlojmë numrin e atyre që përfitojnë nga kjo pako ose duhet të zvogëlojmë vëllimin në ndihmë. Pra, t'i shohim edhe ligjet, nëse duhet parë dhe në qoftë se ky ligj që e kemi aprovuar për veteranët ka mundësuar që vërtetë 46 000 vetë të hyjnë, në vend të atyre që ne kemi pritur të jenë 17 - 18 000 apo 20 000, do të thotë s'është diçka në rregull me këtë ligj. Por, ne duhet ta shohim.

Kjo do të thotë se luftëtarët e vërtetë, luftëtarët të cilët kanë luftuar, ata duhet të servisohen në mënyrë të denjitetshme dhe me një pension që i ka hije një njeriu që ka luftuar me armë në luftë. Pra, ata që kanë ndihmuar luftën dhe që kanë kontribuar, e që janë shumë, atyre duhet dhënë një mirënjohje por nuk mund të kenë tretman të njëjtë me ata që kanë luftuar në front. Prandaj ne duhet të shohim ligjin dhe në qoftë se ligji ka hapur një mundësi të tillë, unë besoj se komisioni që ka qenë aty i ka parë me përgjegjësi ato dokumente, po në qoftë se ligji ka vrirë, ku mund të depërtojnë edhe ata që nuk e meritojnë luftën dhe nuk e meritojnë këtë tretman të veteranit të luftës, domethënë të luftëtarit me armë kundër okupatorit, atëherë mendoj se ne duhet të shohim, përndryshe unë nuk besoj që Kosova mund ta përballojë këtë pako sociale të rënduar nga disa komponentë dhe njëkohësisht të gjenerojë zhvillim ekonomik dhe investime kapitale.

Gjithashtu mendoj se nuk është e arsyeshme që tre vjet jemi duke e shtyrë për çdo 6 muaj zgjidhjen e financimit afatgjatë të RTK-së.

RTK-ja më nuk duhet ta rëndojë buxhetin e Kosovës, duhet të gjendet një burim alternativ i financimit, stabil, i cili i mundëson që të kryejë funksionet e veta si transmetues publik.

Po kthehem përsëri në fillim, ky rishikim i buxhetit është një trend i mirë dhe një lajm i mirë dhe unë ftoj deputetët që ta përkrahin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Mustafa! Fjalën e merr deputetja Besa Baftija, pas saj Bekim Haxhiu, e pas tij Fatmir Rexhepi.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Miratimi i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 më 14 dhjetor është kontrabanduar nga Qeveria dhe Kuvendi, sepse u votua pasi u përjashtua opozita dhe jo në sallën plenare të Kuvendit, po në një hapësirë alternative.

Edhe në rishikimin e buxhetit për vitin 2016 Qeveria e sjell në Kuvendit në afatet e fundit ligjore, në procedura të shpejta, bile edhe materialet në kuti të deputetëve janë shpërndarë vetëm 24 orë para seancës. E kjo tregon se kjo Qeveri sa është e interesuar që të ketë debat në Kuvend lidhur me çështjet shumë të rëndësishme, siç është buxheti.

Sa i përket buxhetit të miratuar për shëndetësi, edhe tani në rishikim, nuk është një buxhet që i përmbush kërkesat dhe nevojat për sistemin shëndetësor në tërësi, e kur kësaj ia shtojmë edhe menaxhimin jo të mirë të buxhetit, atëherë ajo që thonë këta qeveritarë, se shëndetësia është prioritet i kësaj Qeverie, mbetet vetëm në letër.

Prandaj, shpresat për qytetarët për një kujdes shëndetësor më të mirë tani më janë shuar, sepse çdo ditë po ballafaqohen me të njëjta probleme tash e 17 vjet. Ende duhet blerë prej gjilpërës e deri te penjtë kirurgjikë, ende duhet pritur me muaj për një ekzaminim echo stenografik apo rentgenologjik.

Për sigurimet shëndetësore deri tani janë dhënë data të ndryshme të fillimit të implementimit, por ato nuk i kemi.

Në buxhetin 2016, në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve, ku hyn edhe furnizimi me barna, kemi zvogëlim për 10% në krahasim me vitin e kaluar.

Sa i përket investimeve kapitale, edhe pse me rishikim të buxhetit kemi një rritje për 1.1 milionë, prapë kjo nuk siguron se do të kemi ndonjë investim sa i përket infrastrukturës teknologjike mjekësore moderne. Pasi që të gjitha investimet po shkojnë vetëm në asfalt, u tha nga deputetja Pantina se janë diku 204 milionë që janë shkuar për investime kapitale apo infrastrukturë rrugore vetëm në Ministrinë e Infrastrukturës, gjegjësisht në Ministrinë e Bechtel&Enkës, të ashtuquajtur të Bechtel&Enkës.

Të rishikim të buxhetit prapë mjetet të mëdha janë të destinuara për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike, që janë 5 milionë e 800 mijë, deri sa kanë qenë 6 milionë. Kjo le të kuptojë se këta qeveritarë janë duke ndihmuar dhe janë duke punuar për forcimin e institucioneve private, edhe ashtu tanimë me një dallim shumë të madh sa i përket kushteve, qoftë teknologjike me krahasim me ato publike.

Po ashtu kemi një zvogëlim të fondit për stimulim të kuadrove profesionale, për 61.73%, apo shuma mjeteve ka qenë 382.960 euro, tani me rishikim të buxhetit është 146.576 euro.

Prandaj, si t'i joshim profesionistët të punojnë dhe të kontribuojnë në sektorin publik?

Buxheti për mallra dhe shërbime ka hyrë, ky hyjnë edhe barnat, në SHSUK është zvogëluar për 57.96%.

Për sistemin informativ shëndetësor, që është një parakusht për implementimin e sigurimeve shëndetësore, janë ndarë mjete nga Qeveria e Republikës së Kosovës në total 2 milionë e 643 mijë e 956 euro, e tani dihet se për të njëjtin është kah punohet prej vitit 2009, e janë dhënë miliona nga Qeveria e Luksemburgut dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, e nuk dihet se ku kanë përfunduar këto mjete.

Ne kemi kërkuar dhe ende kërkojmë që të bëhet informimi i Kuvendit lidhur me fondet milionëshe të dhëna nga Qeveria e Luksemburgut.

Për odat e profesionistëve shëndetësorë, në nenin 5 të ligjit bazik, paragrafi 2 i shtohet paragrafi me numër 3, ku thuhet se të gjitha të hyrat të arkëtuara në vitin 2016 nga ky nënprogram barten në xhironlogarinë e odave nga Thesari. E dimë se Ligji për Odat e profesionistëve shëndetësorë ka kaluar në Kuvend në vitin 2013 dhe kanë kaluar tre vjet dhe ende odat nuk funksionojnë.

Kanë filluar të ushtrojnë vetëm disa detyra, nuk i ushtrojnë detyrat që parashihen me ligj.

E më 30 shtator, ministri Rahmani ka dorëzuar disa kompetenca te odat, por jo ato që u takojnë me ligj, siç janë licencimi dhe rilicencimi i profesionistëve shëndetësorë, sepse këto licenca deri në dhjetor do të lëshohen nga Ministria e Shëndetësisë, e që është në kundërshtim me odat.

E sot e kemi edhe një reagim të kryetares së Odës së Mjekëve, zonjës Hundozi, e cila e kundërshton këtë vendim të ministrit Rahmani, pasi të gjitha këto janë në kompetencë të odave.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në këtë rishikim të buxhetit nuk do të ketë përmirësim në sektorin e shëndetësisë. Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do të votojë këtë rishikim të buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Bekim Haxhiu, të bëhet gati Fatmir Rexhepi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në aspektin e përgjithshëm, nëse buxheti shikohet brenda kësaj periudhe sa kemi pasur mundësi ta shqyrtojmë tani në rishikim, jam i brengosur se po shkojmë kah një buxhet shpenzues dhe jo kah investimet kapitale.

Ndërsa, nëse hyjmë në detale po shoh, ne edhe në disa diskutime, të cilat i kemi pasur këtu, në veçanti kur kemi pasur raportin e Agjencisë për Komplekset Memoriale, ka qenë kërkesë e të gjithë deputetëve, e shumicës, të them, të deputetëve që të fillojë konservimi i kompleksit memorial “Adem Jashari”, për shkak se kompleksi “Adem Jashari” po rrezikohet pa e bërë këtë konservim. Prandaj, kërkoj që në këtë rishikim të buxhetit të planifikohet konservimi i kompleksit memorial “Adem Jashari”.

Gjithashtu në Projektbuxhetin e vitit 2015, me amendamentin që kemi bërë, kemi pasur të planifikuar 400 mijë euro për stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë, të cilat tani janë në shumë e 290 mijë euro në këtë projektbuxhet, shtuar edhe shumën të cilën kryeministri e ka ndarë për

këtë stadium nga rezervat e tij apo rezervat shtetërore. Mendoj që duhet edhe një buxhet shtesë që stadiumi “Adem Jashari” të përgatitet në total për ndeshjet ndërkombëtare.

Kur jemi te ndeshjet ndërkombëtare gjithsesi kërkoj që pjesë e këtij projektbuxheti të jetë edhe ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Sportive dhe Terapisë Fizikale, në të cilën është e planifikuar të ndërtohet edhe Agjencia anti-doping, për arsye se është kërkesë sipas nevojave të zhvillimit të sportit të Kosovës dhe mendoj që edhe ka qenë i planifikuar dhe i projektuar në kuadër të KASH-së, ka qenë projekt i cili është zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë, por i cili nuk ka ardhur ende për votim në Kuvendin e Kosovës.

Gjithashtu vazhdimi i punimeve në rrugën Klinë e Epërme, Skenderaj, Komoran, duhet të jetë i paraparë në formën që ajo rrugë të përfundojë sipas projeksioneve të bëra në vitet paraprake dhe të mos kemi ngecje në zhvillimin e këtij projekti.

Gjithashtu ishte edhe njëra nga pyetjet e mia parlamentare të sotme për vazhdimin e punimeve në rrugën Prishtinë-Mitrovicë, gjegjësisht nga Stanovci deri në Mitrovicë, rruga M2.

Mjetet e planifikuara për ndërtimin e shkollës “Hamzë Jashari” në Skenderaj prej 50 mijë eurove as nuk përmbushin kërkesat e kërkuësve, në këtë rast Kuvendit Komunal të Skenderajt dhe as nuk mund të projektohet dhe të përfundohet me këtë buxhet të paraparë gjithashtu edhe për shkollën e Qirezit.

Ajo çka është një vërejtje gjithsesi imja edhe për ministrin e Financave, po sigurisht edhe për ministrin e Zhvillimit Ekonomik, janë projektet në kuadër të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, ku kemi të planifikuar buxhetin vetëm për dy ndërmarrje publike, për Infrakosin dhe Trankosin, por janë të harruara ato ndërmarrje publike, ndoshta mund të themi me interes vital.

Unë mendoj që ujësjellësit, edhe të Mitrovicës edhe të Prishtinës, por edhe ambienti do të duhej të ishte një nga prioritetet edhe të Qeverisë, por edhe të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike për zhvillimin e këtyre projekteve.

E dimë fare mirë se Ujësjellësi i Mitrovicës përballet me probleme serioze funksionale, për shkak se ata prodhojnë ujë edhe për pjesën veriore, por asnjëherë nuk kanë arritur të inkasojnë të hyra për atë pjesë, ndërsa sigurisht që do të duhej të kompensohej ose të gjejnë mënyra që këto shpenzime, të cilat do të bëjnë të inkasohet, ose do të duhet një mbështetje shtesë nga Fondi për Zhvillim i pjesës veriore, i cili sigurisht që do ta parashihte që kjo mundësi e financimit të Ujësjellësit të Mitrovicës të bëhet, që vërtet qytetarët e asaj pjesë, po edhe vetë kompania të jetë më funksionale në interesin e tyre.

Gjithashtu nuk ka asnjë mbështetje viteve të fundit për kompani të ambientit, në këtë rast për kompaninë për menaxhimin e mbeturinave dhe kompanitë e komunave, të cilat po përballen me probleme serioze, për arsye se e dimë se inkasomi në komuna, qoftë në kryeqytet apo komuna të tjera, është tejet i ulët dhe këto kompani kanë probleme serioze në funksionimin e tyre, dhe mendoj që këtu duhet një mbështetje e nivelit qendror për këto kompani.

Sigurisht që edhe mbështetja duhet të realizohet në bazë të performancës së këtyre kompanive, se sa janë ato duke realizuar objektivat e tyre dhe sa janë kompani, të cilat vërtet kanë pasur raporte pozitive në vlerësimin e Auditorit të Përgjithshëm, por edhe të vlerësimeve ndërkombëtare sa i përket funksionimit të tyre.

Kur jemi te shëndetësia, gjithsesi mendoj që është më tepër lëshim apo papërgjegjësi edhe vetë hartuesit, nuk e akuzoj tani ministrin e Financave, për arsye se mendoj që në këtë formë ia ka sjellë ministri i Shëndetësisë, por është nonsens që në kuadër të projektit të sistemit të informimit shëndetësor të futen projekte të tjera, siç është projekti për programet investive, ambulanca dhe automjete të tjera, të jenë pjesë e projektit të sistemit të informimit shëndetësor. Nuk ka logjikë që ambulancat dhe automjetet e tjera të nevojshme të futen në kuadër të programit të sistemit të informimit shëndetësor.

Programi i sistemit të informimit shëndetësor duhet të realizohet në atë formë që ky projekt të realizohet dhe të implementohet dhe këto mjete, të cilat kanë mbetur sigurisht, ndoshta është menduar se janë për mirëmbajtjen e këtij projekti, për arsye se planifikimi i implementimit të këtij projekti ka qenë për vitin e kaluar, është provuar, nuk ka arritur.

Dhe ne, pa e implementuar programin e sistemit të informimit shëndetësor nuk mund të kemi sigurime shëndetësore, Këto dy projekte janë të lidhura thellësisht njëra me tjetrën.

Ne nuk mund të flasim për sigurime shëndetësore dhe nuk i kemi të planifikuara në këtë projektbuxhet derisa nuk e kemi të implementuar këtë program.

Prandaj, sigurisht që përgjegjësia bie mbi hartuesin, në këtë rast në Ministrinë e Shëndetësisë, jo mbi Ministrinë e Financave, po sigurisht edhe bashkëpunimi juaj, i nderuar ministër Hoti, me ministrin e Shëndetësisë do të duhej të ishte i nivelit të tillë që ky projekt të përfundonte tani më.

Gjithashtu tek Agjencia e Financimit Shëndetësor, përveç pajisjeve mjekësore, kësaj agjencie tani i janë bartur kompetenca edhe në ndërtim infrastrukturor.

Ndërtimi i objektit të spitalit në Ferizaj do të duhej të ishte projekt i Ministrisë së Shëndetësisë apo i shërbimit klinik spitalor, por jo i agjencisë.

Agjencia në bazë të Ligjit të shëndetësisë ka të tjera kompetenca, nuk i ka investimet kapitale në kuadër të kompetencave të saj.

Prandaj, mendoj që është një gafë e madhe e ministrit të Shëndetësisë kur ka futur projektet të investimeve kapitale në projektin e Agjencisë së Financimit Shëndetësor. Kjo është një papërgjegjësi komplet e ministrit të Shëndetësisë që unë e kam cekur disa herë që ai nuk është i aftë ta kryejë këtë punë. Po, sidoqoftë, që mbetet çështje juaja për ta vlerësuar nivelin dhe performansën e tij.

Në tërësi mendoj që ky projektbuxhet ka nevojë të plotësohet brenda kësaj periudhe të shkurtër kohore, sa na ka mbetur neve si deputetë për ta trajtuar dhe për ta shqyrtuar.

Unë do bëja amendamentet e mia në kuadër të këtij projektbuxheti dhe besoj që me plotësimin e atyre amendamenteve do të japim edhe votën për Projektbuxhetin e rishikuar të Republikës së Kosovës për vitin 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Fatmir Rexhepi, pas tij flet Albulena Haxhiu.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje, kolegë deputetë,

Përsëritje kryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Sot na u dha mundësia që të kemi para veti dhe të diskutojmë lidhur me Projektbuxhetin e rishikuar për vitin 2016.

Prandaj, që në fillim edhe unë do të përkrah në parim fjalën hyrëse të ministrit të Financave, i cili i dha në mënyrë të kompletuar sqarimet për të gjitha politikat të cilat janë udhëhequr deri më tash, po edhe ato të cilat mendoj që duhet edhe më tutje të menaxhohet para publike.

Në mënyrë të veçantë dua të shpreh besimin e plotë timin si deputet. Për periudhën kohore mbi një vit e diçka që ministri i Financave me politikën e drejtë e me politikën profesionale mendoj që ka bërë mirë udhëheqjen dhe menaxhimin e parasë publike në nivel të vendit. Është ndër ministrat e rrallë që prej kur ekziston Kuvendi i Kosovës, pra këtu që kam dëgjuar një punë të atillë me shumë respekt për profesionin që e ushtron si ministër.

Ajo që dëshiroj të potencoj dhe që u tha edhe nga kolegë deputetë këtu, qoftë nga zonja Pantina, qoftë nga profesor Mustafa, e të tjerë, është trendi edhe mundësia që të ruajmë stabilitetin makro-ekonomik të vendit edhe në periudhat që na presin, që nuk është e lehtë.

Prandaj, me shumë kujdes besoj se Ministria, Qeveria, Kryeministri do të shkojnë, pra, që të ruhen këto trende të këtij stabiliteti makro-ekonomik të vendit, në mënyrë të veçantë cili do të ishte shansi më i madh i shfrytëzimit të atyre mjeteve që u thanë këtu që janë mbi 2 miliardë, të cilat janë në formë pasive dhe të cilat nuk po mund të vihen në funksion, nga pengesa ligjore apo edhe pengesa të tjera të natyrave të ndryshme, në mënyrë që vitet e ardhshme, apo viti 2017, 2018 e kështu me radhë të kemi një shans më të mirë me ndryshimin e këtyre projektligjeve në shfrytëzimin e këtyre mjeteve dhe vendosja apo shfrytëzimi i tyre të krijojë mundësi më të mëdha rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne sot i kemi trendet rreth 4% GDP-së që është rritja e produktit vendor, e cila flet pozitivisht për qeverisjen e mirë, mirëpo unë e di që shanset janë shumë më të mëdha, pra që brenda dy vjetëve kjo qeveri dhe vendi ynë ta presim diku ndoshta me mbi 6% rritje ekonomike, që do të ishte me interes dhe me impakt më të madh në zhvillimin e vendit.

Pra, unë pres që ju me politikën tuaj të vazhdoni në mënyrë të veçantë, pra t'i trajtoni këto tema, siç u tha, edhe tema të tjera. Të mos bëjmë hile si shoqëri.

Unë para do ditësh e dëgjova me shumë respekt njërin nga udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të vendit, zotin Jakup Krasniqi, një figurë shumë e respektuar e jetës politike, i cili tha se diku rreth 20 mijë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë marrë pjesë përafërsisht. Prandaj, rritja e

numrave në 45 mijë apo 50 mijë apo sa ka pretendime edhe më tutje nuk flet mirë për vendin, nuk flet mirë për financa, nuk flet mirë as për ata njerëz që kanë luftuar, sepse ata nuk do të kenë mundësi të kenë trajtim meritore ashtu qysh duhet. Pra, është thirrja edhe nga ana ime si deputet për ata njerëz që e kanë këtë kompetencë, për atë institucion i cili e vlerëson dhe e merr këtë vendim, që duhet t'i japin fund deri në fund të vitit listës dhe të mbetet ai numër real, jo të futen në lista njerëz, të cilët e kanë shikuar luftën nga televizori nga vende të ndryshme të vendit.

Prandaj, kjo duhet të ndodhë para se të hartohet edhe projektbuxheti i vitit 2017, në mënyrë që t'u dalim hak njerëzve që vërtet kanë luftuar për këtë vend. Atëherë do ta aprovojmë projektbuxhetin, vlerën reale, mundësitë reale që jep buxheti i një vendi për ta trajtuar këtë kategori të njerëzve. Prandaj, nuk duhet t'ia lëmë kohës, nuk duhet të krijojmë vonesa, nuk duhet të përhojmë të marrin përgjegjësi mbi vete të gjithë ata udhëheqës të luftës, komandantë që e kanë firmën aty. Është nder për vendin të thuhet e vërteta.

Prandaj, presim prej tyre që të japin zgjidhje të drejtë, pa asnjë anim për kërkim. Dhe ne bashkërisht këtu në Kuvend do ta aprovojmë atë shumë të mjeteve, e cila do të reflektonte nesër me dinjitet për këta veteranë, të cilët realisht kanë luftuar për vendin.

Prandaj, për të ruajtur stabilitetin makro-ekonomik ne nuk duhet të ndërtojmë një shoqëri, e cila ka kategoritë të ndryshme sociale, të rënda, që bien mbi barrën e ekonomisë së vendit. Nuk mundet kjo ekonomi të zhvillohet, nuk mundet sektori privat të përparojë, të ketë progres, të ketë investime në qoftë se ne e rëndojmë kaq shumë.

I thashë këto vërejtje dhe iu bashkëngjita këtyre vërejtjeve se janë me të vërtetë ato të cilat do ta prekin dhe të kishin ndikim në politikat makro-ekonomike të vendit. Po kjo nuk është çështje e një ministri, nuk është vetëm çështje e kryeministrit, këto janë çështje të gjitha subjekteve politike t'u japin zgjidhje të drejtë, sepse kur po vijmë në parlament, po flasim në interes nacional, në interes të vendit. Prandaj, nëse na thirr diçka në interes të vendit është edhe kjo, që realisht të japim përgjigje për çështjet të cilat na takojnë, e jo të vonohemi apo të bëjmë politika destruktive.

Një vërejtje, sa i përket specifikimeve që janë dhënë këtu e kam te Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila në faqen 44 i ka paraparë disa mjete, siç thuhet për "Rregullimin e shtratit të lumit Mirusha në Gjiilan". Nuk e pata ndërmend ta përmend, por kjo e ka një histori të veten, diku që nga mandati i vitit 2008, kur isha deputet e deri tash, pra është ky problem që i përcjell qytetarët e Gjiilanit.

Në qendër të Gjiilanit janë hapur ato gropa, janë hapur ato kanale e asnjëherë nuk përfundojnë.

Prandaj, thirrja ime është që të shikohet, mundësisht nëse ka mundësi tash me rishikim të bëhet ndonjë bartje që atje është paraparë më 2017 150 mijë euro, a janë më 2018 a më përpara, në rregull, nëse jo, atëherë sugjerimi im është që së paku në planifikimet buxhetore të vitit 2017 t'i japim fund jo harrimit, po realisht përmbylljes së këtij projekti, i cili ka filluar që po them 8 vjet në komunën e Gjiilanit. Në qendër të qytetit e shihni të gjithë atë gropë dhe e shihni gjithë atë çka është, jo mirë për qytetarët e për jetën e qytetarëve.

Pra, po them, nëse s'këm mundësi tash, atëherë më mirë është t'i planifikojmë për vitin e ardhshëm 300 mijë, 400 mijë, 500 mijë euro dhe t'i japim fund kësaj odisejade, e cila vërtet për qytetarët e Gjilanit është shumë e rëndë.

Unë pres, pra, që nëse jo tash, në planifikimin e vitit 2017 të kemi parasysh t'i japim fund kësaj. Nuk ka kuptim prej qytetarëve të Gjilanit të hapet kjo temë. Janë mundësitë, besoj që gjejmë edhe mundësitë financiare.

Sikur që ishte edhe një projekt i vogël, i cili ndoshta e ka shumë 50 mijë, 70 mijë, 80 mijë euro, që po ashtu te Ministria këtu kur është çështja e ndërtimit të urave, është një urë atje në lumin Morava, e cila lidh fshatin Dobërzan me gjithë një trevë tjetër që vite të tëra po ashtu kanë probleme shumë të mëdha.

Pra, një projekt i vogël, po shumë domethënës për atë regjion.

Mendoni, në qoftë se ka mundësi të përfshihet tash, nëse mund të bëhen gati ta ndërtojnë është mirë, nëse jo, atëherë po kërkoj që kjo të bëhet me projektbuxhetin e vitit 2017.

Në parim jap përkrahje të plotë, po e them sugjerimi im, rekomandimi im është që të kemi shumë kujdes të gjithë, edhe si deputetë, edhe si Qeveri, në politikat makro-ekonomike që e presin vendi. T'i shfrytëzojmë at resurse financiare, ato që kemi mundësi, t'i ndryshojmë projektligjet, po edhe atë kategori që u përmend këtu ta zgjidhim atë problem, të mos ia lëmë veç Qeverisë, po bashkërisht t'i japim zgjidhje të drejtë.

Prandaj, unë përkrah plotësisht dhe ju dëshiroj punë të mbarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Albulena Haxhiu, le të përgatitet Abdyl Ymeri dhe pas tij Vjosa Osmani.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në fillim të këtij viti, Komisioni për Legjislacion ka kërkuar nga institucionet e drejtësisë dhe ato që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit për Legjislacion që para fazës të rishqyrtimit buxhetor të sjellin kërkesat e tyre buxhetore.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë proceduar në Komision për Legjislacion kërkesat e tyre, të cilat janë refuzuar nga Ministria e Financave.

Me që jemi në fazën e rishqyrtimit buxhetor, unë do të mundohem që në këtë seancë të ngre vetëm disa nga çështjet që i konsideroj të rëndësishme dhe natyrisht këtu ftoj edhe anëtarët e tjerë të Komisionit për Legjislacion që t'i ngrenë çështjet që edhe ata i konsiderojnë të rëndësishme.

Së pari Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka kërkuar buxhet për rifunksionalizimin e Zyrrave për Ndihmë Juridike Falas në Gjakovë, që hyjnë dega e Junikut dhe Rahovecit, dhe Ferizaj, ku hyjnë Shtimja, Kaçaniku, Hani i Elezit dhe Shtërpca, dhe atë në vlerë prej 48 mijë euro, ku

përfshihen pagat dhe mëditjet për 6 pozita, gjegjësisht 32 mijë e 200 euro, mallra dhe shërbime 13 mijë e 400 euro dhe shpenzimet komunale 2400 euro.

Pra, duke e ditur gjendjen socio-ekonomike, apo gjendjen e varfërisë në këto komuna dhe, në anën tjetër, nevojat e qytetarëve që i kanë në raport me kontestet e ndryshme, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ndahet buxhet shtesë edhe për funksionalizimin e këtyre dy zyrave.

Po ashtu kjo agjenci ka shprehur shqetësimet lidhje me mungesën e mjeteve për pagesat e avokatëve, pra ndonëse po angazhojmë avokatë për të mbrojtur palët, të cilët nuk i kanë kushtet e mira, po mbesin ata avokatë pa u paguar, gjegjësisht kanë kërkuar 10 mijë euro shtesë për pagesat e avokatëve.

Dy, është kërkesa buxhetore nga Ministria e Drejtësisë. Së pari është brengosëse për mua se si ministri i Drejtësisë nuk ka bërë përpjekje që të shtyjë përpara kërkesat apo nevojat e organizatave që janë përbrenda Ministrisë së Drejtësisë, po them kështu për shkak se ne e kemi parë me retorika të përditshme se si i njëjti kinse po bën përpjekje maksimale për të forcuar institucionet e drejtësisë dhe natyrisht kjo nuk po reflektohet me buxhet.

Sikurse edhe qeveritë e mëparshme, edhe kjo nuk po ndan buxhet më shumë se 2% të totalit buxhetor. Ndoshta është edhe më pak se 2% e totalit buxhetor që u ndahet institucioneve të drejtësisë.

Në letrën e dërguar nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë kërkohet buxhet shtesë për programin 314 për Avokaturën e Shtetit, që ka të bëjë me ndarjen e mjeteve, janë diku 41 mijë euro për nivelimin e pagave të avokatëve të shtetit. Diku janë 6 avokatë të shtetit dhe këta kërkojnë nivelim të pagave në përputhje me Ligjin për avokaturën shtetërore që e ka votuar ky Kuvend.

Më tej, programi 336 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, është kërkuar që të ndahet shuma 58 mijë e 352 euro. Së pari zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës janë në gjendje të mjerueshme, zoti ministër, domethënë ata nuk i gëzojnë as nevojat minimale për punë.

Këtë e kemi parë më së shumti gjatë burgosjeve politike që na janë bërë neve deputetëve të opozitës, ku këta zyrtarë nuk i kanë as nevojat minimale për punë.

Kësi soji është tepër e rëndësishme ndarja e këtyre mjeteve për kompensimin e punës së natës, festave shtetërore dhe rekrutimin e pozitave të lira të buxhetuara.

Sa i përket kërkesave të Institutit Gjyqësor të Kosovës, i njëjti është afër shndërrimit në Akademi të Drejtësisë. Andaj, si Komision kemi rëndë dakord që të bëhet së pari kjo dhe më pas të rishikohen kërkesat buxhetore.

Më tej, është kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, këtu nuk ndaj mendimin e njëjtë me anëtarët e Komisionit për Legjislacion.

Kërkesa e KGJK-së është plotësimi i pozitave, përkatësisht 48 për gjyqtarë dhe 115 pozita për staf administrativ.

Domethënë është e papranueshme për Lëvizjen “Vetëvendosje”, pasi kjo kërkesë bazohet në një marrëveshje të nënshkruar nga Isa Mustafa, që është marrëveshja për drejtësisë, e nënshkruar në janarin e vitit të kaluar, e cila kinse ka për qëllim rifunksionalizimin e gjykatave në veri.

Është dëshmuar që nëpërmjet këtyre negociatave pa parime dhe pa kushte nuk ka integrim të serbëve në veriun e vendit tonë dhe natyrisht që kjo kërkesë për neve është e papranueshme, sepse këto negociata në fakt kanë shërbyer për forcim të pushtetit të Serbisë në Kosovë.

Madje ka qenë e papranueshme se si Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si organ i pavarur kushtetues, ka marrë pjesë në negociatat politike me Serbinë, domethënë kjo është e paprecedent dhe natyrisht që ne nuk e mbështesim këtë kërkesë të Këshillit Gjyqësor. Natyrisht është e nevojshme rifunksionalizimi i gjykatave atje, mirëpo në asnjë mënyrë nuk do të bëhet kjo duke bërë pazare me Serbinë.

Dhe tjetra është kërkesa e KGJK-së, që natyrisht këtë e mbështes dhe është në përputhje me Ligjin për gjykatat. Ka kërkuar funksionalizimin e degës në Fushë-Kosovë dhe shuma për këtë është 29 mijë e 959 euro.

Pra, ne kërkojmë zbatim të ligjeve që po i voton ky Kuvend dhe jo që ato ligje ndonëse i voton Kuvendi, të mbesin në sirtarët e institucioneve gjegjëse.

Ne si Komision për Legjislacion të gjitha këto kërkesa deri më 11 korrik do t’i procedojmë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe natyrisht që do të mundohemi t’i mbështesim dhe t’i çojmë përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që është një mundësi e mirë që me rastin e rishikimit të buxhetit që t’iu mundësohet organizatave buxhetore të rishikojnë dhe të përshtatin projektet e tyre.

Unë kam shikuar me kujdes, mua më tepër më intereson për projektet e tri shkollave në komunën e Skenderajt, të cilët kanë filluar së ndërtuari që disa vjet dhe ne jemi në vitin 2016 dhe ende nuk po përfundojnë.

E gjithashtu, edhe palestra sportive që ka filluar së ndërtuari që nga viti 2009.

E di që për projektet e shkollave ka pasur memorandum marrëveshje mes Komunës dhe Ministrisë së Arsimit. Mirëpo komuna me buxhetin që ka nuk ka mundësi t’i përfundojë këto projekte.

Prandaj, ne edhe nëpërmjet pyetjeve parlamentare kemi kërkuar që në rishikimin e buxhetit të ketë mjete shtesë, në mënyrë që nxënësit e këtyre shkollave të fillojnë mësimin në objektet e reja shkollore.

Për shkollën fillore në Qirez janë ndarë, me rishikim të buxhetit, 80 mijë euro nga komuna dhe 116 mijë euro nga ministria, ndërsa duhen 400 mijë euro për të përfunduar dhe përmbyllur këtë projekt.

Për gjimnazin “Hamzë Jashari” janë ndarë vetëm 50 mijë euro, ndërsa duhet edhe e 900 mijë euro për të përfunduar dhe përmbyllur këtë projekt.

Për shkollën në Çubrel duhet edhe 215 mijë euro për të kompletuar tërë projektin.

Ndërsa për palestrën sportive janë ndarë me rishikim edhe 145 mijë euro, që nuk mjaftojnë për t’u përmbyllur ky projekt.

Konsideroj se mjetet e ndara në rishikim të buxhetit për këto projekte janë të pamjaftueshme dhe nëse vazhdon kështu, na duhen edhe vite të tëra që të përmbyllen këto projekte.

Prandaj, unë kërkoj që për këto projekte të shtohet buxheti, në mënyrë që të përfundojnë këtë vit, sepse ka sa vjet që kanë filluar dhe është e pakuptimit që të fillojnë projekte të reja pa i përmbyllur projektet e vjetra.

Gjithashtu duhet mbështetur Agjencinë për Mbikëqyrjen e Komplekseve Memoriale prej 200 mijë eurosh për ta përmbyllur projektin e Kompleksit Memorial në Morinë.

Unë po kërkoj edhe një herë që të ketë mjete shtesë për këto projekte, në mënyrë që të mos figurojnë më nëpër lista të projekteve kapitale, sepse nëse i shikon dikush mund të mendojnë se atje po punohet shumë, e realisht këto projekte figurojnë nëpër listat e projekteve kapitale që nga viti 2009. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Vjosa Osmani, pas Vjosës e merr fjalën Rexhep Selimi.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa i përket këtij projektligji shumë shkurt do të flas për tri çështje, për të cilat shpresoj që të marr sqarime nga ana e ministrave përkatës.

E para, ka të bëjë me buxhetin për Ministrinë e Integrimit Evropian. Ne si Komision i Integrimit Evropian kemi marrë një njoftim nga ana e kësaj ministrie që një buxhet jashtëzakonisht i rëndësishëm, sado i vogël që është, prej përafërsisht 50 mijë eurosh, që ishte planifikuar të shpenzohej për fushatën e vetëdijesimit për liberalizim të vizave i është marrë Ministrisë së Integrimit Evropian dhe i është kaluar Ministrisë së Arsimit për një projekt të bursave, sa e kuptoj.

Siç e dini, muajt e parë të këtij viti dhjetëra-mijëra qytetarë të Kosovës janë larguar nga Kosova për arsye të ndryshme, mirëpo ka qenë konkluzion i përbashkët edhe i Komisionit për Integrim,

por edhe i Qeverisë së Kosovës dhe ministrave përkatës që kanë raportuar aty, që një prej problemeve më të mëdha ka qenë mungesa e vetëdijesimit të qytetarëve rreth asaj se kur mund të udhëtojnë.

Kjo do të jetë edhe më e rëndësishme në momentin që Kosova e merr liberalizimin e vizave nga të gjitha institucionet e BE-së, sepse në qoftë se futet në atë marrëveshje mes Kosovës dhe BE-së klauzola e suspendimit të liberalizimit, në rast të një numri të caktuar të njerëzve që largohen nga Kosova dhe udhëtojnë për vende të BE-së, kjo do të ndodhë pikërisht për shkak të mungesës së vetëdijesimit.

Prandaj, besoj që është e rëndësishme për të gjitha institucionet që këtë vërejtje ta marrin tepër seriozisht, që qytetarët e Kosovës të informohen për kushtet brenda të cilave mund të udhëtojnë, për periudhën e caktuar brenda së cilës i lejohet të qëndrojnë në vendet e BE-së, a u lejohet të punojnë, në çfarë kushte mund të punojnë, në çfarë kushte mund të studiojnë. Çfarë vize tjetër duhet në këtë rast, e tjera e tjera, pra shumë informata, të cilat fatkeqësisht për momentin qytetarët e Kosovës nuk i kanë.

Pra, pavarësisht se është një shumë e vogël buxhetore, prej 50 mijë eurosh, po flasim për një ministri që ka buxhet të vogël, besoj që është esenciale që brenda dy leximeve të bëhet ky ndryshim nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa në mënyrë që Ministria e Integrimit ta ketë këtë shumë jashtëzakonisht të nevojshme për ta kryer këtë proces që ndër të tjera financohet edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Çështja e dytë ka të bëjë me buxhetin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Siç jeni të informuar, në Kuvend e kemi një projektligj të ri për shërbimin e jashtëm, i cili ndër të tjera parasheh edhe shumë privilegje të tjera për familjarët e diplomatëve.

Këto privilegje dhe pagesa nuk kanë ekzistuar më herët në sistemin tonë apo rrjetin tonë diplomatik, që nënkupton që në qoftë se ky ligj tani kalon në lexim të dytë dhe ka gjasa që vjen menjëherë javën e ardhshme, qysh nga java e ardhshme apo nga muaji i ardhshëm mund të ketë shpenzime jashtëzakonisht të mëdha, të cilat do të jenë barrë e buxhetit të Kosovës.

Pyetja ime konkrete është në qoftë se Ministria e Punëve të Jashtme ka kërkuar buxhet shtesë, sepse në qoftë se ai ligj hyn në fuqi, do t'i bie që 5 muaj të tërë përafërsisht të këtij viti do të kemi nevojë për një buxhet shtesë për politikën e jashtme kosovare.

Dhe, çështja e tretë ka të bëjë me buxhetin e Ministrisë dhe Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Po i shoh ndryshimet që janë bërë këtu, që ka një sërë ndryshimesh apo grante të reja dhe buxhet të ri për kategori të ndryshme.

Megjithatë, siç e dini, ministër Abrashi, Kuvendi i Kosovës e ka miratua edhe një ligj të ri para pak kohe, Ligjin për të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Aty parashihet shumë qartë në ligj që këta persona përveç që do të kenë pensione, do të kenë edhe kujdestarë që do të paguhën nga ana e institucioneve qendrore, mirëpo askund nuk po e shoh atë ligj, apo atë kategori të përfshirë dhe besoj që është tepër me rëndësi, sepse ju e dini se personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë nuk mund të funksionojnë pa ndihmën e kujdestarëve.

Prandaj shpresoj që brenda dy leximeve e keni paraparë dhe do ta përkrahnit një ndryshim që e përfshin edhe implementimin e plotë të Ligjit për paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi, përgatitet deputetja Emilija Rexhepi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam dëgjuar Qeverinë e Kosovës dhe përfaqësues të shumicës duke bërë plane për themelimin e Forcës së Armatosur të Kosovës, respektivisht për ushtrinë. Kam dëgjuar që si zëvendësim i saj po përgatitet eventualisht edhe ligji i ri për FSK-në, por për atë sa po shihet në buxhetin ose Projektligjin për buxhetin e Kosovës, ato paskan qenë thjesht pretime elektorale, të pambështetura në diçka që është e domosdoshme, pra mbi buxhetin dhe financat, të cilët do ta bënin të mundur.

Prandaj, edhe një herë po kërkoj nga Qeveria që të mos e proklamojë më rritjen e kapaciteteve ushtarake të Kosovës nëse njëkohësisht nuk e ka paraparë edhe buxhetin. Unë nuk e kuptoj qysh akoma kanë kurajën të thonë që ne do të bëjmë ushtri, e as një euro nuk e kanë shtuar për ushtrinë në projektbuxhetin, e as tash në rishikimin e saj. E njëkohësisht, po ashtu edhe një çështje tjetër të cilën dua ta ndaj me ju është që po vazhdon për efekte elektorale të rriten numrat e atyre që marrin certifikatat e veteranëve të luftës, jo thjesht të rriten, por të kalohet dyfishi i atyre që kanë qenë të vërtetë, pra për efekte elektorale po rriten numrat, për efekte financiare po zbritet buxheti.

Prandaj, kësë lojërash nuk do të duhet të bëheshin as tash e tutje, siç janë bërë më herët, dhe edhe një herë dua të thërras Qeverinë që të mos manipulojë më me këto dy çështje shumë të rëndësishme, siç është siguria, pra Ushtria e Kosovës dhe po ashtu e kaluara jonë, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJIA REDŽEPI: Hvala, predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Ministri,

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani.

Nažalost Vlada Kosova u 2016. godini i dalje nema razdvojno stratešku politiku za manjinske zajednice, pa nemojte se onda čuditi kada u pojedinim opštinama podignemo svoj glas, i glasamo protiv budžeta iz razloga jer nećemo dozvoliti da pojedinci menadžiraju opštinskim sredstvima bez važovanja naših predstavnika, naših zahteva koje dolaze u saradnje sa lokalnim stanovništvom, kao što je slučaj opštine Prizren. Moram javno pohvaliti opštinu Peći, opštinu

Leposaviću, gde smo naišli na veliko razumevanje od strane predsednika tih opština kada su Bošnjački projekti u pitanju.

Ono što mene i dalje plaši jesu određena resursa ministarstva Vlade koja direktno utiče na razvoj ekonomije, stabilnost određenog geografskog područja, integrisanost određenih regija koje poseduju prirodni i privredni potencijal, ali i ljudske resurse koje se zapostavljaju. Konkretno mislim na Ministarstvo za ekonomski razvoj i Ministarstvo za ambijent, ali i na Ministarstvo za poljoprivredu, koje apsolutno ne ulaže u naše krajeve, jer manjinske zajednice ne ispunjavaju sve te adekvatne kriterijume koje Ministarstvo poseduje, kako bi bili u samom startu selektirani da konkurišu za razne grantove i milionske cifre od strane Ministarstva za poljoprivredu.

Što se tiče Ministarstva za ambijent i te kako negativna kritika, pogledajte kako nam izgleda Prevaoc, i sam nacionalni park Šar. Ako neko smatrao da je region Župe sredstvo za izgradnju hidrocentrala pojedinih individualaca, to sigurno nećemo dozvoliti, jer buduća opština Rečane ima izgrađen svoj elaborat ekonomske samo drživosti tog kraja i zaposlenost naših ljudi, kako bi se delimično zaustavila emigracija Bošnjaka, i ako proces decentralizacije od strane Kosovskih institucija ne obuhvati naš kraj, mi to možemo uraditi i referendumom.

Što se tiče Ministarstva za zajednice i povratak, ali kancelarija ureda Premijera za manjinske zajednice potpune su nepristupačni ili delimičnost su jako, jako u retkim prilikama hoće da pomognu, i tu nam treba, gospodine Premijeru, vaš pritisak na te institucije kako bi i naši građani i institucije Kosova bile dostupne našim građanima za razno razne projekte i pomoći koje te institucije nude našim građanima.

Što se tiče Ministarstva za infrastrukturu i puteve tokom celog mog mandata govorila sam o rekonstrukciji puta, odnosno magistralni put Prizren – Rečane, gde je bezbednost i sigurnost naših građana svako dnevno ugrožena, a tu živi više od 15 hiljade ljudi.

Ministarstvo za obrazovanje ni ove godine nije obezbedilo deo novca za profesore na javnom univerzitetu „Ukshin Hoti“ u Prizrenu, smer ekonomije, a postoji veliki problem oko ukidanja postojećih smerova na edukativnom fakultetu u Prizrenu zbog akreditacije, odnosno nostrifikacije diploma naših profesora. Znači, neko na Kosovu može sa istim diplomama stečenim u zemljama u regionu da radi a neka zajednica je kolatelarna šteta između dve strane i na njoj se sprovode zakon i eksperimentiše se i ne postoji politička volja sa oba dve strane da se to reši.

Molim predstavnike vladinog kabineta, poštovani premijeru, treba naša pomoć, i mirom stojimo na usluzi ali sigurno nećemo glasati ovaj Nacrt budžeta ako do drugog čitanja se ne koriguje. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Qeveria e Kosovës është treguar “supermene” sa i përket shpejtësisë së sjelljes së projektligjit prej 400 faqes në Kuvendin e Kosovës, të cilin unë e kam marrë dje. Duke pas parasysh që për të bërë krahasimin me buxhetin e miratuar dhe këtë buxhet, nevojitet për të krahasuar 800 faqe.

Pra, me fjalë të tjera Qeveria është kujdesur që të mos ketë, të mos u krijojë mundësi deputetëve për të zhvilluar një debat përmbajtjesor sa i përket rishikimit të buxhetit. Megjithatë, dua të theksoj se rishikimi i buxhetit tregon që kemi një rritje prej 33 milionësh, e cila nuk është për t’u krenuar, por për t’u turpëruar sidomos për faktin që kjo Qeveri udhëhiqet nga një kryeministër që është doktor i ekonomisë, akademik dhe një ministër i Financave, i cili e ka humbur kontrollin tërësisht sa i përket kontrollit të financave publike. Kjo u vërejt edhe gjatë pyetjeve parlamentare, të cilat u zhvilluan sot dhe u vërejt edhe gjatë raportit të auditimit të brendshëm, i cili në të gjitha fushat, madje disa organizata buxhetore deri në 77% vlerësojnë se është shumë i keq dhe ka dobësi të mëdha.

Ajo që mua më shqetëson më së shumti është fakti që kjo rritje nuk ka ardhur si pasojë e zhvillimit ekonomik, por si rrjedhojë e rritjes së TVSH-së, sepse 16 milionë janë shtuar pikërisht përmes kësaj rritje, ndërsa 17 të tjerë përmes përfitimeve nga akciza.

Me fjalë të tjera, ne kemi një rritje minimale të buxhetit përmes një ndrydhje maksimale të xhëpave të qytetarëve të varfër të Kosovës, të cilët buxhetin e Kosovës e rritin duke shpenzuar mallrat e konsumit të përgjithshëm.

Nëse buxheti, por edhe rishikimi i tij mund të shikohen edhe si një instrument kryesor për të treguar cilat kategori të qytetarëve përfitojnë dhe cilat humbin më së shumti nga politikat aktuale të Qeverisë, atëherë edhe rishikimi i buxhetit për vitin 2016 tregon që Qeveria e Kosovës gjithë barrën e buxhetit po e vendos mbi shumicën e qytetarëve të varfër të Kosovës, duke i siguruar mjetet kryesore përmes TVSH-së dhe doganave, mjete këto që bien kryesisht barrë e ekonomive familjare.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës kujdeset që barra ndaj korporatave të jetë e vogël, respektivisht 15 milionë më e lartë se vitin e kaluar dhe 5 milionë më e lartë në rishikim të buxhetit. Kjo ndarje e barrës së buxhetit, duke ngarkuar popullsinë e varfër të Kosovës, që në vendin tonë përbën shumicën dhe duke zbutur barrën mbi korporatat që përbëjnë pakicën, rrit hendekun në mes të pasurve që janë pak dhe të varfërve që janë shumë.

Rritja e të ardhurave nga TVSH-ja dhe doganat ka për pasojë ngritjen e çmimeve të konsumit të përditshëm. Kjo natyrisht që do të ketë për pasojë shtrenjtimin e artikujve të konsumit të përgjithshëm dhe rrjedhimisht uljen e fuqisë blerëse të qytetarëve, pra varfërimin e qytetarëve të Kosovës. Transferet sociale në vitin 2015 kapin një shumë prej 396.5 milionë eurosh. Këtë vit kjo shumë është paraparë të jetë 439 milionë, pra gjithsej 42.5 milionë euro më shumë. Nëse kemi parasysh që prej 42.5 milionë euro është ndarë më shumë, 32 milionë janë të parapara për zbatimin e Ligjit të veteranëve, atëherë del që shuma e përgjithshme e shtuar për transferet sociale është gjithsej 10.5 milionë euro.

Pra, gjithsej 10.5 milionë euro më shumë për të gjitha kategoritë që përfitojnë nga skemat e ndryshme sociale, prej pensionistëve, qytetarëve, nevoja të veçanta, e deri tek përfitues të

asistencës sociale, një shumë kjo fare e parëndësishme, duke pasur parasysh numrin e lartë të përfituesve nga skemat sociale.

Çfarë na tregon kjo? Kjo tregon që nëse kemi parasysh shtrenjtimitet e jetesës që vijnë për shkak të rritjes së TVSH-së, shuma prej 10,5 milionë euro nuk mjafton për të mbuluar shtrenjtimin. Kjo tregon që varfëria në Kosovë, përkundër premtimeve të kryeministrit Mustafa për zhvillim ekonomik, do të bëhet edhe më e rëndë dhe më e papërballueshme. Duke vepruar kështu Qeveria nuk ndihmon askënd, përkundrazi rrit varfërinë, duke shpërndarë atë tek shumica e qytetarëve të Kosovës. Nga ndarja e buxhetit përmes rishikimit është interesant të shikohet diferenca në mes të pagesave dhe mëditjeve të transfereve sociale.

Derisa mjetet e ndara për paga dhe mëditje kapin një shumë prej 549 milionë euro, mjetet për transfere sociale janë paraparë të jenë 451 milionë euro. Diferenca mes tyre është gjithsej 98 milionë euro. Në dukje të parë krijohet përshtypja sikur Qeveria është e interesuar shumë që të ndihmojë shtresat e varfra të Kosovës, të cilat hiq diferencën prej 98 milionë eurosh, marrin pothuajse gati njësoj sa janë ata të punësuar. Në fakt, kjo diferencë tregon mjerimin e një qeverie të paaftë për ta zhvilluar vendin. E para është që ne kemi një numër shumë të madh të qytetarëve që përfitojnë nga transferet sociale. Ky numër i madh i përfituesve nga skemat sociale bie në shumicën e tij si pasojë e politikave të gabuara ekonomike dhe paaftësisë së Qeverisë për të krijuar zhvillim ekonomik dhe, si rrjedhojë, vende të reja pune.

Edhe pse mjetet e ndara për transfere sociale iu afrojnë atyre të ndara për paga dhe mëditje, këto mjete nuk i mundësojnë asnjë përfituesi nga këto skema të mbijetojë me mjetet që marrin. Rishikimi i buxhetit për vitin 2016 tregon shumë qartë që për vitin e ardhshëm nuk do të ketë zhvillim ekonomik. Madje një vështrim shumë sipërfaqësor i projektligjit flet me fakte që Qeveria e Kosovës ka caktuar për objektiv kryesor jo rritjen e vendeve të reja të punës, jo rritjen e mirëqenies qytetare, por shpërndarjen e varfërisë.

Nëse shpërndarja e varfërisë është sukses, kryeministri Isa Mustafa është kryeministri më i suksesshëm i varfërisë në Evropë. Ky kryeministër dhe kjo Qeveri thonë që janë të djathtë, por nuk janë. Janë më shumë si pjepër: nga jashtë të verdhë dhe nga brenda të kuq, si dikur Lidhja Komuniste e Kosovës. Në fakt, me politikat ekonomike që zhvillojnë nuk janë as djathtë, as të majtë, janë thjesht të tepërt.

KRYESUESI: Fjalën e merr deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, pas saj Mytaher Haskuka.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje për të gjithë ju, kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë shkurt dua një sqarim nga zoti ministër Abrashi dhe zoti Hoti. Komisioni i Integriteteve Evropiane ka monitoruar Ligjin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Kanë nxjerrë disa rekomandime, të cilat janë votuar po nga ky Parlament dhe kemi thënë aty që në rishikim duhet të parashihen këto rekomandime. Rekomandimet janë që Qeveria është dashur të ndajë një vijë buxhetore për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave kundër trafikimit dhe dhunës, krijimin e një linje të veçantë buxhetore

dhe të qëndrueshme që ka të bëjë vetëm me mbrojtjen sociale të fëmijëve, duke përfshirë edhe financimin e strehimoreve, të cilat ofrojnë shërbime strehimi për fëmijë.

Po ashtu, krijimi i një linje buxhetore për ofrimin e shërbimeve riintegruese afatgjate për fëmijët me nevojë, pasi që ata të dalin nga strehimoret. Në Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës në rishikim të 2016-ës unë nuk pashë asnjë ndryshim dhe nuk pashë që është marrë parasysh asnjë rekomandim i dalë nga ky komision. Dhe, kisha dashur një përgjigje nga zoti Abrashi ose Hoti pse nuk janë marrë parasysh këto rekomandime? Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Mytaher Haskuka, përgatitet Hajdar Beqa.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Patëm biseduar kohë më parë me disa deputetë nga shtetet evropiane, edhe ata treguan që zakonisht për çfarëdo ligji që e marrin ata, diskutimi është diku rreth 4 deri 6 muaj deri në përfundimin e tij.

Po, pasi ky është ligj për buxhet, ndoshta edhe është dashur më pak, por jo vetëm 24 orë që të shikojmë 800 faqe dhe kjo është e pakuptimtë, ngase kanë qenë diku rreth 6 muaj që nga aprovimi i buxhetit të kaluar dhe ndoshta na është dashur të na jepet pak më shumë kohë që të shqyrtojmë buxhetin ose ndryshimet buxhetore, të cilat janë propozuar.

Por, gjendja këtu është ashtu si është, domethënë Kosova çdo ditë e më tepër nga demokracia parlamentare po kalon në një demokraci ose në një diktaturë qeveritare, të themi më mirë. Nëse e shikojmë edhe ky buxhet ka shumë mangësi, por unë e shikova brenda këtyre 24 orëve, domethënë sa pata mundësi shikova pjesën lidhur me hulumtimet e kërkimet shkencore, të cilat sipas Ligjit për arsimin e lartë kërkojnë që të jenë diku 0,7%. Në të gjitha pjesët e buxhetit, ashtu si ka qenë edhe në buxhetin paraprak, nuk është paraparë asnjë buxhet për hulumtim dhe zhvillim. Dhe, si thashë, sipas ligjit duhet të jetë 0,7%, pra diku rreth 11.4 milionë euro.

Ndoshta e gabova, pastaj i shikova pjesën për investime kapitale, por edhe aty nuk pashë kurrëgjë të ndarë për hulumtime. E vetmja gjë që e pashë ishte një investim në Universitetin e Ferizajt, diku rreth 12 mijë euro, që është vetëm 0,01% i asaj të kërkuar, ndërsa në aspektin e anomalive të tjera në këtë buxhet shihet edhe si, për shembull, që janë ndarë diku rreth 30 mijë euro për reformën në arsim. Domethënë, nëse ndahen 30 mijë euro në reformën në arsim, atëherë mendojmë që nuk duhet të ketë reformë në arsim.

Po ashtu ka edhe mangësi të tjera të buxhetit, por me këto 24 orë shumë problematike që të shqyrtohet i gjithë ky dokument, i cili na është dhënë në minutat e fundit. Unë shpresoj që në të ardhmen do të kemi më shumë kohë që t'i shqyrtojmë këto, ashtu që e gjithë Kosova të ketë benefit nga kjo. Një tjetër gjë që s'arrita të kuptoj është që në tabelën Shtojca numër një, ku shkruan domethënë të gjitha kodet buxhetore dhe pikat, vetëm te Radio Televizioni i Kosovës që raporti i saj do të shqyrtohet sot nuk shënohen numri i punëtorëve, nuk shënohen sa para shkojnë në paga dhe mëditje, nuk ka kurrfarë shënimi se sa do të shkojnë në mallra dhe shërbime, kurrëgjë tjetër, pos 1 milion e 600 mijë, të cilat janë paraparë që të transferohen në RTK.

Domethënë, edhe këtu prapë vjen pyetja pse ky institucion po ka njëfarë tretmani të veçantë karshi të gjitha institucioneve të tjera publike, pse kjo nuk raporton për numrin e punëtorëve, pse nuk raportohet për shpenzimet kapitale që ndoshta shkojnë në këtë institucion, por vetëm buxheti i paraparë që do të shkojë si subvencion dhe transfer. Kjo është e pakuptimtë dhe duhet të shpjegohet mirë, pse ka ndryshime të tilla? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka Hajdar Beqa, pas tij e merr fjalën Danush Ademi.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për kryeministrin, kabinetin qeveritar, kolegët deputetë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sot ne po diskutojmë për plotësim ndryshimin e Ligjit 05L/0-71 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. U tha shumë nga shumë deputetë sepse kërkesat janë ndoshta edhe shumë të mëdha në raport me mundësitë tona buxhetore, por kishte edhe kërkesa imediate, siç ishte edhe kërkesa e Këshillit për Shërbyes Civilë dhe kërkesa të tjera.

Unë dua ta ngre sot një çështje të një projekti mediat për qytetarët e komunës së Gjakovës, respektivisht për banorët e 47 fshatrave të Rekës së Keqe dhe të fshatrave të Lugut, të Cerragojës. Në vitin 2009 ka filluar implementimi i projektit furnizim me ujë për 47 fshatra të Gjakovës.

Vlera e projektit ishte 1 milion e 655 mijë e 980 euro. Deri sot Komuna e Gjakovës ka arritur të financojë punimet e realizuara në vlerë prej 660 mijë e 115 euro, për shkak të situatës së rënduar financiare Komuna e Gjakovës nuk ka mundësi të vazhdojë këtë projekt mediat për qytetarët e asaj treve, e cila dha shumë gjatë të gjitha periudhave për Kosovën, pa ndihmën financiare të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

E kuptoj se mundësitë buxhetore të Kosovës nuk na japin komoditet të mjaftueshëm për ta përkrahur në këtë fazë këtë projekt në tërësi, por në këtë rast i propozoj ministrit dhe kërkoj nga ministri i Financave dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ta shikojnë mundësinë e masës buxhetore që një pjesë të këtij projekti, për shkak se është projekt i nisur në vitin 2009, të ndihmohet Komuna e Gjakovës, kodi për rrjetin e ujësjellësve, të ndihmohet një pjesë këtë vit, kurse pjesa vitin tjetër.

Për t'u realizuar komplet ky projekt nevojiten 995 mijë e 865 euro. Kryesisht ne e thamë edhe më herët se një pjesë e projektit është përfunduar, por në mungesë të buxhetit nuk mund të vazhdojë. Nëse Qeveria, në këtë rast dhe komuna, nuk i marrin masat e veta edhe ato rreth 700 mijë euro që janë dhënë deri tani ato pajisje mund të dëmtohen, sepse nuk ka mundësi që kompania që e ka marrë ta kryejë projektin. Andaj, edhe një herë kërkoj prej ministrit dhe komisionit ta shikojnë këtë mundësi buxhetore. Unë edhe si deputet do ta shikoj mundësinë edhe me amendamentet t'i propozoj edhe komisionit, por edhe juve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Danush Ademi, përgatitet Ismajl Kurteshi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sa i përket rishikimit të buxhetit për vitin 2016, e kemi 2017, 2018, dua ta ngre një shqetësim. Nëpër komunat, duke filluar në komunën e Ferizajt, ku në këtë komunë nuk është paraparë asnjë projekt ku janë të banuara me komunitete.

E kemi lagjen “Ejup Statovci”, ku banojnë 1130 anëtarë të komuniteteve dhe asnjë rrugicë nuk është paraparë të shtrohet në këto lagje. Njësoj i kemi 2500 anëtarë të komunitetit ashkali në fshatin Dubravë, ku janë disa rrugica, për të cilat janë parashtruar vazhdimisht kërkesa kryetarit të komunës, e nuk janë paraparë, edhe në këtë buxhet e as në rishikim të buxhetit. Njësoj edhe në Fushë-Kosovë, ku prezent ka qenë edhe kryeministri, me rastin e kafshimit të atyre qenve endacakë, kur ka shkuar ta vizitojë atë lagje, atëherë u patën shtruar dy kamionë zhavorr sa për të shkuar në vizitë kryeministri. Por, prej asaj dite asnjëherë nuk është marrë askush me ato rrugë që t’i shtrojnë komuna apo dikush tjetër.

Edhe në komunën e Lipjanit, nëse e marrim fshatin Gadime, dikush ndoshta e di nga këta deputetët ku jetojnë qytetarët e fshatit Gadime, ku jeton një pjesë e madhe e komunitetit. Po, kryetari i komunës edhe këtu nuk ka paraparë asnjë projekt ku jetojnë komunitetet.

Dua ta marr vetëm një shembull për Ferizaj. Janë disa komunitete të tjera nga komunitetet joashkali që unë i përfaqësoj, kemi pasur lagje vetëm me dy anëtarë të komuniteteve të tjera ku janë shtruar rrugë nga 3-4 km dhe ato fshatra sot janë të pabanuara, kurse në këto pjesët ku jetojnë komunitetet fare nuk janë duke u marrë parasysh nga kryetarët e komunave, sidomos nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Sfarqa. Kërkojmë që së paku në rishikim të buxhetit të ketë parasysh këto kërkesa, të cilat anëtari i Asamblesë Komunale vazhdimisht e ka ngritur shqetësimin për këto komunitete ku jetojnë dhe mendoj që duhet të merren parasysh edhe kërkesat e komuniteteve, e jo vetëm të rishikohen nëpër ato vende ku e kanë grupin votues kryetarët e komunave.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, pas tij Naim Fetahu.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Gjendja në arsimin e Kosovës është jashtëzakonisht e rëndë dhe përveç tjerash është e rëndë edhe për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Kur kësaj ia shtojmë edhe planifikimin apo përcaktimin jo si duhet të prioritetëve, atëherë situata keqësohet edhe më shumë. Unë po i paraqes vetëm disa krahasime, ku shihet se prioritetet nuk janë ashtu si dihet dhe shpenzohet më tepër atje ku nuk duhet, e kursehet atje ku do të duhej të investohet më shumë.

Për investimet kapitale në arsim janë paraparë, sipas këtij projektligji, vetëm 9 milionë e 160 mijë euro, kurse për shërbimet e administratës qendrore, për administratën qendrore dhe ministrin e Arsimit, pra për burokracinë qendrore janë ndarë 6 milionë e 200 mijë euro, ose sa 2/3 e investimeve kapitale. Vetëm zyra e ministrit, sipas këtij planifikimi, do t’i shpenzojë 200 mijë euro, kurse Inspektorati i arsimit të Kosovës, i tërë Inspektorati do t’i ketë vetëm 500 mijë euro, kurse për mallra e shërbime për Inspektoratin janë ndarë 68 mijë euro, e vetëm zyrës së

ministrit për këtë qëllim janë ndarë 108 mijë euro, ose 40 mijë euro më shumë se që ka zyra e ministrit.

Pra, po flitet për Inspektoratin, i cili është i obliguar që të angazhohet për mbikëqyrjen e punës në Ministrinë e Arsimit, në arsim përgjithësi dhe për ngritjen e cilësisë, për të cilën ministri vazhdimisht flet se po angazhohet shumë. Derisa burokracia shpenzon shumë miliona euro, për hulumtimet shkencore nuk janë ndarë pothuajse asnjë cent, edhe pse me ligj Qeveria është e obliguar që të ndajë 0.07% të buxhetit për hulumtime shkencore, e që ato kur kthehen në mjete, diku rreth 11 milionë euro.

Unë i kam dy pyetje, sipas këtij projektligji Instituti i Leposaviqit është i vetmi institut lokal i arsimit që përfiton mjete financiare, pra rreth 40 mijë euro. Pyetja ime është: me çka merret instituti i Leposaviqit, cili është kontributi i tij konkret për arsimin e Republikës së Kosovës? Kurse, për kryeministrin e kam këtë pyetje: në projektligj nuk kam parë askund që janë paraparë rrogat për një 500 pjesëtarë të Mbrojtjes Civile, të cilët nuk punojnë dhe marrin rroga, është mirë të na thoni se nga cili fond i merrni këto të holla që t'i paguani këta njerëz, të cilët nuk punojnë fare?

Dhe, krejt në fund, sipas këtij projektligji parashihet që nga komunat e mëdha të merren mjete dhe ato t'u ndahen komunave të vogla politike, të cilat nuk kanë qëndrueshmëri politike. Pra, kjo është edhe një dëshmi jashtëzakonisht e fortë, e cila flet për domosdonë e rishqyrtimit të decentralizimit dhe komunat të cilat nuk kanë qëndrueshmëri ekonomike të shndërrohen në statusin që e kanë pasur para se të avancohen në komuna. Faleminderit!

KRYESUESI: Naim Fetahu e ka fjalën, dhe diskutues i fundit do të jetë Shukri Buja. Thërrisni deputetët të vijnë në sallë.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra, deputetë,

Te pika e rishikimeve buxhetore dua të ndalem te dy projekte kryesore: ndërtimi i rrugës Podujevë – Prishtinë, një projekt shumë i rëndësishëm, i cili ka një vlerë jashtëzakonisht të madhe, mbi 30 milionë euro. Është paraparë që të ndërtohet, por shuma e mjeteve të cilat janë ndarë për këtë projekt është jashtëzakonisht e vogël. Për shembull, në vitin 2016 janë ndarë vetëm 539 mijë euro, 2017 1 milion e 500 mijë euro, 2018 janë ndarë 1 milion e 600 mijë euro.

A thua sa do të zgjasë realizimi i këtij projekti po qe se shkojmë me këto shuma të mjeteve që po i përmend. Me siguri se për t'u përfunduar ky projekt duhen edhe një 10-15 vjet deri në fund që të realizohet ky projekt.

Nën dy, projekti tjetër i rëndësishëm është vazhdimi i ndërtimit të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në Podujevë. Ky projekt ka filluar para tre vjetëve, mirëpo ende nuk ka përfunduar. Gjendja e qytetarëve që jetojnë në këtë lagje është jashtëzakonisht e vështirë dhe kisha kërkuar që të kihet parasysh, të kenë një trajtim më të veçantë në buxhet. Ndërsa, kisha kërkuar prej ministrit të Punës që ta vizitojë edhe të shohë për së afërmi gjendjen në të cilën jetojnë qytetarët në këtë objekt.

Dhe, gjithashtu kisha dashur që një vëmendje të veçantë t'i kushtohet edhe përfundimit të objektit të shkollës fillore "Enver Maloku". Një objekt i cili ka filluar me vite dhe qytetarët e komunës nuk e dinë se kur do të përfundojë një projekt kaq i rëndësishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Buja e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Shumë shpesh, madje edhe sot po shtrohet një çështje që është bërë problematike, çështja e të ardhurave për kategoritë e luftës, veteranët luftëtarë.

Pse bëhet ky problem kur kategoritë e pensioneve të tjera janë rritur, madje është trumbetuar mjaft shumë rritja e këtyre kategorive, siç është kategoria e pensioneve. Si ka mundësi që një pjesë e të ardhurave pensionale të rriten, e disa të mos kenë mundësi të paguhen në bazë të obligimeve ligjore për kategoritë e dala nga lufta.

Kur thuhet në këtë ligj nuk mund të jenë më të vogla se paga mesatare në Kosovë, nuk u bë problem rritja e një kategorie të pensioneve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, po bëhet problem kategoria tjetër e veteranëve. Kjo duket sikur është goditje e qëllimtë politike. Numri i veteranëve, i vogël apo i madh, i saktë apo i fryrë, është çështje e komisioneve që janë ngarkuar për këtë çështje që janë përgjegjëse, është çështje e organeve të tjera të rregulluara me ligj, siç janë gjykatat dhe prokuroritë. Ndërsa, Qeveria dhe ne deputetët jemi të obliguar që të planifikojmë të ardhurat për veteranët siç është obligim ligjor.

Në këtë rishikim buxhetor një pjesë shihen si projekte të pamenduara mirë, apo që kanë qëllime politike, sepse po e marr një shembull: në Lipjan është planifikuar pastrimi i lumit Sitnica, në vend që të planifikohej realizimi i projektit të lumit Sitnica, i cili është projekt detal. Ky projekt i rregullimit të shtratit të lumit Sitnica është më se i nevojshëm për Lipjan, është i domosdoshëm, ndërsa pastrimi i lumit me 200 mijë euro është hedhje e parave në lumë, sepse pastrimi i lumit mund të zgjasë për një vit dhe pas një viti mbushet lumi.

Do të duhej të planifikohej realizimi i projektit detal i rregullimit të shtratit të lumit Sitnica. Një projekt tjetër i rrugës Magurë - Lipjan, i planifikuar me 170 mijë euro, një rrugë që ata që e njohin dhe shkojnë për në aeroportin "Adem Jashari" shihet se nuk mund të riparohet me 170 mijë euro. Ajo rrugë duhet të rikonstruktohet, duhet të shtrohet prej fillimit apo të jetë projekt prej fillimit. Po ajo që është më shqetësuese në këtë projekt që u ngrit edhe nga disa deputetë të tjerë, është çështja e mosplanifikimit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Sa fjalë e propagandë po bëhet për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, sikur peshë e transformimit të kësaj force të jetë e ëmbël, ju lutem. Pak peshë çon emri, sa peshë çon te forca e saj, tek mjetet logjistike ushtarake, struktura e saj funksionale, teknologjia e përparuar e saj. Pse nuk planifikohet që Forcat e Sigurisë së Kosovës të kenë mjete të motorizuara, të blinduara, me armatim të lehtë, të planifikohet gjithsesi çështja e helikopterëve apo e eskadrilës së helikopterëve, e cila është edhe e drejtë e Forcës së Sigurisë.

Me planifikimin e tyre ne planifikojmë gjithsesi që të kemi një mbrojtje të territorit të Kosovës, të kemi siguri më të mirë për qytetarët. Nuk është pesha tek emërtimi, por është te çështja e strukturimit të saj ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Salih Salihu me vonesë po e kërkon fjalën, veç shkurt.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Bujqësia e Kosovës nuk mund të zhvillohet pa një program të qartë dhe pa mbështetje më të madhe buxhetore.

Buxheti i ndarë për bujqësi është ende shumë i vogël në raport me nevojat që ka ky sektor, por edhe në raport me shtetet fqinje, të cilat ndajnë më shumë buxhet për këtë sektor. Pra, me këtë buxhet zhvillimi i bujqësisë nuk mund të jetë i qëndrueshëm dhe as i konkurrueshëm me bujqësinë e vendeve të rajonit dhe si pasojë kemi invazion të importeve të produkteve bujqësore nga vendet fqinje, sidomos nga Maqedonia dhe Serbia, të cilat subvencionojnë çdo kulturë bujqësore dhe çdo pëllëmbë toke të mbjellë, madje subvencionojnë edhe eksportin duke shndërruar kështu produktet e tyre konkurrent kryesore në tregun tonë.

Kjo Qeveri nuk e ka prioritet nacional bujqësinë, por asfaltin, sepse nuk është e vetëdijshme për rëndësinë e këtij sektori. Bujqësia ka kapacitet të madh absorbues të fuqisë punëtore, si asnjë sektor tjetër. Roli i bujqësisë është shumëdimensional, por ajo që e bën të veçantë këtë sektor, sidomos në rrethanat që ndodhet Kosova, është se bujqësia edhe punëson, edhe prodhon. Me punësim ulim shkallën e papunësisë, me prodhim ulim importin dhe rrjedhimisht ulim edhe rrjedhjen e parasë jashtë vendit.

Një vend i punës në bujqësi është i qëndrueshëm deri në pension, dhe ky vend i punës vazhdimisht prodhon. Ndërsa, një vend i punës në asfalt është 2-3 vjet dhe asgjë nuk prodhon, përveçse mundëson importin më të lehtë të prodhimeve të huaja. Prandaj, investimet kapitale në kapacitetet përpunuese, depo për ruajtje të produkteve bujqësore, pika grumbullimi, garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit primar dhe njëkohësisht vende pune të qëndrueshme.

Natyrisht se Kosova ka nevojë për politika të mirëfillta që mbrojnë prodhimin vendor, ka nevojë për hartimin dhe zbatimin e masave në sigurinë e cilësisë së prodhimeve vendore dhe për promovimin e tyre, ka nevojë për funksionalizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, i cili është njëri ndër agjencitë më të rëndësishme në Kosovë, sepse lidhet me sigurinë ushqimore, e ju për sigurinë ushqimore i paskeni ndarë vetëm 50 mijë euro. Kjo tregon se sa të vetëdijshëm jeni për një institucion që duhet të kontrollojë cilësinë e të gjitha produkteve të importuara që kapin shifrën rreth 800 milionë euro.

Se ku duhet të investohet më së miri tregojnë rrugët hyrëse në pikat kufitare, shiriti hyrës i asfaltit është total i shkatërruar nga importi, ndërsa shiriti i rrugës në drejtim të kufirit është fare pa u dëmtuar, sepse s'kemi fare eksport. Pra, nuk ka tregues më të mirë se ku duhet të investohet, në bujqësi, të rritet prodhimi vendor dhe eksporti, apo në asfalt për ta mundësuar më lehtë importin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, edhe ju informoj deputetëve që do të kemi votime, të gjitha janë ligje këto 1, 2, 3, 4 do t'i diskutojmë dhe do t'i votojmë në fund.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hotin, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit!

Nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për financat e pushtetit lokal, me qëllim të sigurimit të buxhetit për ofrimin e shërbimeve minimale për qytetarë dhe biznese nga ana e bizneseve, nga ana e komunave të vogla në përputhje me kompetencat e tyre.

Në analizat që kemi bërë rezulton se pas rritjes së shpenzimeve rrjedhëse, formula për shpërndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna nuk siguron mbulimin e kostos së shpenzimeve të kostos bazë, që komunat e vogla me pak banorë ofrojnë për qytetarë. Prandaj, me rastin e rishikimit të Buxhetit gjithmonë është dashur të ndajmë buxhet shtesë për komunat e vogla.

Për ta evituar këtë problem dhe përderisa nuk e rishikojmë komplet formulën për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, ne propozojmë plotësim-ndryshimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal.

Me këtë projektligj është paraparë që për një periudhë kalimtare deri në vitin 2019 nga grandit i përgjithshëm, që u takon komunave, që është në shumën prej 10% të të hyrave të rregullta tatimore të ndahet 2,7% të këtij grandit, që kanë popullsi për ato komuna që kanë popullsi më pak se 22 000 banorë. Propozimi në projektligj është që kjo shumë të ndahet sipas dy kriterëve:

- gjysma të ndahet për këto komuna në shumë fikse, pra barabar për secilën komunë; dhe
- gjysma të ndahet për këto komuna në përputhje me numrin e banorëve që kanë këto komuna.

Kjo ua mundëson komunave që t'i tejkalojnë problemet financiare në shpenzimet rrjedhëse, sidomos për mallra dhe shërbime, për ofrimin e shërbimeve bazike për qytetarë.

Ju njoftoj se këtë ndryshim e ka aprovuar komisioni i grandeve në prill të këtij viti, por para përgatitjes së kornizës afatmesme të shpenzimeve 2017 - 2019. Kjo është zgjidhje e përkohshme, përderisa nuk e ndryshojmë komplet formulën e grandit të përgjithshëm në Ligjin për financat e pushtetit lokal. Ne jemi duke e finalizuar strategjinë për financat e pushtetit lokal, e cila pastaj na çon në ndryshimin e Ligjit të financave lokale dhe adresojmë këtë çështje në afat të gjatë.

Ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit hap debatin për diskutim në parim. Fjalën e merr kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës sipas rekomandimit të komisionit të grandeve ka nxjerrë një vendim për shpërndarjen e kontigjencës për korrigjim të formulës, pjesës së grandit të përgjithshëm për vitin 2017 për komuna, në vlerë prej 4 milionë euro. Nga ky propozim, respektivisht korrigjim të formulës së grandit të përgjithshëm do të përfitojnë 12 komuna të Republikës së Kosovës.

Për një periudhë kalimtare deri në vitin 2019 nga grandit i përgjithshëm do të ndahen 4 milionë euro, komunave që kanë më pak se 22 mijë banorë, në mënyrë proporcionale dhe 2 milionë të tjerë do të ndahen bazuar në numrin e popullsisë së tyre.

Komisioni ka shqyrtuar këtë propozim-vendim të Qeverisë, të cilin e ka përkrahur në parim, por ka kërkuar që të bëhen ndryshime dhe plotësime në ligjin, që të mund të implementohet. Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim. Komisioni deri më 13 korrik duhet ta amendamentojë projektligjin, në mënyrë që më 14 korrik të jetë i gatshëm për votim në leximin e dytë dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa u rekomandon deputetëve të Parlamentit të Kosovës, që ta votojnë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare, për PDK-në, Naim Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues,

Në emër të grupit parlamentar e mbështesim Projektligjin për ndihmë shtetërore, ndërsa kontributin tonë do ta japim në fazat e mëpastajme.

KRYESUESI: Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Në fakt, projektligji që na është sjellë është thjesht dy fjali, një nen, i cili kërkon që të ndahet buxhet shtesë për komunat që kanë numër më të vogël të banorëve se sa 22 000, por nuk ka asnjë analizë të mirëfilltë, se si do të sigurohet me këtë ndarje të buxhetit qëndrueshmëria e këtyre komunave, jo vetëm në të ardhmen e cila do të duhej të bëhej me një strategji të mirëfilltë, por edhe tani.

Këto janë shenjat e para, pasojat e para, të cilat tashmë kanë filluar të dalin në sipërfaqe të një procesi të decentralizimit, i cili është bërë pa analizë të mirëfilltë, se si ky decentralizim do të ofronte më afër shërbime të qytetarëve, por në fakt tashmë po vërtetohet, se i gjithë procesi ka qenë politik dhe përkundrazi, në vend se tu ndihmojë qytetarëve duke u ofruar shërbime, në fakt, ai vetëm sa e rëndon buxhetin i cili në vend se të shkojë për investime të ndryshme, tashmë ai duhet të shkojë thjesht në paga dhe mëditje të zyrtarëve, të cilët janë të punësuar në këto komuna.

Vetëm një rikujtim, njëra nga komunat e cila do të përfitojë nga ky grand shtesë, e prapë po them, i cili nuk garanton asnjë lloj qëndrueshmërie financiare, është ta zëmë, Komuna e Parteshit, e cila për vitin e kaluar ka siguruar të hyra vetanake vetëm 36 euro. Tani, si do të sigurohet qëndrueshmëria e këtyre komunave, si do të mund këto komuna të ofrojnë shërbime, kur nuk janë në gjendje as të inkasojnë mjete, të cilat do ta mbulonin dhe arsyetonin, të paktën, pagën e kryetarit të komunës.

Qeveria duhet të bëjë një strategji dhe një analizë të detajuar të gjithë procesit të decentralizimit, për të parë se për cilat komuna duhet të rishqyrtuar edhe njëherë ekzistenca e tyre dhe si pastaj tu ofrohen shërbime qytetarëve, qoftë edhe duke i bërë disa nga shërbimet të përbashkëta në mes komunave. Por, zgjidhje të tilla ad hoc, në fakt, nuk sigurojnë asnjë lloj qëndrueshmërie dhe nuk ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët, prandaj ne nuk do ta mbështetim këtë ndryshim të projektligjit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë për të diskutuar.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Komisioni Funkcional në mbështetje të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj ministrin e financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të adresimit të obligimeve nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, të gjeturave të raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2015 dhe objektivave të Qeverisë së Kosovës konform programit 2015 – 2018, Qeveria ka hartuar Projektligjin për ndihmë shtetërore. Ndryshimet e parapara janë të mëdha, prandaj ky projektligj do të shfuqizojë komplet ligjin aktual për ndihmë shtetërore.

Dy çështje kryesore të trajtuara në këtë ligj janë:

- përcaktimi i procedurave dhe parimeve të kontrollit të ndihmës shtetërore; dhe
- riorganizimi i organeve të kontrollit të ndihmës shtetërore.

Në aspektin e procedurave dhe parimeve të kontrollit të ndihmës shtetërore, projektligji përcakton parimet dhe procedurat, kushtet e përgjithshme, si dhe rregullat për autorizimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore, definojnë konceptet dhe procedurat lidhur me ndihmat shtetërore me dhënësit dhe përfituesit e ndihmës shtetërore. Po ashtu, janë përcaktuar rregullat për skemat e ndihmës shtetërore, ndihmës së përgjithshme, përgjegjësitë dhe obligimet e palëve të interesit, si dhe të gjitha procedurat tjera lidhur me ndihmën shtetërore.

Projektligji rregullon gjithashtu ndihmat e lejuara të karakterit social, që u jepen konsumatorëve individual, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek dhe ndihma për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose nga ngjarjet e jashtëzakonshme.

Në aspektin institucional ky projektligj parasheh ndryshimet në strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore, zyra për ndihmë shtetërore, e cila aktualisht funksionon në kuadër të Komisionit Kosovar të Konkurrencës parashihet të ngritet në nivel të departamentit dhe të transferohet në Ministrinë e Financave.

Projektligji parasheh përbërje të re për Komisionin e Ndihmës Shtetërore, ku dukshëm zbehet prezenca e përfaqësuesve të Qeverisë me vetëm një përfaqësues. Për të garantuar një nivel më të lartë të pavarësisë së organit vendimmarrës të kontrollit dhe ndihmës shtetërore, parashihet një periudhë kalimtare për Komisionin e Ndihmës Shtetërore deri në fund të vitit 2020, ku pas kësaj periudhe ky komision do të përbëhet nga persona teknokratë, të pavarur dhe të emëruar sipas meritës.

Në aspektin e harmonizimit me legjislacionin e BE-së, ky projektligj transpozon në tërësi nenin 107 të Traktatit të Lisbonës, si dhe parasheh funksionimin e trupave të kontrollit të ndihmës shtetërore, konform nenit 108 të Traktatit të Lisbonës.

Sa i përket legjislacionit sekondar të BE-së, ky projektligj transponon Rregulloren e Këshillit të BE-së nr. 2015/1589 e 13 korrikut 2015, që përcakton rregullat për zbatimin e nenit 108 të Traktatit të funksionimit të BE-së dhe pjesërisht është në përputhje me këtë rregullore.

Niveli është i tillë, meqë legjislacioni i BE-së rishtas ka inkuadruar një mekanizëm të ri të kontrollit të ndihmës shtetërore, që quhet mekanizmi i investigimeve në terren dhe Ministria e Financave ka vlerësuar se mungojnë kapacitetet administrative. Sapo të ngritën këto kapacitete do të futet ky aspekt i ri në ligj.

Gjatë përgatitjes së projektligjit të gjitha palët e interesit të sektorit publik kanë qenë të përfshira dhe janë zhvilluar dy herë konsultime publike me palët e jashtme. Po ashtu, për këtë projektligj janë zhvilluar konsultime me trupat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe të komunitetit të energjisë. Ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që të aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndihmë shtetërore përcakton parimet dhe procedurat, kushtet e përgjithshme, si dhe rregullat për autorizimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore. Dhe, me qëllim të përmbushjes së detyrave të dala nga marrëveshja ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Kosovës, ku përfshihen dispozitat për ndihmën shtetërore.

Ky projektligj do të zbatohet për të gjithë sektorët e prodhimit dhe shërbimeve, që veprojnë në Republikën e Kosovës me përjashtim të sektorëve të bujqësisë dhe të peshkimit, përfshirë këtu edhe produktet e përpunuara bujqësore. Po ashtu, me këtë projektligj rregullohen ndihmat e lejueshme me karakter social, që u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që këto ndihma tu jepen pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek dhe ndihma për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose nga ngjarjet e jashtëzakonshme.

Në aspektin institucional, ky projektligj parasheh dhe ndryshimet në strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Zyra për ndihmë shtetërore e cila aktualisht funksionon në kuadër të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës parashihet të ngritet në nivel të departamentit dhe të transferohet në Ministrinë e Financave, si dhe parashihet një ndryshim i strukturës dhe përbërjes së Komisionit të Ndihmës Shtetërore, ku parashihet të themelohet si organ i pavarur, anëtarët e të cilit do të zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës. Miratimi i projektligjit është paraparë edhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 21.6.2016 ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndihmën shtetërore dhe ka vlerësuar, se projektligji plotëson kushtet formale juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim në leximin e parë. Ajo që është vlerësuar e rëndësishme për këtë projektligj është harmonizimi me legjislacionin e BE-së, pasi që ky projektligj buron nga MSA-ja. Për këtë arsye Komisioni më rastin e amendamentimit të tij do të analizojë me kujdes përputhshmërinë e këtij ligji me legjislacionin e BE-së dhe do të propozojë ndryshimet e nevojshme.

Komisioni, po ashtu do të analizojë me kujdes vërejtjet dhe rekomandimet, që do të dalin nga shqyrtimi i sotëm dhe do t'i adresojë ato nëpërmjet amendamentimit të projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, përfaqësuesit ose shefat e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit “Vetëvendosje” është Topalli, ose Pantina, ose të dy. Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Ministri e di se në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk kemi pasur mundësi ta diskutojmë këtë projektligj dhe t'i marrim sqarimet e nevojshme, prandaj besoj se ministri ato sqarime do na i ofrojë tani.

Fillimisht, cila është arsyeja që zyra, e cila tashmë po ngritet në nivel departamenti për ndihmën shtetërore, zhvendoset nga Autoriteti i Konkurrencës, siç ka qenë deri më tani, tek Ministria e Financave. Dhe në veçanti, cila është arsyeja e ekzistimit të nenit 25 të këtij projektligji, i cili është plotësisht i paarsyeshëm dhe si i tillë edhe i panevojshëm.

Natyrisht, se është e domosdoshme të krijohet një komision profesional dhe i përhershëm, në vend të atij ad hoc, siç përcaktohet me ligjin aktual, por është e pakuptimtë pse duhet pritur katër vjet, që të krijohet një komision dhe të funksionalizohet një komision i tillë. Në njërën anë, tek memorandumit shpjegues ju thoni se projektligji është bërë me qëllim, që ndihma shtetërore të jetë e harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe veçanërisht të sigurohet funksionaliteti dhe pavarësia e organit të kontrollit të ndihmës shtetërore, por në anën tjetër, ministër, ju po tentoni ta kontrolloni vetë procesin e ndihmës shtetërore për një periudhë katërvjeçare, deri në fund të vitit 2020.

Kjo mënyrë, siç është e rregulluar me ligjin, në fakt, kjo është tashmë e rregulluar me ligjin në fuqi, përkatësisht me nenin 8 të këtij ligji, i cili komplet është bartur në projektligjin aktual, në nenin 25 të tij. Për më tepër, kjo është vërejtja thelbësore e dhënë edhe në opinionin ligjor, të hartuar nga Ministria e Integrimeve Evropiane për përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së dhe i cili konkludon, se ky projektligj vetëm pjesërisht është në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe saktësisht me Rregulloren e Këshillit të BE-së 2015/1589, në të cilin referohet projektligji në nenin e parë, tek qëllimi, si dhe në Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim, përkatësisht kapitullin 8, pikat 75.1 deri te pika 75.7.

Ky opinion saktësisht ngre shqetësimin për nenin 25 të këtij projektligji. Në fakt, kur lexon opinionin e Ministrisë së Integrimeve dhe projektligjin e propozuar nga Ministria e Financave të krijohet përshtypja se këto dy ministri, ndonëse janë pjesë e të njëjtit institucion, pra të Qeverisë, nuk komunikojnë fare ndërmjet vete. Do të ishte mirë, që të ishte këtu edhe ministri i Integrimeve, zoti Çollaku, për të na dhënë ndoshta edhe ai sqarimet e ministrisë që përfaqëson.

E tash, sa i përket përmbajtjes së projektligjit, në fakt ai duhet të saktësohet në disa nene të tij, për të mos krijuar konfuzion apo paqartësi, gjatë procesit të zbatimit. Për shembull: tek neni 1 i ligjit, qëllimi i ligjit, duhet të saktësohet më mirë, në mënyrë që të shihet se rregullohet vetëm ndihma shtetërore për biznese dhe atë në kuadër të synimeve të caktuara të politikës ekonomike.

Kjo është tejte me rëndësi, meqë më tutje në projektligj përjashtohen grandet apo subvencionet për fermerë nga kjo shprehje.

Më tutje, tek neni 3, tek përkufizimet, termi “deminimus” duhet të definohet më qartë dhe jo të thuhet vetëm “ndihma në bazë të nenit 7”, sepse po të lexohet neni 7 i ligjit, nuk sqarohet asgjë se çfarë është kjo ndihmë. Duhet të ceket te definicionet, se cila ndihmë dhe deri në cilën shumë dhe për cilën periudhë cilësohet si ndihmë “deminimus”.

Mirë do të ishte, po ashtu, që të gjendej një term në gjuhën shqipe për këtë formë të ndihmës, për shembull, ndihmë e imtë apo diçka e ngjashme.

Neni 9, saktësisht pika 3, fillimisht komisioni përzgjedhës do të duhej të kishte numër tek të anëtarëve, parashihet me nen që të jenë 4 anëtarë përzgjedhës të komisionit. Po ashtu, pika 3.4 është e paarsyeshme. Pse u dashka që në komisionin selektues të jetë dikush i Akademisë së Shkencave, meqë atje nuk ka asnjë ekspert të zhvillimit ekonomik, përveç katapultimit të kryeministrit, i cili, në fakt, as nuk do të duhej të ishte pjesë e Akademisë e as nuk është ekspert i zhvillimit ekonomik, të paktën, na e ka dëshmuar këtë për periudhën sa ka qenë kryeministër.

Neni 16 është po ashtu, i palogjikshëm, meqë ndihma shtetërore jepet në bazë të procedurave dhe aprovimit të komisionit dhe rrjedhimisht nuk ka si të jepet ndryshe. Nëse, ndihma shtetërore jepet jashtë këtyre procedurave, atëherë kemi të bëjmë me rast të pastër për Prokurori. Në fakt, skema është e tillë, që ua mundëson politikanëve të japin para pa kontroll, e nëse pastaj nuk mund të korruptojnë komisionin për ta legalizuar veprimtarinë e tyre, krejt çka ndodhë është që kompania përfituese obligohet ta kthejë ndihmën brenda një periudhe të caktuar kohore, ta zëmë, nëse ajo përcaktohet të jetë dhjetëvjeçare.

Dhe çka i bie kjo? Është që këto kompani të përfitojnë një formë ndihme financiare, e cila në fakt i bie të jetë me kamatë shumë të ulët apo fare pa kamatë. Dhe, siç e thamë edhe më lartë, neni 25 duhet të fshihet tërësisht.

Lëvizja “Vetëvendosje” do mund ta mbështeste miratimin e këtij ligji, pasi të sigurohet se ky projektligj do të siguronte pavarësinë e Komisionit për Mbikëqyrje të Ndhmës Shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Kolege të nderuara,

Kolegë të nderuar,

Shqipe Pantina i paraqiti vërejtjet kryesore në lidhje me Ligjin për ndihmën shtetërore. Unë dua të thellohem në dy nene kryesore.

Neni 16 i këtij projektligji merret me çështjen e kthimit të ndihmës shtetërore, në rastet kur ajo është dhënë në mënyrë të paligjshme, pra në rastet kur ka pasur keqpërdorim, kur është shkelur ligji, kur ndihma i është dhënë diku që nuk ka pasur nevojë për ndihmë, kur ka qenë i afërt me pushtetin, kur ka pasur konflikte interesi e kështu me radhë...

Neni 16 thotë në mes tjerash, se në raste të tilla fillojnë procedurat për ndihmë të kundërligjshme. Në këtë rast, mblidhen informacione të nevojshme dhe sillet një vendim për kthimin e ndihmës së marrë në mënyrë të padrejtë. Por, çfarë ndodhë kur konstatohet se ndihma është dhënë në kundërshtim me ligjin? Asgjë. Nuk po tallem unë, por po tallet ligji, vërtet nuk ndodhë asgjë.

Për dhënësin e ndihmës shtetërore, i cili është institucion i Republikës së Kosovës nuk ka asnjë pasojë. Neni 16 i këtij ligji nuk parasheh diçka të tillë. Normalisht, kur një ligj shkelet për çfarëdo që përvetësohet në mënyrë të paligjshme, për çfarëdo abuzimi me mjete publike, parashihet një dënim, por nuk parashihet asnjë masë për të ndëshkuar keqpërdoruesin, respektivisht institucionin që ka shkelur ligjin.

Pra, qytetarët mund të dënohen për çfarëdo shkelje të ligjit, ndërsa pushtetarët edhe kur keqpërdorin pasurinë publike, edhe kur abuzojnë me të, edhe kur e përdorin në mënyrë të papërgjegjshme shpëtojnë pa asnjë therë në këmbë. Në të njëjtën kohë, marrësi i ndihmës shtetërore pavarësisht mënyrës së paligjshme të përfitimit të saj, jo që nuk dënohet, por favorizohet duke lënë afate kohore e kamata mesatare, për të cilat nuk ka asnjë garanci, se mund të jenë më të favorshme se sa ato të bankave komerciale.

Me fjalë të tjera, si ai që abuzon me ndihmën shtetërore, si ai që ka përfituar me abuzim, sipas këtij neni shpëtojnë pa asnjë ndëshkim, madje përfituesi i ndihmës mund edhe të favorizohet.

Shumë problematik është edhe neni 25. Derisa sipas nenit 9 Komisioni i Ndhmës Shtetërore duhet të jetë organ i pavarur vendimmarrës, çfarë vërtet duhet të jetë, sipas nenit 25 ndihma shtetërore deri më 31 dhjetor të vitit 2020 është krejtësisht e varur nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, i cili përbëhet nga Abdullah Hoti, ministër i Financave të LDK-së, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani i LDK-së, kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës Valon Prestreshi, sipas informacioneve tona i LDK-së. Pra, prej pesë anëtarëve tre janë të LDK-së. Dy anëtarë të tjerë nuk janë të rëndësishëm, sepse vendimet merren me shumicë votash.

Pra, prej qëllimit të proklamuar në ligj për të pasur një komision të pavarur, sipas nenit 25 kemi një komision krejtësisht të varur nga LDK.

Zoti Hoti, pse flisni për pavarësinë e Komisionit për Ndhmë Shtetërore dhe të njëjtën kohë për katër vjetët e ardhshme dëshironi ta mbani këtë komision plotësisht nën kontrollin e LDK-së dhe vetëm të LDK-së?

Kjo ndarje e tillë e pushtetit flet më shumë për mjerimin politik në Kosovë, ku ligjet nuk bëhen për qytetarët, por për t'i shërbyer ndarjes së pushtetit në mes koalicionit PDK - LDK. Në këtë llogari keni kalkuluar vetëm një element gabimisht dhe kjo është, se LDK do të jetë në pushtet deri më 31 dhjetor të vitit 2020, gjë që nuk do të ndodhë kurrë.

Më perfidja në gjithë historinë e nenit 25 është pika 1.4, po e përsëris edhe një herë, më perfidja në gjithë historinë e nenit 25 është pika 1.4. Këtij neni, i cili thotë se në këtë komision do të jetë, po citoj: "...përfaqësuesi i asociacioneve të komunave."

Zoti ministër, fjala "asociacion i komunave" është përdorur në shumës. Me sa mua më është e njohur, në Kosovë kemi vetëm një asociacion të komunave. Do të doja të di, pse po e përdorni fjalën "asociacion" në shumës, kur Kosova ka vetëm një asociacion apo dëshironi, që në këtë mënyrë ta kontrabandoni futjen e "Zajednicës" në Komision për Ndhmë Shtetërore. Kjo, mendoj se është një lojë e pandershme, zoti ministër. Kjo është mashtrim dhe një përpjekje për t'i mashtruar deputetët tjerë dhe qytetarët e Kosovës, duke u përpjekur për ta futur "zajednicën" në komision përmes mashtrimit të lojës me fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të interesuar, që të diskutojnë. Qeveria nuk e ka kërkuar fjalën. Urdhëro!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Unë ju falënderoj për komentin. Ju lus që të bëni amendamente dhe në Komision për Buxhet dhe Financa do t'i trajtojmë secilin prej amendamenteve, që ju i dorëzoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, kalojmë në votime.

Kalojmë në deklarimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Të pranishëm janë 70 deputetë. Teknika, deputetë, votojmë tash!

Atëherë, kanë votuar 62 deputetë, për janë 52, kundër janë 2, 8 abstenojnë. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme, që në pajtim me vendimin e seancës plenare të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i raportojnë me rekomandime për seancën plenare të 14 korrikut të vitit 2016.

Kalojmë në votimin e ligjit tjetër. Deklarohemi me votim për miratim në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal. Deputetët dhe teknika bëhen gati, votojmë tash!

Kanë votuar 68 deputetë, për janë 51, kundër janë 10 deputetë, abstenojnë 7 deputetë. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, komisionet e përhershme, që në pajtim me vendimin e seancës plenare ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime për seancën plenare, që do të mbahet më 14 korrik 2016.

Kalojmë në deklarimin me votimin për miratimin në parim të Projektligjit për ndihmën shtetërore. Ju lutem, deputetë dhe teknika të bëhemi gati. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë, 55 janë për, kundër janë 3, abstenojnë 9. Pra, me shumicë votash Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Komisioni FunkSIONAL dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbështetje të vendimit të seancës plenare të datës 9 qershor 2016 ka rishqyrtuar Projektligjin për investime strategjike në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 35 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit. Nëse do kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa, e ke fjalën, nëse ke nevojë. Urdhëro, Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Ne në bazë të konkluzës së Kuvendit, ne kemi mbajtur një takim së bashku me Komisionin për Buxhet dhe aktorët tjerë të interesuar dhe e kemi harmonizuar amendamentin 32, konkretisht deri në amendamentin 32, atë ditë i kemi votuar të gjitha amendamentet tjera. Në amendamentin 32 është harmonizuar dhe është prezantuar në raportin që e keni gjerësisht, në faqen 41, nuk kam nevojë ta lexoj.

Natyrisht, se ne besojmë që pas diskutimeve të shumta lidhur me këto amendamente, ne kemi mbërrirë zgjedhje optimale, nuk janë zgjedhje ideale, siç i kemi dëshiruar, ndoshta aktorë të ndryshëm, por janë zgjedhje optimale, të cilat do t'i testojë praktika dhe besoj se do të nxisin investimet dhe do të realizohen qëllimet e Qeverisë edhe të Kuvendit për nxitjen e investimeve nëpërmjet këtij ligji. Ju ftoj që ta votoni këtë amendament.

KRYESUESI: Faleminderit! Këtu janë nga ana e komisionit, janë propozuar gjithsej 35 amendamente, të cilat janë të gjitha të komisionit, prej 1 deri në 35. Nëse doni, ne i pranojmë të gjitha përnjëherë, nëse doni shkojmë... si të keni qejf.

Pra, kush është për amendamentet e votuara të Komisionit FunkSIONAL nga 1-35. Kush është për? Faleminderit! Kush është kundër? A abstenon dikush?

Amendamentet e Komisionit nga 1-shi deri në amendamentin 35, kanë kaluar.

Tash do të votojmë. Teknika le të bëhet gati. Urdhëro Shaip Muja!

SHAIP MUJA: Zoti kryesues,

Është mirë të mos ngutemi, në të gjitha amendamentet të shkojmë. Ky është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm, po është me rëndësi me lejua me pa vërejtje, ju si gjuhëtar, desha të tregoj në disa pika, ku edhe nga aspekti gjuhësor në gjuhën shqipe, s'po flas për gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze, por edhe nga aspekti ekonomik dhe strategjik, në disa nene kemi të drejtë të vlerësojmë amendamentet ose nenet, të cilat kanë ardhur nga komisioni. Prandaj, nëse duam të japim vërejtje është mirë, nuk janë këtu që po rrimë një javë ditë ne për këtë punë. Po dëgjojmë gjithçka për... të lutem, të shkojmë me radhë, me nene. Edhe e kemi edhe një vërejtje. Po, nuk është si të doni. Unë po ju them, nëse shkohet me nene veç e veç, ka gabime gjuhësore, në të shtypur dhe në të shkruar, me numër, ka dhe gjuhësore dhe ti e miraton si ligj.

Prandaj, këtu tregon se nuk është lexuar thellësisht. Mandej, tek amendamentet, as nuk ceket a është me miratimin e Komisionit FunkSIONAL apo të ndonjë deputeti. Të lutem!

KRYESUESI: Unë punoj me letra, zoti Muja. Në letra thotë: "është me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL." Në letra shkruan kështu e si është tutje, unë nuk interpretoj. Pra, nëse doni unë edhe një herë shkoj për çdo nen.

Amendamenti 1. Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 2. Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 3. Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 4. Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 5.

Po, ku është amendamenti, ku është? Për cilin nen? Atëherë, mos...

(Ndërprerje e incizimit)

Ju lutem shumë!

Amendamenti 5. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 6. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 7. Kundër? Abstenim? Një. Kalon.
Amendamenti 8. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 9. Kundër? Abstenim? Kalon, me shumicë.
Amendamenti 10. Kundër? Një. Abstenim? S'ka. Kalon.
Amendamenti 11. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 12. Kundër? Një. Abstenim? Kalon.
Amendamenti 13. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 14. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 15. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 16. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 18. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 19. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 20. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 21. Kundër? Abstenim? Kalon.
Amendamenti 22. Kundër? Abstenim? Kalon.

Cilin po e do? O zotëri, unë ta jap fjalën sa herë të duash, por thuaj për çka e ke fjalën. Mujës jepjani fjalën, për cilin nen e ka.

SHAIP MUJA: Mos bëni hajgare! Nuk është serioze, zoti kryesues!

KRYESUESI: Kjo është super-serioze, ti s'je serioz.

SHAIP MUJA: Absolutisht, nuk është serioze, unë po të tregoj.

KRYESUESI: Urdhëro, mos komento! A ke propozim, a ke...?

SHAPI MUJA: Në nenin 4, pika 1.1.3. i ke, thotë: “20 milionë investim me numër, ju e pranuat tash. Thotë” 20 dhjetëmijë” me shkrim. Merreni lexojeni!

E dyta, në amendamentin, të cilin ju e thoni, në nenin 18, në amendamentin 30, unë e kam një propozim logjik. Ne kemi ekonomistë këtu, të cilët edhe e kryesojnë Qeverinë, thuhet: Në një amendament, në pikën 3, thuhet: “Eksperti gjyqësor”. Unë propozoj, që “eksperti gjyqësor i certifikuar dhe i pranuar ndërkombëtarisht”. Ekspert gjyqësor për vlerësimin e aseteve ekonomike në Republikën e Kosovës ne nuk kemi. Prandaj, pse po ngutemi? Ky është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Te neni 4 është propozuar një amendament për t'u tërhequr fare, se është qesharake të na shohë dikush, kur zoti ministër Hoti thotë për një vend të punës janë 10 mijë euro, dhe ju i thoni një investitori: investo në energjetikë 30 milionë euro dhe 80 vetë të hyjnë në punë. Cila është logjika, kur në Bashkimin Evropian në energjetikë pranojnë edhe investime më të ulëta dhe të subvencionojnë, edhe e rrit numrin e punonjësve. Në shëndetësi thuhet: 10 milionë euro, të punësohen 50 veta. Janë standarde, që quhen "Medicin beis evidenc". Për personat ose për metër katror, ose për specifikim, ti mundesh me 10 milionë euro vetëm një aparaturë ta blesh dhe e punëson vetëm një person, por ti do ta bazosh në evidencë, kurse ju si Qeveri do të merrni pjesë në investim strategjik.

Prandaj, nuk jemi duke u ngutur për ndonjë inati. Unë jam munduar ta lexoj dhe po shpreh mendimin tim që Komisionit ndoshta i ka shpëtuar... Ose, tek një nen, që ju e kaluat - investimet pesëvjeçare të zgjasin. Më mirë është të thuhet trevjeçare dhe ti e ke një komision operacional atje, i cili e vlerëson ditë për ditë. Por, nëse i thua 5 vjet, investitori thotë: mirë, unë vij për 5 vjet dhe nuk jap rezultate, sepse e kam një bashkinvestitor këtu.

Ka në Republikën e Kosovës investitorë vendorë, të cilët mund të presin, e këtu ne po flasim sikur i kemi 100 mijë investitorë, dhe vetëm po ua bëjmë një ligj këtu, dhe tjerët t'i selektojmë. Madje, një ligj që do të vijë për prapa, me një nen që është në kundërshtim me leje të komunave, që është për asete të komunave. Ata e kanë një ligj, i cili tregon se si jepet pronësia e komunave dhe nuk mund të thuhet në ligj - përkatësisht. Duhet të thuhet qartësisht se kush e merr vendimin e pronësisë së komunës. Kurse, thuhet Kuvendi i Republikës së Kosovës i heq, dhe mund t'ua citoj nëse doni, prandaj është në kundërshtim sepse nesër në interpretim në praktikë do të jetë problem.

Ju lutem, mos të ngutemi, sepse s'kemi nevojë të ngutemi. Ne, ashtu kështu po humbim kohë edhe për gjëra që s'ia vlen, prandaj për këto të shkojmë dalëngadalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë të dëgjova me kujdesin më të madh dhe meqë këtu punojmë me letra, me rregulla, me rekomandime është mirë që këto letra të rregullohen, sepse nuk është punë i perceptimeve individuale.

Amendamenti numër 7 thotë: Neni 4 fshihet. Dhe ky nen 4, ju lutem shumë, është në raportin faqe 13, 14, 15 dhe 16. Ai nen është fshirë. Kolona e tretë s'ekziston, kurse ne tash mund të zgjasim diskutime, por në letra e kanë fshirë dhe unë nuk di çka do të bisedojmë ne kur Komisioni e ka fshirë, prandaj edhe s'kemi çka të flasim.

Kjo është e qartë si biluri, kush e do. E tash, nëse keni kohë të bëjmë biseda, por letrat e kanë fshirë atë nen. Këtu është problemi. Prandaj, qartësisht le jetë, sepse unë me atë s'merrem.

Pra, unë mendoj se jemi në fazën kur kanë kaluar nëpër komision, janë herrë, kanë marrë formë të propozimit ligjor dhe ne po votojmë propozime ligjore, kështu që nuk është punë ngutjeje. Ne mund të rrimë sa të doni, por këto votohen në këtë formë.

Ju thatë, jo të gjitha, dhe vazhdojmë me të gjitha rend dhe unë po ju them nëse s'vlejnë, mos i votoni. Këtë ju e keni në dorë, e unë s'po ngutem, përkundrazi - sa ndejën po e bëjmë. Prandaj, do të vazhdojmë tutje me nenet e tjera.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

E doni fjalën për amendamentin 32? Urdhëro, zoti Fatmir Rexhepi e ka fjalën lidhur me amendamentin 32. Urdhëroni!

FATMIR REXHEPI: Nuk po e qartësoj, por te amendamenti 32 po e vlerësoj variantin e parë të propozimit që e kemi pasur në Kuvend, ku thuhet se bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës të ndërmarrjeve shoqërore te investitori i interesuar duhet të bëhet me një vendim të Kuvendit me shumicë të thjeshtë, që është propozim i ri.

Mendoj se duhet të mbetet varianti që ka qenë më herët në Projektligj, që ky vendim të merret me shumicë të kualifikuar prej 61 votash.

Çdo vendim që ka të bëjë me një pronë, ka një peshë të madhe, aq më parë për një investim strategjik. Edhe legjitimiteti i atij vendimi me 61 vota është shumë më i mirë, më transparent dhe më i fuqishëm për vetë investitorin se sa t'i mundësohet që të merret një vendim me 31 vota.

Duket ndoshta pak e mërzitshme, se ky vendim është marrë në Kuvend, por unë mendoj se për çdo qeveri, pavarësisht a është kjo qeveri apo do të ishte tjetra nesër, këto vendime vetëm sa e fuqizojnë besimin ndaj investitorit strategjik. Nuk duhet lejuar vetes që këto prona të barten me 31 vota në Parlament, por duhet të kthehet me propozimin e parë që të jenë 61 vota.

Do pak mund e punë më shumë, por është shumë më e besueshme dhe shumë më e fuqishme.

Unë e kam edhe një sugjerim për Qeverinë, që të mendojë edhe për Ligjin për buxhet, i cili është i rëndësishëm së veçantë, të cilin e kemi dhe mund ta aprovojmë edhe me 31 vota, por të mendojmë se a duhet aprovuar buxheti me 31 vota. Mendoj që jo.

Prandaj, mendimi dhe propozimi im është për një vlerësim shumë parimor dhe objektiv është që të mbetet me 61 vota. Faleminderit!

KRYESUESI: Për amendamentin 32, a do të paraqitet ndokush tjetër? Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Kjo që e shtroi kolegu deputeti Fatmir Rexhepi është një çështje që e kemi diskutuar dhe kjo ka qenë arsyeja pse kemi shkuar në harmonizim, dhe ne e kemi bërë një harmonizim me Komisionin për Buxhet dhe me të gjithë aktorët e interesuar dhe kemi konsideruar se kjo është një zgjidhje optimale, e cila mundëson një procedurë më efikase.

Çështja e si duhet të vendosë Kuvendi, me 61 vota për buxhet dhe për shumë çështje, ndoshta është një çështje parimore që meriton diskutim më të gjerë. Por, sa i përket këtij ligji, mendoj se jemi plotësisht të sigurt se me kalimin në buxhet, me shumicën e deputetëve prezentë, ne e sigurojmë interesin publik në tërësi, prandaj unë ju ftoj që të votoni këtë amendament, të cilin e kemi harmonizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shqip Muja, për 32-shin.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues,

Te pika 2, përveç vërejtjeve që i tha edhe zoti Rexhepi, thashë të qartësohet, sepse janë ligjet në fuqi për pronën komunale. Nëse thuhet kështu se Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike, përkatësisht komunale, për

investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht kuvendit të komunës përkatëse, ne kemi miratuar në mandatin e kaluar për pronën që i bie në dy pika, edhe te menaxhimi i pronës komunale por edhe te kohëzgjatja, sepse vjen një nen më poshtë këtu, neni 24, ku thuhet se për investime strategjike jepen 40 vjet, ndërsa në pronësinë komunale e japim për 99 vjet, me projekt. Prandaj vjen kjo ndesh me ligjet të cilat janë në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë i dëgjova diskutimet, variacionet. Në dokument është shkruar si propozim alternativ. Ne nuk kemi asnjë germë për ta votuar, pos rekomandimit të Komisionit.

Unë i dëgjova vërejtjet dhe përtej kësaj, s'kam çfarë të them si drejtues, pos ta votojmë ose jo amendamentin 32.

Kush është kundër këtij amendamenti? Mund të votoni me dorë!

(Ndërhyrje)

Si? A doni të votoni?

(Ndërprerje e shkurtër)

Ismet, por vetëm një fjali!

ISMET BEQIRI: Ndoshta kjo fjali është pak e zgjeruar.

Zoti kryesues,

Ju kisha lutur, këtu do të duhej sqaruar, ose edhe ministria, sepse nëse miratohet ky amendament, nuk ka qartësi ose saktësi se çka nëse Kuvendi i Kosovës vendos për dhënien e një prone komunale dikujt, e kuvendi komunal nuk e jep pëlqimin.

Duhet sqaruar se a ka konflikt interesi, sepse në momentin e caktuar vjen në kundërshtim me ligjin që ka të bëjë me shfrytëzimin e pronave komunale, që është ligj i veçantë.

Unë sa munda ta kuptoj zotin Muja, këtu duhet pasur të qartë a ka konflikt në ndonjë mënyrë ose kolizion të këtij ligji që do të miratohet me ligjet që i kemi për shfrytëzim të pronës komunale, që janë ligje të veçanta.

Pra, vetëm ta sqarojmë këtë dilemë, sepse, edhe një herë po e them, nëse Kuvendi i Kosovës vendos, si thuhet atje “për dhënien e një toke në shfrytëzim publik dhe kuvendi komunal....” Çka nëse kuvendi komunal nuk e jep pëlqimin? Atëherë, cilit ligj duhet subordinuar, këtij që tash po e miratojmë, apo të mëhershmit që ka të bëjë me shfrytëzimin e pronës komunale?

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjova venerimin tënd dhe këto venerime kurrkush s'ia ka ndaluar kurrkujt t'i bëjë më herët dhe të bëjë edhe variacione. Si interpretime, ne i dëgjuam.

Edhe një herë po ju them, zonja e zotërinj, ekziston një tekst që është ofruar. Alternativë s'ka. Ju thërras që ta votoni amendamentin 32 me elektronikë.

Pra, le të bëhen gati deputetët dhe regjia që të votojmë amendamentin 32. Votojmë tash!

Nuk ka vota të mjaftueshme.

Kanë votuar 51 deputetë, për janë 25, kundër 12 dhe abstenojnë 14.

Një tip i votimit obstruktiv në Kuvend që s'është herë e parë. Domethënë shumica është për, por deputetët nuk e kanë votuar, dhe për këtë as s'janë për, e as kundër, dhe s'është votuar. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Të nderuar nënkryetarë të Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Ne në seancën e kaluar kemi kërkuar që të shtyhet kjo çështje në mënyrë që të sqarohet papajtueshmëria që ka qenë ndërmjet dy komisioneve të Kuvendit, dhe unë mendoj që s'është asnjë arsye që edhe më tutje të prolongojmë aprovimin e këtij ligji.

Ne ligjin e kemi konsideruar si ligj të veçantë, në interes për vendin, në mënyrë që të tërheqim investitorë të huaj dhe unë nuk shoh nevojën që të gërshetohen interesat tona brenda këtu dhe që ligji pastaj t'u përshtatet interesave të veçanta të individëve në Kuvend.

Këtë e kemi në interes të vendit që ne të kemi investitorë. Nuk duhet veti t'ia komplikojmë që të kemi 61 vota për të vendosur për prona, sepse e dini që nuk është lehtë për t'i siguruar 61 vota edhe për çështje më të rëndësishme, e lëre më për këtë, sepse kemi probleme në terren, të cilat gërshetohen dhe të cilat pastaj na krijojnë pamundësi që ne ta sigurojmë atë votë, kurse në qoftë se ju konsideroni që ne na nevojitet ky ligj, atëherë ligjin ta procedojmë dhe ta aprovojmë.

Në qoftë se vlerësoni se nuk nevojitet, ne nuk kemi nevojë të lidhemi me këtë nen as për shpronësim të pronave, për arsye se nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës vendos që një pronë të një komune ta vërë në dispozicion të një investitori, atëherë është Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të cilët marrin për obligim që të kompensojnë atë pronë, dhe prona kompensohet me procedura të cilat janë propozuar me këtë ligj.

Pra, në qoftë se ajo bëhet, kjo do të thotë se komunës i kompensohen pronat ashtu sikur që i kompensohen edhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sepse edhe me Agjencinë kemi marrëdhënie pronësore e juridike, ne s'mund t'ia marrim Agjencisë pronat dhe të themi se këto tash u bënë tonat pa asnjë kompensim, për arsye sepse duhet kompensuar 20%-shi punëtorëve dhe po ashtu duhet të kompensohen kreditorët potencialë, të cilët mund të na paraqiten në procedurat e kompensimit, prandaj ju lus që ta kapërcejmë këtë, të kemi mirëkuptim, sepse nuk mundemi gjithmonë të nisemi prej pozicioneve individuale, për arsye se ligji është ai që duhet t'i shërbejë shumicës së qytetarëve të Kosovës dhe interesave të Republikës së Kosovës, e jo interesave të individëve, sepse nganjëherë për interesa të ngushta ne po dështojmë në aprovimin e ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë them që ta kryejmë votimin, sepse ne jemi edhe te dy nene të parafundit. Amendamentin 32, unë e vë në votim, edhe një herë!

Votimi le të bëhet me elektronikë.

Pra, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 74 deputetë. Kanë votuar 52, dhe kjo është gjendja. Nëse neni s'kalon, mbetet i vjetri, ju këtë po e dini, prandaj harroni krejt këtë far të ashtuquajtur diskutim parimor, sepse s'po më duket parimor, sepse të dy palët po e kaloni. Prandaj, me mosvotimin e këtij neni, do të thotë mbetet neni i vjetër dhe kjo është humbje kohe i dy mbledhjeve.

Vazhdojmë tutje!

Amendamenti 33.

Për çka e kërkon fjalën? Urdhëroni! Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Për votimin e amendamentit, në tekstin origjinal, në rast se nuk aprovohet ky amendament, mbetet, ka të bëjë me pronat që janë në AKP, ku ai tekst nuk e rregullon çështjen e kreditorëve dhe automatikisht Gjykata Kushtetuese këtë ligj e bën të pavlefshëm.

Prandaj, të jemi të vetëdijshëm çka po bëjmë. Nëse dëshirojmë ta pengojmë këtë ligj, urdhëroni të bisedojmë. Prandaj, ky tekst ka ardhur pas konsultimeve dhe diskutimeve të shumta dhe mos harroni, ne e kemi fuqizuar për dallim prej të gjitha vendeve, që Kuvendi i Kosovës të vendosë. As në Shqipëri, as në Kroaci, as në Maqedoni kuvendi nuk vendos, por vendosin grupe të caktuara brenda qeverive. Ne i kemi bërë të gjitha kushtet që për këtë ligj të vendoset në mënyrë transparente dhe në Kuvendin e Kosovës, përkatësisht në kuvende komunale kur është çështja për pronat komunale.

Prandaj, ju lus, kemi diskutuar shumë dhe unë i ftoj deputetët që ta votojnë këtë amendament, në mënyrë që të mundësohet zbatimi i tij.

KRYESUESI: Zoti Muhamet Mustafa, kjo është punë teknike e votimit dhe tash bindjet apo mosbindjet janë të drejta të deputetëve dhe unë nuk jam këtu që të bëj lobim për ligj.

Unë po ju them se ndryshe nuk ka si të votohet. Ashiqare Kuvendi me 70 e kusur deputetë nuk po voton.

(Ndërrhyrje)

Po, qysh po doni t'i votojmë? Ashtu, ti e kërkoje këtë.

Pra, kush është kundër këtij amendamenti, me ngritje dore?

Kundër, me ngritje dore?

Asnjë s'qenka!

Atëherë, kjo i bie se ata i kanë të regjistruar emrat dhe mos kujtoni se s'dihet qysh keni votuar më parë, dhe të mos luajmë.

Kush abstenon? Abstenojnë 6.

Kush është për, me ngritje dore.

Ju lutem, i numëroni kush është për?

(Ndërprerje e shkurtër)

Nuk është në rregull, s'po duan të votojnë!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Unë megjithatë, ju lus që, nëse sot s'jemi në gjendje të votojmë të mos shkojmë me tërheqje, se tërheqja është më së lehti dhe unë para e kisha tërhequr se sa të lejojmë të aprovohet një ligj i cili do të jetë defektiv, sepse ne s'guxojmë që me ligj të kemi pasoja dhe nesër të mos mund t'i vlerësojmë ose t'i paguajmë pronat që ne i marrim, për arsye se ne s'guxojmë të hyjmë në marrëdhënie të tilla ose që të bëjmë gabime dhe shkelje ligjore. Prandaj unë më shumë e konsideroj mundësinë që ta tërheqim si Qeveri, e fare të mos merremi me të, se sa që të aprovjmë një tekst, i cili do të jetë me defekte, për arsye se propozimi apo teksti fillestar, siç është, nuk e rregullon çështjen e shpronësimit të pronave të AKP-së dhe pastaj ajo çështje nuk mund të bëhet me rregullore të brendshme të Qeverisë, ose në bazë të intuitës së Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, sepse bëjmë shkelje ligjore.

Pra, nëse sot s'kemi numër të mjaftueshëm të votojmë, unë ju kisha lutur ta shtyjmë për seancën e ardhshme të Kuvendit më 14, edhe këtë çështje dhe ta votojmë dhe edhe atëherë nëse s'arrijmë, të enjten ne si Qeveri do ta tërheqim ligjin, sepse nuk do të pajtohemi që në Kuvend të aprovohet një ligj, të cilin Qeveria pastaj nuk mund ta implementojë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYESUESI: Zoti kryeministër dhe deputetë të nderuar, shumica keni shumë legjislaturë dhe i dini rregullat, s'ka nevojë t'ua tregoj unë.

Ne kemi hyrë në votime. Kjo mund të tërhiqet para votimeve dhe nuk është tërhequr para votimeve dhe kjo është marrëveshje kuvendore dhe nëse ju thoni po, duhet të reflektojmë edhe pak për këtë problem, unë e pranoj. Porse, sipas rregullave, një ligj kur hyn në votim, vazhdon të votohet. Ju nëse e keni reflektuar, edhe një herë po ju kthej, votoni, por nuk kemi nevojë më të humbim kohë me diskutime.

Atëherë, seanca tjetër është në vazhdim nesër. Seanca nuk është kryer, e nëse ju doni të kalojmë në trajtim të ndonjë pike tjetër, kalojmë.

Pra, a doni të kalojmë në pikë tjetër dhe të vazhdojmë?

(Ndërhyrje)

Besa Gaxherri e kërkon fjalën.

BESA GAXHERRI: Zoti kryesues!

Ne sot, si shpeshherë, po e qesim veten në lojëra, të cilat vërtet janë të pakuptueshme.

Komisionet funksionale dhe njerëzit kompetentë për këtë ligj kanë punuar me ditë të tëra dhe i kanë sjellë amendamentet e harmonizuara edhe në Komisionin e Buxhetit.

Dhe, ju zoti kryesues, i vutë të gjitha amendamentet – 35 në pako. Dhe ky Kuvend, me vota i votoi dhe janë evidentuar se janë votuar.

Për çka po kthehet procesi i çdo amendamenti, tash duhet të na jepni përgjigje dhe cili votim është tash valid. A është votimi, ai i të gjithë deputetëve që e bëmë në pako, apo është votimi tash amendament për amendament, që futi në lajthitje dhe lojëra njëri-tjetrin këtu dhe dalim qesharakë para qytetarëve të vendit.

Ju kisha lutur që të aprovohen amendamentet ashtu siç i votuam në pako, të gjithë deputetët dhe të mos shkojmë më tutje me këto lojëra.

Ligji është i rëndësishë së veçantë, ekspertët dhe komisionet kanë punuar dhe ne i votuam, dhe pse duhet kthyer prapa? Faleminderit!

KRYESUESI: Shikoni! Bile mua, mos më shitni mend shumë për Rregullore, se e di sa ju, nëse jo, më mirë.

Nëse Kuvendi bën marrëveshje totale që të kalohen, ne e provuam atë dhe ju e patë se u kontestua. Rregullorja e Kuvendit, po e lexoj, letra: “Amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një, sipas radhitjes së paraqitur krahas tekstit të projektligjit”. Pikë! Kuvendi nëse me marrëveshje e bën, sikur që e bëmë ne, por Kuvendi s’e deshi, sepse kishte deputetë që s’e deshën... Pra, kjo nuk është punë vullneti dhe të mos diskutojmë se është provuar.

Këtu ka deputetë që mund të votojnë për, kundër dhe të abstenojnë. Problemi është abstenimi për t’u deklaruar, një problem që e ka shpesh ky Kuvend prej që Enver Hasani ka thënë se pa votuar të deklaruar 61, s’vlen. Dhe ju e dini çka është kjo! Këtë po e shfrytëzojnë njerëzit, dhe kjo është e qartë. Nuk është problemi tjetër, se shumica po votojnë, por 61 deputetë nuk po deklarohen. Mbajeni në mend, as me dorë, as me elektronikë! Dhe, a e keni të qartë?

(Ndërhyrje)

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së do të flasë Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Flas në emrin tim si deputet dhe për shkak të situatës në të cilën tani është futur Kuvendi, për çka besoj edhe ju jeni të qartë, për respektimin e Rregullores, duke pasur parasysh edhe interesin strategjik të Kosovës sa i përket miratimit të këtij ligji, në veçanti për investime strategjike, të gjithë ne këtu, edhe subjektet politike, e kanë gojën plot për investime strategjike dhe thithjen e investorëve për këto investime në Kosovës, ndërsa tani ne vetveten e bllokojmë me arsye, ose, në fakt, pa arsye. Mendoj se në këtë rast nuk ka nevojë fare kryeministri ta tërheqë këtë ligj, por është edhe një mundësi që e jep Rregullorja, është leximi i tretë dhe mendoj që është çështje që mund ta kryejnë komisionet parlamentare dhe brenda një jave të na vijë në Kuvend. Prandaj, mendoj se duhet shfrytëzuar atë mundësi. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYESUESI: Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Konsideroj se teknika e udhëheqjes së kësaj seance lidhur me këtë votim ka mundur të mos na bie në këso situatash. Keni përdorur tri teknika të votimit.

Pra, ka shkuar votimi në pako, që është përsëritur. Pra, është votuar, kundër – s’ka, abstenim – s’ka dhe shkohet më tutje. Është dashur të përfundojë në këtë mënyrë, për arsye se ti me shkrim nuk ke pasur amendament tjetër, por e ke një amendament dhe deri sa e ke një amendament, shkohet në teknikën e njëjtë të votimit për t’iu shmangur asaj që e ka bërë Enver Hasani.

Prandaj, unë të kisha lutur, shko në teknikën e njëjtë: Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka. Dhe, me shumicë, konsiderohet i aprovuar. Kështu përfundohet!

KRYESUESI: Unë ju respektoj dhe ju dua të gjithëve. Nëse ju duket juve se problemi i teknikës është, unë heq dorë prej të triave dhe e bëjmë si të doni, por i kemi provuar të gjitha. Nuk është problem teknike hiç, por është problem vullneti. Nëse ju keni vullnet ta votoni këtë nen, e votoni me tërë teknikat, dhe këtë e zgjidhni vetë. Ismeti e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Meqenëse erdhëm në situatë të tillë, e ne kemi ardhur te amendamenti 32, unë propozoj, sepse kemi të drejtë si deputetë, të propozojmë që seanca të vazhdojë nesër nga amendamenti 32 dhe vazhdojmë më tutje ku kemi mbetur. Ne e kemi këtë të drejtë dhe unë, në konsultim, dominon edhe mendimi i kolegëve, nuk kemi nevojë të vazhdojmë me këto paqartësi dhe nesër vazhdojmë prej amendamentit 32 dhe besoj që e kryejmë ligjin. Unë propozoj pra që seanca të vazhdojë nesër prej orës 10.

(Ndërrhyrje)

Sepse, unë kam të drejtë, dhe ti mund të flasësh vetë, zonjë! Mos ndërhyj! Zoti kryesues, unë propozoj që nesër seanca të vazhdojë prej orës 10 dhe vazhdon prej amendamentit 32, ku kemi mbetur, të këtij projektligji. Pra, ta ndërpresim seancën e sotme dhe vazhdojmë nesër. Faleminderit!

KRYESUESI: Kërkoj deklarin për këtë propozim? Grupet e tjera, PDK çfarë mendon? Kush e merr fjalën, në emër tuajin? Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar e mbështet idenë që të vazhdojmë seancën nesër, me pikat në vazhdim. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupet e tjera? Nga “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Nuk më ka ndodhur të shoh në praktikën e Kuvendit që seanca të ndërpritet në mes të shqyrtimit të amendamenteve të një ligji. Është e panatyrshme edhe për një arsye tjetër dhe jo vetëm për arsye teknike, por edhe përmbajtjesore dhe arsyet përmbajtjesore janë se, nëse ky është interes i Qeverisë dhe nëse deputetët e koalicionit, ka edhe të tillë që nuk e donë pikërisht këtë amendament dhe e kontestojnë atë, tash çfarë do me ndërmarrë Qeveria ose koalicioni qeverisës? T’i shpërblejë, sikur që di t’i shpërblejë gjithmonë deputetët, për të arritur qëllimin e vet? Pra, pikërisht këto ndërprerje mund të fshehin prapa motive të pasinqerta, të cilat nuk duron praktika parlamentare: ndikimi qeveritar për t’i pasur 24 orë për t’i bindur deputetët, të cilët nuk janë të nënshtruar, për t’iu bindur qëllimeve dhe planeve të Qeverisë. Kjo është totalisht e papranueshme!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet e tjera nuk paraqiten. Atëherë, kush është që të vazhdojmë nesër në orën 10:00? Faleminderit!

Kundër? Abstenim?

Atëherë, seancën do ta vazhdojmë nesër në orën 10:00.

* * *

E premte, më 8 korrik 2016

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 7 korrik

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,
Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 7 korrik 2016.

Në sallë janë 64 deputetë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Në seancën e djeshme janë miratuar amendamentet 1 deri 31, të propozuara nga Komisioni Funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve me radhë.
66 deputetë janë në sallë.

Amendamenti 32

A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Një abstenim. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Qysh ke dëshirë, kthehem edhe një herë. Qe një vit e gjysmë, prej se jam kryetar, kështu jemi duke votuar.

Amendamenti 35.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, edhe një kartelë, e bëjmë me dorë pasi je lajmëruar përpara.

A jemi gati tani?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:
52 deputetë kanë votuar. 46 për, plus 3, 49 deputetë, nuk kalon.

(Ndërhyrje...)

Jo, veç nëse doni edhe një herë. 72 deputetë janë.

A e bëjmë me dorë? Përgatitemi me dorë. Lëvizja “Vetëvendosje” po qesh. 72 deputetë janë në sallë.

Kush është kundër? Kush abstenon? 4 abstenime. Kush është për? 51 janë për. Nuk kalon prapë.

Profesorë, a ka mundësi ta vazhdoni seancën, se kam takim.

Me 51, s’kanë votuar hiç, as abstenim, as kundër, nuk po votojnë. Unë s’mund t’i detyroj me zor.

Është e treta herë që po futemi në votim. E vetmja mundësi është përmes formës elektronike, unë nuk mund t’i shtyj me zor. Vetëm pak, të jemi korrektë, se po na sheh gjithë opinionin publik. S’po punon, po kemi një herë, dy herë, të kemi njehur ndash. Kemi njehur si deputetë me votim me dorë, kërkoj falje. 3 minuta, 4, vetëm sa të rregullojnë teknikën. Unë nuk e di se çka ka?

Zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që ky votim nuk është i rregullt, edhe lus dy shefat e grupeve parlamentare, Grabovcin edhe Beqirin, le të merren vesh si koalicion. Nëse edhe anëtarët e tjerë të koalicionit e shohin, le ta shtyjnë këtë për votim tjetër. Kur t’i kemi deputetët, votojmë. Mendoj që nuk është në rregull, nuk bën, ligji është me rëndësi të veçantë, duhet të kalojë në parlament, jo t’u jepet shans grupeve të tjera të mos votojnë ligjin.

KRYETARI: Ju kisha lutur vetëm pesë minuta pauzë, të konsultohemi me administratën për çështje teknike, ose nuk po punon, edhe kartelat, u kisha lutur. Krejt deputetët të cilët nuk kanë kartela, t’i marrin ato dhe do të provojmë edhe një herë, më nuk futem në votime as me dorë as, është edhe kredibiliteti i këtij Kuvendi, tri herë voto, katër herë, i njëjti rezultat.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes pas një pauze të shkurtër.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Do të votojmë vetëm nëpërmjet teknikës.

Sa deputetë janë pa kartelë? Asnjë.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Me kartela janë 77 deputetë, 40 janë për, një është kundër. Nga 44 votime, edhe tri abstenime.

Kuvendi nuk ka kuorum për miratimin e Ligjit për investime strategjike në Republikën e Kosovës.

Ministre, më fal, ministrja e ka fjalën, s’e ka kërkuar paraprakisht, kërkoj falje.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dola këtu të sqaroj disa gjëra për hir të opinionit. Kur e kemi sjellë Ligjin për investime strategjike në lexim të parë ju kemi bërë shumë të qartë që negociata të drejtpërdrejta me investitorët bëjnë jo vetëm vendet tona fqinje, por edhe anëtarët e Bashkimit Evropian, siç janë Kroacia, Bullgaria dhe Malta.

Ju kemi treguar që Kosova nuk është në konkurrencë të barabartë për të tërhequr investitorë pikërisht për shkak të burokracisë, perceptcionit për korrupsionin dhe për shkak se ne sot me ligjet ekzistuese sa herë që investitorët vijnë për të investuar në asetet konkrete tona, ne iu drejtojmë atyre që duhet të konkurroni për të ardhur dhe për të investuar në Kosovë.

Më tregoni ju mua sot, të cilët nuk e mbështetët këtë ligj, a e ka komoditetin Kosova që me 35% të popullsisë të papunë t'u thotë investitorëve gjermanë se për të marrë 3 mijë hektarë tokë për të mbjellë lajthi duhet të shkoni në Agjencinë e Privatizimit dhe të konkurroni dhe të jeni konkurrencë me disa deputetë që ulen sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kanë akses deri më sot të drejtpërdrejtë në pronat e AKP-së. Andaj, kjo është arsyeja për çka sot nuk është votuar Ligji për investimet strategjike, Dhe të gjithë ju, të cilët nuk e keni mbështetur këtë ligj, ta dini se po e mbani peng zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo është e padrejtë.

Ju e keni pasur ligjin si deputetë të Republikës së Kosovës të Kuvendit pesë muaj, keni mundur ta e ndryshoni dhe ta amendamenti, por pa asnjë argument të mos mbështetët, kjo nuk është e drejtë. Kosova ka mbetur peng e individëve që 17 vjet dhe kjo nuk është e drejtë.

Andaj, unë kërkoj nga Prokuroria të hetojë të gjitha privatizimet dhe qysh njerëzit janë bërë pronarë të qindra-mijëra hektarëve, të cilat sot i mbajnë në listën e aseteve dhe i raportojnë në Agjencisë Antikorrupsion.

Mirëpo, nuk janë në gjendje të investojnë, sepse ata i kanë blerë këto prona për t'ua shitur investitorëve të tjerë dhe investitorëve gjermanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Nait, a e kërkoje fjalën?

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Në tabelë ishte një votë kundër, unë isha kundër, ta bëj publike votën time, pikërisht sepse kryetari i komunës... ministre, të lutem rri këtu, na dëgjo. Të lutem, ministre, rri këtu, nuk bën veç të na lëshohen miza e të iket. Nervozizmin nuk mund t'ua heqim ne kur nuk është ligj si duhet dhe ku merr përgjegjësi dhe ngarkon qytetarët e Kosovës dhe Qeverinë.

KRYETARI: Nait, të lutem, për temën.

NAIT HASANI: Të lutem, se nuk është hera e parë që vijnë ministrat këtu, na japin leksikone dhe ikin. Neve na duhet veprime praktike që ta zhvillojmë vendin, e jo t'i ngarkojmë.

Autoritetet që kanë kërkuar edhe me amendament, edhe Qeveria, në nenin 22, pikërisht Projektligjin për investime strategjike, është pikërisht ai, në bazë të të cilit është i gjykuar Ramadan Muja në Prizren.

Prandaj, ta ngarkosh edhe një formë të tillë, edhe tash t'i bartësh këto përgjegjësi, kjo është barabartë me atë që Ministria po thotë për krim, edhe ata po e bëjnë krimin.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e radhës.

7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Paska deputetë të lajmëruar për fjalë.

Për pikat e ardhshme, për këtë pikë. Jo, nuk ia ndal askujt fjalën. Vjosa Osmani, le të përgatitet profesori Muhamet Mustafa, Shaip Muja dhe Albulena Haxhiu.

VJOSA OSMANI: Zoti kryetar!

Besoj për të gjithë ata që e kanë përcjellë mënyrën se si ky ligj është diskutuar dhe si është votuar jo vetëm dje e sot, por edhe para 2-3 javësh kur ka ardhur këtu për lexim të dytë është e qartë një gjë.

Ky ligj nuk kaloi jo për shkak se 2-3 deputetë ia dhanë ndonjë votë kundër, siç është vota e zotit Nait Hasanit apo ndonjë abstenim. Ky ligj nuk kaloi për shkak se shumica e deputetëve nuk morën pjesë në votim dhe për shkak të mungesës së votës, për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në votim të 61 deputetëve ishin vetëm 43 deputetë që morën pjesë, prandaj nuk mund të kalojë asnjë ligj me pjesëmarrjen në votim prej 61 votash.

Përndryshe, sikur edhe 10 apo 20 deputetë, 20, më saktë, të merrnin pjesë në votim do t'i kishim 63 pjesëmarrës dhe nuk do të kishte rëndësi a kanë votuar 10 apo 15 kundër, por fakti që një shumicë ka votuar për.

Një koalicion sot, PDK-LDK, i ka 89 deputetë, prej tyre po marrin pjesë vetëm 40 e diçka në votim. Shumica e partnerëve të koalicionit në këtë rast të PDK-së nuk kanë marrë pjesë në votim, siç u dëshmuar edhe te pasqyra e votimit këtu. Jo, jo nuk po paragjykoj, se u pa shumë qartë, edhe elektronika e vërteton këtë punë. LDK-ja ka votuar thuajse në total, disa prej pakicave kanë votuar, shumica e deputetëve të PDK-së nuk kanë marrë pjesë në votim fare. Pra, nuk është këtu faji i zotit Hasani që ka votuar kundër, po është i të tjerëve që s'kanë marrë fare pjesë në votim. Pse? Është çështje që secili duhet ta arsyetojë.

KRYETARI: Faleminderit! Unë u mundova koleges ministre më herët, e biseduam çështjen e prezencës këtu, edhe çështjen e mosvotimit. Por, megjithatë ajo ka të drejtë, se ka investuar bukur shumë. Ka të drejtë ta thotë mendimin e vet.

Profesor, fjala për ju, pastaj edhe Shaip Muja, edhe e përfundojmë, më nuk ka të tjerë deputetë.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Unë vetëm dëshiroj të theksoj se ky ligj me të drejtë është konsideruar si një nga ligjet më të rëndësishme që duhet të rrisë vëllimin e investimeve në Kosovë.

Pika më kritike e zhvillimit ekonomik të Kosovës është vëllimi i pamjaftueshëm i investimeve.

Natyrisht që ky ligj ka zgjuar interesim shumë të madh dhe ka zgjuar edhe diskutime për dhe kundër.

Komisionin, të cilin unë e udhëheq, në bashkëpunim me të gjitha forcat politike që kanë marrë pjesë në Komision, në një diskutim të durueshëm dhe tolerant me krejt aktorët e interesuar ka mbërritur konsensusin dhe ka bërë përmirësimin, ka bërë përmirësime aty ku është parë e konsiderueshme dhe mendoj se atmosfera deri këtu ka qenë shumë konstruktive, edhe sa u përket amendamenteve, edhe sa i përket punës.

Sot, me të vërtetë është për çudi mospjesëmarrja në votim, unë nuk mendoj se ligji është hedhur poshtë, por votimi nuk është kryer, votimi s'ka qenë i suksesshëm. Pjesëmarrja në votim s'ka qenë adekuate.

Sigurisht deputetët që nuk kanë marrë pjesë në votim e kanë ndonjë arsye. Mendoj se partnerët e koalicionit duhet ta trajtojnë këtë problem, ku janë këto arsye ose secili deputet dhe ky ligj është mirë të kthehet në procedurë dhe të votohet, për arsye se unë jam i bindur që është në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Zhvillimi ekonomik i Kosovës është në interes të cilës forcë politike këtu dhe nuk duhet t'i përziejme çështjet e zhvillimit të Kosovës qoftë me një luftë primitive politike, qoftë me një ego personale, qoftë me interesa të ngushta grupore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muja, fjala për ju dhe pastaj kalojmë në pikat e radhës.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam i befasuar me intonimin që bën ministrja karshi qëndrimeve të verdiktit të popullit që neve na ka sjellë me vota dhe ne e kemi votuar atë qeveri, e cila sot nuk garanton zhvillim ekonomik, por garanton edhe humbje ekonomike brenda Republikës së Kosovës.

Unë kam kërkuar që të bëjmë debat të veçantë për çështjen e performancës së ministrave, të cilët paaftësitë e tyre mundohen t'i hedhin mbi obligimet e deputetëve, të cilët nesër mbasin në një dokumentacion të përvetshëm për gabimet ose për interesat e tyre që i vënë. Meqenëse ministrja përdori, ose këtu disa kolegë thanë "s'ka pasur 61 vota", po s'kanë dashur të bëhen 61, se ishin bërë, nuk do të ishte problem, sepse vetë ligji ka qenë i tillë, që nëse përgatitet një ligj me 30 vota të marrë një pronësi o të pronës komunale, o të pronës publike, kjo është jashtëzakonisht e komentueshme për mua, sepse ata kanë një problem, të cilin ose e kanë personal, ose e kanë për grupet e veta, të cilat kanë interesa për t'i arritur.

Ne kemi raste nëpër Republikën e Kosovës, në komuna të ndryshme sot terrorizohet që disa vjet pothuajse në mënyrë shumë publike, të interesit publik, Ramadan Muja i ka dhënë një pronësi një investitori, pothuajse edhe LDK-ja edhe të gjitha partitë e terrorizojnë thua se e ka bërë namin. Me konfirmizëm një qeveri do të duhej të kishte shkuar e të bënte arsyeshmërinë e plotë juridike, por jo një terrorizim pse është në pozitë dhe hajde, "për shkak të resë më vdektë djali".

Prandaj, nuk bëhet kështu politika dhe ne lusim ministren edhe për çështjen e tokave, nëse kjo ka ligj, le të sjellë ato tokat, të cilat kanë mbetur djerrinë dhe me Ministrinë e Ambientit të monitorohen projektet e ndërtimit dhe projektet e tokave bujqësore, si të ruhen dhe nëse një

investitor nuk e ka përdorur tokën mbi 2 vjet, po e ka lënë djerrinë, atëherë nxirre ligjin që t'ia marrë për pesë vjet t'ia japësh dikujt që ta punojë në bujqësi.

Ne kemi kërkuar në mandatin e kaluar edhe si deputetë të Partisë Demokratike, ndërsa vetë kjo ministre e ka kundërshtuar, duke thënë që po dashka t'ia marrë dikujt tokën për ta përdorur. Ky ligj edhe në Gjermani përdoret në këtë mënyrë, nëse 1-2 vjet nuk e përdor pronari tokën, vetë shteti vë dorë edhe i vë kushte, taksime për tokën. Prandaj, Ligji i investimeve strategjike që po diskutohet, ju keni dashur me këtë ligj t'i bëni disa pronarë brenda me 30 vota, edhe ata pronarë nuk mund të bëhen me 30 votat e Parlamentit. Nëse s'je në gjendje me 60 vota ta bindësh opinionin publik që është në interes të Republikës së Kosovës, atëherë mos sill ligj me 30 vota, se 30 vota i bëj unë, jo Parlamenti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë lajmëruar edhe dy deputetë, a e keni për këtë pikë të rendit të ditës? Zonja Tërmkolli, për tjetrën a? Zonja Tërmkolli, për këtë pikë, edhe atëherë Bardhyl Metaj, Armend Zemaj.

Zonja Tërmkolli e ka fjalën, Bardhyl edhe ti për këtë pikë, a?

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Shumë shkurtimisht, veç nja dy fjalë, ndoshta. Tash është pak vonë se ajo çështje në njëfarë mënyre gati u krye, është pak vonë të flitet. Po puna e parë se është kemi njëfarë deficiti të njohjes së gjuhës shqipe.

Do t'u lutem, deputetë të dashur, mësojeni gjuhën shqipe, shqiptarët dhe tjerët gjuhën e vet. Leksioni, leksikoni, Tërmkolli, termokolli, pak më, kryetari e ka mësuar më në fund.

Ligji, në fakt, ligji për fat të keq jo veç ky ligj, por edhe disa çështje të tjera nuk po kalojnë sepse interesi privat dhe grupor është vënë në shumicën e rasteve mbi interesin e Kosovës. Edhe ne mund të flasim çka të duam, po shihet shumë qartë, po shihet hapur, janë interesa private ose grupe, e të tjera, ka edhe kapak kaprice personale, por janë çështje të tyre.

Në fakt, nuk e di pse nuk po flisni për esencën pse nuk është miratuar ky ligj. Ky ligj nuk është miratuar, ose së paku nuk pati vota të mjaftueshme, a bën pak qetësi, nuk pati vota të mjaftueshme sepse dikush u frikësua që po i faturohet një sukses i madh LDK-së. Unë kisha për t'ju lutur shumë nuk është mirë të rezononi kështu, nëse do të ishte sukses, e besoj që do të ishte sukses shumë i madh nëse votohet, do t'i faturohej krejt Kosovës, jo veç LDK-së, sepse investimet nuk bëhen për LDK-në, as për PDK-në, bëhen për krejt Kosovën.

Edhe, krejt në fund, nuk e di a është rastësi, as nuk di çka po ndodh, po diqysh si vazhdimisht në valë të njëjta po janë deputetët e Listës Serbe edhe të "Vetëvendosjes". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bardhyl Metaj, deputeti i nderuar e ka fjalën.

BARDHYL METAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është fatkeqësi e madhe që ky ligj nuk kaloi dhe është fatkeqësi shumë më e madhe që nuk kaloi në këtë mënyrë.

Unë i dëgjova disa interpretime këtu, se nuk kaloi për shkak të këtyre interesave, apo për shkak se është dashur me 30 deputetë t'i dhurojnë dikujt pronë, por unë po dua t'ua përkujtoj të gjithë deputetëve këtu në sallë, pa marrë parasysh a janë pozitivë apo opozitivë, se kemi të bëjmë me një ligj, i cili Kosovës i sjell në komparitet me Serbinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi, me Kroacinë, me të gjithë të tjerët përparësi në thithjen e investimeve.

E mosvotimi i këtij ligji, për thithjen e investimeve të huaja, për marrjen e investimeve strategjike, është problem i madh i këtij vendi tash e sa vjet. Pra, nëse disa pronarë tokash ose nëse disa pronarë këtu e ndejnë vetën të cenuar se vijnë investorët e huaj, ajo le të mbetet në barrën e ndërgjegjes tyre. Po dua ta përkujtoj edhe opinionin, edhe deputetët këtu se qysh në vitet 2004 e 2005 ne kemi pasur edhe ERV-në, e kemi pasur edhe EON-in, kemi pasur kompani jashtëzakonisht të fuqishme gjermane në Kosovë që kanë qenë prezentë me zyre dhe me të gjitha. Por, nuk kanë mundur të investojnë pikërisht për shkak të këtij ligji.

Duhet thënë edhe këtë se vetëm Serbia ka pasur, edhe Maqedonia e ka njëjtë, me pesë ministra vendosin. Ne kemi tentuar ta bëjmë ligjin, i cili i mundëson Parlamentit të involvohet në vendime, por pse nuk u votua sot, "nëse u hangër pitja", populli thotë, "tepsia ka mbet". Dihet këtu kush votoi, dihet kush nuk votoi dhe pse nuk votoi. Ose kemi pasur debat për këtë ligj, ose s'kemi pasur debat për asnjë ligj tjetër, por si duket janë disa çështje të tjera, të cilat duhet t'i shqyrtojë edhe ky koalicion, edhe ky Parlament.

U përmend "Vetëvendosja". "Vetëvendosja" nuk ka faj pse nuk merr pjesë në votim se nuk e ka obligim t'i bëjë vota shumicës, por kësaj radhe, kur është fjala për investimet e huaja, për fatin edhe të fëmijëve tanë, besoj se ka mundur të japë kontributin e vet, qoftë në debat, qoftë paksa edhe në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç po hapet lista tash, po duan të flasin. Shaip, emrin a ta përmendi dikush që të reagosh? Atëherë, pret i fundit. E ka fjalën Besa Gaxherri, pastaj Shaip Muja dhe Nait Hasani nga një minutë.

BESA GAXHERRI: Unë do të mundohem shumë shkurt. Zoti Veseli, po ju drejtohem juve personalisht. Ju jeni kryetar i PDK-së dhe koalicionin e kemi me PDK-në. Unë po them se vetëm 35 deputetë të PDK-së dhe aq të LDK-së e bëjnë kuorumin.

Ju kisha lutur dhe ju kisha bërë pyetje direkt, unë po ju përcjell ashtu si çdo qytetar i Republikës së Kosovës, kur ti po bën vizita, qoftë kur po pret delegacione nga jashtë këtu dhe po iu premton investorëve të huaj investime edhe legjislacion. Çka keni bërë ju personalisht sot që ky ligj të mos dështojë? Apo vërtet keni punuar që të dështojë? Sepse, ky është dështim personalisht në radhë të parë juaji, pastaj edhe i kryeministrit të Republikës së Kosovës. Edhe kështu nuk mund t'i mashtroni qytetarët, pastaj me interesa, pa interesa, sepse ne e dimë qysh funksionon në Kosovë e çka është duke ndodhur, por përgjegjësinë e keni ju dhe zoti Mustafa.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muja e ke fjalën, dhe zoti Hasani pastaj, pyetjet parlamentare ministrat i kanë të përgatitur dy javë ditë të përgatiten, edhe unë duhet të përgatitem.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Nëse sukseset di t'i numërojë LDK-ja, pra ndonjë sukses me këtë qeverisje, unë do të jem shumë krenar.

Zonja Gaxherri përmendi fjalët e mia që unë i kam thënë para dy seancave për investitorët për t'i mbrojtur investimet e brendshme që i kemi këtu dhe mandej duke i mbrojtur investimet e brendshme që janë kryekëput të lidhura me Qeverinë, me aktivitetin e Qeverisë, por jo me Parlamentin këtu, që po mundoheni ta hedhni topin te deputetët, atëherë dërgoni mesazh pozitiv tek investitorët e huaj. Po të përmendim në mënyrë shumë praktike edhe dokumentuese, letra e fundit që e ka dërguar Sindikata e Pavarur e punonjësve të Ferronikelit, të cilët rrezikohen të mbesin pa punë, më 30 korrik, do të mbesin mbi 10 mijë banorë rast social dhe Qeveria e Kosovës, e cila udhëhiqet nga zoti Mustafa dhe nga kjo ministre, e cila e ngre zërin aq shumë, nuk është në gjendje të formojë një grup ndërministror që të mund të menaxhojë situatën dhe t'i asistojë investitorit, sepse në këtë rast është investitor ai dhe ne po flasim për investitorët e huaj.

Dhe, dikush këtu thotë: "Po, mirë, ai ka pasur, ka fituar boll, dhe pse tash ne të mërzitemi pse ai ka fituar". Jo, nuk është ashtu, sepse është e vetmja industri në Kosovë që funksionon, ndërsa Ferronikeli është në Drenicë e vetmja industri, e cila sot u jep një infuzion ekonomik punonjësve dhe atij komuniteti. Dhe, ju nuk jeni të interesuar, sepse edhe dje në buxhet më shumë iu interesoje disave sa bëhet asfalt në Drenicë, kur nuk është investuar për asnjë vit, se sa në regjionet e tjera, ku gjithmonë kanë pasur investime qoftë nga rrugët, qoftë nga ndriçimet.

Prandaj, mos e politizoni, ligji ka qenë i keq, nëse s'mund t'i bëni 60 vota, mos ejani të bëni hajgare me 30 vota. Investim strategjik quhet kur e bind në aspektin publik edhe popullatën.

KRYETARI: Ju thashë, veç një minutë, edhe po më duket si para fushatave elektorale. Së pari, mos i jepni zor se Kosova është një, më vjen keq, po Kosova është një, por megjithatë a e mbyllim këtë debat? Zonja Gaxherri dhe zoti Hasani a i leni, mjaft, se tani prapë flasin të tjerët, s'po mundem t'ua ndal.

A t'u ka përmendur emrin, zonja Gaxherri? Atëherë zonja Gaxherri e ka fjalën, zoti Hasani pastaj dhe e përfundojmë. Veç, të lutem a ka mundësi me marrëveshje nga një minutë, ok?

BESA GAXHERRI: Jo, tash kur të vijë rendi te unë të mos ma ndal administrata një minutë, se po ua jep mundësinë kushdo të flasë, është bërë këtu "Hajt pak". Unë po i them zotit Shaip që absolutisht unë nuk pajtohem, as nuk po i përmend fjalët e zotit Shaip. Nuk po dua tash të lëshohem në ligj, se kemi punuar 5-6 muaj.

Por, po dua të lëshohem edhe një herë konkretisht. Zoti Veseli, ne nuk kemi koalicion me Shaipin, ne kemi koalicion me PDK-në, dhe tash ju keni obligim ta rregulloni çështjen e kuorumit, të mos dalim ne qesharak, edhe ata deputetë të cilët janë seriozë janë të interesuar të ecën Kosova përpara. Për hir të dikujt ose për hir të mospajtimit tuaj personal ne nuk mund të shkojmë kështu tutje. Ju duhet të hyni në seancë të përgatitur, kur i kemi votat për çështjet çfarë

është ky ligj, atëherë duhet të hyjmë ne në Kuvend, e jo t'i jepet mundësia kushdo të flasë çka do dhe me të bëjmë këtu shaka me njëri-tjetrin.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hasani... Në tri forma deputetët e shprehin vullnetin: kundër, abstenim edhe për. Zoti Hasani, të lutem, emra mos përmend dhe ta mbyllim, ju lutem. Dëgjo, pastaj po hyjmë në sintaksë e gramatikë, e kështu që profesorit duhet t'ia japim fjalën në fund tani. Zoti Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Desha të përkujtoj që Ramadan Muja në Prizren është i akuzuar pikërisht për të njëjtën çështje nga LDK-ja në Prizren dhe është i dënuar me kusht dy vjet pikërisht për çështjen e pronës, e para. E dyta, ministrja iku, por nuk tregoi se ka dështuar Brezovica, e në Kuvendin e Kosovës na kanë detyruar të votojmë. Na kanë detyruar pesë mijë hektarë, e Brezovica ka dështuar, ministrja është përgjegjëse që ka dështuar, Qeveria është përgjegjëse. Ku janë ato investime 400-milionëshe, katërmijë vende të punës?

KRYETARI: Faleminderit!

NAIT HASANI: Ku është ajo që është dashur dhe duhet të thuhet. Prandaj, ministre, mendoj se...

KRYETARI: Kthehemi në pikat e rendit të ditës, ju lutem! Vazhdojmë!

7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar... Jo, deputetë, sa të keni dëshirë do të flisni, vetëm përgatituni mirë. Zoti Baxhaku e ka fjalën. Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” le të bëhet gati, zoti Shukri Buja e kërkon fjalën dhe lajmërohuni ende, po qe se ka.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti Nait, jeni duke i përzier konceptet krejtësisht. Kryetari i Prizrenit është i akuzuar dhe i dënuar për arsye se nuk ka respektuar vendimin dhe nuk ka konsultuar Kuvendin. Dhe, po të ishte ky ligj, kryetari do ta jepte këtë pasuri dhe nuk do të ishte përgjegjës. Do të thotë, mos i përziej konceptet. Ai nuk e ka konsultuar as Kuvendin, Asamblenë dhe nuk e ka dhënë pa kurrfarë baze ligjore. Po të ekzistojë ky ligj, ai e ka shumë lehtë ta japë dhe apo e sheh, që ka bërë mirë që e ka dhënë, sepse e ka bërë zhvillimin ekonomik. Ky ligj bash e mundëson zhvillimin ekonomik.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën. Sa të doni do të flisni.

GLAUK KONJUFCA: Unë vetëm desha ta bëj një reagim lidhur me përpjekjen për krijimin e paraleles këtu në mes Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Listës serbe. Lista serbe është formacion politik, i cili është krijuar prej Hashim Thaçit në Bruksel në vitin 2013, në bashkëpunim me Aleksandër Vuçiqin. Është formacion politik, për të cilin ka marrëveshje politike në negociatat e Brukselit.

Ky formacion politik është futur në koalicionin qeverisës PDK-LDK. Ju e keni partner të koalicionit listën serbe dhe a e dini me cilën marrëveshje? Zonja Tërmmkolli, a e dini me cilën marrëveshje është Lista serbe në koalicion me juve? Është në koalicion me marrëveshjen e Rashkës. Më dëgjo mirë!

Në koalicion me juve, me marrëveshjen e Rashkës, e cila i ka edhe pikat e kompromisit, ku ju keni lëshuar pe për shtetin e Kosovës, në mënyrë që ta merrni Listën serbe në gjirin e juaj.

Pra, përgjegjësit pse ekziston Lista serbe në Kosovë, përgjegjësit pse është pjesë e qeverisjes suaj është Lidhja Demokratike e Kosovës, Isa Mustafa, që është nënshkrues i marrëveshjes së Rashkës edhe Hashim Thaçi, që me Vuçiqin e kanë krijuar Listën Serbe në vitin 2013 në Bruksel. Kjo është e vërteta.

E tash, çka bën Lista Serbe? Shikoni, çfarë bën? Ministrat e Isa Mustafës, që është kryeministri yt, e kolonizojnë atje Zveçanin me “Luginën e Diellit”, kryeministri yt del edhe e kundërshton “Luginën e Diellit”, kurse ministrat këtu, ministrat e Isa Mustafës shkojnë dhe e inaugurojnë “Luginën e Diellit”, shkojnë e presin shiritat e inaugurimit të “Luginës së Diellit”, që është kolonizim i Kosovës. E ju, na shisni këtu pallavra, bëni krahasime ndërmjet Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Listës serbe!

Tash, sa i përket kësaj për të cilën jeni kapur ju dhe po bëni këtu shou mediatik dhe televiziv, përderisa interesat i keni të përbashkëta. Unë për këtë projektligj, që s’po mundeni kurrqysh me e miratua, i kam vetëm dy fjalë. Natyrisht, se secili grupacion politik i ka interesat e veta politike. Secili, pse dhe qysh po voton, i ka interesat e veta politike, natyrisht. Por, duhet t’i shpjegojmë se përse dhe çfarë janë ato interesa, për secilin grupacion veç e veç. E ja, unë po ju tregoj me tri fjali.

“Vetëvendosja” nuk po e voton, jo pse nuk është ligj i mirë, “Vetëvendosja” po ua jap besën, që vet po të ishte në pushtet, do ta bënte një ligj të tillë, që e vërteta. Nuk po di më drejtpërdrejt si të them! Por, pse nuk po ua jep votën? Nuk po ua jep votën për një arsye të thjeshtë, sepse LDK-ja po do t’ia zë vendin PDK-së, për çka ka bërë deri tash, pra krejt manipulimet e deritashme me AKP-në, krejt kontrollin politik. Ju vetëm haraçin që PDK-ja ua ka qitur investitorëve të huaj, jo po doni t’ia zini vendin PDK-së. Kjo është arsyeja pse po e bëni ligjin. Nuk ka këtu ndonjë, ku me ditë çfarë përfitimi për Kosovën e përralla tuajat, të cilat jemi mësuar gjithmonë t’i dëgjojmë.

Kurse, pse PDK-ja... pse nuk po e voton PDK-ja, shtrohet pyetja. Siç e shpjegoi Vjosa Osmani, PDK-ja nuk po e voton se nuk po do t’ia lëshojë vendin Qeverisë së LDK-së, e cila do t’ia marrë interesat asaj. E pse nuk po e voton Lista serbe, shtrohet pyetja. Edhe ajo i ka interesat e veta. Interes i Listës serbe është që frikohet se tash Qeveria do me u hy nëpër komuna, ku ajo e kontrollon “Trepçën”, Brezovicën e kështu me radhë, dhe nuk po do të lëshojë pe prej atyre aseteve të cilat i kontrollon me strukturat e veta, prej Beogradit.

Qe, këto janë katër grupacionet politike dhe kjo është e vërteta se përse gjithsecili qysh po voton.

KRYETARI: Faleminderit! Zonjës Tërmkolli ia ka përmendur emrin. Urdhëro fjalën, se ia ka përmendur emrin. Ja, kjo Tërmkolli. Mos, se... A gabova prapë, a? Kërkoj falje, në qoftë se kam gabuar, zonja deputete. Kam problem!

MELIHATE TËRMKOLLI: OK! Faleminderit!

Thënë të drejtën, s’kisha pasur qejf kështu që Kuvendi të duket si shou gjithmonë, po pak më seriozë është më mirë. Kryetari sa ma mësoi mbiemrin, ka nisur ta prishë sërish. Sherrin e ka “Vetëvendosja”. Më falni, nuk e keni ju fajin, po...

Kështu, puna e parë kryeministri nuk është as i imi, nuk është as i LDK-së, kryeministri është i Kosovës. Ata që kanë logjikë shtetërore, në shërbim të Serbisë nuk e di kush është më shumë. Ngadalë, ngadalë, mos u ngutni! Ata që kanë logjikë shtetërore e dinë shumë mirë, që kryeministri është i Qeverisë së Republikës së Kosovës si shtet i pavarur, sovran e demokratik, që është shpallur këtu, e para.

E dyta, LDK-ja s’po ia zë vendin kurrkujt, as PDK-së, as kurrkujt. Ky ligj nuk është për t’ia zënë vendin dikujt. Ligji për investime strategjike është ligj për ta zhvilluar Kosovën. Nëse, ju nuk po doni të jeni pjesë e votimit të një ligji, që është në interes të Kosovës, por mos hidhni baltë kurrkund, e dyta.

E treta, krahasime, po më vjen keq nëse ju e keni kuptuar, që bëra krahasim, unë thash mund të jetë veç një rastësi. Pse? Jo rrallëherë, po ndodhë që deputetët e Listës serbe votojnë njësoj, ose të “Vetëvendosjes” votojnë njësoj, si të Listës serbe. Nuk është ky ndonjë krahasim, por ndodh. Mund të ndodhë edhe deputetët tjerë që ndonjëherë janë në valë të njëjta, nuk ka kurrgjë të keqe këtu. E keqja qëndron në atë, që thjesht, po i dini krejt. Shumë interesant, krejt po dini çfarë kemi menduar, çfarë do të mendojmë, edhe kush qysh ka me qenë në të ardhmen, e krejt... nuk e di kush po ju tregon, po krejt po i dini.

Edhe, së fundmi, po thoni që Lista Serbe është krijuar nga Hashim Thaçi me marrëveshjen e Rashkës. Sinqerisht, unë sot e dëgjova për herë të parë, e ka krijuar Hashimi apo jo, unë nuk e di, ndoshta ju edhe këtë po e dini. Por, unë kam lexuar, tash nuk e di edhe kjo nëse është tamam, tash më tregoni ju, pasi po i dini, se po thonë që edhe “Vetëvendosjen” e ka krijuar Kadri Veseli. Faleminderit!

KRYETARI: Besoj, se pat debat relaksues. Kërkoj falje! Nuk pat fyerje. Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. Kërkoj mirëkuptim, ju lutem!

7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin e kryeprokurorit të shtetit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për emërim. Më falni, i kemi dy...

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën, në qoftë se dëshiron.

ALBULENA HAXHIU: Nëse mund të flas edhe në emër të Komisionit për Legjislacion, edhe në emër të grupit parlamentar.

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2016 e shqyrtoi propozimin e kryeprokurorit të shtetit për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe vlerësoi, se propozimi për emërimin e anëtarit është në përputhje me nenin 3.3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Prandaj, i propozoj Kuvendit që t'i emërojë anëtarët e Këshillit Drejtues, prokurorin Haxhi Dërguti. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjat dy vjet. Domethënë, ky është propozimi i Komisionit për Legjislacion.

Dhe, në anën tjetër, po jap edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Së pari, Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës është një organ jashtëzakonisht i rëndësishëm, domethënë për ata që e njohin funksionimin e Institucionit Gjyqësor të Kosovës e dinë se cila është përgjegjësia e këtij instituti.

Domethënë, i njëjti bën politikën për emërimin apo trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për ne, si grup parlamentar, propozimi në fjalë është i papranueshëm. Domethënë, propozimi që na ka ardhur nga kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, është i papranueshëm. Ne mendojmë se zoti Haxhi Dërguti nuk është kandidat i denjë për të përfaqësuar zyrën e kryeprokurorit të shtetit në Këshillin Drejtues të IGJK-së. Përveç tjerash, të cilat nuk po dua t'i përmend këtu, për një fakt tjetër që deputetët e kanë para vetes. Domethënë, për pak minuta ju kisha lutur që të shihni CV-në e këtij kandidati, që na e ka propozuar Aleksandër Lumezi dhe e shihni, se në një CV, që i ka diku dy fletë, me një fond 18, a 16, s'po e di bash mirë, i ka diku 30 gabime drejtshkrimore. Tridhjetë gabime drejtshkrimore!

E mora rolin e gjuhëtarit, ose lektore, për t'ia përmirësuar gabimet drejtshkrimore. Është për keqardhje, sepse po flasim për një kryeprokuror të Apelit, ushtrues drejtues detyre i kryeprokurorit të Apelit, që s'di ta shkruajë as fjalën “Kosovë”, as fjalën “Klinë”, as “jurisprudencë”, as “universitet”, as “kam” e as “jam” e as “emërim”... edhe shumë të tjera, por po flas për disa prej tyre.

Domethënë, ky sistem ka prodhuar njerëz të tillë, të cilët duke mos qenë kredibël dhe profesionalë, janë shumë më shumë të dëgjueshëm dhe instrumente të këtij pushteti.

Andaj, unë i ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emër të grupit parlamentar, që të mos e përkrahin një propozim të këtillë. Le të mos e degradojmë Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës me njerëz të këtillë. Dhe, po ashtu, i bëj thirrje Aleksandër Lumezit, që të jetë serioz karshi këtij Kuvendi, le të mos tallet me deputetët me propozime të këtilla. Unë ju kisha lutur, në emër të grupit, që të mos e përkrahin një propozim të këtillë, mirëpo ta kthejmë mbrapsht, në mënyrë që Aleksandër Lumezi të jetë më serioz karshi nesh dhe të propozojë një kandidat tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës e përkrahë kandidatin Haxhi Dërguti, që të zgjidhet si anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin që ka ardhur nga Prokuroria e shtetit. Në fakt, kjo është një detyrë ex officio, që i takon që jetë anëtar në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Ajo çfarë duhet që të jemi të vëmendshëm si Kuvend dhe si politikë, është që të mos u bëjmë presion organeve të drejtësisë në çfarëdo forme a mënyre, por t'i ndihmojmë në luftimin e krimit dhe të korrupsionit në vend. Instituti Gjyqësor apo Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës ka mandat vetëm për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, e tash me Ligjin e ri për akademinë e drejtësisë do t'i shtohet edhe për punëtorët apo ekspertët gjyqësorë dhe si të tillë mendoj se kandidaturat që vijnë drejtpërdrejt u takojnë atyre sipas ligjit. Për çështjet tjera, mendoj se duhet të rezervohemi si Kuvend, sepse etiketimet që i bëhen shikohen drejtpërdrejt si ndërhyrje në punën e Gjyqësorit.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës përkrah këtë propozim pa anashkuar edhe formën dhe mënyrat se si i ka udhëheq edhe Instituti Gjyqësor i Kosovës. Pra, ne i japim përkrahje dhe vota jonë është pro.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, a ka deklarim? Jo! Grupi “6+?” Jo! Zoti Haskuka e ka kërkuar fjalën nga deputetët dhe të tjerë nuk ka.

MYTAHIR HASKUKA: Unë s'di qysh përkrahet një kandidat i cili me të vërtetë s'di të shkruajë një CV me dy faqe. Por, politika e LDK-së dhe e PDK-së është të zgjidhen njerëz analfabetë dhe ata të jenë servilë për ta dhe normal ju e keni një kryetar që faktikisht i ka 90 dosje në prokurori dhe në anën tjetër edhe PDK-ja i ka plotë njerëz që janë në prokurori, por normal, për të pasur kontrollin e tyre i votoni njerëzit analfabetë.

KRYETARI: Atëherë, zonja Haxhiu e keni kërkuar fjalën, apo është shtypur butoni gabimisht? Zoti Zemaj u tërheq. Po, urdhëro merre fjalën! Zonja Haxhiu e ka fjalën!

ALBULENA HAXHIU: E para, po flet për presion dhe ndërhyrje në sistemin e drejtësisë dikush, partia e të cilit e ka kapur këtë sistem të drejtësisë. A nuk po të vjen marre zoti Zemaj që ju, kryeministri që e kontrollon sistemin e drejtësisë sot, bashkë me Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin po bëni deklarime të tilla që kinse “Vetëvendosja”, për shkak se po flet për një fakt që tashmë e keni para veti, po bëka presion në sistemin e drejtësisë.

Natyrisht se këto deklarime të zotit Zemaj janë të turpshme dhe as që duhet marrë parasysh.

Dhe, e dyta, Instituti Gjyqësor i Kosovës, është organ i pavarur që i raporton këtij Kuvendi dhe përgjegjësinë për Institutin Gjyqësor të Kosovës e ka ky Kuvend. Pra, ne si përfaqësues të

popullit e kemi obligim kushtetues që të dërgojmë njerëz profesionistë, kredibilë në institucionet e pavarura.

Natyrisht se nuk ndodhë kështu për shkak se e keni kapur të gjithë sistemin dhe është e vërtetë që s'ndodh kështu. Mirëpo të paktën në një institucion ku e kemi të drejtën ose mundësinë, të themi, le ta dërgojmë dikë që është më kredibil.

Zoti Haxhi Dërguti, ne e dimë mirë se me kë mbahet e kush ia rreh krahun. Unë e kuptoj. Mirëpo, po e thërras LDK-në që mos ta votojë një propozim të tillë sepse, ju e dini mirë me kë mbahet Haxhi Dërguti. Faleminderit!

KRYETARI: Së pari, shprehje të tilla se me kë mbahet e me kë kapet, këto janë shumë të këqija. Urdhëroni zotri Zemaj, dhe jemi duke folur për sistemin gjyqësor, një vend ku s'duhet të shkoni në prokurori dhe t'i ngritni të gjitha çështjet, por për sistemin gjyqësor po flasim në Kuvend dhe mirë është të tërhiqeni. Vetëm kjo është, se për mua, fjalën e keni gjithë ditën.

(Ndërhyrje)

E kemi profesorin e nderuar këtu, akademik për gjuhën shqipe dhe e hap edhe një kurs të gjuhës shqipe në Universitetin veror dhe për mua që s'po mund t'i shqiptoj mirë mbiemrat, edhe juve nganjëherë që po i përdorni... Zoti Zemaj, të lutem do të ishte mirë të flisni sa më shkurt.

ARMEND ZEMAJ: Të ju them të drejtën, unë nuk bisedova për replikë. E dhashë mendimin në emër të Grupit Parlamentar dhe as që mendova, e kjo është vërejtje për Kuvendin se çdoherë që bëhet ndërhyrje në punën e drejtësisë, ky zotëria është i emëruar kryetar i Gjykatës Komunale nga përfaqësuesi special i OKB-së dhe nëse Lidhja Demokratike ka arritur për ta kapur edhe OKB-në, është arritur e madhe.

Si do që të jetë, edhe këtë mund ta zbulojnë këta, sepse këta shpeshherë e zbulojnë edhe ujë të nxehtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për emërimin e zotit Haxhi Dërguti anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se 70 deputetë kanë marrë pjesë në votim. 59 janë për, 7 kundër dhe 4 abstenime dhe Kuvendi emëroi zotin Haxhi Dërguti anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës me mandat dyvjeçar.

Të nderuar deputetë, kisha kërkuar vëmendjen nga ju sepse e kam një propozim, nëse ju pajtoheni. I kemi dy votime të fshehta, një nën pas tjetrës dhe nëse pajtoheni, administrata ka ndërmarrë masa, i ka bërë dy fletëvotime për të votuar përnjëherë dhe ato janë me ngjyra të ndryshme.

Këtë unë ashtu kështu e vë në votim për ju, sepse ka të bëjë me pikën 8 - zgjedhja e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe me pikën e 9 - zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Nëse pajtoheni me këtë propozim për t'i futur të dyja për njëherë, atëherë do të votojmë në mënyrë elektronike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! 66 deputetë kanë votuar, dhe 66 janë për.

Atëherë, do të procedojmë në bazë të dy procedurave, dhe procedurat do t'i lexoj dhe pastaj votimi është i përbashkët.

8. Zgjedhja e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen me votim të fshehtë të njërit nga dy kandidatët e propozuar.

Ftoj kryetarin e Komisionit për legjislacion, zonjën Albulena Haxhiu që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë rekomandimin.

ALBULENA HAXHIU: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 5/a të Ligjit Numër 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim:

- I rekomandohet Kuvendit për votimin e kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç përcaktohet me nenin 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 të Kushtetutës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit si në vijim:

- Nenad Laziq 48 pikë, dhe
- Bogolub Staletović 45 pikë.

Kuvendi prej 2 kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor do të zgjedhë njërin nga kandidatët.

Votimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor bëhet me votim të fshehtë dhe mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është 5 vite.

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë te pjesa e pikës 9.

9. Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, mbështetur në Ligjin për Rregullimin e Shërbimit të Ujit, i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendësudrejtor të Autoritetit Rregullator për Shërbimit të Ujit dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen me votim të fshehtë të njërit nga 2 kandidatët e propozuar.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Bujqësi, zonjën Duda Balje, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

DUDA BALJE: Hvala! Komisija za poljoprivredu, šumarstvo, sredinu i prostorno planiranje, bazirajući se na član 7. Zakona 05/L-042 o regulisanju usluga vode, vodila je proceduru izbora kandidata za zamenika direktora Regulatornog autoriteta za usluge vode i nakon rezultata vođenog intervjuja Parlamentu predlaže 2 imena za glasanje, gospodina Hali Blaca i gospodina Aluš Rama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, gjithmonë jemi duke biseduar paralelisht për dy pika të rendit të ditës.

Tani është radha e deklaramit të grupeve parlamentare, nëse duan të deklarojnë, për të dy pikat. Partia Demokratike e Kosovës. Fjalën e ka zoti Grabovci, shef i Grupit Parlamentar.

ADEM GABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon si anëtar të Komisionit zonjën Emilija Rexhepi.

KRYETARI: Ok! Do ta mbajmë por një herë të dimë a pajtohem me anë të deklaramit. A ka kush për t’u deklaruar? Nuk ka.

LDK, a do të deklarojë? Një herë jo, tash për komision, se do të shkojmë me procedurë. “Vetëvendosja” a do të deklarojë? Një herë jo për Komision votues, por vetëm për këto kandidatura dhe për pikën 8 dhe 9. Nuk ka!

“6+”? Nuk ka.

Atëherë ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar të Komisionit votues, i cili do të jetë për të dy pikat e rendit të ditës si komision votues.

Zoti Grabovci, nga Partia Demokratike e Kosovës e propozoi zonjën Emilija Rexhepi. Zoti Beqiri?

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Ne e propozojmë deputeten Besa Gaxherri.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Simiq?

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče! Poslanička grupa Srpske liste predlaže za člana ad hoc komisije gospodina Nenada Rašića. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje? Mytaher Haskuka, nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka fjalën!

Zonja Mufera, është fjala për ju, për “6+”.

MUFERA SHINIK: Grupi “6+” e propozon deputetin Qerim Bajrami!

KRYETARI: Faleminderit! Tash, lus deputetët, me ngritjen formale të dorës, të deklarohej për votim për komisionin votues.

A ka kundër? Abstenim? Nuk ka!

U miratua propozimi. Konstatohet se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb dhe në të njëjtën kohë për zgjedhjen e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Lus komisionin që të fillojë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen për të votuar, sipas listës.

Lus anëtarët e Komisionit t’i zënë vendet dhe të fillojnë punën.

Atëherë, nëse Komisioni është përgatitur, fillojmë të votojmë:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Njomza Emini, Anton Çuni, Arben Berisha, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Sabri Hamiti, Donika Kadaç-Bujup, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Hetem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Slobodan Petroviq, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Millka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Ismajl Kurteshi, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljeviq,....

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slobodan Petroviq.)

KRYESUESI: Shaip Muja, Selville Halimi, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta

Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmak, Zafir Berisha i Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: Molim poslanike koji nisu glasali, da glasaju! Ima li neko od poslanika da nije glasao, ili nije prozvan?

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Në ndërkohë, i kisha lutur shefat ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare të na tregojnë që, pas këtyre votimeve, a do të shkojmë në pushim dreke, apo a janë deputetët këtu, për të vazhduar?

Të nderuar deputetë, tani Komisioni votues do t'j paraqesë rezultatet e votimit.

EMILJA REDŽEPI: Poslanici Kosovskog parlamenta su uzeli učešće na glasanju i na dnevnom redu je bio predložen kandidat za člana Sudskog saveta Kosova. Imali smo 2 kandidata, Nenad Lazić i Bogoljub Staletović.

Komisija je konstatovala da su važeći 77 glasova i videćemo kako je to glasanje proteklo.

Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Bogoljub Staletović,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Bogoljub Staletović,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,

Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić, i
Nenad Lazić.

Prebrojaćemo glasove:

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Slobodan Petroviq.)

KRYESUESI: Reč ima Komisija. Izvolite!

EMILIJÀ REDŽEPI: Poštovani poslanici, glasanje za člana Sudskog saveta Kosova ispred Srpske zajednice jej bio sledeći:

Proces glasanja odnosno na učešće glasanja, učestovao 77 poslanika.

Nevažećih listića bilo je 31.

Nenad Lazić je dobio 42 glasa.

Bogoljub Staletović je dobio 4 glasa.

Nijedan od ovih kandidata ne uspunjava uslove, tako da će se ponoviti konkurs u narednom periodu. Zahvaljujem se!

Proces glasanja se danas ponavlja i još jednom ponovićemo glasanje.

KRYESUESI: Imamo još jedan krug glasanja za ovo. Reč ima predstavnik komisije.

BESA GAXHERRI: Vazhdojmë me procesin e punës së komisionit për zgjedhjen e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimin e Ujit.

Kandidatë të propozuar për zëvendës drejtor të Autoritetit Rregullator për Shërbimin e Ujit kanë qenë Halil Bllaca dhe Alush Rama.

Në procesin zgjedhor kanë marrë pjesë 77 deputetë dhe vazhdojmë me numërimin e votave:

Alush Rama,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,

Alush Rama,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Halil Blaca,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
Alush Rama,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Alush Rama,

Halil Bllaca,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
Halil Bllaca,
Alush Rama,
Alush Rama,
Alush Rama,
Alush Rama,
Halil Bllaca,
E pavlefshme,
Alush Rama,
E pavlefshme,
Halil Bllaca, dhe
Alush Rama.

KRYESUESI: Izvolite vi iz Komisije!

BESA GAXHERRI: Në bazë të votimit, 77 deputetë kanë marrë pjesë.

Të pavlefshme janë 15 fletëvotime.
Halil Bllaca i ka fituar 30 vota, kurse
Alush Rama i ka fituar 32 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullatorin e Shërbimit të Ujit dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave prej 77 deputetëve të cilët kanë votuar, prandaj rishpallet konkursi. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem Komisioni! S obzirom danemamo kuorum, pauza je do 14:30 pa ćemo nastaviti drugo glasanje. Hvala!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Slobodan Petroviq.

Poštovani narodni poslanici, ja vam se zahvaljujem što ste došli, ali pošto nemamo kvorum, sednica se nastavlja u ponedjeljak u 10:00 sati. Hvala!

* * *

E hënë, më 11 korrik 2016

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 7 korrik

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Kolegë të nderuar,

Do të vazhdojmë mbledhjen, të cilën e kemi ndërprerë javën e kaluar.

Për votime nuk ka kuorum, kështu që fillojmë me diskutimet e raporteve.

10. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka miratuar për miratim.

Po ashtu Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Së pari, paraqitet Komisioni Funkcional, të cilin e drejton Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional flet deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Funkcional në mbledhjen e kaluar e ka shqyrtuar raportin e Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015, me 3 vota për dhe 2 kundër, ka miratuar pozitiv raportin për vitin 2015.

I nderuar nënkryetar,

Më lejo që të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar, nëse ka mundësi në vazhdim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës dhe ka këtë vlerësim si në vijim.

Ndryshe nga vitet e tjera, këtë radhë Bordi dhe menaxhmenti i mediumit publik na ka afruar një raport më shumë kualitativ, duke na ofruar informacione të nevojshme dhe të mjaftueshme për proceset që kanë ndodhur dhe po ndodhin në vazhdim në këtë institucion.

Edhe pse ky vit për RTK-në ishte më i vështiri nga vitet e tjera, duke pasur fjalën pra te pamundësia e zgjidhjes afatgjate të çështjes së buxhetit dhe pronës, sfidat që e kanë shoqëruar Bordin, bashkë me menaxhmentin nuk ua kanë humbur fokusin në çështje që kanë të bëjnë me aspektin përmbajtjesor, me funksionalitetin e tij, e në veçanti me ndryshimin e infrastrukturës ligjore dhe teknologjisë në prodhimin e brendshëm në këtë medium.

RTK si medium është përballur me mbizotërimin e zhvillimeve politike në vend dhe si prodhim i këtyre rrethanave në RTK kanë mbizotëruar pjesa e informacionit, ku janë përfshirë lajme dhe aktualitete si dhe emisione debative.

Duke e ditur se Kosova është vendi i vetëm që ende nuk e ka filluar kalimin e transmetimit analog në digjital, RTK-së ende nuk i është dhënë mundësia që të përmbushë nevojat e audiencës, e cila në shumë rajone të vendit tonë s'ka mundësi as të ketë qasje në transmetuesin publik, sepse dimensionin e tillë teknologjik i këtij mediumi duhet të plotësohet me një platformë të re teknologjike.

Por, këto edhe këtë vit nuk do të ndodhin nëse Kuvendi, pra ne si themelues nuk arrijmë të sigurojmë një buxhet dhe një pronë legale për këtë institucion.

Sa u përket çështjeve programore për vetëm një vit kanë kanalet e reja televizive të themeluara në vitin 2014 janë zhvilluar, mund të themi admirueshëm. Duke u bërë kështu pothuajse të pavarura njëra prej tjetrës në aspektin e funksionimit.

Kanali kryesor televiziv RTK1 ka vazhduar skemën e rregullt programore, duke përmbushur obligimin ligjor programor.

Rëndësi më e madhe u është dhënë lajmeve dhe emisioneve politike debutuese, për shkak të zhvillimeve politike në vend, por sigurisht që nuk kanë mundur as emisionet argëtuese, edukative dhe kulturore.

Me gjithë këtë performansë, mendoj se është ruajtur balanca e përfaqësimit të subjekteve politike dhe kjo gjë është vlerësuar edhe nga raportet e KQZ-së, Komisionit të Pavarur për Media dhe organizatat e tjera në vazhdimësi që janë marrë me monitorime.

Kanali televiziv në gjuhën serbe RTK2 ka konsoliduar në masë të madhe skemën e vet programore dhe ka shtuar prodhimin vetjak në mbi 10 orë në ditë program.

RTK radio ka vazhduar të mbajë primatin me dëgjueshmëri dhe mbetet përsëri referencë e lajmit zyrtar edhe për mediat e tjera jopublike në vend që operojnë në frekuenca të ndryshme.

Radiotelevizioni i Kosovës rregullohet me Ligjin e RTK-së, statutin e RTK-së, standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e RTK-së, por gjatë këtij viti bordi ka arritur të plotësojë edhe infrastrukturën ligjore sekondare terciare me pjesën tjetër të ligjshmërisë.

Radiotelevizioni i Kosovës gjatë vitit 2015 ka funksionuar me katër kanale të televizionit me program 24 orë secili, edhe me dy kanale të radios, po ashtu 24 orë program secili në vete.

Janë mbuluar në mënyrën e mirë më të mundshme periudhat e ngërçit politik dhe situatave të krijuara në Kuvend, duke qenë i vetmi medium publik në rajon edhe më gjerë që i ka afruar audiencës një përqindje më të madhe të prezencës të partive opozitare.

RTK ka ruajtur diversitetin kulturor etnik dhe për këtë është vlerësuar edhe nga organizmat e shumtë ndërkombëtarë.

Programi satelitor, në bazë të disa informacioneve që ne kemi marrë si Komision, ka ende nevojë të shtojë efikasitetin e punës dhe të kujdeset që bashkatdhetarëve t'u përgjigjet në interesat e tyre në mënyrën më të përgjegjshme, sepse kemi vërejtje për të cilat ka nevojë kualifikime saktësie.

Duke kërkuar nga Bordi dhe menaxhmenti që të vazhdojnë të punojnë në rritjen e transparencës dhe shërbimeve edhe më të mira për audiencën e madhe, Grupi Parlamentar i PDK-së do të mbështesë këtë raport me votën për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Izmaku, e cila foli edhe për Komisionin, edhe për Grupin e PDK-së.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ka diskutim.

Kalojmë te përfaqësuesit ose te shefat e grupeve parlamentare. Në emër të grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës flet deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së ka një vlerësim tjetër në lidhje e performansën e Radiotelevizionit të Kosovës. Vërejtjet ne i kemi dhënë në Komision, në fakt ka pasur shumë debat në lidhje me performansën e televizionit publik.

Natyrisht sfidat e këtij televizioni mbesin të shumta, por mund të them që këtij televizioni, i cili është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, gjithashtu i ka munguar kontrolli nga ana e Kuvendit.

Mjafton të përmend shembullin ose faktin që kur raportet e këtij televizioni nuk janë miratuar në Kuvend, pasojat ose konsekuencat kanë qenë zero, sepse kemi vazhduar të kemi të njëjtin bord, të njëjtin mungesë të llogaridhënies nga ana e këtij televizioni, e tjerë.

Për sa i përket konkretisht raportit, vazhdon të ketë mangësi të mëdha, nuk raportohet ashtu sikurse duhet.

RTK-ja vazhdon të punësojë njerëz pa kritere, një numër jashtëzakonisht të lartë, nga ana tjetër, vazhdon të blejë programe nga kompanitë e jashtme, domethënë kemi një paradoks këtu. Në njëërë anë punësohen shumë njerëz, nga ana tjetër blihen programet. Atëherë shtrohet pyetja pse punësohen këta njerëz? Pra, përtej nevojave të vetë televizionit.

Mendoj që kjo është e gabuar, ashtu sikurse është e gabuar edhe hapja e kanaleve të tjera televizive pa pasur një mbulesë buxhetore. Kur jemi te buxheti, Radiotelevizioni i Kosovës vazhdon të financohet nga buxheti i Kuvendit, ndërkohë që ende nuk e kemi zgjidhjen për sa i përket parapagimit që do të duhej të ndodhte, ashtu sikurse ndodh me të gjitha televizionet publike në vendet demokratike.

Ne si Grup i LDK-së jemi duke punuar për zgjidhjen, pra mbështesim idenë e parapagimit, sikurse thashë, bëjnë plot vende të tjera demokratike dhe kjo do t'i shërbejë rritjes së efikasitetit dhe të transparencës së punës së Televizionit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Lama! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” flet deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Para se të flas për gjendjen e Radiotelevizionin publik, unë dua vetëm t'ia tërheq vëmendjen e publikut se raporti, i cili po shqyrtohet sot, e i cili, në fakt, ka kaluar në dy komisione parlamentare, nuk është raport ligjor, do të thotë që nuk i përmbush kërkesat ligjore, gjegjësisht neni 29, pika 2.9 e Ligjit për RTK-në, i cili kërkon që para se raporti të vijë në Kuvend për shqyrtim dhe miratim, ai fillimisht duhet të miratohet nga Bordi i RTK-së dhe ky raport nuk e ka marrë miratimin e Bordit të RTK-së dhe kjo po ashtu mund të dëshmohej nga procesverbali i mbledhjes së 39-të të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e cila është mbajtur më 24 maj të këtij viti, kur Bordi ka raportuar para këtij Komisioni.

Dhe, në fakt, ky Kuvend sot po e shqyrton një raport, i cili nuk është ligjor dhe kjo është edhe një dëshmi për nivelin e degradimit dhe pothuajse shkatërrimit të RTK-së dhe fajin për këtë e merr komplet ky Kuvend, si themelues dhe mbikëqyrës i këtij Komisioni. Pse po e them këtë?

Në vitin e kaluar, jo vetëm raportin e vitit të kaluar, por për katër vjet radhazi ky Kuvend nuk ka miratuar raport të punës dhe raport financiar Radiotelevizionit të Kosovës dhe çfarë ka ndodhur si pasojë e kësaj.

Kryetari i Bordit, i cili e ka udhëhequr RTK-në vitin e kaluar, kur nuk është miratuar raporti dhe drejtori i përgjithshëm, të cilët janë përgjegjës kryesorë për menaxhimin e RTK-së, jo vetëm që nuk janë shkarkuar, e të mos flasim për dorëheqjen e tyre, por të njëjtëve u është vazhduar mandati. Pra, ata janë shpërblyer për faktin se Kuvendi nuk ka miratuar raportin, për shkak të shkeljeve të shumta ligjore që janë gjetur në atë raport.

Bile, drejtorit të përgjithshëm i është vazhduar mandati ende pa i kaluar ai aktual, duke kujdesur që Bordin e kanë nën kontroll dhe ai i kishte votat e mjaftueshme në atë kohë.

Me datën 2 prill të vitit të kaluar ky Kuvend, pas një debati bukur të gjatë, kishte miratuar unanimisht, pra pa asnjë votë kundër disa rekomandime për RTK-në.

Në rekomandimin e dytë të Kuvendit pati thënë se pas shqyrtimit të raportit vjetor bazuar në raportin vjetor dhe raportet e auditorit do të varej pastaj mbikëqyrja që Kuvendi do ta ushtronte mbi RTK-në.

Të dyja këto raporte, raporti vjetor nuk u miratua nga Kuvendi, ndërsa raporti i Auditorit vuri në pah shumë probleme me keqmenaxhim, keqpërdorime të fondeve dhe sidomos rritjen e borxheve të RTK-së.

Po ashtu, rekomandimi i fundit i atyre që votuan më 2 prill kërkonte nga Bordi i RTK-së t'i kthente në punë dy sindikalistët, të cilët ishin përjashtuar nga drejtori i përgjithshëm.

Por çfarë ndodhi me këto rekomandime? Komisioni Hetimor, si kërkesë e rekomandimit të dytë, nuk u formua asnjëherë, edhe pse unë një gjë të tillë e kisha kërkuar edhe në një seancë tjetër, gjatë një deklarimi jashtë rendit të ditës.

Ndërsa kryetari i sindikatës dhe nënkryetari, të cilët u kthyen në punë pas vendimit të Inspektoratit, sepse u gjetën shkelje me rastin e largimit të tij, tani kryetari suspendohet sërish, kësaj here vetëm se kishte shkruar një status në Facebook.

Tjetër, çfarë ndodhi. Punëtorët, gjegjësisht redaktorët e Radiotelevizionit të Kosovës, kishin protestuar kundër emërimit në pozitat e kryeredaktorëve dhe të disa redaktorëve përgjegjës, emërimet të cilat i kishte bërë drejtori i përgjithshëm, po ashtu në kundërshtim me Ligjin për RTK-në.

Të njëjtit njerëz që ishin me vendim të Bordit ishin suspenduar nga pozitat e redaktorëve, tash me propozim të drejtorit ky bord i zgjedh në pozita të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të Radios dhe të Televizionit të Kosovës, e i cili proces po ashtu është i kontestueshëm dhe cilësohet si joligjor nga pjesa tjetër e anëtarëve të bordit.

E sa për raportin të mos flasim fare për shkeljet ligjore që i përmban ai për parregullsi të shumta në punësim të njerëzve dhe për tejkalime të shumta të buxhetit dhe për rritjen në vazhdim të borxhit, i cili asnjëherë nuk u bë publik se si ishte krijuar, si erdhi ky borxh 5 milionësh apo më shumë i Radiotelevizionit.

Dhe, kjo formë, kur përkundër të gjitha këtyre shkeljeve prapë të njëjtit njerëz shpërblehen me pozita, jo vetëm për këtë institucion, por po shërben edhe për institucione të tjera si inkurajim se ata që i keqmenaxhojnë dhe i keqpërdorin pasuritë publike dhe institucionet që drejtojnë, jo vetëm që ndaj tyre nuk ka pasoja, por përkundrazi ata shpërblehen. Mjafton që këta njerëz t'i rehatojnë në punë familjarë e miq të zyrtarëve partiakë në pozita dhe për këtë pastaj kalojnë qetë.

Kështu është rasti për RTK-në, aty janë punësuar fëmijë të deputetëve, apo bashkëshortë të kryetarëve të komunave pa konkurs dhe pa asnjë kriter profesional.

Unë me keqardhje duhet t'u them punëtorëve të RTK-së, sidomos atyre që përkundër ndërhyrjeve të mëdha partiake mundohen ta ruajnë profesionalizimin e tyre, se shpresa se Radiotelevizioni i Kadrisë, ashtu siç ata vetë e cilësojnë dhe më së mirë dëshmohet këtu, kur brenda një faqe janë të paktën tetë lajme vetëm për kryetarin e Kuvendit Veseli, gjegjësisht kryetarin e PDK-së, nuk do të mund të kthehet në Radiotelevizion të Kosovës përderisa ky koalicion është në bashkëqeverisje.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Pantina! A ka dikush tjetër që do të flasë?

11. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015

Komisioni Funkcional ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit Funkcional, Muhammet Mustafa, e merr fjalën për arsyetimin e raportit dhe rekomandimeve.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbledhjen e mbajtur më 24 maj të këtij viti e ka shqyrtuar raportin dhe i ka propozuar Kuvendit që të aprovojë këtë raport me rekomandimet si vijon.

Kemi konstatuar se raporti ka tepër përshkrime e pak analiza, kështu që me raportet vijuese duhet të kemi një analizë më të thuktë të fakteve, të cilat janë brenda raporteve.

Ecuria e investimeve në të gjitha organizatat, domethënë që janë të ndërlidhura me rregullatorin, duhet të prezantohet më hollësisht dhe të paraqiten ngecjet në realizimin e këtyre investimeve. Mu për këtë Komisioni edhe ka kërkuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji që ta informojë Komisionin me një raport të veçantë mbi realizimin e investimeve, për arsye se vitin e kaluar kemi pasur ngecje në realizimin e investimeve pothuajse në të gjitha organizatat, përpos KOST-it, e sidomos kemi pasur ngecje edhe te KEDS-i.

Një çështje, të cilën e kemi trajtuar mjaft në Komision të ndërlidhur me raportin, e cila edhe është formuluar në formë të rekomandimit, është se ZRRE-ja duhet të gjejë një zgjidhje më të mirë lidhur me problemin e ngarkimit të çmimit të energjisë elektrike që e paguajnë konsumatorët e përgjegjshëm me humbjet komerciale, përkatësisht me borxhet e këqija. Domethënë faturat që i paguajnë konsumatorët përmbajnë edhe një pjesë të borxheve të këqija, të cilat nuk i paguajnë konsumatorët e tjerë, kështu që konsumatorët e përgjegjshëm dëmtohen apo ngarkohen dy apo trefish.

ZRRE-ja duhet të jetë më efektive në trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe kjo vlen sidomos edhe për KEDS-i, për arsye se afër gjysma e ankesave të konsumatorëve nuk ka marrë një përgjigje nga KEDS-i.

ZRRE-ja duhet të ketë në dispozicion tërë dokumentacionin përcjellës lidhur me licencimin e operatorëve të rinj.

Edhe një çështje që është diskutuar mjaft ka të bëjë me çmimet e nxehjes, ngrohjes, çmimet e energjisë termike. Meqenëse ka ndryshua teknologjia dhe ngrohja termike tash për Prishtinën bazohet në koogjenerimin me KEK-un, e çmimi ka mbetur me kriteret e vjetra, sikur kur ka punuar Ngrohja me mazut, ne kemi kërkuar që të bëhet një strukturë e re e çmimit për ngrohje, e cila do të ishte më e volitshme për konsumatorët.

Ju propozoj që me këto rekomandime të aprovohet raporti, dhe e dyta, edhe në emër të LDK-së e aprovojë raportin me këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Muhamet Mustafa foli edhe për Lidhjen Demokratike, edhe për Komisionin. Kërkojmë deklaratimet për raport të grupeve të tjera parlamentare. Për PDK-në, Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015.

Unë do të bëj përpjekje që të kursehem në kohë, dhe ne si përfaqësues të Partisë Demokratike në Komisionin parlamentar jemi pajtuar me rekomandimet, të cilat i ka nxjerrë Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Po vlen të theksohet se si Parti Demokratike, me theks të veçantë kemi kërkuar që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të analizojë një zgjidhje më të mirë lidhur me tejkalimin e problemit të ngarkimit të çmimit për konsumatorët e përgjegjshëm me humbjet komerciale, përkatësisht borxhet e këqija që t'i kërkohej një rrugëzgjidhje që të mos ngarkohen këta konsumatorë për shkak të humbjeve të tilla që ka energjia elektrike.

Krejt në fund Grupi Parlamentar e mbështet raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe kërkoj që edhe kolegët e tjerë deputetë ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Donika Kadaç-Bujupi.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Kur u privatizua KEDS-i për një çmim komik, Qeveria Thaçi aso kohe konfirmoi dhe na tha nga kjo foltore se çmimi është i ulët, por benefitet për Kosovës do të jenë të mëdha. Sepse, sipas kontratës dhe sipas kryeministrit aso kohe dhe ministrave përkatës, investimet thuaj se do të ishin milionëshe, se do të intervenohej në rrjet, që nënkuptonte se do të kishte furnizim më cilësor me rrymë, zvogëlim të humbjeve dhe çmim më të volitshëm të energjisë.

Po ashtu, thuajse jemi me shumë fat që kemi një investitor serioz, i cili kishte vendosur të investonte në vendin tonë.

Ndërkaq, me shqetësimin tonë aso kohe për fatin e mijëra punëtorëve, na u tha këtu nga kjo foltore dhe për këtë ekzistojnë edhe transkriptet, më kujtohen deklaratat e Hashim Thaçit, Besim Beqajt e të tjerëve, se numri i të punësuarve do të rritet dhe se kontrata ka paraparë siguri për çdo vend pune ekzistues, e madje edhe rritje, edhe zhvillim ekonomik gjatë këtyre investimeve marramendëse, të cilat pritej të ndodhnin.

Ku jemi sot? Prej se është privatizuar KEDS-i, përveç që po paguajmë më shtrenjtë, energjinë elektrike edhe furnizimin po e kemi më të paktë, ndërkohë që investimet kanë stagnuar.

Pronari privat i KEDS-it nuk ka investuar asgjë në përmirësimin e rrjetit, të shpërndarjes së energjisë elektrike, përveç disa matësve të energjisë, të cilët edhe ashtu ishin blerë në kohën kur kjo ndërmarrje ka qenë në pronësi publike.

Në mungesë të investimeve nga ana e KEDS-it shumë herë obligohen komunat të investojnë në rrjet, që i bie paratë e taksapaguesve, të cilat duhet të përfundonin në bujqësi, shëndetësi ose arsim, investohen në një kompani private, e cila përvese e ka blerë, ose më mirë të themi përveçse i është falur ndërmarrja, po abuzon në vazhdimësi duke filluar prej mosfurnizimit, e të

gjithë jemi dëshmitarë në muajt e fundit si është furnizuar Kosova me energji elektrike, e sidomos sa kanë vuajtur bizneset nga ky mosfurnizim, e deri te abuzimi duke rrezikuar jetën e njerëzve, e madje edhe në përgjegjësi shëndetin publik.

Në vijim unë u lutem për vëmendje, sepse do të prezantoj para jush disa fakte dhe disa shkelje të rënda, madje edhe vepra penale, të cilat kanë ndodhur në muajt e fundit dhe të cilat, përveç disa raportimeve në media, kanë përfunduar si të patrajtura nga Policia dhe Prokuroria, ndërkohë që dëmet për Kosovën janë shumë të mëdha.

Skandali i KEDS-it rreth keqtrajtimit të vajit të PCB-së, të njohur si poliklorur bifenol. Ky faj është një materie kimike shumë e rrezikshme që përdoret për ftohjen e transformatorëve.

Ky vaj kimik tepër i rrezikshëm dyshohet se është nxjerrë në mënyrë të paligjshme nga transformatorët dhe nuk i dihet destinacioni përfundimtar. Rasti ka ndodhur në trafostacionin Prishtina tre, që gjendet afër ndërtesës kryesore të KEDS-it.

KEDS në mënyrë të kundërligjshme ka tentuar të mënjanojë këtë vaj të rrezikshëm në mënyrë joligjore dhe joprofesionale, sepse ky vaj nuk guxon të nxirret nga transformatorët, por është dashur të mënjanohet së bashku me transformatorë nga kompanitë e specializuara për trajtimin e këtyre materieve të rrezikshme.

Sipas informatave, kompani të tilla nuk ka në Kosovë dhe bëhet fjalë për një sasi tepër të madhe, afërsisht mbi 200 tonë vaj, që janë keqtrajtuar. Po ashtu janë humbur gjurmët edhe të një sasive të vajit që ka qenë në fuqi të njohura në trafostacionin e Lipjanit, bëhet fjalë përafërsisht dy tonë e gjysmë, gjegjësisht 12 fuqi.

Këtë veprim e ka kryer një kompani vendore e kontraktuar nga KEDS-i, e që është e njohur edhe për Policinë e Kosovës, e cila nuk ka ndërmarrë absolutisht asgjë.

Rasti ka ndodhur në gjysmën e parë të muajit dhjetor të vitit 2015. Policia e Kosovës veçse ka filluar hetimin në fund të muajit janar 2016 dhe gjithçka është heshtur ndërkohë.

Janë argumentet direkte, të cilat do t'i paraqes para jush, por janë shumë teknike dhe nuk do t'i citoj një nga një. Mirëpo, bëhet fjalë për vepër penale të dënueshme edhe në nenin 45 të Kodit Penal.

Bëhet fjalë për shkeljet e vazhdueshme, të cilat rrezikojnë shëndetin e qytetarëve, e të cilat për shkak se dikush që është i fuqishëm e që ka vendosur të bashkëpunojë me një kompani të këtillë dhe ta falë KEDS-in për interesat e veta dhe jo për interesa të Kosovës po vazhdon që ta mbrojë edhe nga policia, edhe nga prokuroria. Dhe, unë mendoj që ky Kuvend duhet të kërkojë pikërisht përgjegjësi edhe nga ZRRE-ja.

Skandali i dytë, edhe më i rëndë, bëhet fjalë për një rast të një fëmije 15-vjeçar nga Xërxa i Rahovecit, i cili ka rënë në tension elektrik dhe ka humbur jetën me fajin e KEDS-it. Ky rast ka ndodhur më 31 mars të këtij viti. Për habi, askush nuk është marrë në pyetje dhe as që e ka çarë kokën kush. E tash, çfarë mund të themi kur disa gangsterë të KEDS-it luajnë edhe me jetët e

fëmijëve tanë, ndërkohë për shkak të milionave dhe të të fortëve, të cilët po i mbrojnë, ata nuk japin asnjë llogari.

Po ashtu, rasti i njehsorëve të instaluar në KEDS, ku janë instaluar mbi 40 mijë njehsorë me matje të dyshimtë, rasti është në gjykatë, por po ashtu po heshtet dhe po neglizhohet. A nuk është krim, të nderuar kolegë deputetë, që rreth 9 apo 10 milionë euro që harxhon pjesa veriore e Mitrovicës të kalkulohe në faturat tona. Sa herë qytetarët e Republikës të Kosovës duhet të paguajnë rrymën? Duhet të paguajnë 10 milionë euro, të cilat kalkulohe në faturat tona, e shpenzohen në veri të vendit, nga ata të cilët nuk e njohin Republikën.

Sigurisht, asgjë nga këto nuk gjendet në raportet e ZRRE-së, e as në komunikimet e tjera zyrtare të këtij institucioni. Në raportin e ZRRE-së çdokush ka rastin të shohë vetëm normat, që i lejohen nga shteti ynë kompanisë private për të siguruar fitimin, pavarësisht nga shërbimi ose, më mirë thënë, nga dëmet që na i shkakton. Qytetarët e Kosovës nuk duhet të harrojnë se në çdo rast këto që formalisht po quhen institucione të pavarura përbëhen nga njerëzit e PDK-së dhe, së fundmi, masivisht edhe të LDK-së, kryesisht individë, të cilët janë shquar për shkathtësitë e tyre në mbrojtjen me fanatizëm të interesit të grupeve mafioze.

Ne mund të themi hapur se Zyra e Rregullatorit të Energjisë është as më pak, e as më shumë se sa Zyra e Koordinimit të ndarjes së fitimit midis mafisë së energjisë dhe fitimit të paligjshëm të konsorciumit “Limak - Çalik”. Për këtë dhe për të gjitha arsyet që rendita më sipër u bëj thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos e votojnë këtë raport, sepse votimi i tij do të nënkuptonte që edhe ky Kuvend legjitimon këtë krim, i cili po ndodh në Kosovë përmes sektorit të energjisë elektrike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Kadaj! Deputeti Abdyl Ymeri e ka kërkuar fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sektori i energjisë, i cili konsiderohet si më i rëndësishëm që do të ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit, akoma vazhdon të mbetet në gjendje jo të mirë.

Përkundër hartimit të strategjisë së energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2013-2022, e cila, në fakt, orienton politikat e përshtatshme zhvillimore të këtij sektori. Prej pasluftës kemi pasur investime të shumta të bëra nga donatorët e jashtëm dhe Qeveria e Kosovës, mirëpo ende nuk janë arritur objektivat e dëshirueshëm që ky sektor të jetë i qëndrueshëm dhe stabil. Sepse, edhe në këtë kohë nuk kemi furnizim të rregullt me energji elektrike dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorë.

Edhe pse duke bërë një krahasim me vitet paraprake është diç më mirë. Mendoj se moszhvillimi i kapaciteteve të reja prodhuese, problemet rreth mirëmbajtjes joadekuate të termocentraleve ekzistuese, si dhe përmirësimi në tërësi i rrjetit elektrik kanë bërë që ende të mos kemi një sistem energjetik të qëndrueshëm. Prandaj, i duhet një ristrukturim dhe reformim këtij sektori, me qëllim që të kemi një furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji.

Ky sektor aktualisht nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e Kosovës për energji, kur dihet se kërkesat për energji janë rritur, dhe për këtë kemi import të energjisë me çmime bukur të larta. Prandaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Qeveria e Kosovës, pas nënshkrimit të marrëveshjes me kompaninë amerikane për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re, duhet t'i përshpejtojë procedurat në mënyrë që në afatin e paraparë, e pse dhe sa më shpejt, ta ndërtojë këtë termocentral që do të kemi një rritje të kapaciteteve të reja prodhuese me një teknologji më të avancuar, i cili mundëson një furnizim të qëndrueshëm dhe të volitshëm me energjinë elektrike, që është parakusht i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Kosovë.

Në kuadër të kësaj, roli i Zyrës së Rregullatorit për Energji, si organ i pavarur, është që të rregullojë të gjitha aktivitetet që i përkasin sektorit të energjisë në Kosovë, siguron funksionimin transparent dhe jodiskriminues të tregut të energjisë, duke u bazuar në parime të tregut të lirë. Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Energji është mirë i ndërtuar dhe i strukturuar që paraqet pothuajse të gjitha informatat e nevojshme rreth aktiviteteve të zhvilluara në sektorin e energjisë, edhe pse në disa pika nuk është i detajuar, por i përgjithësuar.

Mosimplementimi i marrëveshjes së arritur në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë për energjinë, e cila mundëson eliminimin e pengesave të kyçes së KOST-it në ENCO, do të sjellë në mënyrë të vazhdueshme probleme deri në implementimin e plotë të saj. Në tabelat 5.11 dhe 5.12 janë paraqitur të dhënat për investimet e bëra në sistemin e shpërndarjes, të cilat nuk kanë qenë të vogla, por ende janë të pamjaftueshme për të siguruar furnizim cilësor dhe të qëndrueshëm për konsumatorët.

Në diagramin 5.15 shihet se kemi rritje të konsumit në sistemin e shpërndarjes për vitin 2015 për 2,7% krahasuar me vitin paraprak. Nevoja për investime në rrjetin elektrik, në llojin më të mirë të përçuesve dhe transformatorëve shihet tek humbja në rrjetin e shpërndarjes, e cila vazhdon të jetë e lartë, humbjet teknike janë 15,45% dhe humbjet komerciale 16,38%.

Prandaj, në këtë drejtim është mirë të punohet në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes, sepse këto humbje mbulohen nga tarifa e konsumatorëve. Është mirë që të forcohet mekanizmi i kontrollit të të gjitha organeve përgjegjëse me qëllim të zvogëlimit në nivelin më të ulët të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

Nga tabelat për faturim dhe arkëtim shihet se kemi një rritje të vazhdueshme për vitin 2015, energjia e faturuar e shprehur në të holla është 285 milionë, ndërsa e arkëtuar 272,1 milionë. Tek cilësia e tensionit kemi vetëm një përshkrim për numrin e ankesave të parashtruara nga konsumatorët që janë 304, që janë zgjedhur 264 apo 87%, ndërsa nuk kemi një përshkrim për standardin e cilësisë së tensionit se si duhet të jetë ajo.

Apo nuk kemi të paktën edhe një shembull të vetëm në ndonjë zonë të caktuar se vërtet si është cilësia e tensionit në rrjetin shpërndarës. Ndërsa, unë i di shumë lagje nëpër fshatra të ndryshme që kur të shkosh, e thonë banorët, se kemi problem me rrymën, se tensioni është shumë i ulët. Këtyre ditëve kemi mundur të shikojmë një kronikë televizive të zhvilluar në fshatin Gradicë të komunës së Drenasit, në të cilën banorët e këtij fshati përshkruajnë në detaje se si përballen me ndërprerjen dhe tensionin e ulët të energjisë elektrike, e besoj se raste të tilla ka kudo në Kosovë.

Krejt në fund dua të theksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, nënshkruese e kontratës me KEDS-in, të shikojë në detaje se si po përmbushet kontrata mes Qeverisë dhe KEDS-it sa u përket investimeve, si dhe mënyra se si po përmbushen obligimet ndaj punëtorëve, sepse pothuajse këtyre ditëve dhe ditëve në vijim kemi pasur një varg protestash të punëtorëve, të cilët kanë kontrata me KEDS-in, i cili nuk përmbush obligimet që dalin sipas kontratave, si dhe ka shpëputje të kontratave të punëtorëve edhe pa paralajmërim, që i bie se kemi zvogëlim të numrit të punëtorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk desha të thellohem shumë në këtë temë, mirëpo falënderoj parafolësin, zotin Ymeri, deputetin i cili ishte më i orientuari, më i adresuari në problemet e këtij raporti dhe i cili në mënyrë të qartë propozon, ose në një mënyrë tregon që edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik nuk është i fokusuar në studimin e këtij raporti, por siç e kemi bërë modë sjellim raporte dhe veç sa për të kaluar raportin, votojmë dhe pas një viti ndoshta i vjen radha prapë përsëriten të njëjtat forma dhe nuk arrijmë asgjë.

Ne, Zyra e Rregullatorit dhe vërejtjet, të cilat edhe deputeti i përcaktoi me fakte të evidentuara, të cilat duhet edhe Zyra e Rregullatorit me operatorin e distribuimit, në këtë rast me KEDS-in, edhe me prodhuesin, të jetë në nivel, të cilin ne si deputetë dhe si Kuvend e kemi obligim të nxjerrim disa rekomandime dhe të monitorojmë në mënyrë periodike aktivitetin e tyre.

Është e vërtetë në shumë fshatra të Kosovës, kryesisht siç u përmend edhe fshati Gradicë, ka 4 vjet që me shkrim unë personalisht i kom kontaktuar edhe personat përgjegjës, nuk kanë ndërmarrë asgjë dhe ata sikur pjesë e lënë anash, ose shumë fshatra të tjera. Po, tema e cila mua më provokoi më së shumti për komisionin dhe që u shqetësova është kërkesa e natyrshme dhe e arsyeshme që të kërkohej edhe të nxehja me mazut si dhe të ulet çmimi i rrymës, siç tha kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Po më befaso i çështja e kryetarit se një letër që e ka marrë nga sindikata e pavarur e punonjësve të “Ferronikelit”, më datën 29 korrik 2016, ky komision as nuk është diskutuar nga asnjë deputet lidhur me shqetësimet që i ka cekur Sindikata e Pavarur e Drenasit. Në pikën e parë ka kërkesën, në të cilën mund të ndërhyjë ZRRE-ja dhe ne mund të ndërhyjmë si deputetë në bashkëpunim edhe me Qeverinë që të shohim një formë të uljes së çmimit të rrymës për kompaninë “Ferronikeli”, sepse rrezikohen këta 900 punëtorë të dalin nga puna.

Dhe, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, për çudi, asnjë fjalë nuk e tha dhe, më 30 korrik në rast se nuk bën zgjedhje tjetër me operatorët anësorë dhe dihet fort mirë që për të bërë një kontratë për furnizim anësor, jashtë strukturës aktuale duhet një vit kalendarik përpara të ketë mundësi që të hyjë në radhë për ta siguruar një çmim një operator ekonomik. Ne shpeshherë po flasim, edhe unë jam dakord, për çështjen e kualitetit të furnizimit dhe shkallën e çmimit të energjisë elektrike për zhvillimin ekonomik.

Është për t'u mbajtur një seancë e veçantë lidhur me këto çështje për shumë arsye, sepse ne kemi nevojë që të analizojmë industrinë aktuale, sa po paguan industria aktuale për të mbuluar borxhet e këqija dhe humbjet komerciale dhe teknike që i ndodhin dhe ne nuk mund t'i ftojmë për

zhvillim ekonomik të tjerët, duke u faturuar faturën këtyre ekzistueseve, e de facto ne po shkatërrojmë ekzistuesit dhe po bëjmë njëfarë forme vetëm thirrje filozofike: “Ejani, se ju keni kushte më të mira”.

Prandaj, unë ftoj të mos votohet ky raport, por të shtyhet në një seancë tjetër dhe të bisedojmë në mënyrë më të përgatitur dhe ta analizojmë me rekomandime, sepse nuk bëhet nami nëse shtyhet ky raport dhe me rekomandime t’i ndihmojmë edhe komisionit dhe të jemi më të fokusuar në kuadër të ligjit me rekomandime ta udhëzojmë edhe ZRRE-në.

Në çdo kontakt të shqetësimeve që ne i paraqesim me Zyrën e Rregullatorit, ata thonë që ne jemi institucioni përgjegjës si deputetë. Për çudi, askush vërejtjet kur merren në drejtim të ZRRE-së nuk mundohet t’iu japë përgjigje. Po ashtu, te KEDS-i, ne i kemi parë para disa ditësh nxjerrjen nga puna të 200-300 punëtorëve të KEDS-it, të cilët demonstrojnë para KEDS-it, demonstrojnë nëpër media dhe në një mënyrë duket sikur të ishin në Afrikë ata punonjës, duke demonstruar pa asnjë përshtypje. Mirëpo, ne duhet të shohim se nëse e kemi privatizuar KEDS-in, nuk ia kemi dhënë të drejtën e keqpërdorimit as të ligjeve, as të ligjeve të punës, e as të të drejtës t’i keqpërdorë ata punëtorë, të cilët nesër bëhen raste sociale.

Prandaj, unë ju ftoj, kolegë të nderuar, pa nervozë ta shtyjmë këtë raport, të mos e votojmë, por ta mbajmë një seancë me propozimin e Komisionit për Zhvillimin Ekonomik, duke u thelluar në mënyrë më të thukët lidhur me rekomandime dhe me angazhimet e deputetëve që ne të gjejmë kushte për zhvillimin e industrisë, duke i dhënë favore Zyrës së Rregullatorit dhe duke aplikuar, edhe vërejtje të bazuara në ligj për operatorët prodhues dhe distributivë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se ne duhet të bazohemi në atë që përmban raporti dhe rekomandimet. Rekomandime janë pothuajse të gjitha këto çështje, të cilat po vihen në dukje, e para. E dyta, ne nuk mund të kontestojmë krejt raportin dhe krejt punën me problemet e një organizate.

Ne e kemi pritur me mirëkuptim angazhimin edhe të deputetit Muja lidhur me “Ferronikelin”, për arsye se ajo është një organizatë e madhe, punëson shumë njerëz. Ka ardhur në krizë, por kriza e saj është vjen si pasojë e rënies së çmimeve në bursën e metaleve. Nuk është problemi i “Ferronikelit” për shkak të Rregullatorit, as për shkak të Qeverisë së Kosovës, as për shkak të Kuvendit të Kosovës. Për arsye se “Ferronikeli” kur i ka pasur çmimet dyfish më të mëdha se tash nuk ka ardhur fare këtu që të paraqitet te ne edhe nuk ka rezervuar mjete që t’i përdorë në kohën kur çmimet bien dhe vjen situata e pavolitshme.

Prandaj, për shkak të një organizate, ne nuk mund ta përgjithësojmë, as ta denigrojmë punën e asnjë komisioni, asnjë parlamenti, por të një sektori të caktuar. Probleme ka, ne kemi biseduar edhe me “Ferronikelin”, ata kanë vërejtje se mund të kalkulohet një çmim më i volitshëm, ne këtë kërkesë në bazë të autorizimeve të komisionit ia kemi përcjellë rregullatorit, sepse komisioni nuk mund të formojë çmime.

Çmimet i formon Rregullatori, e para. E dyta, kanë edhe një kërkesë tjetër për hekurudhën që e kemi kërkuar nga Bordi i Agjencisë së Privatizimit ta zgjidhë, edhe një kërkesë tjetër te KPMM-ja. Të gjitha kërkesat janë bërë, por komisioni, as Kuvendi i Kosovës nuk mund ta korrigjojnë çmimin në bursën e metaleve, edhe duhet të jemi objektivë kur flasim këtu, të mos bëjmë marketing politik të lirë, për shkak se dikush i ka votues ata njerëz që vijnë në pozitë të vështirë që ne i mirëkuptojmë. Ne duhet të bëjmë çmos, por nuk mund të akuzohen institucionet për shkak të situatave që janë jashtë fuqive të tyre.

Gjithashtu, jemi të informuar që Qeveria në mënyrë intensive ka biseduar me “Ferronikelin” dhe po tenton të gjejë zgjidhje për këto probleme, prandaj nuk duhet të shfrytëzojmë gjithmonë këtë temë që 5 herë, që 10 herë këtu në mënyrë që të shitet një politikë e lirë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shaip Muja, replikë. Shkurt!

SHAIP MUJA: Shkurt, zoti kryesues, nga aspekti psikologjik po e dëmton debatin demokratik. Nuk mundesh as shkurt, as gjatë të më tregosh, sepse automatikisht më nxjerr nga tema. Nëse ke dëshirë të më nxjerrësh nga tema, atëherë kontribuo.

Unë desha t’i përgjigjem zotit Mustafa...

KRYESUESI: Edhe unë ty, veç me fjalë të tjera e thashë Rregulloren, e ti e di Shaip sa i ke për replikë.

SHAIP MUJA: S’ke nevojë të më tregosh a shkurt a gjatë, pra! Faleminderit!

KRYESUESI: Kam nevojë, se jam duke drejtuar...

SHAIP MUJA: Unë për qartësi, për spekulim, meqë po thotë zoti Mustafa për spekulim politik. Udhëheqësi i sindikatave të pavarura të “Ferronikelit” është militant i Lidhjes Demokratike, ndërsa unë jam anëtar i Partisë Demokratike.

Prandaj, ato që thonë për spekulime, ato mund t’i mbash për veti. Tjetra, ne nëse kishim pasur vullnet, nuk po flas vetëm për “Ferronikelin”, po flas për tërë industrinë, çmimi i cili faturohet për t’i mbuluar borxhet, mua më kanë thënë edhe në ZRRE se dikush duhet t’i paguajë borxhet, dika. Është e dëmshme që ju si profesor të flisni në këtë mënyrë që kur ka fituar “Ferronikeli” nuk na ka takuar neve, ndërsa tash që janë krijuar rrethanat e bursës, atëherë unë po ta tregoj një metodë që quhet “Fleksibil monitoringo economy development”, anglisht e ke dhe ta jap edhe shifrën ku mund ta shohësh, edhe si Qeveri.

Tash të tregoj se komisioni qeveritar mund të formohet edhe të monitorojë bursën dhe t’i caktojë “Ferronikelit” sa për qind do të fitojë, është mënyrë transparente diagrami i rrymës dhe diagrami i bursës së metalit. Prandaj, nëse do ti, ata punonjës në Drenicë, 10 mijë punonjës të mbeten pa bukë, 10 mijë banorë të mbeten ...

(Ndërprerje incizimi)

KRYESUESI: Faleminderit! Muhamet Mustafa, ti e di që një minutë e ke.

MUHAMET MUSTAFA: Ani, mirë, një minutë më mjafton.

E para, sa u përket çmimeve të biznesit, por një informim kolegut tri herë komisioni i ka trajtuar çmimet e biznesit dhe kemi kërkuar që të rregullohet çmimi i energjisë dhe të jetë më i volitshëm për biznese.

“Ferronikeli” e paguan diku 45 euro, a ka kërkuar t’i paguajë 30, ne e kemi drejtuar në Rregullator.

E dyta, nuk duhet me fieskula angleze këtu të tentohet të mësohet dikush, për arsye se dihen shumë mirë relacionet, ku dhe qysh janë. E treta, nuk ka rëndësi për mua aspak përkatësia partiake e askujt në KEDS apo në “Ferronikel”. Në qoftë se kjo ka rëndësi për dikë tjetër, për mua nuk ka rëndësi. Për mua ka rëndësi konkurrenca e barabartë dhe pozita e barabartë e të gjithë prodhuesve në ekonominë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Të drejtë nuk ke, Shaip, me Rregullore, atëherë po ta jap një gjysmë minute, se nuk jeni duke zgjidhur asgjë.

SHAIP MUJA: Neve nuk na kalon treni nëse nuk ulemi qartësisht, zoti kryetar, që t’i diskutojmë. Nuk po them që të mos votohet, as të anulohet krejt ai raport. Unë po them ta mbajmë një seancë, t’i ndihmojmë edhe ZRRE-së, edhe industrisë, edhe qytetarëve, edhe amvisërisë. Ndërsa, problemit që unë do t’i mëshoj, i kam mëshuar e do t’i mëshoj kësaj teme jo pesë herë, po edhe 50 herë, sepse kjo temë është për ta trajtuar.

Prandaj, unë nuk i bie pishman, problemi nuk është vetëm me “Ferronikelin”. Unë po flas në mënyrë gjenerale për krejt industrinë. Bëni sondazh, krejt industria ka të njëjtat probleme, kanë prodhuesit probleme me korrentin qoftë edhe nga ana e furnizimit që iu bëhet në mënyrë jokonstante, por kanë probleme edhe me çmimin, edhe me faturimin e çmimit. Prandaj, nuk po flas unë për një çështje të...

(Ndërprerje incizimi)

KRYESUESI: A po do edhe ti prapë të vazhdosh, a? Dy sqarime, një minutë.

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem, një minutë, mjafton përsëri. E para, sa i përket problemit të pagesave, te konsumatorët e përgjithshëm që e paguajnë barrën e konsumatorëve që nuk paguajnë, është rekomandimi në raport, kolegu mund ta shohë atë rekomandim.

Nën dy, sa u përket bizneseve, ekzistojnë rekomandime të Kuvendit që i ka propozuar komisioni për pozitën e bizneseve. Nën tre, problemi i “Ferronikelit” ka dalë më 2016, ky raport është për 2015. Prandaj, po më duket që vetëm po e keqpërdorim punën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Në fakt e kërkoja fjalën për raportin shumë më herët, para se të ndodhë ky debati për “Ferronikelin”. Është interesant qysh dy deputetë të partive që e konsiderojnë veten parti të djathta shtyhen cili është për më shumë që të subvencionohet me para publike sektori privat.

Kjo është e mirë që mendohet kështu, por është e keqe kur i drejtohet vetëm një ndërmarrjeje, siç është këtu kërkesa, pra një ndërmarrje e cila ka kapacitet që ta ndryshojë mendimin e njerëzve individualisht. Por, sidoqoftë mendoj që duhet të kthehemi te raporti dhe te çështja e energjisë në përgjithësi.

Te raporti i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sepse ky raport prapë sikur edhe viteve të tjera është shumë më i rëndësishëm në ato që nuk i thotë, se sa në ato që i thotë. Pra, në shumë aspekte të zhvillimeve goxha dramatike në sektorin e energjetikës në përgjithësi gjatë vitit 2015, raporti është i heshtur, është i heshtur, nuk thotë gjë. Pra, nuk thotë gjë së pari për marrëveshjen, e cila është nënshkruar më 25 gusht të vitit të kaluar, pra në vitin 2015, marrëveshjen për energjetikën. Si dhe, ky raport Zyra e Rregullatorit të Energjisë mjaftohet ta përmendë vetëm me 2-3 rreshta aty, ku tregon se si për shkak të moszbatimit të saj KOST-i ende nuk është anëtar i plotë në ENCO dhe, rrjedhimisht, edhe nuk mund t’i shfrytëzojë të gjitha ato të mira ose lehtësi që do të vinin nga një anëtarësim i tillë.

Nuk ka asnjë fjalë për kompaninë, e cila në marrëveshje është dakorduar që të themelohet për të ofruar furnizim dhe shpërndarje të energjisë elektrike për një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Përkundër faktit që aty, në marrëveshje mes të dy kryeministrave të dy vendeve, pra të Kosovës dhe të Serbisë, thuhet që ZRRE-ja do ta licencojë një kompani të tillë, ZRRE-ja këtu nuk e thotë asnjë fjalë të vetme, për këtë shkelje së pari flagrante që ia kanë bërë pavarësisë formale të kësaj Zyre të Rregullatorit të Energjetikës, sepse dy kryeministra, pra dy përfaqësues politikë të ekzekutivit të dy vendeve, i obligojnë Zyrën e Rregullatorit, e cila, po e përsëris, do të duhej të ishte formalisht e pavarur që ta licencojë një kompani. Kjo natyrisht që duke u bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare e përjashton plotësisht çfarëdo mundësia që ZRRE-ja do ta kishte për ta trajtuar seriozisht licencimin e kësaj kompanie në bazë të kriterëve dhe të kushteve teknike, por edhe ekonomike të licencimit të një kompanie të tillë.

Dhe, kjo ndërhyrje kaq flagrante në pavarësinë e ZRRE-së që nënkupton automatikisht ndërhyrjen shumë flagrante politike në tregun e energjisë elektrike, natyrisht që është një problem jashtëzakonisht i madh. Por nuk qenka fare për ZRRE-në, sepse në raport këta kanë zgjedhur të mos e përmendin asnjëherë këtë çështje. E dëmi që do t’i vijë Kosovës nga kjo marrëveshje për energjinë elektrike në mes të Kosovës dhe Serbisë tashmë është evident.

Përveç kësaj kompanie, kohët e fundit jemi dëshmitarë të pamundësimit të shfrytëzimit siç duhet të linjë 400 kilovoltëshe ose “autostradës energjetike”, siç është quajtur disa herë, të ndërtuar tashmë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për shkak të ndërhyrjeve të Serbisë, dhe prapë këtu ZRRE-ja nuk ka asnjë fjalë.

Pra, ZRRE-ja nuk na tregon, duke qenë pjesëmarrëse në negociatat në Bruksel për energjetikën, nuk na tregon në asnjë mënyrë se si mendon Kosova ta pavarësojë sistemin e vet energjetik nga Serbia. Po këtë edhe nuk mund ta thotë ZRRE-ja natyrisht, sepse në marrëveshjen për energjetikën me Serbinë, në fakt Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës,

kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka pranuar që sistemi energjetik i Kosovës praktikisht të bashkohet me atë të Serbisë.

Pra, në vend se të ndahemi nga Serbia në aspektin energjetik, me marrëveshjet e fundit, përveç që po përafrohemi me Serbinë në energjetikë, edhe po e bëjmë Serbinë pjesë të brendshëm të sistemit energjetik përmes kompanive shtetërore që po i licencen ose që po kërkohet nga ZRRE-ja t'i licencojë.

Një çështje e dytë po aq madhore, e cila është zhvilluar përgjatë vitit 2015, në heshtje, pa kurrfarë transparence, është edhe çështja e marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe fondit investiv "Kontor Global" për ndërtimin e kapaciteteve të reja të energjetikës ose të gjenerimit të energjisë elektrike. Dhe, në këtë drejtim prapë ZRRE-ja nuk e thotë asnjë fjalë të vetme, përveç në pikat 5.2 dhe 5.3, edhe 5.4, më falni, të raportit, ku përmenden që është arritur, thotë ka marrë në vendim, në fakt, Komiteti drejtues që kompania amerikane të shpallet fituese e preferuar, asgjë tjetër nuk na jepet.

Pra, vetëm ato që i kemi dëgjuar shkurtimisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, se sipas planifikimeve në fund të vitit 2016 apo në fillim të vitit 2017 do të fillojnë ndërtimet, asgjë tjetër nuk tregohet për këtë projekt. Pra, e kemi një projekt madhor për Kosovën, i cili natyrisht që do ta definojë sistemin energjetik në përgjithësi në Republikën e Kosovës, dhe për këtë Qeveria e Republikës së Kosovës asnjëherë nuk është denjuar as këtij Kuvendi, e as qytetarëve të Republikës t'u japë asnjë informatë që do t'i njoftonte për atë se çfarë po ndodh dhe ZRRE-ja e bën të njëjtën gjë.

Pra, si autoritet rregullator i pavarur i tregut, ZRRE-ja zgjedh ta ndjekë rrugën e Qeverisë për sa i përket këtij projekti, rrugën e mostransparencës. Dhe në këtë drejtim, pra ZRRE-ja këtu po e fsheh të vërtetën për këtë projekt, ndërkohë që do të duhej që t'i raportonte këtij vendi për këtë projekt, meqenëse edhe ky projekt ndodh në sistemin e energjetikës dhe në tregun e energjisë, që kjo do të duhej që ta monitoronte.

Pastaj, këtu ka një lloj, them unë, ose mungesë profesionaliteti ose, mbase, edhe mungesë etike, sepse për t'i fshehur gjërat shkojnë edhe shkruajnë kundër tij, ose kontradikta brenda vetë raportit dhe atë brenda të njëjtës faqe. Për shembull, këtu thotë që një prej arsyeve, te dizajni i tregut, te pika 5.3 e raportit thotë, një prej arsyeve, këtu janë renditur disa faktorë, pra një prej faktorëve që e pamundëson hapjen e tregut, pra liberalizimin e tregut, siç e quajnë këtu disa herë, e cila me Ligjin për energji në Republikën e Kosovës do të duhej të ndodhte që nga janari i vitit 2015, ku qytetarët, konsumatorët e Republikës së Kosovës do ta kishin mundësinë se prej kujt të furnizohen me energji elektrike, me çfarë çmimi dhe me çfarë cilësie. Dhe thotë, njëri prej faktorëve, pra kur renditen disa, si vartësia nga aeroporti, mungesa e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë elektrike, është edhe fleksibiliteti i pamjaftueshëm i njësive gjeneruese. Pra, kjo është një prej arsyeve pse tregu në Kosovë nuk mund të realizohet sipas raportit të ZRRE-së.

Dhe pastaj, në 5.4, në pikën pasrëndëse tek investimet në kapacitetet gjeneruese, tregon se si është shpallur "Control-Global" fitues i preferuar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese me kapacitet 450 MW. Dhe, asnjë fjalë nuk e thotë këtu ZRE-ja se si ky projekt vetëm sa do ta rrisë mosfleksibilitetin e njësive gjeneruese, pra do ta shtojë edhe më shumë problemin, siç e

quajnë këta “të liberalizimit të tregut”. Pra, këtu ka një kontradiktë të hapur, por unë nuk mendoj se është kjo kontradiktë, ose lëshim, mosprofesional, por që besa për të mos e treguar të vërtetën, këta kanë zgjedhur që të heshtin, të mos flasin fare për këtë çështje, të mos u tregojnë deputetëve nëpërmjet raportit dhe, rrjedhimisht, nëpërmjet Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës, se çfarë po ndodh me këtë projekt.

Projekti “Kosova e Re” është një prej projekteve më të dëmshme në të cilin do të hyjë Qeveria e Republikës së Kosovës, jo pse Kosova nuk ka nevojë për kapacitete të reja gjeneruese. Kosova ka shumë nevojë, sepse ne tashmë jemi duke u përballur me një krizë të thellë të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike, mirëpo përmes projektit “Kosova e Re”, mënyra se si është dizajnuar ai, çmimi i energjisë elektrike do të rritet pafundësisht në Republikën e Kosovës dhe me ndërtimin e këtyre kapaciteteve gjeneruese ai llogaritet të jetë, ose që do të jetë diku 50% më i shtrenjtë, se sa që paguajmë aktualisht.

Dhe, kështu do të vijmë në një situatë kur as ekonomia, e aq më pak amvisëritë e Republikës së Kosovës do të kenë mundësi që të kenë qasje në furnizim të rregullt me energji elektrike për shkak të çmimit të tij. Ky problemi që u diskutua deri tash, ndërmjet profesor Mustafës dhe deputetit Shqip Muja, vetëm sa do të rritet me ndërtimin e këtyre kapaciteteve të reja, sepse çmimi do të jetë shumë më i lartë dhe rrjedhimisht nuk do të jetë i leverdishëm për ekonominë e vendit.

Duhet ta kuptojnë të gjithë deputetët se mania, ose tendenca privatizuese në sektorin e energjetikës, natyrisht që e shndërron energjetikën në një mall komoditet shumë të shtrenjtë tregu dhe na pamundëson neve që të përdorim kapacitetet energjetike, pasurinë e resurseve energjetike për zhvillim ekonomik, sepse duke e privatizuar energjinë elektrike, ose edhe gjenerimin edhe shpërndarjen, atëherë çmimi i energjisë elektrike edhe është jashtë kontrollit tonë, por në anën tjetër edhe bëhet tepër i lartë për të mundësuar çfarëdo zhvillimi ekonomik të bazuar në një përparësi krahasuese, që e kemi te resurset e energjisë elektrike.

Pra, mënyra se si Qeveria e Republikës së Kosovës sot funksionon në sektorin e energjisë elektrike dhe mënyra se si ZRRE-ja, e ndikuar politikisht, pra me bord të anëtarëve politike, të cilët janë servilë karshi Qeverisë dhe që e dëgjojnë Qeverinë, po e trajton këtë sektor të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Shqip Muja, 2 minuta!

SHIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë nuk desha t’i përgjigjem zotit Visar Ymeri, mirëpo ne nuk jemi duke... ne jemi në Parlamentin e Kosovës dhe këto bisedime që i patëm me profesor Mustafën quhen diskutime demokratike dhe ne po zhvillojmë demokraci dhe nuk po instalojmë armiqësi. Dhe, këtë është mirë që edhe ju ta kuptoni, sepse jeni më të rinj edhe me moshë, edhe si deputetë. Keni filluar t’i kuptoni kohët e fundit, mirëpo çka kërkova unë, atë që bisedove ti dhe çfarë biseduan shumë deputetë të tjerë, ne ta shtyjmë këtë raport për një seancë të veçantë, sepse është shumë e rëndësishme që të mos votohet.

Prandaj, nuk kemi nevojë ta politizojmë në planin privat, sepse unë do ta kundërshtoj në çdo rrethanë, çdo gjë që unë e vlerësoj, ose me ata që më këshillojnë mua, për të diskutuar këtu, qoftë në nivelin e përfaqësuesve elektorale apo të qytetarëve, në përgjithësi.

Prandaj, ne nuk kemi, as unë personalisht nuk kam, asnjë armiqësi me asnjë individ, por do të diskutoj dhe do të zhvilloj debat, sa herë që mua më teket dhe ma merr mendja që e kam mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë e kam një çështje, e cila fare nuk është paraqitur në raportin e ZRRE-së dhe natyrisht se kjo çështje përbën jashtëzakonisht problem, sidomos për qytetarët që jetojnë në komunën e Obiliqit.

Për shembull, në bazë të raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, del se në vitin 2015 në komunën e Obiliqit dhe të Fushë-Kosovës, sëmundjet janë të rritura për 30%. Domethënë, ZRE-ja nuk e ka marrë mundin që të bëjë asnjë veprim apo të marrë ndonjë masë, sa i përket mbrojtjes së ambientit, e cila është në gjendje jashtëzakonisht të rëndë.

Domethënë, ZRRE-ja është dashur që të kërkojë nga KEK-u investime, sa i përket mbrojtjes së ambientit. Në ndërkohë, në qoftë se lexojmë raportin e ZRRE-së, nuk shohim një gjë të tillë. Natyrisht, që kjo paraqet problem jashtëzakonisht të madh për qytetarët që jetojnë edhe në Fushë-Kosovë, mirëpo edhe në Obiliq, e pse jo edhe në komunat tjera, duke e ditur se sa të rëndë e kanë jetën ata qytetarë që jetojnë atje.

Dua të theksoj faktin që edhe Avokati i Popullit e ka ngrehur këtë çështje në Prokurori, mirëpo deri më tani nuk e kemi parë asnjë veprim të prokurorisë sa i përket të njëjtës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Kalojmë në raportin e fundit:

12. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015 dhe Kuvendit i rekomandon që ta miratojë. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar këtë raport dhe i ka rekomanduar për miratim Kuvendit.

Fjalën e merr kryetarja e Komisionit Funkcional, Albulena Haxhiu, për ta arsyetuar raportin.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20. 6. 2016 e shqyrtoi raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015.

Në këtë raportim nga kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zonja Valdete Daka, anëtarët e Komisionit për Legjislacion shprehën shumë vërejtje dhe shqetësime të tyre, sa i

përket punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mirëpo edhe ato të cilat janë paraparë në raportin e KQZ-së.

Ndër problemet kryesore ishte problemi me mospastrimin e listave dhe nevojën për bashkëpunimin e komunave, sa i përket kësaj çështjeje, votimin e qytetarëve jashtë vendit e po ashtu, edhe me problemin kryesor që po vazhdon ta bëjë KQZ-ja, që po i lejon qytetarët serbë të jenë me dokumente të Serbisë, pa pasur fare dokumente të identifikimit të Republikës së Kosovës.

Më tutje, shqetësime tjera kanë qenë edhe për organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, ndonëse kjo mbetet përgjegjësi kryesore e kryeministrit Mustafa dhe të Qeverisë, mirëpo anëtarët e Komisionit për Legjislacion kanë shprehur shqetësimet edhe për këtë çështje, angazhimin e KQZ-së në auditimin financiar të subjekteve politike, ju i dini shumë mirë problemet që i kemi me financa të subjekteve politike, andaj deri më tani nuk është bërë asnjë auditim i mirëfilltë, se ku ose qysh po shpenzojnë paratë, ose ku po i marrin paratë subjektet politike.

Pra, këto janë disa nga çështjet të cilat janë diskutuar në Komisionin për Legjislacion. Për më tepër, deputetët e Kuvendit e kanë raportin e KQZ-së dhe natyrisht, që Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar Kuvendit që të miratohet raporti i punës së këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Për Komisionin për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani. Kush flet? Safete, s'je paraqitur. Unë po i lexoj disa emra të tjerë. Kush është i caktuar le të flasë, Safete Hadërgjonaj, ë? Ende s'ka Safete këtu të regjistruar, ka Selvije, ka...

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015, sipas të dhënave të cilat faktikisht, i kërkon Ligji për Komisionin Qendror Zgjedhor.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitet paraprake.

Buxheti fillestar i ndarë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015 ka qenë 5 329 718 euro, ndërkaq buxheti përfundimtar i komisionit ka qenë 5 272 642 euro, duke përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shkurtime, sipas vendimit të Qeverisë. Nga kjo shumë janë shpenzuar 5 228 118 euro, apo 99,16%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë: paga dhe mëditje 100%; mallra dhe shërbime 86,57%; shpenzime komunale 99%; dhe subvencione dhe transfero 99%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më datën 1. 6. 2016, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2015 vlerësoi se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike

dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta bëjë miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë me diskutuesit në emër të grupeve parlamentare. Për PDK-në, Selvije Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015 dhe në parim e përkrah këtë raport dhe gjithashtu kërkon nga institucionet e vendit që t'u përgjigjet sfidave, me të cilat po ballafaqohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Të gjitha këto sfida janë të theksuara në raportin e punës të KQZ-së për vitin 2015 dhe gjithashtu janë diskutuar edhe në komision dhe ky raport pastaj është diskutuar edhe në grup parlamentar. Sa u përket rekomandimeve që kryetarja e Komisionit Qendror Zgjedhor ka kërkuar për t'u ballafaquar dhe për të tejkaluar sfidat, të cilat po e pengojnë në njëfarë forme një punë më të suksesshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Rekomandimet e kryetares së komisionit i përkrah Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, të cilat kanë të bëjnë me:

- integrimin e sistemit unik të adresave në regjistrin civil, krijimin dhe qasjen, që duhet të shërbejë në qendra të votimit për personat me aftësi të kufizuara;
- pastaj të bëhet edhe auditimi i raporteve financiare të partive politike, trajnimin meritore të Komisionit Qendror Zgjedhor, si dhe të stafit mbështetës;
- caktimin e objektit me hapësirë më të madhe, në mënyrë që Komisioni Qendror Zgjedhor dhe stafi i tij të mund të kryejë punën e tij, që e ka të përcaktuar me ligj;
- ofrimin e mbështetjes nga ana e komunave për zyrtarët e KKZ-ve, nga se kjo po mungon deri më tash;
- definimin e qartë të së drejtës së votës për votuesit dhe të përcaktohet, se vetëm qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë edhe dokumente identifikimi të Republikës së Kosovës të kenë të drejtë votimi dhe këta duhet të jenë të regjistruar në regjistrin qendror civil; si dhe
- të krijohet mundësia që të sigurohet një hapësirë më e madhe për numërimin e votave, nga se sipas sfidave të KQZ-së, tashmë mund të merret hapësira që deri më tash është shfrytëzuar për dislokimin e fletëvotimeve dhe numërimin e tyre dhe të sigurohet hapësira, që në zgjedhjet e ardhshme të mos kemi këso problemesh.

Të gjitha këto rekomandime të kryetares së Komisionit Qendror Zgjedhor i përkrah PDK-ja dhe njëherësh kërkojmë nga institucionet e vendit, si nga Kuvendi ashtu edhe nga Qeveria, që t'u përgjigjet të gjitha këtyre sfidave dhe t'i plotësojë kërkesat e Komisionit Qendror Zgjedhor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për grupin e LDK-së flet deputeti Agim Ademi.

AGIM ADEMI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ky raport i plotëson kushtet që të shqyrtohet në këtë seancë. Ne mendojmë se duhet të aprovohet ky raport pune.

Dihet se nuk ka pasur zgjedhje gjatë vitit 2015, përpos zgjedhjeve të jashtëzakonshme në komunën e Graçanicës. Ka pasur disa masa që janë marrë në KQZ, ose disa përkrahje që ky komision ka pasur nga donatorë të ndryshëm, siç është USAID; IFES-i... për trajnime të ndryshme në këtë periudhë.

Sfidat, ose rekomandimet që i përmend kryetarja e KQZ-së, e që u thanë këtu nga kolegja ime qëndrojnë dhe Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah të njëjtat, me theks të veçantë që duhet të definohet saktë e drejta e votës, kush ka të drejtë vote në Republikën e Kosovës dhe a është në regjistrat civilë, që mund të votojë në zgjedhje.

Duhet pasur parasysh, gjithashtu që Komisioni që ka punuar më herët në pastrimin e listave zgjedhore, duhet të funksionalizohet. Pra, ky komision është nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të rifunksionalizohet dhe të punojë në pastrimin e listave zgjedhore.

Krejt në fund, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin e punës, është një raport që ka paraqitur mirë gjendjen në KQZ dhe i ftoj kolegët e mi që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja” janë tre të paraqitur. Në emër të grupit flet Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015. Meqë, po raportohet për vitin e kaluar dhe brenda raportit është përfshirë edhe procesi zgjedhor në komunën e Graçanicës, duhet të potencohet se në këto zgjedhje kanë votuar votuesit me dokumente të Serbisë. Si një shkelje e rëndë e legjislacionit, e sidomos si një shfaqje e ndërhyrjes së Serbisë dhe legjitimitimi që po i bëhet pranishë së saj edhe nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Domethënë, lidhur me këtë shkelje, KQZ-ja në vend që t’i ndalojë këto veprime, ajo në njëfarë mënyre i ka lejuar duke heshtur kundrejt kësaj dhe duke mos reaguuar për t’ua kërkuar që dokumentet e vetme valide për të votuar janë vetëm dokumentet e Republikës së Kosovës.

Unë edhe këtu nga zoti Ademaj e dëgjova, që është në pikëpyetje se kush ka të drejtë të votojë në Republikën e Kosovës. Unë besoj që edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës edhe Ligji për zgjedhje të përgjithshme e përcakton këtë qartë. Shqetësuese për mua mbetet deklarata e zonjës Daka, e cila thotë që ligji nuk e përcakton se cilat dokumente, të cilit shtet. Qasja e saj karshi pyetjeve dhe shqetësimeve të Komisionit për Legjislacion ka qenë e padrejtë, për shkak se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme është ligj për zgjedhjet në Republikën e Kosovës dhe natyrisht, që vetëm dokumentet e Republikës së Kosovës duhet të jenë dokumente të vlefshme për votim.

Në anën tjetër, raporti më tepër se sa për punën e KQZ-së për vitin e kaluar, flet për dështimin e KQZ-së për të përmirësuar operacionet zgjedhore me qëllim të garantimit të integritetit të zgjedhjeve. Në raport janë renditur si sfida dhe vështirësi cilësia e listës së votuesve dhe qasja e votuesve në qendrat e votimit dhe votimi jashtë Kosovës, ndërsa në brendësi të raportit shihet, se pothuajse nuk është bërë asgjë në drejtim të pastrimit të listës së votuesve dhe lehtësimit të mërgatës, që do të marrin pjesë në zgjedhje. Mirëpo, për këto të dyja çështje do të flasin deputeti Ismajl Kurteshi dhe deputeti Driton Çausi.

Më tej, është kjo KQZ e cila në dy palë zgjedhjet e fundit kishte përfshirë në listën e votuesve mijëra persona, të cilët ishin sjellë nga regjistri i Serbisë dhe me numra personal të letërnjoftimeve të Serbisë, gjersa është e papranueshme që Kosova me një mërgatë masive aktive dhe shumë e lidhur me vendin të kenë një pjesëmarrje kaq të ultë në zgjedhje, siç është rreth dymijë votues. Merreni me mend, 30% e popullsisë që jetojnë jashtë vendit, në ndërkohë vetëm dymijë votues e shfrytëzojnë këtë të drejtë, për shkak të procedurave burokratike të KQZ-së.

Pothuajse, asnjë projekt nuk është realizuar gjatë vitit të kaluar, edhe pse ka qenë një vit jozgjedhor, e që do të duhej të shfrytëzohej për realizimin e projekteve që e përmirësojnë administrimin e zgjedhjeve dhe sigurojnë integritetin e zgjedhjeve. Pjesa dominuese e raportit flet për vizita jashtë vendit e vëzhgim të zgjedhjeve nëpër vende të caktuara, të cilat përveçse i kushtojnë buxhetit shtetëror ato fatkeqësisht, nuk po i shërbejnë asgjë institucionit dhe proceseve zgjedhore.

Siç shihet edhe në raportin e shpenzimeve vjetore, pothuajse kategoria e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit reflekton shpenzime gati 100% të planifikimit, kjo kategori më së mirë reflekton qasjen dhe nivelin e këtij institucioni. Kur bëhet fjalë për mëditjet, për shembull, vetëm kryesuesja e KQZ-së, zonja Valdete Daka, vetëm gjatë vitit të kaluar nga të dhënat e deklaruara në Agjencinë Kundër Korrupsionit i ka marrë diku gjashtëmijë euro mëditje nga udhëtimet jashtë vendit apo mesatarisht mbi njëqind ditë qëndrim në udhëtime jashtë vendit, gjersa në këto udhëtime, së paku, nuk ka takuar asnjë organizatë të vetme të mërgatës për t'i informuar, se si të bëhen pjesë e zgjedhjeve në Kosovë. Domethënë, nuk ka takuar bashkatdhetarë për t'i informuar që sa më shumë të marrin pjesë në zgjedhjet që organizohen në Republikën e Kosovës.

Udhëtime të shumta dhe të paarsyeshme, natyrisht që kanë edhe anëtarët tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Domethënë, kjo dëshmon për një qasje të gabueshme të institucionit, ku përfitimet materiale vendosen para atyre operacionale dhe organizative. Në anën tjetër, mungon një mekanizëm i bartjes së përvojave apo të njohurive të përfituara nga këto vizita studimore dhe vëzhguese. Për më keq, në pjesën dërmuese të vizitave, as nuk përgatitet një raport, sado simbolik për qëllimin e vizitës, agjendën dhe gjetjet apo përfitimet nga vizitat.

Në kuadër të vizitave jashtë vendit është i pranishëm një fenomen shqetësues, që ka të bëjë me atë që pothuajse për çdo vit dhe më shumë se një herë realizohen punëtori jashtë vendit për punë shumë rutinë të KQZ-së, siç janë, për shembull, hartimi i planit të punës... të bëhen vizita jashtë vendit, mendoj se është e panevojshme. Mirëpo, edhe për ta bërë raportin vjetor, këto që po i shqyrtojmë ne në këtë seancë.

Përfundimisht, raporti më shumë se për punën e KQZ-së flet për atë se çfarë nuk është bërë dhe që, thuajse nuk është punuar asgjë në atë që konsiderohet si përgjegjësi parësore dhe thelbësore të KQZ-së, siç janë përgatitjet më të mira për organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Ismajl Kurteshi e merr fjalën, në të njëjtën kohë i thërras deputetët le të kthehen në sallë, se e kemi veç edhe një diskutues e do t'i votojmë të gjitha pikat.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në raportin e punës që e kemi në shqyrtim më tepër bëhet fjalë për zgjedhjet në komunën e Graçanicës, se sa për shumë probleme tjera dhe detyra të rëndësishme të komisionit, siç është përditësimi i listave të votuesve, që do të thotë heqja nga lista e personave që kanë vdekur, ose që kanë lëshuar Kosovën, gjegjësisht që e kanë humbur nënshtetësinë e Republikës së Kosovës ndërmjet dy palë zgjedhjeve, si dhe futjen në listë të atyre qytetarëve, që në mes të dy palë zgjedhjeve i kanë plotësuar kushtet për të votuar, ose për të qenë të votuar.

Edhe mërgata, e cila edhe ka kontribuar dhe po kontribuon shumë për mirëqenien e Kosovës dhe janë pjesë e këtij vendi, pothuajse është injoruar fare. Ata praktikisht janë përjashtuar nga e drejta për të votuar, ose për t'u zgjedhur, për shkak të moszgjidhjes adekuate të këtij problemi dhe krijimit të kushteve për ta që të votojnë për të zgjedhurit në këtë vend. Mospërditësimi i listave nga ana e KQZ-së nuk paraqet vetëm mungesë disipline dhe përgjegjësie në punë, për të cilën paguhen mu nga votues të ndershëm të këtij vendi, por çojnë edhe në falsifikimin e rezultateve zgjedhore nga votuesit, komisionarët e zyrtarë të tjerë të pandershëm.

Nuk janë të rralla rastet, kur në emër të të vdekurve, ose të atyre që me dekada janë larguar nga Kosova, votohet nga keqpërdorues të ndryshëm. Edhe pse, përditësimi i listave është shumë i rëndësishëm dhe njëra nga detyrat kryesore të Komisionit Qendror Zgjedhor, ky komision gjatë vitit 2015 përkundër faktit se ka formuar një komision për përditësimin e listave, nuk ka bërë asgjë konkrete në këtë drejtim, pra nuk është marrë me përditësimin e listave të votuesve, gjë që do të mundësojë që edhe në zgjedhjet e ardhshme të falsifikohen rezultatet. E kjo është një dëm i madh, që do t'i shkaktohet vendit nëse deri atëherë nuk do të ndërmerret asgjë.

Vlen po ashtu, të thuhet se viti 2015 në këtë drejtim nuk dallon shumë nga vitet tjera, sepse mospërditësimi i listave zgjedhore është problem që ndjek këtë vend që nga viti 2000. Mjafton të përmendet vetëm fakti, se në zgjedhjet e vitit 2014 numri i votuesve në lista për votim ishte pothuajse sa numri i përgjithshëm i qytetarëve, që do të thotë se aty ka pasur numër tepër të madh të atyre që objektivisht nuk kanë pasur mundësi të votojnë.

Me vite të tëra numërimi i votave zgjatë me javë në Fushë-Kosovë e KQZ-ja nuk ka ndërmarrë asgjë për sigurimin e teknologjisë, për zgjidhjen e këtij problemi dhe pakësimin e mundësisë për falsifikim të rezultateve. Prandaj, ia përkujtojmë KQZ-së edhe një herë, se Kushtetuta e Kosovës përveç tjerash e ngarkon për përgjegjësinë e krijimit dhe mirëmbajtjes së listave të personave, që kanë të drejtë të votojnë.

Ne kërkojmë që KQZ-ja të fillojë menjëherë me përditësimin e listave dhe këtë punë ta vendosë në prioritetet e sajë më të rëndësishme, përndryshe ajo do të bëhet përgjegjëse për moskryerjen e obligimeve të sajë kushtetuese dhe krijimin e kushteve për falsifikim të rezultateve të zgjedhjeve. Faleminderit!

KRYEUESI: Diskutuesi i fundit për këtë çështje është deputeti Driton Çausi.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të pranishëm,

Sipas shumë regjistrimeve rreth 30% e familjeve në Republikën e Kosovës, kanë të paktën një anëtarë e më tepër në mërgatë. E dimë të gjithë, që mërgata është e lidhur ngushtë me vendin e saj dhe ka dhënë një kontribut të madh ekonomik e politik, si në të kaluarën ashtu edhe tani.

Besoj se në këtë pikë pajtohemi të gjithë. Mërgimtarët tanë me të drejtë u pajisën me dokumente të Republikës së Kosovës, në mënyrë që ta vërtetojnë shtetësinë e tyre, por veçmas gatishmërinë e vullnetin për t'u angazhuar në jetën qytetare dhe politike të vendit.

Nuk ka dyshim, se të gjithë flisni fjalë të mira për mërgatën. Sigurisht, se ju pëlqen që vitin e kaluar kontributi i mërgatës së Kosovës kalon shifrën prej 10% të të ardhurave bruto të vendit tonë. Derisa Qeveria e Kosovës këtë vit ka ndarë 549 milionë euro për paga dhe mëditje, mërgata e Kosovës ka sjellë në vend mbi 700 milionë euro, pra shumë më shumë se sa të gjitha rrogat e paguara në sistemin tonë publik e që u përdorën kryesisht për të financuar mbijetesën në Kosovë, që u përdorën kryesisht për të siguruar bukën për familjarët e tyre, për të zëvendësuar sigurimet shëndetësore që nuk i kemi e për të siguruar drutë gjatë dimrit.

Ju pëlqen sigurisht, që mërgata u bë faktori kryesor i ruajtjes së paqes sociale dhe stabilitetit ekonomik në vendin tonë, por nuk ju pëlqen që ajo të votojë, nuk ju pëlqen që ajo të ketë ndikim në rrjedhat politike të vendit. Pra, ju pëlqen që mërgata të zbusë varfërinë, të financojë, të investojë, por e doni larg, sa më larg vendimmarrjes.

Pse nuk dëshironi që mërgimtarët e Kosovës të votojnë? Pse i përjashtoni nga e drejta elementare për të votuar?

Deri më tani numri i votuesve nga jashtë, që cilët kanë votuar përmes postës është sjellë rreth 2 000 - 2 500 votues. Duke pasur parasysh madhësinë e mërgatës, ky numër nuk shpreh as minimalisht, as vullnetin e as interesimin për të marrë pjesë në zgjedhje. Kur kemi parasysh se çfarë bëri mërgata në të kaluarën, çfarë dhe sa i madh ishte angazhimi i saj politik, nuk mund të thoni që ky vullnet mungon sot. Përkundrazi, ai është shtuar.

Arsyeja pse numri i votuesve është kaq i vogël qëndron në procedurat e komplikuar të votimit, në mungesën e informacionit dhe mbi të gjitha në mungesën e vullnetit dhe angazhimit institucional për ta shtuar këtë numër dhe për këtë fajtor dhe përgjegjësi kryesorë kanë dy partitë në pushtet.

Kjo mospërthuje e theksuar dhe e papranueshme në mes të madhësisë së mërgatës sonë, kontributit politik kombëtar e ekonomik dhe përfshirjes së tyre në zgjedhje është jashtë çdo parametri dhe standardi edhe ndërkombëtar për zgjedhjet.

Shumë vende me mërgatë shumë më të vogël, pa lidhje kaq të fuqishme me vendet dhe me kontribut shumë më të vogël kanë një pjesëmarrje shumë më të madhe në zgjedhje.

Andaj, pyetja që duhet të parashtrijmë të gjithë është se - pse kemi 2 000 deri 2 500 votues dhe si mund të qëndrojmë të qetë dhe indiferentë kundrejt kësaj të dhëne turpëruese për të gjithë institucionet e Republikës e veçanërisht për KQZ-në.

Këtë pyetje do të duhej ta parashtronte para se gjithash Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si institucion përgjegjës për t'u ofruar qytetarëve të Republikës mundësinë që të votojnë pavarësisht se ku ata jetojnë apo banojnë.

Çfarë ka bërë KQZ-ja gjatë vitit 2015 si vit jozgjedhor, kur ka pasur kohë të mjaftueshme për të ndërmarrë veprime e projekte që e thjeshtësojnë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e mërgatës sonë në zgjedhje. Më duket.... absolutisht asgjë.

Aktualisht qytetari i Kosovës që jeton jashtë vendit ka dy mundësi për të votuar fizikisht dhe duke ardhur në Kosovë ose të votojë përmes postës. Për të votuar përmes postës votuesi fillimisht duhet të regjistrohet pranë KQZ-së duke plotësuar një formular dhe duke i bashkëngjitur një numër dokumentesh që dëshmon se është person me të drejtë vote.

Mirëpo, a ka bërë KQZ-ja gjatë këtyre 12 muajve qoftë edhe një përpjekje për t'i vlerësuar shkaqet e kësaj pjesëmarrjeje të ulët, për të dizajnuar programe informimi e trajnimi për shoqatat e mërgatës për pjesëmarrje në zgjedhje, për t'u mundësuar përdorimin e teknologjisë dhe internetit në regjistrimin e mërgatës si votues për zgjedhjet e ardhshme.

Raporti i punës që kemi para vetes na tregon se KQZ-ja nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim, edhe pse në planin vjetor të punës së vitit për të cilin po raportojmë e kishte paraparë së paku zhvillimin e një aplikacioni online për regjistrimin e votuesve që jetojnë jashtë vendit.

Ku është aplikacioni online, pse nuk e keni bërë këtë? Pse nuk ndërmorët asnjë hap gjatë gjithë këtyre viteve për të nxitur e mundësuar pjesëmarrjen e mërgatës në zgjedhje? Pra, çfarë bëri KQZ-ja gjatë gjithë kësaj kohe?

Gjatë dy palë zgjedhjeve u angazhuar kundërligjshëm të mundësojë vota të orkestruara dhe të falsifikuara nga Serbia që kishin për qëllim zbarkimin e Serbisë në Kuvendin e Kosovës përmes Listës serbe. KQZ-ja kundërligjshëm dhe tërësisht në dëm të interesave shtetërore, siç u pa edhe më pas me politikat e Listës serbe, kishte dërguar ekupe të zyrtarëve që fizikisht të pranonin dhe grumbullonin dhjetëra-mijëra aplikacione dhe fletëvotime në Nish, gjersa votuesit shqiptarë nga mërgata nuk arrinin as të informoheshin me kohë për mënyrën dhe periudhën e votimit.

Kujtojmë këtu se vetëm me dy palë zgjedhjet e fundit ku ndërhyrja politike kishte karakterizuar këto zgjedhje kemi këto të dhëna të regjistrimit si votues jashtë vendit.

Në vitin 2013 nga gjithsej 41 158 aplikacione, 38 228 apo 92,85% ishin nga Serbia, ndërsa 2 940 nga mërgata shqiptare.

Në vitin 2014 nga gjithsej 29 745 aplikacione, 25 433 ishin nga Serbia respektivisht 85% e totalit të aplikacioneve për votim jashtë vendit.

Përderisa KQZ-ja kundërligjshëm grumbullonte aplikacione në Serbi, pothuaj se nuk bëri asgjë për të mundësuar pjesëmarrjen më të madhe të mërgatës në këto zgjedhje. Jo vetëm që nuk ka treguar kurrfarë ndjeshmërie ndaj mërgatës, por me gjithë afatin e shkurtër për aplikim shumë prej bashkatdhetarëve nuk arritën të dërgojnë formularët e tyre.

Ne konsiderojmë se pjesëmarrja e mërgatës në zgjedhje duhet të stimulohet në mënyra të ndryshme e sidomos duke thjeshtësuar procesin e regjistrimit dhe të votimit.

Përgjithësisht, regjistrimi i votuesve nga mërgata duhet të jetë më fleksibil dhe përveç aplikimit nëpërmjet postës, e-mail-it dhe faksit, atyre duhet t'u mundësohet regjistrimi online, duhet plotësuar një aplikacion duke e dërguar atë nëpërmjet internetit, e po ashtu, me këtë rast duhet t'u mundësohet edhe regjistrimi fizikisht dhe direkt në ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, edhe votimi i tyre duhet të kombinohet, përveç dërgimit të fletëvotimit përmes postës, duke u mundësuar edhe votimin në ambasada dhe konsullata.

Mërgata meriton trajtim më të dinjitetshëm, ashtu siç edhe ajo është, pra me më shumë përkushtim dhe më shumë solidaritet dhe dashuri ndaj vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I përfunduan diskutimet për këtë raport. Tash, meqë jemi në pikën e trembëdhjetë, pas kësaj do të kalojmë në votime dhe ta shqyrtojmë këtë propozim:

13. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e 5 Shtatorit - “Ditë të Bamirësisë Nëna Terezë”

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2016 ka vendosur që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqesë propozimin që data 5 shtator të shpallet “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” në Republikën e Kosovës.

Do t'ju sjell ndërmend se duke vlerësuar dhe nderuar jetën e veprën e humanistes dhe bamirëses shqiptare Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Terezë, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 17 dhjetor 2012 e ka miratuar Rezolutën për “Ditën Ndërkombëtare të Bamirësisë” - 5 Shtatori.

Unë kërkoj deklaratimet e shefave të grupeve parlamentare për këtë propozim të kësaj dite nga ana e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në emër të PDK, fjalën e ka zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje këtij propozimi dhe kësaj nisme, edhe pse e konsiderojmë si të vonuar, por populli thotë më mirë vonë se sa kurrë, prandaj jemi dakord që ta mbështesim dhe u bëj thirrje të gjithë deputetëve që të japin përkrahjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, e ka fjalën Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit nënkryetar!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet propozimin për shpalljen 5 Shtatorin “Ditë të Bamirësisë Nëna Terezë” dhe njëkohësisht i ftojme të gjithë deputetët që ta miratojnë këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zonja Puhije Demaku!

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta mbështesë këtë iniciativë të cilën e mirëpresim gjithsesi dhe ftojme të gjithë deputetët që ta votojnë këtë iniciativë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! Për grupet tjera parlamentare nuk ka të paraqitur.

Atëherë, fjalën e kanë deputetët. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se ky vendim është një nga vendimet shumë të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës, ndoshta jo krejt i mjaftueshëm por për nga rëndësia, një vendim shumë i rëndësishëm.

Natyrisht, besoj se do ta përkrahim të gjithë, sepse mendoj që s’ka arsye mos me përkrah por duhet përkrahur fuqimisht, bile-bile duhet të përkrahim edhe shumë gjëra tjera që lidhen me këtë vit shumë të rëndësishëm.

Pra, ky vit, siç dihet është shpallur me të drejtë vit i Nënës Terezë, për faktin se në shtator ne do të kemi shenjtërimin e Nënë Terezës.

Është një ngjarje historike, e veçantë për shqiptarët, por edhe një ngjarje për gjithë botën.

Në fakt, unë do të përqendrohem në një çështje për atë se sa ne po tregohemi të kujdesshëm si institucione dhe qeveritare dhe tjera rreth kësaj çështjeje.

Mendoj se nuk i kemi kushtuar kujdes të duhur institucional e shtetëror të gjitha aktiviteteve që janë bërë dhe po bëhen në funksion të shënimit të kësaj ngjarje të rëndësishme.

Para disa muajsh, siç e dinë shumica këtu, e ndoshta një pjesë edhe nuk e di, është inauguruar në Prishtinë himni i Nënës Terezë, në një koncert madhështor.

Në fakt, ky himn do të intonohet edhe në Ditën e Shenjtërimit të Nënës Terezë në Vatikan. Prandaj, duke e ditur se himni është një rëndësi e veçantë, ku janë angazhuar dhe janë pjesë e tij personalitete të shumta të jetës kulturore e tjera, në mes të cilave në radhë të parë sopranoja me famë botërore Inva Mula e tjerë, mendoj se Qeveria, Kuvendi por edhe institucionet tjera relevante urgjentisht duhet të ofrojnë përkrahjen e tyre për këtë ngjarje. Do të ishte e pafalshme dështimi i antonimit të himnit në Ditën e Shenjtërimit t'lumes Nënë Terezë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Shpallja e 5 shtatorit Ditë Ndërkombëtare e Bamirësisë, është një nder i jashtëzakonshëm të cilin padyshim se e ka merituar, që i bëhet mbi të gjitha popullit shqiptar, sepse Nënë Tereza është bijë e kombit shqiptar dhe nderimi që i bën OKB-ja Nënës Terezë duhet të shërbejë si kampanë mbi të gjitha për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendin e Shqipërisë që të jetë në nivelin e duhur e ndoshta do të duhej t'i kishte paraprirë këtyre lloj aktiviteteve dhe këtij lloji nderimi për Nënë Terezë.

Përveç mbështetjes që duhet ne t'i bëjmë si Kuvend, kjo natyrisht duhet të shoqërohet edhe me aktivitete të përgjithshme, jo vetëm për këtë vit që është shpallur si vit i Nënës Terezë, por çdo vit të ndahen fonde të caktuara, të përdoret kjo figurë me të nderuar të mbarë botës për të promovuar edhe vetveten si komb.

Sigurisht se këtë vit kjo edhe do të bëhet sepse bëhet shenjtërimi i Nënës Terezë nga Vatikani dhe këtë lloj diplomacie mbarë botërore po e bën ky institucion.

Mirëpo, unë dua të tërheq vërejtjen që Kuvendi i Kosovës deri tani asnjëherë nuk ka reaguar ndaj përpjekjeve të disa qarqeve të caktuara këtu në Kosovë, që fatmirësisht janë të vogël në numër qarqe radikale të cilët janë përpjekur të fyejnë figurën e Nënë Terezës. Po kështu, kemi pasur edhe disa incidente kur statuja e saj është përdhosur.

Ky Kuvend duhet të reagojë fuqishëm ndaj çfarëdo lloji veprimi të tillë dhe ndaj çfarëdo lloji gjuhe të tillë. Nënë Terezën e nderon mbarë bota, e si të mund mos ta nderojmë ne, kështu që dua t'i bëj thirrje Kuvendit që të jetë shumë më i përgjegjshëm herën tjetër, që të reagojë në momentin e duhur me një distancim total, por edhe duke kërkuar llogari në institucionet e Kosovës të cilët kanë për detyrë të merren me menaxhimin e incidenteve të tilla.

Edhe një herë, të gjithë ne duhet të ndjehemi të nderuar që i përkasim popullit të cilës i përket edhe Nënë Tereza. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë nuk përzihem sesi diskutojnë deputetët, por çështja është themelore, sepse do të marrim vendim dhe a jeni që kjo ditë të shpallet 5 Shtatori, kurse të tjerat, më vonë vijnë ato. Xhevahire Izmaqu e ka fjalën!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Propozimin e Kryesisë unë do ta përkufizoj me një shprehje, me një fjalë të urtë të cilën e kishte përdorur Nëna Terezë gjatë jetës së vet: “Ne s’mund të bëjmë dot gjëra shumë të mëdha, por ne mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe”.

Shpallja e 5 shtatorit “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” i jep krenari këtij Kuvendi. Ne po materializojmë vlerën tonë nacionale në një datë të caktuar, ku emri i Nënës Terezë na frymëzon, jo vetëm si politikë, por si shtet i rinë përgjithësi.

Në emër të saj, mbar bota flet për humanizmin. Ne nga sot me votën tonë obligojmë edhe të gjitha institucionet tjera në vend për përkushtim më të madh në humanen. Sigurisht edhe unë ndihem krenare që sot do të votoj për këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar!

Natyrisht se edhe unë, si koleget e mia të cilat ishin të shumta që diskutuan sot, i bashkëngjitëm përkrahjes për propozimin e shpalljes së 5 Shtatorit “Ditë të Bamirësisë Nëna Terezë” dhe mendoj që është një propozim tejet i qëlluar, aq më tepër që vjen pikërisht pak kohë para ceremonisë zyrtare të shenjtërimit të Nënës Terezë, e cila do të mbahet në Vatikan.

Kohë më parë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2012, përmes një Rezolutive, e ka shpallur pikërisht datën 5 shtator si ditë kur vdiq Nëna Terezë - Ditë të Bamirësisë. Sponsorizuesit e kësaj rezolutive, asokohe shteti shqiptar si dhe shumë shtete bashkërisht kontribuan që përmes kësaj rezolutive të shpallin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ditën 5 shtatori si Ditë të Bamirësisë, ndërsa mendoj që Kosova edhe pse nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara propozimin që të shpall datën 5 shtator si Ditë të Bamirësisë, mendoj se Kosova po i bën homazh të merituar aktivitetit si dhe trashëgimisë së Nënës Terezë, e njohur ndërkombëtarisht, si dhe e vlerësuar botërisht për përkushtimin dhe punën e saj gjatë tërë jetës në ndihmë të varfërve si dhe të njerëzve në nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit zoti nënkryetar!

Mendoj se u thanë të gjitha dhe ka mbetur pak të thuhet. Padyshim se ne e përkrahim pa asnjë rezervë këtë propozim dhe mendoj që na bën nderë edhe ne si Kuvend dhe kombit tonë se e kemi një personalitet aq të madh, aq të njohur që është sinonim i bamirësisë në gjithë botën.

Edhe unë mendoj se jemi vonuar pak, por megjithatë meqë sivjet është edhe shenjtërimi i Nënë Terezës, atëherë kjo ndërlihet disi.

Unë e kisha një ide që ne ta quajmë ndoshta jo dita e Nënë Terezës - “Dita e Bamirësisë”, por mendoj që meqë Nënë Tereza është e kombit tonë e ne duhet t’i kushtojmë pak më shumë rëndësi dhe hapësirë asaj, mendoj se do të ishte ndoshta më mirë që të jenë ditët e Nënë Terezës, ditët e bamirësisë dhe të mos jetë vetëm një ditë në vit por të jenë një 3 ditë dhe që të gjithë ata që dëshirojnë të mund të japin një kontribut pak më të madh për çështje bamirësie të njerëzve që kanë shumë nevojë.

Megjithatë, sido që të aprovohet, unë mendoj se është ide e mirë dhe se do ta përkrahim pa asnjë rezervë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit që e ka lypur fjalën për deklaram lidhur me çështjen, është deputetja Mexhide Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë 5 Shtatori tani e tutje do të na kujtojë se trashëgimia e saj do të mbetet gjallë dhe e pavdekshme.

Nëna Terezë është simbol i sakrificës, i vetëmohimit, i dashurisë njerëzore, simbol i modestisë.

Çfarë përfaqëson kjo datë për shqiptarët? Tashmë 5 shtatori nuk do të jetë vetëm datë kur bota e humbi Nënë Terezë, por datë në të cilën bota do të sensibilizohet për të bërë më shumë për të ndihmuar personat në nevojë.

Qëllimi i kësaj dite është që t'i shërbejë kujtimit të figurës së Nënës Terezë, të promovojë shembullin dhe veprën e saj në Kosovë dhe jashtë saj në shërbim të mbrojtjes së vlerës njerëzore dhe paqes që janë trashëgim i përbashkët universal.

Unë mendoj se te çdo grua shqiptare gjend diçka nga Nëna Tereze, pasi që ajo i ka dhënë gruas shqiptare kurajën, besimin, thjeshtësinë, forcën jo vetëm për të zgjidhur problemet por edhe për t'i ndihmuar njerëzit të cilët kanë nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Të tjerë s'kemi që duan të flasin për këtë çështje.

73 deputetë janë të pranishëm në sallë. Ju lus të përgatitemi të votojmë!

Pra, zotërinj deputetë, zonja e zonjusha - kolege deputete, do të vazhdojmë me votimin e propozimit të Kryesisë së Kuvendit që data 5 Shtator të shpallet "Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë" në Republikën e Kosovës.

Teknika të bëhet gati, votojmë tash!

Kanë votuar 61 deputetë dhe të gjithë janë për, s'ka kundër as abstenim.

Prandaj, konstatoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës me propozim të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës vendosi, që:

1. Shpallet 5 Shtatori "Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë" në Republikën e Kosovës;
2. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Faleminderit! Vazhdojmë me votime tjera dhe votojmë:

10. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015

Bëhemi gati dhe votojmë tash!

Janë të pranishëm 72 deputetë.

Kanë votuar 52, për kanë votuar 32, kundër 13 dhe 7 abstenime...

Zonja dhe zotërinj deputetë, ju e dini se me këtë qysh keni votuar, nuk bëni kurrgjë. Ju i asgjësoni të gjitha diskutimet, e unë ju kam diskutuar vëmendshëm, por kjo s'prodhon asgjë.

Nëse doni, unë e përsëris votimin, por mos më thoni pastaj pse e përsërite. Kjo s'thotë kurrgjë.

Pra, edhe një herë votojmë. Në daç e pranoni, në daç jo, por mosni kështu, sepse kështu do të thotë të hiqni dorë prej vetvetes me këtë që po e bëni.

Pra, teknika dhe deputetët bëhuni gati të votojmë edhe një herë dhe votojmë tash!

Kanë votuar prapë në mënyrën e vet, kanë abstenuar ashiqare një numër i madh dhe prapë janë 59. Unë po të kisha edhe një njeri që më zëvendëson, se i kam pasur nja tri fjalë. Nuk e kam ndërmend të flas sepse ju kam dëgjuar e kam mbajtur edhe shënime. Kjo i bie, dhe le t'më lejohej si deputet po flas, jo si kryesues se s'mund të dal atje.

Kjo i bie që krejt ato zonja e zotërinj çka thatë ju sot, kot e keni thënë. As që ju intereson fati i atij votimi. Mos i merrni individualisht, sepse emrat i keni të shkruar atje, kështu që unë kam të drejtë të shpreh mendimin dhe mendimi im është ky dhe nuk fle vetëm për këtë, por edhe për të tjerat që ju po zhvillonin gjëja polemika për substanca dhe kur vjen puna e vendosjes ju s'jeni as për, as kundër, as abstenim - në hava.

Vazhdojmë për të votuar raportin tjetër:

12. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015

Ju lutem, bëhuni gati, dhe votojmë tash!

Kanë votuar 65 deputetë për raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 53 janë për, 6 kundër dhe 6 kanë abstenuar.

Konstatohet se me shumicë votash kalon raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015.

Tash kalojmë në votimin e raportit tjetër:

11. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim dhe votojmë tash!

Kanë votuar 55 deputetë.

A doni të provojmë të votojmë edhe një herë. Është e drejtë juaja, e unë nuk insisto, por para kësaj kërkoj të dimë praninë e deputetëve në sallë nëpërmjet elektronikës.

Të pranishëm janë 72 deputetë, kurse kartela nëpër tavolina, janë 81.

Edhe një herë, a doni të provojmë ta votojmë këtë raport.

Është raporti i Zyrës së Rregullatorit për Energjinë për vitin 2015, dhe votojmë tash!

Kanë votuar 71 deputetë. Për janë 30, kundër 21 dhe kanë abstenuar 20, nuk kalon.
Faleminderit!

Po vazhdojmë të votojmë për 1 anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky është votimi i dytë, sepse herën tjetër s'ka fituar askush.

Sipas Rregullores, anëtarët e Komisionit le të marrin vendet dhe të shkojmë drejtpërdrejt në votime.

(Ndërprerje e incizimit)

Përbërja e Komisionit është: Emilija Rexhepi, Besa Gaxherri, Mytaher Haskuka, Nenad Rashiq dhe Qerim Bajrami.

Ju lutem, “Vetëvendosja” a ka ndonjë anëtar tjetër? Haskuka mungon!

(Ndërhyrje)

Po unë, ftova anëtarët e Komisionit. LDK-ja, a ka anëtar në vend të zonjës Gaxherri? Urdhëro Salih!

SALIH MORINA: Për mungesën e deputetes Besa Gaxherri, e propozon deputetin Veton Berishën.

KRYESUESI: Veton Bersiha, a është i pranishëm? Atëherë unë filloj t'i ftoj deputetët për votim. Materialet i keni para veti.

Abdyl Ymeri, Adem Brabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurtishi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku,

Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Gutaj-Veselaj, Margarita KadriuUkelli, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Millka Vuletiq, Mirjea Kalludra, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sergjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha dhe Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: Urdhëroni, kryetare e Komisinit!

EMILIJÀ REDŽEPI: Hvala! Na osnovu člana 108, stav 6 tačka 3 Ustava Republike Kosova, člana 5 Zakona Br. 05/L-033 o izmenama i dopunama Zakona Broj 03/L-223 o Sudskom savetu Kosova kao i člana 51 Poslovnika Skupštine, Komisija za ocenjivanje koja je formirana Odlukom Skupštine 8. Jula 2016. Godine donela je sledeću:

ODLUKU

- Na glasanje je izašlo 61 poslanik.
Sada ćemo videti kakav tok glasanja će teći:

Učešće su uzeli 2 kandidata, iz redova Srpske zajednice, Nenad Lazić i Bogoljub Staljetović.

Sada ćemo brojati glasove:

Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Bogoljub Staljetović,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,

Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Bogoljub Staljetović,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Bogoljub Staljetović,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić,
Nenad Lazić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nevažeći listić,
Nenad Lazić.

Potpredsedniče, sada ćemo da prebrojimo glasove.

KRYESUESI: Urdhëroni, na e prezantoni raportin Komisionit.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala vam gospodine predsedavajući! Na osnovu prebrojenih glasova, Nenad Lazić je dobio 38 glasova, Bogoljub Staletović, 3 glasa, dok nevažećih glasova je bilo 20.

Na osnovu rezultata glasova, u skladu sa članom 108 stav 6, tačka 3 Ustava Reopublike Kosova, člana 5 Zakona Broj 05/L-033 o izmenama i dopunama Zakona Broj 03/L-223 o Sudskom savetu Kosova, kao i člana 51 Poslovnika Skupštine, konstatuje se da je gospodin Nenad Lazić izabran za člana Sudskog saveta Kosova iz redova Srpske zajednice na mandat koji traje 5 godina. Čestitamo!

Zahvaljujemo se predsedniče!

KRYESUESI: Faleminderit zonja kryetare e Komisionit! Atëherë, në bazë të rezultatit të votimit të rundit të dytë, kandidati që ka marrë më së shumti vota për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është Nenad Laziq i cili i ka fituar 38 vota.

Prandaj, konstatoj se Kuvendi, në bazë të rezultatit të votimit, e zgjodhi zotin Nenad Laziq anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb, me mandat pesëvjeçar.

Me kaq përfundon punën kjo seancë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*